Metodat e hulumtimit të cilat janë përdorë për identifikimin e virusit Covid 19 ne qytetin e Gjilanit, përmes testeve: PCR dhe antigjen, janë; gjurmimi i rasteve në terren nga institucionet shtetërore përgjegjëse, dhe paraqitja vullnetare e qytetarëve për ti bërë testet vlerësuese për gjendjen e tyre. Certifikimin dhe zyrtarizimin e të këtyre testeve e ka bërë instituti më kredibil i Kosovës; Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK-ja).
Nga numri i testeve që kanë rezultuar pozitiv nga pandemia Covid 19, kemi nxjerr edhe numrin e vdekjeve te qytetarëve nga të infektuarit.
Gjithashtu, nga këto rezultate, e kemi nxjerr edhe numrin e vdekjeve nga pandemia Covid 19, sipas grup moshave nga: 0-20, 20-40, 40-60, 60-80, dhe mbi 80 vjeç.
Për ta vlerësuar gjendjen sa ma reale te ndikimit nga pandemia Covid 19 ne qytetaret e Kosovës, do te marrim edhe rezultate nga disa qytete tjera te vendit tone, qe ti analizojmë dhe vlerësojmë efektet e shëndetit publik ndaj qytetareve nga kjo pandemi. Për grup moshat, krahasimin do ta bëjmë me qytetin e Fushe Kosovës. Ndërsa, me qytetin e Drenasit, do ta krahasojmë, numrin e testeve pozitive dhe negative, pastaj numrin e testeve ne raport me banoret, dhe numrin e te infektuarve ne raport me testet e bëra dhe me numrin e banoreve.

## Rezultatet:

| Muajt | mars | prill | maj | qershor | korrik | gusht | shtator | tetor | nëntor | dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Testet | 145 | 350 | 485 | 409 | 591 | 719 | 862 | 1465 | 1870 | 1085 | 7981 |
| Pozitiv | 15 | 36 | 32 | 99 | 301 | 366 | 172 | 492 | 1190 | 450 | 3153 |
| Negative | 130 | 314 | 453 | 310 | 290 | 353 | 690 | 973 | 680 | 635 | 4828 |
| Vdekjet | - | 11 | 1 | 5 | 14 | 15 | 7 | 9 | 22 | 23 | 107 |
| % e rasteve pozitive ne raport me testet | 10.3 | 10.2 | 6,59 | 24.2 | 50.9 | 50.9 | 19.9 | 33.5 | 63.6 | 41.4 | 39.5 |
| % e rasteve negative ne raport me testet | 89.6 | 89.7 | 93.4 | 75.7 | 49.0 | 44.6 | 80.0 | 66.6 | 36.3 | 58.5 | 60.5 |

Tabela 1. % e rasteve pozitive dhe negative ne raport me numrin e testeve për periudhën mars-dhjetor 2020.




Grafikon1.

Ne kete grafikon eshte paraqitur % e rasteve pozitive dhe negative ne raport me numrin e testeve për periudhën mars-dhjetor 2020, ne qytetin e Gjilanit.




Grafikon1.1

Grafikoni 1.1 paraqet % e rasteve pozitive dhe negative ne raport me numrin e testeve për periudhën mars-dhjetor 2020, ne qytetin e Gjilanit

| Muajt | mars | prill | maj | qershor | korrik | gusht | shtator | tetor | nëntor | dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| % e testeve te bëra ne raport me nr. Banoreve | 0.26 | 0.64 | 0.89 | 0.75 | 1.08 | 1.32 | 1.58 | 2.70 | 3.44 | 2.00 | 14.7 |
| % e rasteve pozitive ne raport me nr. Banorëve | 0.02 | 0.06 | 0.05 | 0.18 | 0.55 | 0.67 | 0.31 | 0.90 | 2.19 | 0.82 | 5.8 |
| % e rasteve negative ne raport me nr. Banoreve | 0.23 | 0.57 | 0.83 | 0.57 | 0.53 | 0.65 | 1.27 | 1.79 | 1.25 | 1.17 | 8.9 |

Tabela 2. % e testeve te rasteve pozitive dhe negative ne raport me numrin e banoreve ne qytetin e Gjilanit




Grafikoni 2.

Grafikoni 2 paraqet % e testeve te rasteve pozitive dhe negative ne raport me numrin e banoreve ne qytetin e Gjilanit, per perudhen mars-dhjetor 2020.

| Muajt | mars | prill | maj | qershor | korrik | gusht | shtator | tetor | nëntor | dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| % e vdekjeve ne raport me testet pozitive | - | 30.5 | 3.12 | 5.05 | 4.65 | 4.09 | 4.06 | 1.82 | 1.84 | 5.11 | 3.39 |
| % e vdekjeve ne raport me numrin e banoreve | - | 0.02 | 0.001 | 0.009 | 0.025 | 0.027 | 0.012 | 0.01 | 0.040 | 0.042 | 0.19 |

Tabela 3. % e vdekjeve ne raport me testet pozitive dhe numrin e banoreve ne qytetin e Gjilanit, per periudhen mars-dhjetor 2020.




Grafikoni 3.

Grafikoni 3 paraqet % e vdekjeve ne raport me testet pozitive ne qytetin e Gjilanit, per periudhen mars-dhjetor 2020.




Grafikoni 3.1 .

Grafikoni 3.1 paraqet % e vdekjeve në raport me numrin e banorëve ne qytetin e Gjilanit, per periudhen mars-dhjetor 2020..

| Grup moshat | 0-20 | 20-40 | 40-60 | 60-80 | mbi 80 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| % e vdekjeve sipas grup moshave Gjilan | 0.934 | - | 14.95 | 68.22 | 15.88 | 100% |
| % e vdekjeve sipas grup moshave Drenas | 0 | 3 | 18 | 64 | 15 | 100% |

Tabela 4. % e numrit te vdekjeve sipas grup moshave Gjilan-Drenas.




Grafikoni 4.

Ne kete grafikon eshte bere krahasimi i vdekjeve ne perqindje, sipas grup moshave për qytetet: Gjilan-Drenas.

## Diskutimi

Duke i ‘u referuar rezultateve nga Pandemia Covid 19, për periudhën mars-dhjetor 2020, ne qytetin e Gjilanit, të prezantuara përmes tabelave dhe grafikeve përkatëse, në vazhdim do ta bëjmë diskutimin e këtij hulumtimi.

Ne gjithë globin, Pandemia Covid 19, po ka një efekt shume te madhe ne shëndetin publik, duke shkaktuar edhe shume vdekje. Nga këto efekte është prekur edhe qyteti I Gjilanit.
Ne periudhën sa është bere hulumtimi ne këtë qytet, janë realizuar gjithsejtë 7981 teste, apo 14.71% e qytetareve të testuar. Nga këto matje, kanë rezultuar 3153 raste pozitive me Covid 19, apo 39.5%, dhe 4828 raste negative, me Covid 19, apo 60.5 % e të testuarve. Ne raport me numrin e banoreve, qytetaret e Gjilanit, kane rezultuar pozitiv me 5.8%, ndërsa negative me 8.9 % .
Infektimi i qytetareve nuk ka qene i njëjte neper muaj, sepse ne muajt: korrik, gusht, nëntor dhe dhjetor, kemi pasur numër me te madhe te qytetareve te infektuar. Ne muajin korrik, kemi pasur 301 raste pozitive, apo 50.9 % ne raport me testet bëra, ne muajin gusht, kemi pasur 366 raste pozitive, apo 50.9 % ne raport me testet e bëra, ne muaj nëntor, kemi pasur 1190, apo 63.6 % ne raport me testet e bëra dhe ne muajin dhjetor, kemi pasur 450 raste pozitive, apo 41.4 % ne raport me testet bëra. Muaji me numër ma te madh te infektuar është nëntori.
Nga infektimet me Covid 19, ne qytetin e Gjilanit kane vdekur 107 qytetar, apo 3.39%, prej atyre qe kane rezultuar pozitive nga testet e bëra, ndërsa ne raport me numrin e banoreve, vdekshmëria është 0.19% Edhe numri i vdekjeve nuk kane qene i njëjta neper muaj. Numër me te madh te vdekjeve ka pasur ne muajt: prill 30.5 % , qershor 5.05 % dhe ne dhjetor 5.11%. Edhe sipas grup moshave I kemi analizuar dhe vlerësuar vdekjet ne këtë qytet. Prej 0-20 vjet, kemi 1 vdekje, apo 0.934%, prej 20-40, nuk kemi asnjë vdekje, prej 40-60, kemi 16 vdekje, apo 14.95 %, prej 60-80, kemi 73 vdekje, apo 68.22% dhe mbi 80 vjet, kemi 17 vdekje, apo 15.88%. Pra, vdekshmëria me e larte është te grup moshat 60-80 vjet.
Për te pare gjendjen e grup moshave edhe ne një qytet tjetër, kemi marre rezultatet e qytetit te Drenasit, dhe sipas ( Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna Drenas, raporti 2020)[ix],ne këtë qytet kem: 0-20 vjet , nuk kemi asnjë rast, prej 20-40, kemi 3% te vdekjeve nga te infektuarit, 40-60, kemi 18% te vdekjeve nga te infektuaret,60-80, kemi 64%, te vdekjeve nga te infektuarit, dhe mbi 80 vjeç, kemi 15%, te vdekjeve nga te infektuarit.
Ne qytetin e Gjilani, kemi një vdekje te një fëmijë, ndërsa te qyteti i Drenasit, kemi 3% te vdekjeve te grup moshat 20-40 vjet. Me se shumti vdekje kemi te të dy qytet ne grup moshën 60-80 vjeç.
Për ti vlerësuar efektet ne shëndetin publik nga Pandemia Covid 19,kemi marre edhe qytetin e F. Kosovës, me 34.718 banore (http://www.wikiwand.com/sq/Fush%C3%AB_Kosova)[x].
Ne këtë qytet, sipas ( QKMF, Komuna e Fushe Kosovës, raporti 2020)[xi] nga Covid-19, janë testuar 4678 qytetar. Prej këtyre testeve, 2217 kane rezultuar pozitiv, apo 47.3%, ndërsa 2461 negativ, apo 52.7%. Ndërkaq, ne qytetin e Fushe Kosovës janë testuar 13.47 % e qytetareve.
Ne periudhën mars-dhjetor 2020, ne këtë qytet kane vdekur 30 qytetare, apo 1.35 % nga te infektuarit, ndërsa 0.08 %, ne raport me numrin e banoreve.
Duke bere krahasimin e vdekjeve ne dy qytetet, shifet se ne qytetin e Gjilanit, ka pasur me shume vdekje, ne krahasim me qytetin e Fushe Kosovës.
Pas analizave dhe vlerësimeve te bëra, nga ky hulumtim, kemi ardhur ne përfundim se; aty ku ka pasur popullate me te madhe, mundësia e përhapjes se virusit Covid-19, ka qene me e madhe.
Duke përfunduar këtë punim hulumtues, mund te konstatojmë se, nga Pandemia Covid 19, efektet ne shëndetin publike ndaj qytetareve kane qene te medhaja, me simptoma kryesore: ethe, koll, gulçim dhe dhembje muskujve, (https://sq.wikipedia.org/wiki/COVID-19)[xii], dhe ne shumicën e rasteve kane përfunduar edhe me fatalitet.

# Diskursi komunikologjik i revistës “Edukata islame” në epokën digjitale

**Prof. Asst. Dr. Rexhep Suma**

Profesor në Kolegjin AAB-Prishtinë- Fakulteti komunikimit masiv dhe gazetarisë

## Abstrakt

Revista fetare, kulturore e shkencore “Edukata Islame” tashmë ka lënë gjurmë të thella e të pashlyera në historinë e letrave të shtypit religjioz në Kosovë dhe jo vetëm. Ajo me anë të urtësisë së artikujve të saj ka ndikuar në mbjelljen dhe shpërndarjen e vlerave të dhe identitetit tonë kombëtar Bashkësia Islame e Kosovës, si komunitet fetar, e nis jetën e tij duke i dhënë një rëndësi të veçantë sferës së komunikimit media ku me anë të botimit të revistave të saj ka përçuar zërin e vlerave tradicionale dhe mesatare tek audienca shqiptare. Temat që janë shtjelluar në atë kanë pasur në fokus mësimet pedagogjike (religjioze) të cilat janë bazuar në mësimet dhe vlerat fetare. Andaj edhe lexuesi gjatë shfletimit të kësaj reviste kanë artikuj të mjaftueshëm, bashkëkohor dhe të nevojshëm për ngritjen dhe formimin e tyre intelektual duke pasur për bazë “Edukatën islame” si frymëzim për vlera dhe tolerancës ndërfetare. Madje jo vetëm kaq por si revistë ajo tashmë është bërë edhe subjekt trajtimi e studimi në shkallët akademike duke filluar që nga niveli i studimeve themelore (bachelor) e deri tek studimet e doktoratës. Mes revistave fetare të botuara në Kosovë ajo përbën një model më vete por përbën një model mjaft interesant studimor. Publiku komunikon me institucionet e tij në mënyrë të ndërmjetësuar përmes “Edukata Islame” me një gjuhë që është e tija, pra e thjeshtë, e kuptueshme, por jo e thjeshtëzuar.

Është një komunikim që krijon njëherësh vetveten si kod komunikimi dhe komunitetin e përdoruesve të këtij kodi, komunikuesit besimtarë.

**Fjalëkyqe:** media, kod komunikimi, mësime burimore, identitet, vlera globale.

## HYRJE

Qëllimi kryesor i trajtimit të kësaj teme është njohja objektive e rolit që kanë luajtur shtypi dhe periodiku fetar në përgjithësi e “Edukata Islame” në veçanti në aspektin identitetit e formimit të drejtë kombëtar, kulturor, arsimor, shoqëror e religjioz të shqiptarëve të Kosovës dhe më gjerë.

“Për këtë qëllim Islami që nga paraqitja e tij, komunikimit dhe informimit i kushtoi rëndësinë që ai e meriton, qoftë në shtrirjen e misionit dhe të qëllimeve të tij gjatë ndërtimit të shoqërisë së re apo edhe gjatë dialogimit me ato forca, që kishin mendim të kundërt.”[1]

Sigurisht që edhe informimi fetar në gjuhën shqipe synon të arrijë qëllime të larta njerëzore që në shoqëri rrezatojnë dobi dhe mirësi.

Misioni i informimit fetar synon të qartësojë të vërtetën islame për t’u ngulitur në shpirtrat e njerëzve dhe për t’i fisnikëruar ata. Po ashtu kultivohet edhe kultura fetare islame si dhe reflekton dhe përçon botëkuptime dhe koncepte të shëndosha dhe paqësore tek masa apo xhemati. Ajo që mbetet parim parësor i këtij informimi është fakti se kultivon vlera dhe etikë të lartë. Fundja, feja ngrihet mbi besim të pastër dhe dialog. Tekstin e parë të shenjtë që zbrit Zoti në Kur’an është “Ikre”, që në gjuhën e bukur shqipe do të thotë ”Lexo, mëso, studio, hulumto”.

Që nga dalja e saj më 1970, kishte në fokus konsolidimin e identitetit tonë fetar e kombëtar. Gjatë këtyre dekadave shtypi u pa si një nga nevojat e brendshme mbarëkombëtare për theksimin e atyre tipareve që i përbashkonin shqiptarët

[1] Morina, Q.(2005). *Roli dhe misioni i informimit në Islam,*Shtypi islam, dje, sot dhe nesër, Prishtinë, p.257.

dhe ruajtjen e identitetit fetar nga ndikimet dhe kanosja nga regjimi i ish-Jugosllavisë së Tito-s.
Marrë në tërësi, revista “Edukata Islame” ka ndikuar në ngritjen, formimin fetar e kulturore të shqiptarëve, si zë shumë i fuqishëm e i patrembur në kuadër të mbrojtjes të përcaktimit tonë fetar dhe kombëtar për liri dhe pavarësi; ka krijuar edhe gjenerata që i kanë sintetizuar njohuritë fetare në një unitet atdhedashurinë dhe përkushtimin fetar si dy përbërës, që nuk mund të ecin pa njëri tjetrin në rrugën e zhvillimit të një kombi, dhe sigurisht që kanë ruajtur edhe raportet me atdheun dhe lirinë, duke vënë në pah kontributin e tërë atyre punimeve shkencore dhe mendimit që do të bëhej edhe ndërgjegjja e nesërme e kombit tonë shqiptar.
Në këta numra të parë kontribuuan penda të ndritura si myderriz Sherif Ahmeti, Hajrullah Hoxha Qemajl Morina, Nexhat Ibrahimi, Sabri Bajgora, Bajrush Ahmeti, etj. Kryeredaktori i parë i “Edukatës Islame” ishte myderriz Sherif Ahmeti, i cili kishte një vizion të qartë se si duhej të ecte revista me publikun dhe si të komunikonte me masën e gjerë dhe me përkushtim të madh e shndërroi në tribunë e zëdhënëse të vërtetë të kultivimit dhe mësimit të mendimit islam në Kosovë si dhe në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi. Në këtë medie deri në fillim të viteve të nëntëdhjetë trajtoheshin vetëm tema nga shkencat fetare, si: tefsir, akaid, ahlak, hadith, fikh, histori islame, filozofi, sociologji etj.
Një vend të veçantë tek “Edukata Islame” kanë zënë përkthimet e kokave të mendimtarëve islamë, si Muhamed Gazaliu, Muhamet Tantavi, Jusuf Kardavi, Mustafa Mahmud, Husein Xhozo, Sinanudin Sokoloviç, Hasan Kaleshi, Enes Kariçi etj.
Në vitet e nëntëdhjeta “Edukata Islame” merr një dimension tjetër përtej atij fetar, duke trajtuar artikuj nga mendimi kulturor, arsimor, historik dhe shkencor. Pra, vërehet një hapje dhe pranim i temave edhe nga fusha të tjera që nga numrat 55 dhe 64, duke u identifikuar si revistë fetare, shkencore e kulturore. “Sikurse në vitet nëntëdhjetë ku e tëra u vu në funksion të informimit të opinionit. Si të thuash e mori rolin e një reviste informative,ku denonconte dhe informonte për dhunën që pushteti serb ushtronte mbi shqiptarët”.[2]

Edukata Islame më 1971 botohej si organ i Shoqatës Ilmije në Prishtinë, për të vazhduar deri në (nr.61-62) të vitit 1997. Ndërsa prej numrave 63-64 të vitit 1998 e deri më sot del si organ i Kryesisë së BI të Kosovës. Iniciator i kësaj nisme dhe kryeredaktor i parë, ishte mulla Sherif ef. Ahmeti, myderriz i shumë brezave, që kaluan nëpër duart e tij në Medresenë ‘Alauddin” të Prishtinës. Me këtë hap u vu edhe themeli i periodikut dhe publicistikës islame kosovare. Kryeredaktori i dytë ishte Hajrullah ef. Hoxha që nga numri 50-54, prej vitit 1988-1990, edhe pse ishte për një kohë të shkurtër ai prapë mbetej shtylla e revistës, krah i djathtë i të gjithë kryeredaktorëve si dhe ishte prezent me shkrimet e tij. Kryeredaktor i tretë ishte Resul ef. Rexhepi i cili e udhëhoqi atë prej numrit 55 deri në 64, prej vitit 1992-1998) ku revista gjatë kësaj kohe u pasurua si në aspektin përmbajtësor, por edhe e ndryshoi formatin e saj, duke hyrë në mesin e revistave islame bashkëkohore. Kryeredaktor i katërt ishte Prof. Qemajl Morina që udhëhoqi me revistë që nga nr.65 e vitit 2001 e deri në nr.111 (2016)
Kryeredaktori i pestë është Prof. Sabri Bajgora që është duke udhëhequr me revistë që nga viti 2016 kurse nr.112 ka dalë më 2018. Revista “Edukata islame” është tribunë e shprehjes së mendimit islam dhe përgjatë këtyre pesë dekadave deri më tani mbetet arkiv i gjallë i kulturës sonë islame. Ajo është kronika më e mirë e kulturës dhe jetës sonë shpirtërore dhe si e tillë asnjë studiues i kësaj fushe nuk mund të mos ta ketë referencë shkencore-fetare ”Edukatën Islame”.
Edhe pse në fillim zotëronin kryesisht përkthimet nga gjuhë të huaja e në mënyrë të veçantë nga boshnjakishtja, siç ishin revistat "Gllasnik- Preporod" etj., pati edhe përkthime nga gjuha arabe e më vonë dhe nga anglishtja. Por, nuk ishin të pakta temat origjinale nga autorë shqiptarë. Kështu revista nga numri në numër zgjeronte tematikën, shtonte bashkëpunëtorët, ngrinte cilësinë e materialeve, shtonte vëllimin e përgatitjen teknike, gjuhësore e estetike. Meritë kryesore për këtë ka pasur redaksia me redaktorin përgjegjës mulla Sherif Ahmetin në krye, për dy dekada të tëra (deri në vitin 1987) (nr. 49). Përmbajtja kryesore ka qenë ajo fetare, duke pasur për bosht komentimin e librit të shenjtë, Kur'anit, jetën e të dërguarit Muhamed (a.s.) dhe historinë islame. Dhe kjo me studime origjinale dhe përkthime. Angazhimi i bashkëpunëtorëve ka qenë i përkushtueshëm. Ata kanë qenë autoritete fetare, pedagogë në medrese, intelektualë, nxënës të medresesë, studentë në universitete të ndryshme islame. Revista nuk kishte rubrika të veçanta që udhëhiqeshin nga njerëz të caktuar, por ato plotësoheshin sipas materialeve. Kishte raste kur një autor paraqitej në

[2]Tërnava, N. (2016) *Dituria Islame një tribunë e mendimit fetar e kombëtar*, Dituria Islame, nr.313,Prishtinë, p.5.

disa rubrika. Cilësia dhe brendia e revistës vazhdimisht vinte e përmirësohej. Shtohej numri i faqeve dhe i bashkëpunëtorëve. Ajo u bë një tribunë e edukimit shpirtëror, e pasqyrimit të veprimtarive fetare islame në vendin tonë dhe në botë. Në faqet e saj pasqyrohej ideja e tolerancës dhe e mirëkuptimit, interesat kombëtare viheshin gjithnjë në plan të parë dhe lidheshin ngushtë me luftën për fenë, gjuhën, kulturën, traditat e identitetin kombëtar. Në numrat e revistës ka pasur shkrime origjinale, përkthime e përshtatje, studime e artikuj të karakterit fetar, filozofik, moral, shoqëror, kulturore historik, portrete personalitetesh, përkujtime ngjarjesh, kronikë veprimtarish.[3]
Roli i saj në shërbimin e Islamit dhe mbrojtjen e besimit islam përballë devijimit intelektual, si dhe rolin e tij në mbrojtjen e çështjeve arabe dhe islame, përveç rolit që ka luajtur revista për të rrënjosur dhe përhapja e mendimit islam dhe mbështetja e vlerave islame duke u mbështetur në fakte të qarta.
**Thuaj: "Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë dhe ai që vjen pas meje.(Jusuf,108)**
Studiuesit tregojnë se media autentike islame i përmbahet gjithmonë vlerave, standardeve dhe parimeve të Islamit dhe i shpreh ato në gjithçka që u paraqet njerëzve me informacione faktike ose elemente imagjinare.
Në fillim doli me një tirazh prej 1000 ekzemplarë që nga numrat e parë hasim tema që rrahin problematikat dhe nevojat e kohës që mësimet e tilla si në fushën e akaidit, historisë islame, da've e tj. Kishin për qëllim që nëpërmjet kësaj revisteje të predikohej Islami sa më drejtë dhe mesatar në mesin e popullatës sonë. Dikur ky hap ishte një ëndërr që më vonë të bëhet realitet dhe ngjarje e madhe kulturore. Nisi me pak mundësi por me shumë entuziazëm. Hapëroi me sukses, madje edhe me përkushtim të madh, duke ruajtur gjithmonë dinjitetin e vetëm duke shprehur thellësisht realen. U bë faktor aktiv në të gjitha rrjedhat e zhvillimit të jetës islame, dhe ka kontribuar në të gjitha fushat e aktivitetit, duke luajtur rol të rëndësishëm në jetën e njeriut tonë duke ruajtur dhe qëndruar besnik misionit dhe objektivit të saj. Andaj, me krenari e shënojmë sot 50 vjetorin e saj dhe është një hap shumë i madh në jetën kulturore islame si dhe na obligon që edhe më shumë të punojmë dhe ta avancojmë fjalën e shkruar konform platformave të reja të komunikimit bashkëkohore. Nuk mundemi të kremtojmë këtë jubile 50 vjeçar të jetës së "Edukatës Islame" pa kujtuar kryeredaktorët e deritanishëm të saj.

Në numrin e parë të saj gjejmë shkrimin e h.Sherif Ahmetit me titull "Prezantimi i Zotit xh.sh., në natyrë dhe procese ku mes tjerash thotë: "Gjithçka në natyrë, e edhe njeriu, është krijua sipas një procesi të vazhdueshëm e të gjatë. Intervenimi i Zotit në natyrë manifestohet nëpërmjet të veprimit të ligjeve të natyrës"[4]. Por edhe nga ana tjetër kemi edhe publicistin tjetër Hajrullah Hoxha i cili që nga numri i parë kontribuon në revistë me shkrimet e tij.'Muhamedi a.s., dhe përhapja e fesë islame"- është shkrimi i tij që në të paraqet rëndësinë dhe peshën e Hamzës r.a., në forcimin e da'ves dhe radhëve të besimtarëve dhe përhapjes së dhe predikimit të thirrjes islame.
Në numrin e parë po ashtu kanë kontribuar Jashar Jashari me temë "Detyrat e fëmijëve ndaj prindërve", Qemajl Morina si nxënës i klasës së 5 në Alauddin shkroi 'Kushtuar ditëlindjes së Muhamedit a.s.,; Jetish Bajrami "Problemi i prapambeturish së përgjithshme", Abdulfetah Kadriu, "Butësia dhe mëshira e Ymerit të Hatabit". Po ashtu hasim edhe tema të tjera që kanë të bëjnë direkt me misionin e thirrjes islame si 'Butësija" të trajtuar nga Shaqir Anamali ku jepen shembuj shumë të mirë nga thesari i vlerave islame sesi duhet të zotërojmë këtë cilësi në jetën tonë dhe misionin tonë. "Mirësija nuk është pasuri e ne pasëardhese te shumet, porse mirsija është dituri e butesi dhe ne mbasmburrjen me ibadet qe i ben Zotit kur punon pune te mira dhe kur kërkon falje prej Tij kur gabon"[5]
Në një nga shkrimet e radhës së revistës "Edukata islame" ka të bëj me aktivitetin dhe shtrirjen e predikimit të Islamit nga ana e imamëve duke iu bë një analizë predikimit dhe gjendjes asokohe të thirrjes islame dhe se imami është faktor me rëndësi në ngritjen e jetës fetare. "Imamët nëpër xhami zhvillojmë mësim-besimin pa kurrfarë pengese, si në qytete ashtu edhe në fshatra. Ja kështu pra, po bëhet përpjekje masive kundra "xhahilijitetit" ( injorantët) në drejtimin islam, dhe kështu me plotë optimizëm pohojmë se feja islame është në perspektivë"[6].
Në vijim kemi edhe formën tjetër të predikimit të fesë që ka të bëj me hytben dhe gjejmë që në numrin 8 të revistës gjejmë hytbe me titull "El Hutbetu fi deaimil islam" të shkruar nga hfz Muharem Ramadani, ku kërkohet dhe sqaron

---

[3] Morina,Q. (2002), Edukata Islame, Tri dekada të revistës "edukatës Islame", nr,68,p.17.
[4] Ahmeti,Sh. (1970) Edukata Islame, Prishtinë, viti 1, nr.1,Prishtinë,p.9.
[5] Anamali,Sh.(1972) Butësija, *Edukata islame,* viti,2,nr.6,Prishtinë,p.51.
[6] Gashi,M.(1972) Jeta fetare në Kosovë,*Edukata islame, viti,2,nr.6,*Prishtinë,p.52.

format e forcimit të imamit dhe përmirësimin e raporteve ndërnjerëzore.  Por edhe në numri 9-10 precizon rëndësinë e përgatitjes së imamit në çdo pikëpamje e edhe në atë teknike me qellim që të jemi në gjendje të mbrohemi nga armiku eventual, natyrisht kjo sipas mësimeve fetare.”Nurin e imanit gjithmonë duhet të mundohem ta mbajmë dhe ta forcojmë tue u lidhë me punët që na porosit Kura’ni i madhnueshem, dhe Pejgamberi i Zotit Muhammedit a.s., dhe duhet ta dijmë se vetem nji besim i thatë, ia përgjan nji kandili pa fener të cilin fryma shum e lehtë mund ta shqymin, ashtu edhe Zoti na rujtë  imani (besimi) pa amel asht vetëm me  than se asht njeri mysliman”[7]

Revista po ashtu drejton edhe këshilla për imamët se si duhet të predikojnë në misionin e daves dhe të kenë rol pozitiv në drejtimin dhe ndryshimin e shoqërisë. Imami i talentuar gjithmonë flet  mbi krijimin e njeriut me vlera njerëzore si të punojnë në emër të Zotit të jetë i sjellshëm në familje në shoqëri etj. Andaj gjithherë janë të përgatitur ndaj masës dhe flasin tema të zgjedhura. E nëse flasim tema të pazgjedhura dhe jo të studiuara mirë në një mes njerëzor, me fjalët tona do të krijojmë errësirë.

Mendoj se na duhet definitivisht lartëpamësi, dhe me vetëdije të qëndrojmë zgjueshëm mbi problemet dhe dukuritë negative që nga të gjitha anët mundohen ta grisin rrjetën tonë fetare. Të mos kotemi në momentin e tanishëm dhe mëkatet që u takojnë të tjerëve t'i marrim përsipër. Për ne është e nevojshme gjallëri shpirtërore për ta arrijtë atë çfarë e dashuro më. T’i mbështetemi Kur'anit dhe hadithit të Muhammedit a. s. Vetëm kështu do të futet një gjallëri më e madhe në organizatën tonë dhe në gjithë pjesëtarët e Bashkësisë Islame. Në momentin e tanishëm, tani kur rruga e jonë në vend të dafinave e lulesh është e shtëruar me gjemba të mos bëjmë veprime, që më tepër u ngjasin ujërave nëntokësor, atëherë edhe më tepër do të na shtohen gjembat, më tepër do të shtohet dekadenca etj.[8]

Po ashtu  në temat e trajtuar të kësaj fushe kemi edhe aso që kanë të bëjnë edhe më e përgatitjen e vaizit . Këtë shkrim e gjejmë me titull “Si duhet të jetë Vaizi: në nr.13 të vitit 1975 ku më tej  artikulli trajton  se si pejgamberët ishin ata të cilët bënë thirrjen për në rrugën e Zotit dhe këshilluan njerëzinë.

“Detyra e vaizit sa është e lartë dhe e rëndësishme, mban në vehte edhe përgjegjësi të madhe, pse fati i një populli mbi njohjen e drejtë të mësimeve të Zotit dhe udhëzimeve të Pejgamberit kryekëput është i lidhur për Shpjegimet e ylemave, qëndrimet dhe sjelljet e tyre. Pra, vaizi si përgjegjës për çështjet e besimit në një popull, lypset t’i plotësoi të gjitha normat e duhura dhe vetëm pastaj ti lejoi veti të pranoi një detyrë kaq të rëndësishme”[9].

Më pas kemi artikuj edhe për përhapjen dhe predikimin e Islamit, nga autori Hajrullah Hoxha me titull: ”Muhamedi a.s., dhe përhapja e Islamit” ku mes tjerash thekson  angazhimin e  sahabiut të nderuar Mus’ab bin Umejrit në Medine në përhapjen dhe urtësinë e tij në misionin e da’ves ku aktiviteti i tij depërtoi në Medine me një shpejtësi jashtëzakonisht të madhe sa që brenda një viti nuk ngeli asnjë familje nga fiset Evs dhe Hazrexh pa e pas ndonjë anëtarë të fesë islame. “Mus'abi e zhvillonte misionin e tij të shenjtë, me plotë krenari dhe entuziazëm, duke qenë i kënaqur me suksesin e kishte arritur brenda kësaj kohe. Pasi që u afruen muajt e Haxhit, ai shkoj në Meke dhe ia rrëfej Muhamedit a. s. gjendjën e Muslimanëve të Medinës, duke informue mbishtimin e numrit të tyre, kushtet e mira jetësore, mbi mbi shtimin e numrit të tyre, kushtet e mira jetësore, mbi do ta vizitoj Qabën një grup nga Muslimanët e Medinës shumë më i madh për kah numri dhe më i fuqishëm për kah besimi në Zotin e madhërueshëm”[10].

 Që edhe në vitet e hershme  është trajtuar me kujdes në numrat e kësaj grevisteje se kush duhet të flasë në emër të fesë dhe sa me përgjegjësi është të folurit dhe të dhënit fetva në emër të fesë. Këtë e ka trajtuar edhe haxhi Sherif Ahmeti në artikullin ‘Për të folë mbi fenë”  duke theksuar se ai që flet mbi fenë dhe parimet e saja domosdo duhet të jetë i pajisur me besim të thellë dhe të jetë i bindur se është duke folur mbi një ide të drejtë; njashtu të jetë i bindur se duke predikuar parimet e fesë është duke zgjua ndjenjat e njerëzisë për ta largua prej  veprimeve të dëmshme e orientua kah  të dobishmet. ”Udhëheqësit e bashkësive islame duhet ta ndiejnë vedin përgjegjës për emanetin të cilin e bartin në supet e veta, t'u ndihmojnë imamve në pregatitjen e hytbeve, atyre që kanë nevojë, pse më mirë do të ishte të mos lexohet predikohet fare, se sa të ligjërohet nga i papërgatituri. Natyrisht, kjo është përgjegjësi e gjithë atyre që munden me dhënë komtribut në këtë lëmi, por udhëheqja u mbetët obligim bashkësive islame. Shpresoj se lexuesit e nderuar

---

[7]Ramadan,  M. (1973)El Hutbetu fi deaimil islam, Edukata islame,  viti,2,nr.8,Prishtinë,p.44.

[8] Aliu,A.(1973). Aktivizimi i nëpunësit fetar-arma kryesore për mbrojtjen e Bashkësisë *I*slame, Edukata islame, nr.8,Prishtinë,p.61.

[9] S.P, (1975)Si duhet të jetë Vaizi, Edukata Islame,nr.13,Prishtinë,p.33,

[10] Hoxha, H.(1975), Muhamedi a.s., dhe përhapja e Islamit, Edukata Islame, nr14,Prishtinë,p.37.

do të formojnë gjuhë përbashkët dhe do të ndihmojnë përmirësimin e gjendjes në ato vende ku ka nevoje”[11].
Po ashtu kemi edhe rubrikën e hytbes si formë e predikimit të da'ves ku spikat emri i Safet Basha, ku rytbeja paraqitet me tekst në gjuhën arabe dhe më pas të përkthyer edhe në gjuhën shqipe që ka të bëjë me muajin e Ramazanit, dhe rëndësisë së tij[12]. Kurse poashtu edhe autorin tjetër që ka kontribuar me rubrikën e hytbes është edhe Emin Behrami me titull “Urdhri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja”[13]
Shaban Hoxhiq po ashtu në vazhdim sjell shkrimin “Disa vërejtje mbi vaizin dhe vaizet” të përkthyer nga Bajrush Ahmeti. ”Prandaj vaizin nuk duhet ta kuptojmë si një lloj fjalimi, por si një detyrë të lartë të cilën e kanë kryer të gjithë pejgamberët e Zotit dhe njerëzit e zgjedhur. Ata edhe për atë janë dërguar me atë detyrë që t'i udhëzojnë njerëzit në atë rrugë të jetës që të jenë të lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër, këtë edhe e kanë bërë duke i mësuar njerëzit atë që nuk e dinë duke i zgjuar nga moskujdesi, neglizhenca, duke i ndaluar në ata kufi, që njerëzia apo burrëria i kërkon”[14].
Edhe autori tjetër Bajrush Ahmeti ka participuar në këtë drejtim duke e pasuruar revistën me temë “Si duhet të jetë ligjëruesi (vaizi)”ku në pesë faqe përshkruan dhe paraqet rolin dhe rëndësinë e vaizit në tetë pika, me tjerash thekson se: “Vaizi duhet të jetë i butë, sepse me brutalitet e me ashpërsi i largon njerëzit. Porosia e tij është se dëgjuesit xhemati pak e shfrytëzojnë diturinë e tij, e ajo gjithsesi është fatkeqësi për atë xhematë, e fatkeqësi del nga mosdija e tij”[15].
Më pas vjen me shkrimin “Çka është e bukur të gjindet te vaizi” (edukata islame, nr.26 f.20-22).Po ashtu kontribut tjetër në lidhje me hytben ka dhënë edhe F. Sheta me titull “Hutbeja-porosi e rëndësishme javore” (nr.48-49,f.42-460). Po ashtu në numrin 80 të “Edukatës Islame” hasim se ka trajtuar disa artikuj e studime në lidhje me temat edukative, pedagogjike. Rrezehana Hysa sjell artikullin ‘Rëndësia pedagogjike e Kura'nit” ( f.55-67), Dr. Musa Musai paraqitet me temën “Amullia e psikologjisë së modernitetit” ( f.105-115),më pas kryeredaktori i revistës në këtë kohë tashmë i ndjeri Mr. Qemajl Morina sjellë artikullin “Roli i edukimit fetar në shoqërinë bashkëkohore” (f/191-199), Rrok Mirdita paraqet artikullin “Rëndësia e edukimit fetar” (f.199-207).Në numrin 82/2007 revista boton një intervistë me ish diplomatin gjerman, prof.dr. Murad Hofman i cili duke folur për metodat e thirrjes në islam dhe mënyrën e qasjes së kësaj thirrje në kohën tonë thekson se: “duhet të ndryshohet metoda e thirrjes, të cilën po e zbatojnë thirrësit sot në të gjitha mjetet e informimit. Duhet të kemi një kujdes të veçantë për myslimanët e Perëndimit dhe ata të Evropës, të përfitojmë nga veprimtaria dhe përvojat e tyre dhe t'u japim atyre rastin të jen thirrës të Islamit. Unë jam thellë i bindur se rezultatet do të jenë të mira. Dhe se vetë myslimanët janë përgjegjës për imazhin e keq të Islamit në Perëndim”.[16]
Po ashtu në këtë vazhdë revista sjell për lexuesit e vet edhe temën se si duhet prezantuar mesazhin islam në botën bashkëkohore-diskursi komunikologjik nga autori Eldin Duçiç, duke filluar nga hutbeja si medium i (pa) shfrytëzuar, pastaj gazetaria fetare si shtypi (gazetat, revistat. Librat) mjetet audiovizuele (radio & TV) dhe komunikimi elektronik (teleteksi, videoteksi, interneti)[17], kurse Qemajl Morina boton temën që ka të bëjë me shprehjen dhe nevojën që duhet ruajtur gjuha në ligjërimet fetare “ Gjuha dhe feja”( f,83-95).
Numri 87 duket me më shumë tema nga fusha e da'ves ku spikat shkrimi i Dr.Zakir Naik “Thirrja (da'veti) në Islam është një përgjegjësi e madhe” (f.117-129/2008), (151-166/2008), pastaj Ahmed Omer Hashim, “Thirrja e Islamit për modesti dhe largim nga mendjemadhësia (f.143-151/2008).Halef Muhammed el Xherrad, “Islami dhe sfidat e globalizmit” (f.167-183/2008); Bisedë e huazuar me prof.dr. Rozhe Garodi “Islami dhe perëndimi” (f.183-197/2008), që paraqesin rolin dhe përgjegjësinë e madhe që kemi karshi shoqërive të botës dhe përgatitja profesionale e duhur dhe orientimi i duhur kohor dhe hapësinor në lidhje me shpjegimin e Islamit sipas vendit dhe ambientit social. Shkrimi i radhës vie nga Samir Ahmeti “Osmanlinjtë dhe metodat e tyre rreth përhapjes së fesë islame në Kosovë”,f.117-134/2009.

---

[11] Ahmeti, Sh.(1976) Për të folë mbi fenë, Edukata Islame, nr.15-16,p.53.
[12] Basha,S.(1976) Hytbe, Edukata islame, nr.18,,Prishtinë,p.8-11.
[13] Behrami, E. (1978). Urdhëri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, nr.22,p.8-14.
[14] Hoxhiq, Sh. (1979),Disa vërejtje mbi vaizin dhe vaizet, Edukata Islame,nr.24,Prishtinë,p.38.
[15] Ahmeti, B.(1979),Si duhet të jetë ligjëruesi (vaizi), Edukata Islame,nr.25,Prishtinë,p.45.
[16] Intervistë me Murad Hofman, Edukata Islame, nr.82/2007, p.228.
[17] Duçiç, E.(2007)Mesazhi islam në botën bashkëkohore-diskursi komunikologjik, Edukata Islame, nr.84,p.87.

“Koncepti i Kuranit për da’ven” – është artikulli i radhës nga hfz Ataullah Aliu i cili në këtë trajtesë shqyrton 63 ajete që kaun të bëjnë me daven në përgjithësi, pastaj koncepti i disa autorëve për virtytet e daiut dhe me këtë koncepte kuranore për daven i hapet rruga dhe nuk humb orientimi në ecurinë e tij.[18]
Po ashtu ka shkrime edhe për etikën islame në komunikim (da’ve) ku autori Rexhep Suma sjell artikullin me titull “Etika islame në komunikim” (nr.104,2013,f.143-174). Më pas po ashtu në sferën e thirrjes islame kemi edhe temën tjetër që ka të bëjë me sfidat bashkëkohore të daves dhe thirrësit “Sfidat e thirrësit islam në epokën e globalizmit” . Thirrësit bashkëkohorë apo teologët, duhet të fokusohen mbi parandalimin e mendimeve ekstreme në shoqëri, kurse bashkësitë fetare vazhdimisht kanë ndihmuar në forcimin e rolit të imamit dhe për etikën e përcjelljes mesazhit së besimtarët. te Epoka në të cilën po jetojmë karakterizohet me planifikim, vizion dhe menaxhim të kohës, dhe nuk ka vend për rastësi dhe fabrikim të rastit. Andaj, me të drejtë shtrohet pyetja se veprimet tona, të qofshin edhe më të thjeshtat, a duhet të vlerësohet, çmohen me kaluarën dhe larg kritereve bashkëkohore dhe shkencore Ku do të renditeshin dhe t'iu jepej përparësi në dyjave që duhet të jenë primare e të prolongohen, apo janë sekondare për momentin?[19]
Tema e radhës është “Thellësi ideore dhe civilizuese në adhurimet islame”. (nr.112/2018,f.197-210).Më pas autori Bali Sadiku vjen me temën “Lidhja e thirrjes së Muhamedit a.s., me thirrjen e Pejgamberëve para tij (nr.114/2018,f.91-110). Më tutje autori Sulejman Osmani vjen me temën “Edukata fetare islame reflektimet e saj tek individi dhe shoqëria (nr.115/2019,f.73-88).

## REZYME

Njerëzit vdesin, ngjarjet po nuk u regjistruan harrohen nën pluhurin e rëndë të historisë. Ajo ë mbetet është fjala e shkruar si argument për punën dhe angazhimet e individit për mundin e përmbushjes së amanetit hyjnor mbi këtë planet.
“Edukata Islame” ka arritur që shumëfish të luajë misionin e saj në kultivimin e fjalës së shkruar islame në gjuhën e bukur shqipe, e pastaj duke qenë, në kohë e ditë të vështira, edhe si tryezë e klasës intelektuale të popullit tonë. Po ashtu, ajo luajti një rol përcaktues edhe në nxjerrjen në dritë të shumë penave të reja nga të gjitha viset tona. S’duhet harruar se revista “Edukata Islame” lindi në kohën e sistemit komunist ateist, për të vazhduar në periudhën e vështirë të riokupimit të Kosovës, e më pastaj përjetoi edhe fatin e Kosovës dhe të popullit tonë - Luftën çlirimtare, për të vazhduar misionin e saj në lirinë e Kosovës dhe, së fundmi, në bërjen e shtetit. Ajo do të mbetet si revistë që është frymëzim i gjallë dhe balancues në misionin e predikimit të vlerave të predikimit të islamit, në ambientin shqipfolës. Ndërsa revistës “Edukata Islame” i urojmë që të festojë edhe shumë përvjetor si një fanar i pashuar i frymës së myslimanëve të këtyre trojeve. Ndërsa për redaksinë e tanishme dhe të ardhshme mbetet përgjegjësia që ta avancoj edhe më tej Edukatën islame drejt platformave të reja akademike dhe të synoj drejt platformave prestigje të zhurnalëve në platformën skopus e simotrave të saj.

[18] Aliu, A. (2010), Koncepti i Kuranit për da’ven, Edukata Islame, nr.92,p.37.
[19] Suma. R. (2016), Sfidat e thirrësit islam në epokën e globalizmit, Edukata Islame, nr.111,p.78.

# Rëndësia e miratimit të ligjit për pagesën e TVSH-së në brendi të vendit për mallërat e importuara për bizneset në Kosovë

**Prof. Asst. Dr. Refik Havolli**
College of International Management "Globus", Republic of Kosovo, Prishtina
ORCID iD: https://orcid.org/0000-0003-0215-0689
refik.havolli@kolegjiglobus.com
**Prof. Asst. Dr. Betim Spahiu**
College of International Management "Globus", Republic of Kosovo, Prishtina,
ORCID ID: https://orcid.org/0000-0003-3429-9162
E-mail: betim.spahiu@kolegjiglobus.com
**Fitim Raci**
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë,fitim-raci@hotmail.com
Arbër Havolli
arber.havolli@passable-ks.com

**ABSTRAKT**

Me këtë punim synojmë të paraqesim dhe argumentojmë rëndësinë që ka implementimi i ligjit për pagesën e TVSH-së në brendi të Kosovës për bizneset në përgjithësi e sidomos për bizneset që merren me importimin e produkteve. Edhe pse kanë kaluar 22 vite nga çlirimi i Kosovës dhe 14 vite nga shpallja e pavarsisë së Kosovës për fat të keq Kosova ka pas regres në aspektin e mënyrës së inkasimit të TVSH-së nga instutucionet kompetente (Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës) dhe kështu ka dëmtuar ndjeshëm në suksesin e bizneseve. Duke argumentuar me disa statistika të besuara dhe duke krahasuar vlerën e TVSH-së në mënyrë specifike për një biznes që meret me importimin e produkteve do të arrihen rezultate të qarta, të matshme dhe të arritshme për një tematikë që bizneset kërkojnë me urgjencë të gjejë zbatim. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar aktualisht është e rregulluar me Ligjin Nr.05/L-037 i miratuar në muajin gusht të vitit 2015 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vendosja e sistemit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në teritorin e Kosovës është i dobishëm për bizneset, e nevojshme dhe gjithashtu ekzistojnë parakushtet që edhe implementimi të jetë i suksesshëm.

Partitë politike gjatë fushatave të tyre zgjedhore duke ditur rëndësinë që ka ligji për TVSH-në i propozuar nga ekspertët e ekonomisë dhe bizneset, premtuan pa fije turpi se do e fuqizojnë ligjin që të mundësohet pagesa e TVSH në brendi të vendit edhe për mallrat e importuara por kjo asnjëherë nuk u realizua. Pandemia Covid -19 kishte një ndikim global e sidomos në Kosovë ku balanci tregtar shënon një disbalancë të theksuar. Për shkak të problemeve të shfaqura në zinxhirin e furnizimit pati në vazhdimësi edhe ngritje të çmimeve dhe probleme të natyrave tjera për bizneset. Kishte gjithashtu një mbyllje të shumë aktiviteteve biznisore me muaj të tërë gjatë kohës së pandemisë Covid-19. Prandaj pas të gjitha këtyre ngjarjeve negative për ekonominë në përgjithësi, kërkohet një presion më i madh nga bizneset, ekspertët e ekonomisë dhe palët tjera të interesit që më fuqimisht të kërkojnë ndryshimin dhe miratimin e ligjit për pagesën e TVSH-së në brendi të vendit për mallërat e importuara.

**Fjalët kyçe**: TVSH, kupon fiskal, paisje elektronike fiskale, ATK, Dogana e Kosovës.

## HYRJE

Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar i cili aktualisht është në zbatim në Republikën e Kosovës është Ligji Nr.05L-037 i propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për Tatimin mbi vlerën e shtuar ka hasur në vështirësi dhe probleme, të cilat janë paraqitur në analizën e ofruar përmes Koncept Dokumentit për Trajtimin e Kuadrit Ligjor të Tatimeve dhe Procedurave në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).

Është vlerësuar se kuadri ligjor në fuqi ka nevojë për ndryshime meqenëse janë paraqitur probleme në zbatimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Këto probleme kanë lindur si rrjedhojë e disa dispozitave të paqarta dhe jo efektive, si dhe zbrazëtirave të shumta që lënë hapësira për interpretime të ndryshme. Këto pengesa janë theksuar gjatë administrimit të procesit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Gjithashtu, duke marrë parasysh pakot fiskale të vitit 2018 posaqërisht ato për subjektet prodhuese dhe lirimet në import kanë shkaktuar diskriminim për prodhuesit vendor të atyre lëndëve të liruara në import. Për këtë arsye qëllim kryesor ka qenë të harmonizohet ligji i TVSH me vendimet e qeverisë. Në veçanti vlen edhe të theksohet që nevoja për ndryshim të ligjit ka lindur me vendimin që të mundësohet pagesa e TVSH në brendi të vendit edhe për mallrat e importuara. [20]
Viteve të fundit pothuajse të gjitha partitë politike e kanë vërejtur rëndësinë e ndryshimit të ligjit për TVSH-në nga ajo e inkasimeve që bëhet në pikat kufitare apo terminalet doganore në formën që është praktikë e shteteve të rajonit dhe BE-së që tatimi të mbledhet në brendi. Këto parti politike pothuajse të gjitha kanë ardhur në pushtet por asnjëra nuk e ka mbajtur premtimin e tyre.
Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, citojmë: "Secili person është i obliguar që të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj"[21] – Neni 119 pika 8.
Ministria e Financave e Republikës së Kosovës në korrik të vitit 2018 filloj hartimin e një dokumenti konsultimi për projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar -TVSH e cila mbeti vetëm si një inciativë e pa realizuar deri më sot. Nga Dogana e Kosovës gjatë vitit 2021 vetëm TVSH u grumbullua shuma 743,767,883.26 €. Nga kjo shumë e përgjithshme, 2/3 do të mund të përdorej nga bizneset importuese për aktivitetin e tyre, shitje të mëtutjeshme dhe kjo shumë përseri do ishte pjesë në buxhetin e Kosovës pasi të realizohej shitja te konsumatori final.

**Qëllimi i punimit**

Qëllimi i këtij punimi është të paraqes rëndësinë që ka ndryshimi i ligjit për pagesën e TVSH-së nga ajo që është aktualisht në pagesën në brendi të Kosovës për bizneset e Kosovës. Duke argumentuar këtë fakt i cili tashmë është pranuar nga politikbërësit, e disa qeverive paraprake dhe kësaj aktuale por fatkeqësisht për shkak të paaftësisë së tyre dhe mungesës së vullnetit ende nuk është finalizuar për miratim dhe implementim. Përmes këtij punimi që titullohet "***Rëndësia e miratimit të ligjit për pagesën e TVSH-së në brendi të vendit për mallërat e importuara për bizneset në Kosovë***" dëshirojmë ta ngrisim si temë që Qeveria e Kosovës sa më parë ta bëjë implementimin e këtij ligji.

**Methodology – Metodologjia**

Ky punim është hartuar duke u bazuar fillimisht në hulumtim nga tavolina ku kam marë informacione për tematikën e caktuar, nga materiale në formë të shtypur dhe nga materiale të publikuara në internet, në gazeta, revista, raporte të qeverisë si dhe informata të pranuara nga Agjensia e Statistikave të Kosovës pasi u kam dërguar email. Gjithashtu jam bazuar në rast specifik në biznesin Passable se si ndikon TVSH në dy zërat kryesor në bilanc e që janë stoqet e mallrave dhe llogaritë e arkëtueshme.

**Çfarë është TVSH-ja dhe cilat janë normat e saj në Kosovë**

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) është një tatim i përgjithshëm, mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve.[22]
Tatimi mbi vlerën e shtuar – TVSH, përfshin aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, që është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve. TVSH llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, dhe në fund i ngarkohet konsumatorit.[23]
TVSH-ja është një tatim mbi qarkullimin e mallërave dhe shërbimeve (konsumin). Ai mblidhet nga personat që janë të regjistruar për këtë lloj tatimi nëpërmjet shitjes së shërbimeve dhe kryerjes së furnizimeve të ndryshëm që i bëjnë konsumatorit më të parë.
Çdo person i tillë në qarkullimin që kalon malli apo shërbimi nga burimi i furnizimit dhe deri te konsumatori i fundit vendoset një vlerë e shtuar e cila mblidhet nga shitësi për llogari të shtetit. Konsumatori i fundit është ai që kryen

[20] Dokumenti per Konsultim per Projekt ligjin per TVSH 15 07 2018.doc (live.com)
[21] https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf
[22] https://www.tatime.gov.al/c/4/96/110/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar
[23] https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/10/DoracakuTVSH_ALB.pdf

qarkullimin final me shumat e vlerave të shtuara furnizimit qe ai ka blerë në çdo hap që ka kaluar furnizimi.[24]

Normat tatimore sipas legjislacionit në Kosovë ndahen në tri grupe:

○ Norma standarde ku TVSH ngarkohet me normën prej 18%
○ Norma e ulur ku TVSH ngarkohet me normën prej 8%
○ Norma e liruar ku TVSH ngarkohet me normën 0%.

**4. Kush i nënshtroht ligjit për pagesën e TVSH-së**

Secili person i cili zhvillon një aktivitet të pavarur ekonomik (prodhim, tregti apo kryen shërbime të ndryshme) në Kosovë dhe kur qarkullimi në 12 muajt e fundit tejkalon pragun prej 50,000 € duhet të regjistrohet për TVSH dhe të deklarojë atë në bazë të periudhave të caktuara tatimore.[25]

**Rëndësia e përfshirjes së palëve të interesit për Ligjin e Tatimin mbi Vlerën e Shtuar – TVSH-në**

Për të qenë ligji më i mirë, më i dobishëm dhe më i pranuar është mirë të përdoren si referencë ligjet nga vendet e rajonit dhe ato të BE-së, të merren sugjerime nga palët e interesit siç janë: Bizneset që janë tatimpagues të rëndësishëm mund të japin kontribut të veçantë, Shoqatat e Kontabilistëve në Kosovë, Këshilli Kosovar për Raportim Financiar, Odat Ekonomike, kompanitë që merren me auditim dhe konsulencë financiare, ekspert të ekonomisë, Dogana e Kosovës, Administrata e Kosovës dhe instutucione tjera që kanë ekspertizën e nevojshme dhe vullnetin për të kontribuar që Ligji i ri mbi Vlerën e Shtuar të jetë sa më i mirë.

**Disa statistika të importeve dhe vlera e TVSH e paguar në Doganat e Kosovës**

Importet e Kosovës në vitin 2021 u rritën për 42.% krahasuar me vitin e kaluar, duke realizuar importin më të lartë në histori me vlerë 4 miliardë 652,8 milion Euro, kurse vlera e exportit ishte 749.721 milion Euro duke shenuar një balancë tregtare me vlerë negative në vlerë -3.903.030€.

Tabela e importeve, eksporteve dhe balanca tregtare e Kosovës për vtet 2018-2021, në mijë euro

| Period<br>Periudha | Exports (FOB)<br>Exporti | Imports (CIF)<br>Importi | Trade balance<br>Bilanci tregtar | Percent of cover<br>Përqindja e mbulimit |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4=2-3** | **5=2/3** |
| 2018 | 367.500 | 3.347.007 | -2.979.507 | 11,0 |
| 2019 | 383.491 | 3.496.942 | -3.113.451 | 11,0 |
| 2020 | 474.884 | 3.296.635 | -2.821.751 | 14,4 |
| 2021 | 749.721 | 4.652.751 | -3.903.030 | 16,1 |

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

[24] https://altax.al/cfare-eshte-tvsh-ja/

[25] Shih fq 8 për informata të detajuara për regjistrim të TVSH-së dhe faqe 27 për info të periudhave tatimore https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/10/DoracakuTVSH_ALB.pdf




Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

1.37 miliard euro janë të hyrat vjetore për vitin 2021 nga Dogana e Kosovës. Kjo u bë e ditur përmes një konference për medie nga drejtori i përgjithshëm i Doganës, Agron Llugaliu[26].

Nga të dhënat – statistikat e publikuara nga Dogana e Kosovës mund të paraqesim në grafik pjesëmarrjen në mënyrë specifike dhe vlerën e përgjithshme të tri grupimeve. Vlerën e përgjithshme e përbëjnë:

○ Taksa e doganës në vlerë 123,502,165.98€,
○ Taksa e Akcizës në vlerë 494,988,415.15€, dhe
○ Taksa e TVSH-së në vlerë 743,767,883.26 €:




Burimi: Dogana e Kosovës

Pra vlera e cekur më lartë do të ishte si mjet financimi për bizneset që ato të mos ekspozohen shumë në bankat komerciale dhe gjithashtu do të krijonte një qendrueshmëri financiare për to. Pra, politikat qeveritare duhet më tepër

[26] https://zeri.info/ekonomia/437263/dogana-ne-vitin-2021-grumbulloi-1-37-miliard-euro-importi-arriti-ne-4-6-miliarde-euro/

të fokusohen në miratimin e të drejtave të bizneseve importuese. Bizneset kërkojnë drejtësi e jo lëmoshë nga cilado qeveri që vije në pushtet.

**Si ndikon ligji i ri i TVSH-së për një importues si në rastin e kompanisë Passable sh.p.k**

Në rastin kur kompania Passable do të importoj produkte, me ligjin e ri për TVSH-në nuk do duhej ta bëjë pagesën e TVSH me rastin e zhdoganimit në pikat kufitare apo terminalet doganore. Nëse llogarisim mesatarisht më stoqet e mallrave në depon e kompanisë Passable sh.p.k, ndodhen rreth 1.000.000 € mallra pa TVSH me çmim kushtues dhe vlera e TVSH-së për këto stoqe sillet rreth 180.000€.

Gjithashtu nëse shikojmë zërin Llogari të arkëtueshme gjatë viteve mesatarisht ka qenë 1.000. 000€ duke përfshi TVSH-në. Pra, nëse llogaritë e arkëtueshme pa TVSH do ishin 847.457,63€ dhe TVSH 152.542,37€ atëherë Passable do të kishte mesatarisht në dispozicion shumat: 180.000+152.542.37 = 332.547,37€ në dispozicion për zhvillimin e aktivitetit të saj. Me posedimin e këtyre mjeteve ekspozimi ndaj bankave do të zvoglohej për këtë vlerë. Përpos dobisë që do të kishte në aspektin e likuiditetit financiar gjithashtu do të zvoglohej edhe rreziku nga borxhet e këqija, pasi që vlera e llogarive të arkëtueshme do ishte më e vogël për pjesën e TVSH-së.

Pra, me këta dy zërat ndër më kryesorët në bilanc, stoqet e mallit dhe llogaritë e arkëtueshme do pasqyronin një realitet të ri më të qëndrueshëm, më të dobishëm për bizneset që merren me importimin e produkteve apo shërbimeve.






Burimi: Passsable

## KONKLUZIONE

Me rastin e zhdoganimit të mallrave të importuara në Dokumentin Unik Doganor kalkulohet përpos vlerës së akcizësë (për mallrat me akcizë), doganës edhe vlera e TVSH-së e cila paguahet menjëherë në llogari të buxhetit të Kosovës. Në rastet kur biznesi ka një depo doganore të licencuar, atëherë pagesën e bën në baza javore ashtu si i planifikon shitjet.

Miratimi i ligjit të Ri për TVSH-në që të mundësohet pagesa e TVSH në brendi të vendit edhe për mallrat e importuara, tashmë është publikisht i njohur dhe i pranuar edhe nga bizneset edhe nga politikbërësit por mos implementimi i tij mund të kuptohet si mungesë e vullnetit nga qeveritë e kaluara dhe kjo aktuale, si paaftësi dhe mungesë e kapaciteteve për implementim, si dobësi e palëve të interesit si bizneseve, odave ekonomike, ekspertëve të ekonomisë etj për një presion të argumentuar dhe konstruktiv mbi qeverinë.

Kuponët fiskal lëshohen për konsumatorët, dmth personat që nuk zhvillojnë aktivitet ekonomik, të cilët blejnë mallra apo shërbime me shumicë apo pakicë. Kuponët fiskal duhet të lëshohen nga të gjitha njësitë apo lokacionet që kryejnë aktivitet ekonomik.[27]

Termi "Pajisja Elektronike Fiskale" përfshinë pajisjet elektronike si regjistruesit e arkave fiskale dhe pajisjet e pikave elektronike të shitjes, të cilat licencohen dhe autorizohen nga organet kompetente të Ministrisë së Financave në mënyrë që të njihen si të fiskalizuara. Këto pajisje shfrytëzojnë memoriet e zhvilluara elektronike të integruara në regjistruesit e arkave ose sistemet e zhvilluara me bazë kompjuterike për regjistrimin e transaksioneve të shitjes, printimet e tyre nëpërmes printerëve fiskal dhe certifikimin e tyre nëpërmes pajisjeve fiskale elektronike për nënshkrim dhe pajisjeve të ngjashme. PEF shfrytëzohet për lëshimin e kuponëve fiskal për të hyrat.[28]

## REKOMANDIME

Është shumë e rëndësishme dhe një ndihmesë e jashtëzakonshme që të mundësohet pagesa e TVSH-së në brendi të vendit edhe për mallrat e importuara bizneseve që merren me importimin e produkteve dhe shërbimeve. Pagesa e TVSH-së do të ishte mirë të bëhej nga shitësi me pakicë i cili ndodhet në fundin e zingjirit të shitjes. Pra, shitësi i cili bën shitjen finale te konsumatori final, të bëjë shtypjen e kuponit fiskal dhe me këtë të krijohet obligimi për pagesë të TVSH-së në muajin vijues.

Në rastin kur importuesi bën shitjen me shumicë apo me destinimin për shitje të mëtutjeshme, dyqaneve, rrjeteve të marketeve apo ndonjë subjekti juridik atëherë faturimi të bëhet pa e ngarkuar blerësin me TVSH. Blerësi juridik të nënshkruaj faturën, të vulosë atë dhe në përshkrim të faturës të shkruhet një formë e deklaratës me tekstin: "malli është për shitje të mëtutjeshme". Zbatuesit e ligjit apo tatimmbledhësit, në rastin konkret Administrata e Kosovës e Kosovës të jetë profesionale, e përgjegjshme, transparente dhe e pa korruptuar dhe në mardhënien me blerësin të sillet sipas fjalës popullore " Merre mjaltin por mos e thyej kosheren" që nënkupton që ta mbledh tatimin por në asnjë mënyrë mos ta dëmtoj biznesin.

Me implementimin e ligjit të ri për TVSH do ishte e nevojshme shtimi i numrit të inspektorëve që detyrë prioritare do kishin regjistrimet e stoqeve te subjektet afariste në mënyrë që mos të ketë invazion fiskal nga bizneset e papërgjegjshme.

Përdorimi i paisjeve elektronike fiskale do ishte i nevojshëm të bëhej nga të gjitha bizneset pa dalim madhësie dhe teritori. Me këtë do të luftohej ekonomia informale dhe kështu do kishte barazi dhe konkurencë lojale për bizneset pa dallim.

Pagesa e TVSH-së të behet nga biznesi i cili është i fundit në zingjirin e shitjes. Kjo formë është perdorur para 20 vitesh në ish sistemin, dhe e njejta përdoret edhe sot kudo në Europë dhe në këtë mënyrë lehtëson të bërit biznes për kompanitë.

Nuk është praktikë e mirë që bizneset që merren me importe të detyrohen ta bëjnë pagesen me rastin e zhdoganimit të

[27] https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/10/DoracakuTVSH_ALB.pdf , faqe 17
[28] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11015 . faqe 3

mallrave pasi që është një barrë që ju krijohet padrejtësisht.
Ligji i ri i propozuar për TVSH-në nuk ka implikime buxhetore afatmesme apo afatgjata sepse TVSH përseri do të vilet dhe do jetë në buxhetin e shtetit mesatarisht pas 2 deri 4 muajve nga momenti kur malli importohet.
Bizneset importuese do kërkojnë më pak financime nga bankat komerciale dhe kështu bankat do të orientojnë përkrahjen e tyre në bizneset prodhuese dhe agrokulturë. Rritja e prodhimit të produkteve vendore gjithashtu do të mundësoj që ekonomia jonë të ketë rritje të qëndrueshme, të përmirësohet balanca tregtare e vendit dhe të kemi një ekonomi stabile, rritje të punësimit dhe me këtë edhe stabilitet ekonomik e social.

## Bibliografia


[1] Dokumenti per Konsultim per Projekt ligjin per TVSH 15 07 2018.doc (live.com)
[2] LIGJI NR. 05/L-037 PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR/SHTOJCA (rks-gov.net)
[3] https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/10/DoracakuTVSH_ALB.pdf
[4] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11015
[5] https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdfn
[6] https://kt-to.org/sh/reports
[7] https://bqk-kos.org/nsdp/sq/
[9] https://bqk-kos.org/nsdp/sq/ Faqja Përmbledhëse e të Dhënave Kombëtare (FPDK) (bqk-kos.org)
[10] https://zeri.info/ekonomia/437263/dogana-ne-vitin-2021-grumbulloi-1-37-miliard-euro-importi-arriti-ne-4-6-miliarde-euro/

# Dukuria e rimarrjes së kundrinës në mediet e shkruara në Kosovë

**Prof. Qëndrim Morina**
Gjimnazi "*Hasan Nahi*", Prishtinë (Kosovë)
*Qmorina93@gmail.com*

**ABSTRAKT**

Përgjithësisht, dukuritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike në shqipe grupohen në: *dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen në mbarë shqipen* dhe *në dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen vetëm në dialektin e jugut apo toskërishte.* Të dyja format gjejnë mbështetje në kushtet historike, situatat etnike etj.

Marrëdhëniet shumëshekullore ndërmjet popujve të Ballkanit kanë bërë që gjuhët e tyre të zhvillohen e të përhapin dikonizma. Këtu është fjala për bashkëpërkime dhe paralelizma që janë përftuar gjatë zhvillimit të gjuhëve ballkanike. Ballkanizmat nuk kanë pasur përhapje të njëjtë në të gjitha gjuhët e Ballkanit. Shqipja në gjuhët e sotme të Ballkanit ka pasur përhapje të madhe dhe ndryshime gjatë evolucionit të tyre.

Siç dihet, *Ballkanizmat janë faktet e dukurive gjuhësore të përbashkëta të gjuhëve të popujve të Ballkanit.* Ballkanzimat kryesorë janë:

- *Prapavendosja e nyjës shquese (*e ndeshim në: shqipe maqedonishte, greqisht);
- *Formimi i kohës së ardhme me ndihmën e foljes ndihmëse dua (*e ndeshim në: shqipe, greqishte, maqedonishte);
- *Njësimi formal i rasave dhanore e gjinore (*e ndeshim në: shqipe, greqishte, maqedonishte);
- *Zëvendësimi i paskajores me lidhore (*e ndeshim në: shqipe, greqishte, rumanishte);
- *Rimarrja e kundrinave me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë (e* ndeshim në: shqipe, greqishte, maqedonishte, rumanishte).

Në këtë korpus jemi munduar të kundrojmë rrafshin strukturor dhe funksional të dukurisë së rimarrjes së kundrinave, si dhe zhvillimin e tyre në shqipen e sotme *(si bazë kemi marrë disa gazeta ditore të Kosovës)*. Brenda këtij hulumtimi kemi pasur parasysh edhe përdorimin e kundrinave me karakter stilistik.

Si pikënisje kemi shqyrtuar veprat e autorëve që janë marrë me këtë dukuri, si: Kolec Topalli, Besim Bokshi, Oda Bucholz, Victor Friedman etj.

Në këtë punim jemi munduar që të caktojmë edhe faktorët që kanë ndikuar në rimarrjen e kundrinës, si dhe elementët që përbëjnë atë kundrinë. Nxitur nga hipoteza se shfaqja e kësaj dukurie do të jetë e kushtëzuar nga një a më shumë faktorë gjuhësorë, kemi synuar sqarimin e këtyre faktorëve të brendshëm gjuhësorë që e kanë krijuar dukurinë dhe mbështetur në këta faktorë, parashikimin e zhvillimit të kësaj dukurie. Përzgjedhja ka përfshirë edhe përndarjen dialektore, e cila ka shërbyer si model krahasimi me format normative.

**Fjalët kryesore:** gjuhë ballkanike, rimarrje e kundrinave, ballkanizma, dukuri gjuhësore etj.

## Origjina e rimarrjes së kundrinës

Sipas Demirajt (1988: 609), rimarrja e kundrinës nuk është një dukuri e izoluar e gjuhës shqipe. "Ajo është përftuar nga gjuhë të tjera ballkanike: rumanishtja, maqedonishtja, bullgarishtja dhe greqishtja" (Demiraj, 1988: 611).

Rimarrja e kundrinave në gjuhën shqipe paraqet një mënyrë të të shënjuarit të kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë në rasën dhanore dhe kallëzore. Kjo dukuri gjuhësore dëshmohet edhe në një varg gjuhësh të tjera evropiane; ndër to bën pjesëshumica e gjuhëve ballkanike dhe romane. Ndër gjuhët ballkanike që shfaqin dukurinë e rimarrjes së kundrinave duhen përmendur përveç shqipes, bullgarishtja, maqedonishtja, greqishtja e re, rumanishtja, arumanishtja si dhe torlakishtja (*e folme e serbishtes*).

Sipas Olivera Jashar- Nasteva (1988: 43), dyfishimi i kundrinës në maqedonishte është vërejtur në shek. XIII dhe se

këtë gjuhë vërehet njëfarë pabarazie.
Në bullagrishten letrare sipas Demirajt (1998: 60), rimarrja e kundrinës ka karakter fakultativ. "Mirëpo, ndryshe nga gjuha shqipe dhe gjuha maqedonishte, dyfishimi i kundrinës në bullgarishte është krejtësisht josistematik dhe në këtë mënyrë kryefjala kalon nga një variacion, i cili është i lidhur me diskursin." (Kallulli dhe Tasmowski, 2008: 49).
Pra, sipas Friedmanit (2008: 88), kryefjala përbën ndryshim diskursi.
P.sh.: Vajzës *ia* jep librin.
Mendojmë që kjo rimarrje në këtë shembull për shqipen është i pranueshëm, por nuk jemi të sigurt për maqedonishten e bullgarishten.

**Trajtat e shkurtra dhe ngatërrimet që bëhen me to gjatë rimarrjes së kundrinës**

Gjatë zhvillimit historik të gjuhës shqipe janë krijuar edhe trajtat e shkurtra të përemrave vetorë ose ndryshe i quajmë edhe si forma të patheksuara, që përgjithësisht ndryshojnë në trajtë nga përemrat e theksuar duke pësuar shpeshherë reduktime e rënie të disa formave.
Sipas R. Përnaska (2010: 59), Da Lecce qe i pari që vuri re që shqipja ka trajta të shkurtra të përemrave vetorë, që më 1716.
Trajtat e shkurtra përdoren edhe si kundrina të drejta dhe kundrina të zhdrejta (pa parafjalë) dhe përseritëse të tyre. Përdorimi i tyre (kallëzore) varet nga theksi logjik i fjalisë. Kur theksi logjik bie mbi kundrinën e drejtë, trajta e shkurtër nuk përdoret, kurse kur theksi logjik bie mbi ndonjë pjesë tjetër të fjalisë dhe kundrinat shprehen me një emër të shquar apo me përemër, trajtat e shkurtra janë të detyrueshme për të rimarrë kundrinën e drejtë, e cila në këtë situatë ka funksionin e temës.
P.sh.: 1. Bleva **një fletore.** (*kundrinor i panjohur*)
2. E lexova **librin**. (*kundrinor i njohur*) – libri për të cilin të kam folur.
Siç shihet, në shembullin e dytë, kemi të bëjmë me një kundrinor të njohur për dëgjuesin, d.m.th. theksi bie mbi foljen dhe jo mbi kundrinorin.
Shembuj të tjerë ilustrues:
Flora **i** kishte takuar shokët e gjimnazit.
Flora **kishte takuar** shokët (dhe jo shoqet) e gjimnazit.
Në bazë të këtyre dy shembujve (*1,2*) vërejmë që topika (rendi) nuk është faktor kyç për rimarrjen e kundrinave.
Disa autorë të vjetër të shqipes (*Buzuku, Budi*) i kanë përdorur edhe rastet kur në një fjalë përdoren dy forma të patheksuara, njëra në funksionin e kundrinës së drejtë dhe tjetra në atë të kundrinës së zhdrejtë. Një përdorim të tillë kemi edhe sot.
P.sh.: 1. Ta dhashë **ty**, ose **Ty** ta dhashë (jo dikujt tjetër).
2. "Buxheti të dëmton **ty** vetëm për çastin, ndërsa loja jote më futë në qorrsokak", u shpreh deputeti. (Kosova sot, 2018: 9)
Shembuj të tjerë ilustrues të përdorimit të trajtave të shkurtra dhe ngatërrimet që bëhen me to gjatë rimarrjes së kundrinave:
"Habia e madhe **ia** kish pre **fjalën të dyve**, e asnjani s'dinte si me thye heshtjen në të cilën krisshin lugët tue u përpjek në çinija." (Koliqi, 1925: 91)
Në shembullin (1), sipas formave normative do të duhej që trajta e shkurtër e bashkuar **ua** të ishte në vend të asaj **ia**, sepse kundrina e zhdrejtë është në numrin shumës *të dyve* **u** + *fjalën* **e** dhe **u** + **e** na jep rezultatin **ua**.
"Ia shtrëngoi dorën me miqësi të përzemërt të gjithve." (Koliqi, 1925: 59)
Në shembullin (2), sipas formave normative do të duhej që trajta e shkurtër e bashkuar **ua** të ishte në vend të asaj **ia**, sepse *kujt ua shtrëngoi dorën? – të gjithëve,* d.m.th. **u** + **e** na jep rezultatin **ua**.
"Vuçiqi dërgoi një mesazh të qartë. Serbia nuk ju frikësohet atyre." (Koha ditore, 2018: 9)
Në shembullin *(3)* kemi të bëjmë me ngatërrimin e trajtës së shumësit **ju** për *juve* me trajtën **u** për *atyre.*
"Mos i jepni shqiptarëve ilaçe për rimburësim." (Koha ditore, 2018: 12)
Në shembullin (*4*) kemi të bëjmë me ngatërrimin e trajtës së shkurtër **i** për *atij-asaj* me **u** për *atyre*.

## Rimarrja e kundrinave në medie të shkruara në Kosovë

***(Rezultatet dhe gjetjet)***

Rimarrja e kundrinave gjatë përdorimit në mediet e shkruara (*gazeta ditore*) në Kosovë, përbën një nga domenet më të rëndësishme dhe gjithashtu ngjall interes studiimi për intervalin e përdorimit të tyre.
Siç thamë edhe në fillim, ky punim u bazua në dy gazeta ditore të Kosovës: "*Koha ditore*" dhe "*Zëri*"- me nga dhjetë numra hulumtimi për të dyja, pra, njëzet numra. Në këta numra kemi vërejtur që rimarrja e kundrinës nuk tregon përdorim aq të madh, krahasuar me numrin e fjalëve të përdorura. Denduria e tyre dallon nga faqja në faqe, duke u paraqitur në forma të ndryshme.
Në numrin e gazetës "*Koha ditore*" (2018: 7673) kemi hasur në 22 raste (0.15%) të përdorimit të rimarrjes së kundrinës së zhdrejtë. Nga ky numër, 18 raste (0.12%), rimarrja e kësaj kundrine ka ndodhur me trajtat e shkurtra **i**,**u,** kurse 3 raste (0.02%) është dyfishuar me anë të trajtave të shkurtra të bashkuara në rasën dhanore dhe kallëzore dhe vetëm në një 1 rast është rimarrë me vetën e parë njëjës **mua më**. Në këtë numër kemi hasur edhe në 8 raste kur është dashur të rimerret kundrina e zhdrejtë, e cila shprehet me trajtë të shkurtër në rasën dhanore.
Përpos rimarrjes së kundrinës së zhdrejtë, në këtë numër kemi hasur edhe rimarrjen e kundrinës së drejtë. Ky numër ka pasur një përdorim prej 68 rasteve (68%) të rimarrjes së kundrinës së drejtë, kur në 8 raste (0.05%) nuk është rimarrë.
Vlen të theksohet që rastet kur nuk është shprehur rimarrja ka ndodhur kur është shprehur me një emër të shquar ose grup emëror në rasën kallëzore apo me trajtë të shkurtër. Pra, kjo mosrimarrje e kundrinës së drejtë ka ndodhur në 6 raste (0.44%).
Nga gjithsej 68 raste, kundrina e drejtë është rimarrë në trajtat e shkurtra: **e** (29 herë), **i** (15 herë), **ta** (8 herë), **t'i** (14 herë), **na e** (1 herë) dhe **ju** (1 herë).
*Shembuj ilustrues:*
I ftohti i madh që mbizotëronte në Prishtinë nuk **i** kishte ndaluar **qindra qytetarë** që të protestonin. (Kosova sot, 2018: 6)
Gruevski konfirmoi se **ju** sigurua azili politik në Hungari. (Koha ditore, 2018: 15)
Pas takimeve të grupeve punuese pas nisjes së implementimit, atëherë ne **e** bëjmë **një gjë të tillë**. (Koha ditore, 2018: 2)

Në gazetën "*Zëri*" (2018: 6051) kemi hasur në përdorimin e rimarrjes së kundrinës. Në 30 raste, sa ishin gjithsej, në 10 prej tyre, kundrina nuk është rimarrë, kur do të duhej të rimerrej.
Shembuj ilustrues:
Krerët shtetërorë urojnë **besimtarët** myslimanë për muajin e Ramazanit. (Zëri, 2018: 5)
*Siç shihet, në këtë shembull (1), mungon rimarrja e kundrinës.*
Presidenti Thaçi dhe kryeministri Haradinaj, por edhe subjekte të ndryshme politike, **i** kanë uruar **besimtarët** islamë të Kosovës me rastin e fillimit të muajit të shenjtë të Ramazanit. (Zëri, 2018: 9)
*Siç shihet, në këtë shembull (2) është rimarrë kundrina*.

Nga kjo që pamë mund të përcaktojmë faktorët që ndikojnë në rimarrjen e kundrinës: *funksioni në strukturën temë-remë, shquarësia e emrit, theksi logjik, theksi i fjalisë dhe tipi i kundrinës.*

## Përfundime

Në këtë hulumtim jemi munduar të paraqesim në formën origjinale, pra, ashtu siç janë përdorur format gramatikore të rimarrjes apo mosrimarrjes së kundrinave.

Nxitur nga hipoteza kryesore se rimarrja e kundrinës në mediet e shkruara në Kosovë nuk rimerret, jemi munduar të përcaktojmë faktorët kryesorë, që bëjnë ndikimin.

Siç e kemi cekur edhe në fillim, korpusi i këtij hulumtimi ngushtohej në mediet e Kosovës, respektivisht, në gazetat "Koha ditore" dhe "Zëri"- me nga dhjetë numra për secilën.

Në këtë hulumtim kemi pasur parasysh edhe sasinë e fjalëve të përdorura kundruall rimarrjes së kundrinës. Gjithashtu, përmes këtij korpusi kuptuam edhe faktorët që ndikojnë ri (mos)marrjen e kundrinës, siç janë: *funksioni në strukturën temë-remë, shquarësia e emrit, theksi logjik, theksi i fjalisë dhe tipi i kundrinës.*

## Bibliografia


Agalliu, Fatmir & all (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe (Morfologjia)*, vëllimi I, AShSh, Tiranë.
Ajeti, Idriz (1985). Studime gjuhësore në fushë të shqipes III, Rilindja, Prishtinë.
Beci, Bahri (1980). *Gjuha shqipe 8*, Dukagjini, Pejë.
Bokshi, Besim (2004). *Për vetorët e shqipes,* AshAK, Prishtinë.
Demiraj, Shaban (1988). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
Demiraj, Shaban (1994). *Gjuhësi Ballkanike,* Logos- A, Shkup.
Friedman, Viktor (1994). *Ballkan objekt reduplication in areal and dialectologica*, 1994.
Kallulli & Tasmowski (2008). *Clitic Doubling in the Ballkan Languages,* Amsterdam.
Liberacka, Kamila (2009). *Gjurmime Albanologjike*, Seria e Shkencave Albanologjike, IAP, Prishtinë.
Memushaj, Rami (2004). *Shqipja standarde*, Toena, Tiranë.
Përnaska, Remzi (2009). *Çështje të studimeve diakronike të shqipes,* AShAK, Prishtinë.
Rugova, Bardh (2009). *Gjuha e gazetave*, Botimet Koha, Prishtinë.
Topalli, Kolec (2008). *Evolucioni historik i përemrave të shqipes*, AShSh, Tiranë.
Kelmendi, Tafil (2010). *Funksionet sintaksore të ndryshme me paskajore në gjuhën shqipe*, IAP, Prishtinë.

# Pluralizmi politik në Maqedoninë e Veriut – Lindja, orientimet dhe veçoritë e pluralizmit dhe partive politike

**Mr. Ilir Mustafa**
Tetovo, Republic of North Macedonia, ilirmustafa1993@gmail.com

***Abstract***
*Political pluralism is one of the core values of representative democracy, by which competition between political parties to govern state power is assured and promoted. This value of democracy will come into effect only after the separation of North Macedonia from the former Yugoslav Federation. The peculiarity of Northern Macedonia, unlike other states of the former Yugoslavia, is that it abandoned political monism without war. The political transition brought about a large number of political parties that transcended civic interests, with the rapid development of pluralism leading to some parties having the same political platforms. The political parties in Northern Macedonia, although pro-democracy civic parties, have actually functioned as ethnic parties. Albanian political parties generally have no significant program differences, but internal conflicts and the dominant position of political party leaders have led to the creation of a relatively large number of political parties created by division or merging.*
***Keywords: Political pluralism, political parties, representative democracy.***

***Abstract***
*Pluralizmi politik është një ndër vlerat kryesore të demokracis përfaqësuese, me anë të së cilit sigurohet dhe jetësohet konkurenca në mes partive politike për të udhëhequr me pushtetin shtetërorë. Kjo vler e demokracisë do gjejë zbatim vetëm pas shkëputjes së Maqedonisë së Veriut nga ish Federata Jugosllave. Veçori e Maqedonisë së Veriut për dallim nga shtetet tjera të ish-Jugosllavisë është se ajo e braktisi monizmi politik pa luft. Tranzicioni politik solli një numër të madhë të partive politike i cili tejkalonte interesat qytetare, ku nga intenziteti i shpejt i zhvillimit të pluralizmit ndodhte që disa parti të kenë platforma të njejta politike. Partitë politike në Maqedoninë e Veriut edhe pse shiten si parti qytetare realisht ato kanë funkisonuar si parti etnike. Partitë politike shqiptare kryesishtë nuk kanë dallime të theksuara programore, por konfliktet e brendëshme dhe pozita dominuese e kryetarëve të partive politike kanë sjell deri tek krijimi i një numri relativisht të madh të partive politike të krijuara me ndarje ose bashkimin e tyre mes veti.*
**Fjalët kyçe: Pluralizmi politik, partitë politike, demokracia përfaqësuese.**

## Lindja e Pluralizmit Politik në Maqedoni

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në të gjithë territorin e Jugosllavisë vinte në shprehje vetëm monizmi politik. Edhe pse ekzistonin edhe disa parti politike ato ishin vetëm figurativisht sepse ato ishin nën hijen dhe kontrollin e potë të partisë komuniste. Gjatë fundit të shekullit XX të gjitha njësit federative të Jugosllavisë filluan qoftë me dhunë ose paqe, që të shkëputen prej Federatës dhe të formojnë shtetet e tyre të pavarura, e të përqafojnë demokracinë dhe pluralizmin politik. Maqedonia e Veriut ishte shteti i vetëm i cili u shkëput prej federatës në mënyrë paqësore. Realisht, Republika e Maqedonisë së Veriut ishte ndër republikat e fundit të Federatës Jugosllave e cila vendosi të orientohet prej monizmit politik në pluralizëm politik.[29] Kjo ndodhi si pasoj e kundërshtimit të madh nga Lidhja e Komunistëve të Maqedonisë, për arsye se me pranimin e pluralizmit politik do të cënoheshin interesat e tyre dhe pozita e tyre në pushtet nuk do ishte e sigurt. Megjithatë me 21 shtatorë të vitit 1990 pas shumë debatesh dhe kundërthëniesh Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë miratoi amendamentet kushtetuese prej LVII deri LXXXI[30] me anë të së cilave u përcaktua liria e organizimit dhe veprimit politik dhe shteti kaloj prej monizmit politik në pluralizëm politik. Në të njëjtën ditë Kuvendi solli ene Ligjin për zgjedhjen dhe revokimin e deputetëve dhe këshilltarëve[31], dhe kështu u hapën dyert për organizimin e zgjedhjeve të para shumëpartiake, me të cilat vjen në

[29] Tanja Karakamisheva, “Izbori i Izborni Sistemi”, Shkup, fq. 246
[30] Amendametet në kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, Gazeta Zyrtare nr. 28, 1990.
[31]Ligji për zgjedhjen dhe revokimin e deputetëve dhe këshilltarëve, Gazeta Zyrtare nr. 28, 1990.

shprehje dhe fundi i monizmit politik. Kuvendi i RS të Maqedonisë aprovon 25 amendamente të Kushtetutës së RSM-së nga viti 1974, me çka bëhen ndryshime radikale në sistemin shoqëror-ekonomik dhe politik. Një gjë e tillë e shënon fillimin e tranzicionit të shtetit drejt sistemit të ri parlamentar dhe drejt krijimit të shtetit sovran dhe të pavarur. Mes tjerash me amendamentet kushtetuese mundësohet pluralizëm politik dhe pronësor[32]. Më 11 nëntor u organizuan zgjedhjet e para shumëpartiake dhe në bazë të tyre u formua edhe kuvendi i parë pluralist i Maqedonisë së Veriut. Kuvendi i parë pluralist mori tre vendime shumë të rëndësishme për të armen e shtetit, Deklaratën e Pavarësisë së Maqedonisë, referendumin për shtet të pavarur dhe Kushtetutën si akt më i lart juridik. Vlen të theksohet se organizimet politike të shqiptarëve nuk e përkrahen dhe e bojkotuan referendumin si dhe nuk e dhanë pëlqimin e tyre për Kushtetutën. Me sjelljen e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë me nenin 8 të saj, pluralizmin politik dhe zgjedhjet e lira, të drejtpërsëdrejti dhe demokratike i llogarit si vlera të rendit kushtetues së vendit[33]. Me Kushtetutën e re Maqedonia e Veriut thiret në shtet demokratik ku pushteti i takon popullit, garanton lirit dhe të drejtat e njeriut, shtetin ligjor, kufizimin dhe ndarjen e pushtetit shtetëror, pluralizmin politik etj.

**Partitë Politike Dhe Orientimi i Tyre Programor**

***Lindja e partive politike maqedonase***

Me ndryshimet kushtetuese të cilat krijuan mundësi për pluralizëm në Maqedoni për një kohë shumë të shpejt u krijuan një numër i madh i partive politike, ku ndodhte që mes vete të kenë edhe program të njëjtë politik, për shkak të krijimit të tyre në periudha shumë të afërta kohore dhe mosnjohja e statuteve të njëra tjetrës. Qysh në fillim u vërejt që numri i madh i partive politike i tejkalonte nevojat e vërteta të tregut politik. Pluralizmi politik në Republikën e Maqedonisë është zhvilluar me një intensitet të shpejt, këtë e dëshmon fakti se në gjyqin e Apelit në Shkup në periudhën kohore nga viti 1991 deri në vitin 1998, janë regjistruar 88 subjekte politike dhe shoqata qytetare.[34] Vetëm gjatë vitit 1991 janë regjistruar 21 parti politike. Veçori e pluralizmit politik në Maqedoni është se partitë politike janë të organizuara në baza etnike. Të gjitha përkatësit etnike në vend janë të përfaqësuara nga partitë e tyre të pastra etnikisht, edhe pse ato në statutet dhe programet e tyre paraqiten si parti të hapura për të gjithë, ato kanë për qëllim kryesor tërheqjen e votuesve të përkatësisë përkatëse. Qysh në fillim nga disa parti politike u proklamua ideja "shoqëri për të gjithë" mirëpo kjo ide nuk gjeti mbështetje nga elektorati dhe për një kohë të gjatë u shua, për tu ringjallur përsëri pas më shumë se 20 viteve ku edhe do të gjej përkrahje nga qytetarët. Sot numërojmë një numër të madh të partive politike, por ne do ti shtjellojmë vetëm ato më kryesore dhe ato që kanë lënë gjurmët e tyre në pluralizëm.

*Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë*- LSDM është partia e cila e trashëgoj Lidhjen e Komunistëve të Maqedonisë, ku me ndryshimet kushtetuese u ndryshua edhe klima politike dhe kjo ndikoj edhe në Lidhjen Komuniste të Maqedonisë. Në qershor të vitit 1990 u formua Lidhja e Komunistëve të Maqedonisë- Partia për Transformim Demokratik. Në prej prillit 1991 kjo parti përsëri bëri ndryshime për ndërrimit e emrit të saj në LSDM. Vendimi për të ndryshuar emrin nga LKM-PTD në LSDM është marrë në Kongresin e 11-të të LKM-PTD[35]. Kjo parti arriti që me sukses ti përdor të gjitha favoret si parti trashëguese, duke shfrytëzuar organizimin, financat si dhe burimet njerëzore të LKM-së. LSDM u përcaktua si parti e cila do të angazhohej për interesat e qytetarëve dhe ato shtetërore dhe do jetë parit për të gjithë qytetarët.. Me programin e saj ajo e llogarit vetën si parti e majtë, e cila do vepronte sipas parimeve bashkëkohore të social-demokracisë, e që bazohet në mirëqenie shoqërore e ekonomike. LSDM angazhohet për integrimin e vendit në NATO dhe BE, dhe ishte partia kryesore e bllokut maqedonas që bëri hapa konkret për vendosjen e miqësisë së mirë me shtetet fqinje dhe dha kontributin e saj për ndërrimit të emrit të Maqedonisë, si një ndër kushtet kryesore për integrimin perëndimor të vendit. Gjithashtu në zgjedhjet e vitit 2016 ajo e proklamoj edhe konceptin qytetar me qëllim të prishjes së barrierave ndëretnike, dhe në radhët e saj u anëtarësuan edhe një numër i madh i qytetarëve jomaqedon, ku disa prej tyre u zgjodhën edhe si përfaqësues në Kuvend. Sot LSDM është një nga partitë më me ndikim në vend.

*MAAK* - Partia e parë politike që njeh pluralizmi i Maqedonisë është *Lëvizja për Aksion Mbarëmaqedonas*-MAAK. Kjo parti u regjistrua në qershor të vitit 1900. Ishte ndër partitë e para që u angazhua për pavarësimin e

---

[32] www.sobranie.mk/content/Парламентарен%20институт/Историја%20на%20парламентаризам-ALB.pdf
[33] Kushtetuta e R.M, neni 8, Gazeta Zyrtare e R.M nr. 52, 1991
[34] Jusuf Zejneli, "Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë", Tetovë, 2013, fq. 51
[35] http://www.sdsm.org.mk/Istorija-na-partijata.aspx

Maqedonisë. MAAK dallonte prej partive të tjera sepse ajo pretendonte se çështja e maqedonasve ishte ende e pazgjidhur, ajo proklamonte identitetin maqedonas si vazhdimësi e maqedonasve antik. MAAK do të angazhohet për mbrojtjen e interesave të maqedonasve që jetonin jasht territorit të shtetit veçanërisht në shtetet fqinje, me mënyra paqësore nëpërmes dialogut dhe bashkëpunimit. Kjo parti u radhit si parti e qendrës së djathtë si parti konservatore por ajo realisht ishte parti nacionaliste e së djathtës. Megjithatë kjo parti nuk arriti që të korte sukses në skenën politike, ku në asnjë cikël zgjedhor nuk arriti që të fitoj as edhe një mandat. Ajo dy herë ndërrojë emrin e saj dhe pas zgjedhjeve të vitit 2002 ajo u shkri në partin e VMRO-DPMNE-së.

VMRO-DPMNE është një ndër partitë kryesore të Maqedonisë. Më 5 gusht të vitit 1990 u regjistrua si parti politike VMRO-DPMNE (*Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase- Partia Demokratike për Unitet Nacional Maqedonas*). Kjo parti veten e llogarit si vazhdimësi e VMRO-së si Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase e cila luftoj për çlirimin e Maqedonisë nga pushtuesit osman, dhe për krijimin e Maqedonisë si shtet i pavarur, demokratik dhe ekonomin e lirë të tregut. VMRO-DPMNE ishte ndër partitë kryesore që mbështeti idenë për ndarjen e Maqedonisë nga Federata Jugosllave dhe krijimin e shtetit të pavarur dhe instalimin e demokracisë. Qëllimi i krijimit ishte "kthimi i dinjitetit dhe krenarisë së popullit dhe shtetit maqedonas" dhe "bashkimi i tërësishëm shpirtëror, politik, ekonomik dhe etnik i shtetit maqedonas të copëtuar, në Bashkimin Europian". Kjo parti u angazhua për instalimin e demokracisë në shtet dhe zhvillimin e shpejt të ekonomisë së lirë të tregut dhe pronës private. Në fillimet e saj vërehet qartë një dozë e tepruar e nacionalizmit dhe platformës së saj nacionaliste radikale, por ajo gjatë viteve evoluoj dhe u moderua. Si qëllime dhe detyra të saja ajo llogarit: zhvillimin dhe prosperitetin e Maqedonisë së pavarur dhe sovrane, shteti ligjorë, ngritjen e dinjitetit dhe vlerave shpirtërore të popullit maqedonas, qytetarëve dhe shtetit Maqedonas, anëtarësimin e shtetit në NATO dhe BE[36] etj. Edhe pse vetën e llogarite si parti demo-kristiane ajo në realitet është një parti e djathtë nacionaliste. Përkundër qëllimeve statutare ajo tenton ta përforcoj lidhjen e maqedonasve me maqedonasit antik, dhe nuk ndërmori veprime për integrimin e vendit në NATO dhe BE duke mos vendosur raporte të mira fqinjësore dhe duke mos e zgjidhur problemin e emrit me Greqinë. Edhe pse proklamon partneritet me shtetet perëndimore ajo në praktik është parti pro-serbe dhe pro-ruse. Kjo parti njihet për fjalorin e saj nacionalist dhe antishqiptar.

*Partia Liberale-Demokratike-* kjo parti u krijua si bashkim i dy partive, Partisë Liberale dhe Partinë Demokratike. Partia Liberale u formua më 1993 si vazhdimësi e Lidhjes së Forcave Reformiste të krijuar me iniciativë të kryeministrit të fundit të RSFJ-së Ante Markoviq. Partia Liberale u angazhua për idenë e "formimit të shoqërisë qytetare", me qëllim të zhvillimit shoqërorë në paqe dhe bashkëjetesës së popullit maqedonas me nacionalitetet tjera. Për Partia Liberale zhvillimi Decentralizimi dhe transformimi i shoqërisë maqedonase kishin rendësi të veçantë. Edhe Partia Demokratike u formua më vitin 1993, me idenë për bashkimin e të gjitha forcave demokratike pavarësisht cilës kombësi i takojnë, të cilat mbi të gjitha angazhohen për interesat dhe mirëqenien e shtetit. Partia Demokratike u radhit si parti e djathtë me ideologji liberale. Më vitin 1997 në Shkup u mbajt Kongresi i bashkimit të PL-së dhe PD-së dhe u formua PLD. Programi i PLD ishte një përzierje e programeve të dy partive të mëhershme. PLD u përcaktua për integrimin e vendit në strukturat euro-atlantike dhe në zhvillimin e shtetit ligjor, lirive dhe të drejtave të qytetarëve, krijimin e marrëdhënieve të mira me fqinjët, si dhe përmasimin dhe avancimin e marrëdhënieve ndëretnike si një detyrë më kryesore. Edhe pse kjo parti kishte një program shumë përparimtar, ajo nuk arriti që të qëndroj një kohë më të gjatë në skenën politike si rezultat i mospasjes sukses në proceset zgjedhore dhe më vitin 2000 u riformua Partia Liberale si parti e veçantë.

Gjatë gjithë pluralizmit politik janë formuar një numër i madh i partive politike, shumica e të cilave janë formuar edhe me anë të bashkimit apo shkëputjes nga ndonjë parti politike. Sot shumica e partive politike maqedonase ose kanë pushuar së ekzistuari ose janë shkri në koalicionet e partive më të mëdha politike. Si parti më të njohura të cilat janë krijuar me ndarje nga VMRO respektivisht LSDM dhe vazhdojnë jetën e tyre politike, janë VMRO-Popullore dhe PRSD-Partia e Re Socialdemokrate, të cilat janë parti të reja me politikan të vjetër. VMRO-popullore u krijua nga personat e pakënaqur nga udhëheqsha e VMRO-DPMNE dhe kjo ka një program politik thuajse të ngjashëm me partin nga e cila rrjedh. PRSD Poashtu u krijua nga pakënaqësi në LSDM, dhe kjo parti radhitet si parti e qendrës së majtë e cila do angazhohet për luftën kundër varfërisë.

---

[36] Statuti i VMRO-DPMNE, nr. 02-193/1, 2016, fq. 2-3.

***Partitë politike të bashkësive më të vogla etnike në Maqedoni***

Duke parë realitetin shumetnik të shtetit, edhe bashkësitë e tjera joshumicë si turqit, romët, boshnjakët, serbët shfrytëzuan ndryshimet kushtetuese për të qenë pjesëmarrëse në pluralizmin politik. Qysh në fillim të jetësimit të pluralizmit politik në Maqedoni, edhe minoritetet krijuan partitë politike të tyre me qëllim të përfaqësimit të bashkësive të tyre në jetën politike. Kështu këto parti i kanë dhënë një laramanitet pluralizmit politik në vend.

Turqit e Maqedonisë sot përfaqësohen me anë të disa partive ku më kryesore janë: Partin Demokratike të Turqve dhe Partia Lëvizja Turke. Të dy partitë politike kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të turqve në Maqedoni, duke mbrojtur identitetin e tyre kulturor, zhvillimin e arsimit, përdorimin e gjuhëve etj. Për dallim nga Partia Demokratike e Turqve e cila angazhohet më shumë për interesat komunitetit turk, Partia Lëvizja Turke si parti majtiste e llogarit vetën si parti pluraliste, multietnike, multikulturor dhe angazhohet për ngritjen e vlerave demokratike dhe zhvillimin e shtetit në të gjitha sferat e jetës.

Edhe romët kanë krijuar një numër të konsiderueshëm të partive politike, ku dy prej tyre dominojnë tek elektorati romë. Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve u krijua në gushtë të 1990 dhe Bashkimi i Romëve të Maqedonisë që lindi më vitit 1996. Këta dy parti nuk dallojnë shumë nga njëra-tjetra dhe të dyja kanë për qëllim përfaqësimin e interesave të romëve. Dallimet në praktik qëndrojnë më shumë se cilit partner të koalicionit ata i bashkohen.

Përveç turqve dhe romëve, edha vllahet dhe serbët kanë partitë e tyre politike, të cilat nuk është se dallojnë shumë nga partitë e tjera.

Partitë politike të minoriteteve për shkak të elektoratit më të vogël në numër dhe sistemit zgjedhorë ato nuk mundë që të vetëm të arrin pushtetin. Për këtë shkak për jetësimin e qëllimeve të tyre ata hynë në koalicione parazgjedhore me partitë më të mëdha maqedonase, me qëllim prekjen e pushtetit. Bashkësitë tjera joshumicë kanë pasur përfitime direkte politike prej veprimeve të shqiptarëve, qoftë prej konfliktit të armatosur të vitit 2001 ku me Marrëveshjen e Ohrit avancohen edhe të drejtat e të gjithë komuniteteve, qoftë në ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe në të gjitha sferat e jetës politike. Edhe pse ata gjithmonë kanë përfituar në kurriz të shqiptarëve, partitë shqiptare nuk kanë arritur që partitë e minoriteteve ti kthejnë kah veti, dhe kështu ata gjithmonë kanë qen të “strehuara” tek partitë maqedonase.

***Pluralizmi politik tek shqiptaret e Maqedonisë***

Shqiptarët e Maqedonisë pluralizmin politik nuk e pranuan vetëm si mundësi për krijimin e organizatave politike, por ai ishte mundësi e daljes prej errësirës politike për to. Ishte mundësi për shqiptarët të angazhoheshin për mbrojtjen e çështjes shqiptare në Maqedoni, sigurimin dhe avancimin e pozitës juridiko-kushtetuese dhe përmisimit të statusit të tyre si popullsi shtetformuese e jo si pakicë kombëtare.

Edhe pse nën pluralizëm politik grupet e qytetarëve kanë të drejtë në organizim politik, kjo gjë nga ana e maqedonasve shihej si “rrezik për shtetin dhe popullin maqedonas”, dhe si rrjedhojë e kësaj ndaj shqiptarëve ushtrohej një presion i madh politik dhe psikik, në mënyrë që ato të hiqnin dorë nga organizimet e tyre politike. Maqedonasit në fillim të viteve nëntëdhjetë iu impononin shqiptarëve një organizim politik të huazuar dhe të kontrolluar si nga brenda dhe nga jashtë.[37] Megjithatë shqiptarët përsëri krijuan partitë e tyre politike dhe për dallim nga partitë maqedonase, ato në fillim thirreshin si parti shoqërore ku në radhët e tyre do të mirnin pjesë edhe pjesëtarë të komunitete tjera. Sot kemi një nunër të madh të partive politike shqiptare i cili i tejkalon nevojat e shoqërisë shqiptare në Maqedoni.

Partitë e para politike që do të krijoheshin nga shqiptarët gjatë fillimit të viteve 90 ishin: Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratike Popullore.

*Partia për Prosperitet Demokratik*- në prill të vitit 1990 në fshatin Xhepçisht të Tetovës u mbajt Kuvendi Themelues i PPD, kurse e njëjta do të regjistrohet më 25 maj të po të njëjtit vit. PPD është partia e parë politike e shqiptarëve në Maqedoni. PPD ngjalli një eufori të madhe tek shqiptarët, të cilët përveç si parti politike PPD e llogaritshin edhe si “Lëvizje mbarëpopullore të shqiptarëve të Maqedonisë”. Ajo për një kohë shumë të shkurt arriti që të shtrinte ndikimin e saj në të gjithë territorin ku jetonin shqiptar dhe të formoj organet e saja partiake. PPD lindi si rezultat i nevojave të shqiptarëve gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë. Qëllimet e PPD ishin që krijimit të shtetit ligjor, definomi i statusit të shqiptarëve të Maqedonisë si popull shtet-formues, krijimin e një shoqërie të barabartë,

[37] Etem Aziri, “Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore”, Tetovë, 2015, fq. 142.

zyrtarizimin e gjuhës shqipe përkrah asaj maqedonase, zhvillimin e arsimit shqip etj. Mediat dhe partitë politike maqedonase PPD-në e quajtën si parti etnike e cila tentonte që të destabilizonte shtetin unitar të Maqedonisë. PPD këtë e kundërshtoj me anë të programit të saj, ku Partia për Prosperitet Demokratik theksoj se është parti qytetare, parti e qytetarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare, myslimane, turke, maqedonase etj. Këtë e dëshmoj edhe me zgjedhjen e Dushko Apostollovskit si sekretarë i parë i partisë i cili nuk i përkiste etnitetit shqiptarë. PPD theksonte se qëllimi i saj ishte prosperiteti i demokratik i të gjithë qytetarëve të vendit dhe se nuk është parti nacionale. Megjithatë ajo gjatë veprimit të saj politik vërehet se ishte parti politike që si pik kryesore kishte interesat e shqiptarëve, edhe pse në radhët e saj kishte edhe anëtarë të përkatësive të tjera etnike. Me zhvillimin shumë të shpejt të saj nuk u arrit që ajo të plotësoj interesat e të gjithë anëtarësisë së saj, dhe për këtë shkak do të fillojnë të krijohen grupacione brendapartiake, dhe do të ketë një luftë të brendshme e cila në fund do të rezultojë me shkëputjen e një pjese të partisë dhe formimin e një partie të re politike. PPD ishte partia e parë që mori pjesë në ekzekutiv që në konstituimit të parlamentit të parë pluralist. Si rezultat i ndarjes së saj në dy parti ajo do filloj ta humb primatin dhe në garat zgjedhore do të formoj koalicione parazgjedhore me qëllim të mbijetesës politike, por megjithatë ajo u shua përfundimisht në vitin e 2017 ku anëtarësia e saj, si e ndarë iu bashkëngjit dy partive opozitare shqiptare.

*Partia Demokratike Popullore*- u krijua në Tetovë në qershor të vitit 1990. Me krijimin e PDP do të jetësohet pluralizmi politik edhe brenda shqiptarëve. PDP dallohej për angazhimin e saj që të jetësonte realizimin e vetëvendosjes së popullit shqiptarë në territorin e ish-Jugosllavisë, si një nga të drejtat natyrore që duhet ti takoj çdo populli. PDP kishte një program mjaft të pasur dhe vizionar. Programi politik i PDP parashihte një Maqedoni të barabartë për të gjithë nacionalitetet, si shtet qytetar dhe binacional, si e vetmja mundësi për artikulimin e interesave të shqiptarëve PDP ishte partia e parë e cila llogaritte se çështjet me rëndësi të veçantë që i prekin interesat e popullsive joshumicë duhet që të zgjidhen me anë të konsenzualitetit. Ajo u angazhua për përdorimin e gjuhës shqipe në çdo nivel të arsimit dhe për krijimin e Universitetit të Tetovës. PDP edhe pse parti e re, ajo nuk kishte dallime të theksuara programore nga PPD, dhe deri diku qëllimet politike ishin të njëjta, pasi që të dy partitë politike angazhoheshin për mbrojtjen dhe avancimin e interesave të shqiptarëve të Maqedonisë brenda territorit të shtetit. Si pasoj e kësaj edhe një sërë veprimesh politike do të ishin veprime të përbashkëta të të dy subjekteve politike. PDP gjithmonë ngeli si parti sekondare nën primatin e PPD.

PPD dhe PDP u ishin parti që angazhoheshin për avancimin e interesave shqiptare në vend, ato bënë përpjeke të përbashkëta në vazhdimësi me qëllim arritjen e objektivave të tyre. Kuvendi i parë plural solli 3 vendime të rëndësishme për vendin edhe atë: Deklaratën për pavarësi, Referendumin për shtet të pavarur dhe Kushtetutën e shtetit. Asnjëra nga këto akte nuk gjeti përkrahje tek faktori politik shqiptarë, ngase sipas tyre ato nuk i përfaqësonin interesat e tërë shoqërisë dhe ishin diskriminuese ndaj shqiptarëve. Deklaratën e pavarësisë partitë shqiptare e llogaritën si akt politik por jo edhe juridik dhe ato qëndruan indiferent ndaj saj. Me qëllim që të jetësohen përcaktimet e Deklaratës për pavarësi të RSM, Kuvendi i RSM, në bazë të nenit 318 paragrafi 8 nga kompetencat e tij, sipas Kushtetutës së PSM të vitit 1974, si bartës kryesor i të drejtave dhe detyrimeve të RSM mori vendim për mbajtjen e referendumit në vitin 1991.[38] Referendumi u mbajt më 8 shtator 1991 i cili u bojkotua nga popullsia shqiptare. Më 17 nëntor 1991 Kuvendi miratoi edhe Kushtetutën si akti më i lart i shtetit, gjatë përpilimit të së cilës nuk kishte asnjë ekspert shqiptar. Kushtetuta nuk u votua nga deputetët shqiptarë. Këto 3 vendime kryesore të shtetit, faktori politik shqiptar i vlerësoj si akte të njëanshme, jo të drejta e të cilat nuk e pasqyronin realitetin etnik të shtetin dhe krijonin bazë për diskriminimin e popujve të tjerë joshumic. Pas mospërfilljes së interesave politike të shqiptarëve nga ana e faktorit politik maqedonas, faktori politik shqiptar formoi Kuvendin e Autonomisë dhe mori vendim për organizimin e referendumit për autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve të Maqedonisë. Referendumi u mbajt më 11 dhe 12 janar 1992, ku qytetarët duhej të deklaroheshin : "*A janë për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni*". Nga gjithsej 383.894 votues shqiptarë të regjistruar në 17 komunat përkatëse, në votim kishin dalë 361.627: prej tyre 361.263 kishin votuar "PRO" Autonomisë Politike–Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, 57 kishin qenë "KUNDËR" dhe 307 kishin qenë fletëvotime të pavlefshme.[39] Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratike Popullore morën një iniciativë të përbashkët për ndërrimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

---

[38] Vesna Mukoska Çingo, "Knstitucionalizmi", Shkup, 2007, fq. 174

[39] http://shenja.tv/themelimi-dhe-shuarja-e-autonomise-se-shqiptareve-ne-maqedoni/

Kjo iniciativë kishte për qëllim pengimin e politikave të maqedonasve dhe parandalimin e një konflikti të mundshëm ndëretnik. Ndryshimet kushtetuese duhet të jen në frymën e realitetit politik të shtetit shumetnik, vetëvendosjes së popujve si e drejt natyrore dhe vullnetit të shqiptarëve të shprehur në referendumin e 11 dhe 12 janarit. PPD dhe PDP përmes procedurës parlamentare kërkuan që Kushtetuta të ndryshoj karakterin e saj nacional-maqedonas dhe theksimin e shtetit multietnik, parlamentin dydhomësh, barazi të plot të popujve dhe përfaqësimi i plot institucional dhe njohjen e shqiptarëve si popull shtetformues. Kjo iniciativë nuk u zhvillua deri në fund dhe e njëjta prej në fillim nuk u përfill nga partitë politike maqedonase, gjë e cila ndikoj në tensionimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe krijimin e krizave politike. Kundërshtimet lidhur me jetësimin e autonomisë u paraqitën në mbledhjen e kuvendit të mbajtur në prill 1992, në pjesëmarrje të PPD dhe PDP dhe anëtarëve të Komisionit të Kuvendit. Kundërthënie kishin të bëjnë me atë se a do të shkohet mëtutje me jetësimin e autonomisë apo me kërkesën e shtetformësisë.[40]. Përplasjet e brendshme dhe mos dakordimet mes tyre si rezultat sollën amortizimin e idesë për autonomi dhe përçarje të brendshme.
Në vazhdimësi të dy partitë politike do të ndërmarrin edhe shumë veprime të përbashkëta ku vlen të theksohet angazhimi i tyre për krijimin dhe zyrtarizimin e Universitetit të Tetovës.
*Partia Demokratike Shqiptare*- Qysh në Kongresin e I-rë të PPD u vërejtën dallime mes dy grupeve të anëtarëve, të cilat edhe pas mosdakordimit mes veti vazhduan të funksionojnë si një parti. Dallimet mes grupeve sa vinë e shtohen dhe kjo gjë do të reflektoj në thirrjen e parakohshëm të Kongresit të II-të të PPD. Paralelisht do të mbaheshin dy kongrese, të cilët do të zgjidhnin dy kryesi paralele. Si pasoj e këtyre zhvillimeve PPD do të ndahet në PPD dhe PPDSH-Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve. PPDSH do shkëputet nga pjesa tjerët e PPD me pretekstin se PPD nuk ka arritur që të realizoj kërkesat e shqiptarëve dhe se duhej ndryshuar kursi politik. Edhe pse ajo që nga momenti i shkëputjes nga PPD, kishte të gjitha organet e saj dhe funksiononte si organizatë e kompletuar ajo si parti politike u regjistrua në vitin 1996. Me 4 korrik 1997 në Tetovë, u mbajt "Kongresi i Bashkimit", i cili u organizua nga PPDSH dhe PDP. Nga ky kongres u formua një parti e re politike si rezultat i bashkimit të dy partive opozitare PPDSH dhe PDP në një parti edhe atë në Partin Demokratike Shqiptare. Partia Demokratike Shqiptare do ti trashëgoj qëllimet e dy partive të mëparshme. PDSH për një kohë të gjatë do të jetë si një ndër dy opsionet kryesore të shqiptarëve. Ajo llogaritet si parti e qendrës së djathtë, e cila angazhohet për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO, parlament dydhomësh, ndarje të drejt të buxhetit shtetërorë, zyrtarizimin e gjuhës shqipe, përfaqësimin e drejt etj. PDSH është e mendimit se Maqedonia të vetmen alternativ të mbijetesës së saj e ka anëtarësimin në NATO dhe BE. PDSH njihet si partia politike e cila 3 herë ka qenë pjesë e qeverisë, por asnjëherë në historinë e saj nuk ka arritur që të fitoj zgjedhjet parlamentare tek elektorati shqiptarë.
*Partia Demokratike Kombëtare*- u formua në mars të vitit 2001. Kjo parti lindjen e saj e llogarit si pasoj e paaftësimit të partive politike shqiptare për të përfaqësuar interesat e shqiptarëve dhe statusi i pakënaqur juridik e politik i shqiptarëve të RM. PDK ishte parti etnikisht e pastër dhe angazhohet për përfaqësimin dhe mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve të maqedonisë, për shtet multietnik dhe barazi mes komuniteteve në të gjitha fushat e jetës. PDK në platformën e saj parashihte rrënimin e sistemit unitar të shtetit dhe ridefinimin e shtetit. Me fjalë të tjera PDK ofronte federalizmin e Maqedonisë dhe jetësimin e referendumit për autonomi të vitit 1992, nëpërmjet të cilës shqiptarët do të mundë tu gëzoheshin të drejtave që u takojnë. Federalizmi do të zgjidhte shumë probleme siç është: përdorimi i gjuhës, simboleve kombëtare zyrtarizimin e Universitetit të Tetovës eliminimin e mbivotimit të deputeteve shqiptar në parlament etj. E gjithë platforma politike do të ngel vetëm si një ide e parealizuar, pasi që më vitin 2003 PDK –ja do të shuhet duke e bërë shkrirjen e saj në organizatën më të madhe politike shqiptare BDI. Edhe pas shkrirjes së saj në BDI, një grup anëtarësh do të vazhdojnë që të mbajnë gjallë këtë parti edhe për disa vite mirëpo me një forcë dukshëm më të vogël.
*Bashkimi Demokratik për Integrim*- u krijua në korrik të vitit 2002. BDI u themelua si pasoj e veprimeve të dala nga konflikti i armatosur i vitit 2001, e cila edhe do të llogaritet si parti e dal nga strukturat e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Konflikti i armatosur i vitit 2001 do të ndryshoj të gjithë klimën politike në vend, si pasoj e së cilës kemi Marrëveshjen e Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese. BDI do të vijë në skenën politike me qëllim të që jetë bartës dhe garantuese e për ndryshimet kushtetuese dhe implementimin e detyrimeve që parasheh Marrëveshja kornizë e Ohrit.

[40] Jusuf Zejneli, "Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë", Tetovë, 2013, fq .49.

Me anë të ndryshimeve kushtetuese dhe Marrëveshjes së Ohrit, BDI do të angazhohet për integrimin e plotë të shqiptarëve në të gjitha sferat politike.
BDI si qëllime dhe detyra kryesore ja ka vënë vetës: Ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të Maqedonisë; Shtet multietnik, në të cilin të gjithë qytetarët do të ndjehen të lirë dhe të barabartë; Maqedoni stabile si interes i të gjithë qytetarëve dhe si interes parësor rajonal dhe evropian, Integrim të Maqedonisë në strukturat euroatlantike; Sistem bashkëkohor ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut dhe konkurrencës lojale, që do të rriste mirëqenien e popullatës; Sistem funksional social, që do të mundësonte një jetë dinjitoze për të gjithë; Masa institucionale për mbrojtjen e ambientit jetësor; Zhvillim të vlerave kulturore të cilat promovojnë komunikimin multikulturor; Arsim cilësor dhe të bazuar në parimet e profesionalizmit; Avancim të pozitës së femrës në nivelet e vendimmarrjes; Krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitetet sportive dhe kulturës fizike[41]
BDI është bartëse e një sërë proceseve si ndarja territoriale e shtetit, avancimi i përdorimit të gjuhëve, ngritjen e nivelit të arsimit me zyrtarizimin e Universitetit të Tetovës dhe krijimin e Universitetit Nënë Tereza, përfaqësimin e drejt dhe adekuat, bashkëudhëheqëse në proceset e anëtarësimit të vendit në NATO dhe BE etj.
BDI njihet edhe si e vetmja parti politike në vend, e cila në çdo cikël zgjedhor ka triumfuar karshi partive tjera politike shqiptare.
*Lëvizja Besa*- u themelua në nëntor të vitit 2014, si parti e cila do të angazhohet ridefinimin e shtetit si shtet të barabartë për të gjithë, e cila do të çonte në një marrëveshje të re në mes maqedonasve dhe shqiptarëve, e cila do të instalonte parimin e konsensusit të përgjithshëm në të gjitha nivelet e shtetbërjes, duke mënjanuar majorizimin dhe do prodhonte një shtet stabil dhe të sigurt. Edhe pse ajo pati një eufori në fillimet e saj dhe kori sukses në procesin zgjedhorë ajo u përball me kriza të brendshme të cilat si rezultat dhanë ndarjen e saj në dy pjesë.
- Në fazën e dytë shpërndava pyetësorët në klasat e X-XII, ku përmes pyetësorëve janë marrë të dhënat nga nxënësit për përdorimin e ditarit elektronik si dhe kur e përdorin, për çka e përdorin dhe rezultatet e tyre mësimore. Pyetësorët ishin të njëjtë për të gjithë nxënësit e katër shkollave të përzgjedhura.
- Në fazën e tretë të këtij hulumtimi analizova të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorëve dhe sistemimin e përgjigjeve në programin SPSS (Statistical Package for the Social Sciences), pastaj rezultatet e fituara i prezantova në mënyrë tabelare dhe grafike.

**ANALIZA E REZULTATEVE**

Në vazhdim janë paraqitur përgjigjet e pjesëmarrësve në formë grafike dhe tabelare.
Pyetja demografike e pyetësorit për mësimdhënës.
Në tabelë është paraqitur numri i mësimdhënësve dhe shkollat në të cilat ligjërojnë. Nga shkolla e mesme "Naim Frashëri" në Shtime kemi 15 mësimdhënës, nga "Shkolla e mesme profesionale" në Shtime kemi 15 mësimdhënës, nga shkolla e mesme private "Mileniumi i tretë" në Prishtinë kemi 15 mësimdhënës, si dhe nga shkolla e mesme "7 Shtatori" poashtu kemi 15 mësimdhënës.

**Analizat përshkruese**

Grafikoni 1. Përqindja e mësimdhënësve se a e përdorin ditarin elektronik apo ditarin manual.




Grafikoni 2. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: A e përdorni ditarin elektronik gjatë orëve mësimore?




Grafikoni 3. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Pasi që ju e preferoni ditarin elektronik për ta përdorur për çfarë arsyje e përdorni më shumë?




Grafikoni 4. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Pasi qe ditari elektronik ka shume mundesi perdorimi, a e perdorni ditarin elektronik per te krijuar ndonje kuiz?




Grafikoni 5. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Bazuar në përvojën tuaj a duhet që të gjithë mësimdhënësit të përdorin ditarin elektronik në vend te ditarit manual?




Grafikoni 6. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Bazuar në përvojën tuaj të përdorimit të ditarit elektronik a është i sigurt përdorimi i ditarit elektronik?




Grafikoni 7. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: A ndikon përdorimi i ditarit elektronik në rezultatet e nxënësve?




Grafikoni 8. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Me përdorimin e ditarit elektronik a është bërë më i lehtë komunikimi me prindër?




Grafikoni 9. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Sa e përdorin mësimdhënësit ditarin elektronik gjatë orëve

mësimore?




Grafikoni 10. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Sa e përdorni ditarin elektronik gjatë orës mësimore për të mësuar?




Grafikoni 11. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: A ju kanë mësuar mësimdhënësit tuaj se si ti shihni të dhënat tuaja mësimore në ditar elektronik?




Grafikoni 12. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen Çka ju lejohet të shikoni në ditar elektronik?




Grafikoni 13. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: : A keni mundësi që materialet mësimore ti shkarkoni dhe ti merrni për të mësuar?




Grafikoni 14. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Për çfarë arsyje e përdorni ditarin elektronik?




Grafikoni 15. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Përmes kujt kyqeni në ditar elektronik?




Grafikoni 16. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Si mendoni për qasjen e prindërve në ditar elektronik?




Grafikoni 17. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen Si mendoni a ndikon përdorimi i ditarit elektronik tek suksesi juaj?




Grafikoni 18. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Me përdorimin e ditarit elektronik a është bërë më i lehtë komunikimi me mësimdhënësit?




**DISKUTIMI**

Ky hulumtim u realizua për të elaboruar përdorimin e ditarit elektronik dhe ndikimin e tij, përkatësisht në suksesin e rezultateve mësimore.

Duke iu referuar pyetjeve hulumtuese, rezultatet e dala nga ky hulumtim tregojnë për rëndësinë dhe efektet e përdorimit të ditarit elektronik në procesin mësimor, po ashtu në ngritjen e cilësisë në të nxënit e nxënësve.

Pra, rezultatet e fituara nga ky hulumtim i përgjigjen të tri pyetjeve me përgjigje pozitive që tregojnë zbatimin e ditarit eletronik nga ana e mësimdhënësve dhe nxënësve, përdorimi i ditarit elektronik ka treguar sukses të mirë në rezultatet e të nxënit si dhe komunikimi në mes të subjekteve të cilët e shfrytëzojnë DE.

Dhe si rezultat i fituar nga klasat e përzgjedhura të cilat kanë shënuar ngritje në rezultatet e të nxënit si i tillë ka ardhur nga ndikimi i përdorimit të ditarit elektronik gjegjësisht pyetësorëve të plotësuar nga ana e nxënësve dhe mësimdhënësve.

Po ashtu ditari elektronik ka motivuar nxënësit që të mësojnë më shumë, rezultatet e fituara e dëshmojnë një gjë të tillë.

Hipoteza e këtij hulumtimi ishte:

**Përdorimi i ditarit elektronik lehtëson dhe avanson punën me nxënës, prindër dhe mësimdhënës.**

Nëse i referohemi hipotezës së këtij studimi, sipas kornizës teorike që është paraqitur më lartë, dhe sipas hulumtimeve të elaboruara në shqyrtimin e literaturës dhe rezultateve të këtij hulumtimi është pohuar se përdorimi i ditarit elektronik mund të ndikoj në rritjen e rezultateve të nxënësve dhe suksesit mësimor

Për të kuptuar rëndësinë e DITARIT ELEKTRONIK si dhe për të vërtetuar hipotezën e këtij hulumtimi ne kemi formuluar dy pyetësor me anë të të cilëve kemi vlerësuar efektet e përdorimit të DE në mësimdhënie dhe nxënie. Përveq se kemi fituar një rezultat të lartë nga përgjigjet e dhëna, ne kemi parë edhe një motivim më të mirë nga nxënësit në procesin mësimor. Poashtu interesimi për të përdorur DE është vërejtur edhe gjatë vëzhgimit të nxënësve në klasë të cilët kanë shprehur një interesim më të mire për të përdorur DE gjatë orës mësimore.

Duke i'u referuar rezultateve të fituara nga ky hulumtim dhe poashtu shqyrtimit të literaturës së ndryshme rreth problemit të ngritur në këtë temë, atëherë mund të themi se ditari elektronik lehtëson dhe avanson punën me nxënës, mësimdhënës, prindër si dhe rritë cilësinë në të nxënit e nxënësve.

Për dallim nga klasat që e përdorin ditarin elektronik, klasat ku e përdorin ditarin manual (fizik) na kanë sjellë një rezultat më të ulët në aspektet mësimore. Në klasat ku përdoret mënyra tradicionale dhe jo shfrytëzimi i teknologjisë informative kryesisht përdorimi i DE ka bërë që në këto klasë të kemi një rezultat më ulët në motivimin e nxënësve për të nxënë.

**KUFIZIME**

Realizimi i këtij studimi përmbanë disa kufizime që jemi në dijeni nga ana jonë të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë interpretimit të rezultateve. Popullata e targetuar është në dy shkolla të mesme të ulëta të Komunës së Shtimës dhe dy shkolla të mesme të ulëta të Prishtinës , duke lënë anash nxënësit e të njëjtës grupmoshë nga shkollat tjera të këtyre komunave dhe qyteteve tjera. Një tjetër kufizim i supozuar ka të bëjë me saktësinë e përgjigjeve të plotësuara

nga nxënësitë dhe mësimdhënësit. I bëmë të gjitha përpjekjet për të inkurajuar përgjigjet e ndershme nëpërmjet ruajtjes së privatësisë, por fakti që pyetësorët e nxënësve u kryen në klasë mund të ketë ndikuar në përgjigjet e tyre ose në dhënien e përgjigjeve “të dëshirueshme”. Një kufizim tjetër lidhet me faktin e mungesës së studimeve të kësaj natyre në vendin tonë, e cila sjell pamundësinë e krahasimit të gjetjeve.

**REKOMANDIMET**

Ky hulumtim ka përfshirë një mostër relativisht të vogël, si i tillë nuk mund të gjeneralizoj rezultatet për një popullatë më të gjerë andaj hulumtimet tjera që do të mund të realizoheshin, do të mund të përfshinin numër më të madhë të pjesëmarrësve nga më shumë shkolla të mesme të ulëta/larta publike dhe private e poashtu në më shumë qytete të Kosovës. Megjithatë nga ky hulumtim kemi fituar një rezultat pozitiv mbi përdorimin e ditarit elektronik, me këtë rezultat të fituar rekomandoj që të gjitha shkollat, të gjithë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit të përdorin ditarin elektronik që t’ lehtësohet puna dhe të arrihen rezultate sa më të larta në mësimnxënie.

**REFRENCAT BIBLIOGRAFIKE**


Anderson, T.(2008). The Theory and Practice of Online Learning, Second Edition. Canada.

Caka, N. (2006). *Metodologjite e mesimit elektronik.* Tirane.

Cardon, T. A. (2012). Teaching caregivers to implement video modeling imitation training via iPad for their children with autism. Research in Autism Spectrum Disorders,

Epstein, J.L. (1995). School/family/community partnerships: Caring for the children we share. Phi Delta Kappan, 76(9), 701-7012.

Grant, L. (2011). ‘I'm a completely different person at home’: Using digital technologies to connect learning between home and school. Journal of Computer Assisted Learning

Kosaretskii, S. G., & Chernyshova, D. V. (2013). Electronic communication between the school and the home. Russian Education and Society

Mexhuani, A. (2014). *Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie.* Prishtinë: IPK.

Mossley, D. D. (2013). *Open Educational Resources and Open.* Burrows, L. (2004). Compassionate communication with parents of children and young people with learning disabilities. Australian Journal of Learning Disabilities,

Musai, B. (2012). *Metodologjia e mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.

NSW Department of Education and Training. (2003). Time to teach: Time to learn. Retrieved from

OECD, O. F.-O. (2007). Giving Knowledge for Free - THE EMERGENCE OF OPEN EDUCATIONAL RESOURCES.

Woolfolk, A. (2011). Psikologji Edukimi. Tiranë: CDE.

Zhang, D., Hsu, H. Y., Kwok, O. M., Benz, M., & Bowman-Perrott, L. (2011). The impact of basic-level parent engagements on student achievement: Patterns associated with race/ethnicity and socioeconomic status (SES). Journal of Disability Policy Studies

# Challenges of online learning during the pandemic in Kosovo and the world

**Jeton Osmani**

ABSTRACT

Ky studim paraqet një pikëpamje analitike që krahason mënyrën, formën, procesin dhe efikasitetin e zhvillimit të mësimit online me formën fizike normale te zhvillimit të mësimit në vendin tonë. Analiza sqaron kënaqjen me anë të të dhënave të prodhuara nga anketat e zhvilluara si të dhëna të dorës së dytë, si dhe të dhënat që prodhojnë rezultatet mësimore të studentëve për t'i krahasuar me vitet e zhvillimit të zakonshëm mësimor. Sigurisht që në bazë të materjes është që të shqyrtohet nëse zhvillimi i mësimit online nuk është më efikas sesa mësimi i zakonshëm apo nëse zhvillimi i mësimit online në vendin tonë dështon të arrijë nivelin e mësimit online nëpër botë.

Fjalë kyçe: *mësimi online, analiza,, etj.*

## Hyrje

Edukimi online ka përshkuar shoqërinë tonë me një rritje dramatike që ka sjellë në një epokë të re të mësimdhënies dhe të nxënit. Premtimi dhe potenciali i arsimit në distancë është i lavdërueshëm; ai ka aftësinë për ta bërë arsimin më të përshtatshëm dhe më të aksesueshëm. Përparimet në teknologjinë e internetit e kanë bërë të mundur këtë pasi mësimi mund të ndodhë "asinkronisht": në çdo kohë, kudo, kudo (Commons, 2010). Edhe pse mësimi online ka përjetuar rritje eksponenciale në të gjitha nivelet arsimore, zgjerimi ka qenë më befasues në nivelin e asociuar, i cili përbën më shumë se 50% të popullsisë totale të studentëve në internet (Allen, 2008). Edhe pse ky premtim është mbresëlënës, nuk është pa pasoja negative të padëshiruara. Mbyllja e shkollave për shkak të pandemisë me COVID-19 shpërfaqi sfidat e mëdha të organizimit të mësimit online në Kosovë. Sfidat më të theksuara ishin në përfshirjen e nxënësve të komuniteteve jo shumicë. Nishikant (2009) argumenton se edukimi në internet është shumë i ndryshëm nga klasat tradicionale, të cilat kanë një tendencë për t'u dominuar nga instruktori me ndërveprim të kufizuar me studentët. Si i tillë, mësimi online ka krijuar një paradigmë të re në lidhje me mënyrën në të cilën njerëzit e perceptojnë procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit (Nishikant, 2009). Ndërsa arsimi online vazhdon të përparojë, çështjet specifike për këtë modalitet mësimor, të tilla si përgatitja teknologjike e studentëve duke ruajtur ashpërsinë dhe cilësinë e kursit, rezonojnë gjatë gjithë arsimit të lartë (Council, 2010). Transmetimi i mësimit nga distanca kishte filluar më 23 mars 2020 ku nxënësit në Kosovë kanë ndjekur mësimet në shtëpi përmes Radio Televizionit Publik të Kosovës. Megjithatë kur fëmijët nuk pasur teknologjinë e nevojshme komunikimi me mësuesit e tyre ka qenë i pamundur. Prindërit dhe organizatat qeveritare kanë shprehur shqetësim për këtë problematikë duke qenë edhe pse mësimi në gjysmëvjetorin e dytë ka nisur fizikisht, në rastet e infektimeve të mëdha në shkolla, mësimi do të organizohet sërish online.

Ndërsa mësimi online vazhdon të ndryshojë peizazhin arsimor, instruktorët dhe studentët përballen me çështje të reja. Për shembull, fakulteti ka një tendencë për të përmendur një rritje të ngarkesës së punës si një sfidë kur jep mësim në një kurs online (Sammons, 2007). Në fakt, përgatitja për të dhënë mësim në një format online për herë të parë në përgjithësi kërkon të paktën dhjetë orë trajnim jashtë një ngarkese të rregullt mësimore (Council, 2010). Perceptimi i pranisë dhe ndërveprimit shoqëror duket të jetë një shqetësim i përbashkët si për mësuesit ashtu edhe për studentët. Ndryshe nga mësimdhënia tradicionale, është vënë re se instruktorët rrallë përfshihen në dialog pedagogjik për mësimin online. Në mënyrë të ngjashme, studiuesit kanë gjetur se të nxënit e përgjithshëm të perceptuar të studentëve lidhet me ndjenjën e pranisë sociale të lehtësuar në kurs (Herbert, 2006). Kështu, studentët që perceptojnë mungesën e ndërveprimit social ose pranisë së mësuesit mund të jenë më të prirur të tërhiqen (Tello, 2007). Përveç tërheqjes dhe dështimit, studentët gjatë mësimit online kanë tendencë për të fituar nota më të ulëta në detyrat kur krahasohen me studentët në një klasë tradicionale. Mund të egzsitojnë arsye të ndryshme që shpjegojnë rastet në fjalë, të tilla si dërgimi i detyrave me vonesë dhe leximi i gabuar ose neglizhimi i udhëzimeve. Mbajtja në hap me ekspertizën teknologjike të nevojshme për të lulëzuar në komunitetet e të mësuarit në internet është një çështje për të gjithë anëtarët e këtyre komuniteteve. Për studentët, çështja nuk është vetëm të përgatiten për autonominë e mjedisit online, por të jenë gati

për ashpërsinë e një mjedisi mësimor online. Studentët që nuk janë të përgatitur teknologjikisht për një kurs në internet mund të ndikojnë negativisht tek instruktori si dhe tek studentët e tjerë.

1.1 Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi është që të hulumtojë sfidat e mësimit online gjatë pandemisë në Kosovë dhe në Ballkan. Ky hulumtim synon të prezantojë mendime analitike dhe kritika të fushave të ndryshme nga tre pozitat pjesëmarrëse në materje që janë mësuesi, prindi dhe nxënësi, si dhe shëmbujt që mund të ishin zgjedhur në vend të rrugës që është ndjekur.

Rezultatet që priten të nxirren nga të dhënat e dorës së parë, kanë për qëllim të paraqesin këndvështrime të ndryshme që i përkasin kësaj platforme të zhvillimit të mësimit. Rezultatet që priten të nxirren nga të dhënat e dorës së dytë, kryesisht synojnë të përmbledhin pikëqëndrime dhe opinione të ndryshme për të konstruktuar një analizë krahasuese mes asaj çfarë paraqet mësimi online në Kosovë e çfarë në Ballkan.

**1.2 Nën-objektivat:**

Të përcaktojë si është mbajtur ora mësimore para dhe pas pandemisë.

Të konstatojë rolin e teknologjisë në avancimin e edukimit.

Të përcaktojë nivelin e mbarëvajtjes së procesit të orës mësimore online

**1.3 Pyetjet hulumtuese:**

PK1. Cila ishte mbarëvajtja e procesit të mësimit online në aspektin e nivelit akademik të orës mësimore të mirëfilltë?

PK2. Si ishte menaxhimi i mësmidhënësëve në përshtatjen e platformës online me atë fizike?

PK3. Cili ishte ndryshimi i mësimit online nga ai i zakonshëm për mësimnxënien?

PK4. A mund ta zëvendësojë mësimi online, mësimin e zakonshëm në përsosmëri?

**1.4 Hipotezat**

H1: Gjatë mësimit online nxënësit mund të shpërqendrohen lehtësisht nga ambienti që i rrethon dhe kjo bën që ata të jenë më pak të vëmendshëm se sa në mësimin në kushte normale në shkollë.

H2: Për mbarëvajtjen e rregullt të procesit të mësimit online është e nevojshme qasja me internet si edhe pajisjet e duhura për zhvillimin e msimit, të cilat shpesh mund të kufizojnë aktivitetin apo pjesëmarrjen e nxënësve në mësim.

H3: Rrjeti i dobët dhe energjia elektrike shpesh mund të jenë shkak i ndërprerjes ose pengesës së zhvillimit të mësimit në distancë.

Shqyrtimi i literaturës

***Gazeta Ndërkombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Menaxhimit: Efektiviteti i të mësuarit në internet në pandeminë Covid-19***

Ky hulumtim është një studim sasior përshkrues që përdor metoda të anketimit online. Studimi synon të zbulojë mediat e të mësuarit në internet që mund t'i bëjnë studentët entuziastë për ndjekjen e leksioneve, veçanërisht studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit West Sulawesi. Të dhënat janë marrë përmes plotësimit të pyetesorit që u janë shpërndarë të gjithë të anketuarve në formën e google docs. Bazuar në rezultatet e analizës së të dhënave të marra nga plotësimi i pyetësorëve të studentëve, mund të konkludohet se sistemi i mësimit online i zhvilluar gjatë pandemisë COVID-19 është efektiv por joefikas. Konsiderohet efektiv për shkak të kushteve me te favorshme për mësim online dhe joefikase, sepse kostot janë më të larta në krahasim me mësimin në kushte normale, kryesisht shpenzimet për rrjetin e internetit për të vazhduar me leksionet online. Aplikacioni më i përshtatshëm për t'u përdorur gjatë leksioneve në internet është WhatsApp sepse është më i lehtë i qasshëm dhe me i përdorueshëm. Kufizimet që hasen gjatë ligjëratave online janë problemet me rrjetin (Awal Bahasoan, 2020).

***Webinar COVID-19: Një botë e re për mësuesit, punëtorët e vijës së parë të arsimit - Webinar arsimor COVID-19***

Më 27 Mars, UNESCO u kushtoi webinarin e dytë Covid-19 atyre që janë në vijat e para të sigurimit të vazhdimësisë së të mësuarit: rreth 63 milion mësues të prekur në 165 vende, së bashku me personelin e arsimit. Duke sjellë së bashku pjesëmarrës nga të gjitha rajonet, seminari hodhi dritë mbi një gamë të gjerë çështjesh, nga ofrimi i trajnimit dhe mbështetjes për mësuesit te sfida e mësimdhënies në distancë në zona të largëta ose rurale me lidhje të dobët ose pa lidhje interneti. Kthimi i materialeve mësimore në format digjitale ka qenë një sfidë pasi pak mësues kanë aftësi të përdorin pajisjet teknologjike. Në shumë vende në Azinë Jugperëndimore dhe Afrikën nën-Sahariane vetëm rreth 20% ose shpesh më pak familje kanë lidhje interneti në shtëpi, e lëre më kompjuterat personalë (UNESCO., 2020).
Në Peru, Z. Cruzado Silverii raportoi se vetëm "35% e mësuesve kanë qasje në një kompjuter dhe internet". Ministria për këtë arsye zgjodhi të përdorë zgjidhje të teknologjisë së ulët siç janë kanalet televizive dhe radio për të siguruar klasa dhe mësim për studentët. Në Ugandë, qeveria është duke u mbështetur në programin UNESCO-Fondet Kineze të Mirëbesimit, i cili ka krijuar një sistem të fuqishëm të trajnimit të mësuesve në të gjithë vendin. Institucionet e trajnimit të mësuesve janë vendosur për të ofruar punëtori për ndërtimin e kapaciteteve për mësuesit pa aftësi të TIK përmes njërit prej tre qendrave të TIK të programit. Në kohë të tilla të pashembullta dhe të pasigurta, është normale që njerëzit të përjetojnë nivele më të larta stresi dhe ankthi, përfshirë mësuesit, të cilët kanë nevojë për mbështetje socio-emocionale për të përballuar presionin shtesë që po u bëhet për të dhënë mësim në një kohë krize si dhe për të mbështetur nevojat emocionale të studentëve të tyre (UNESCO., 2020).

***Pandemia e sëmundjes koronavirus 2019 (COVID-19) mund të jetë stresuese për njerëzit.***
Frika dhe ankthi mund të jetë mbizotëruese dhe të shkaktojë emocione të forta tek të rriturit dhe fëmijët. Veprimet e shëndetit publik, të tilla si distancimi social, mund t'i bëjnë njerëzit të ndjehen të izoluar dhe të vetmuar dhe mund të rrisin stresin dhe ankthin. Sidoqoftë, këto veprime janë të nevojshme për të zvogëluar përhapjen e COVID-19. Përballimi i stresit në një mënyrë të shëndetshme do t'ju bëjë më të fortë ju, njerëzit për të cilët kujdeseni dhe komunitetin tuaj (Centers for Disease Control and Prevention. , 2020)

***Universiteti Pendidikan Indonezi: Perceptimi i mësuesve për mësimin online gjatë pandemisë***
Ky studim hulumtoi perceptimin e mësuesve të gjuhës angleze për mësimin online të gjuhës angleze. Ky studim përdori një dizajn përshkrues me një qasje cilësore. Përmes një pyetësori dhe interviste janë nxjerrë përgjigjet e 102 mësuesve të anglishtes të shkollës së mesme të ulët në Bandung, Indonezi. Gjetjet e studimit zbuluan se pjesëmarrësit treguan një perceptim pozitiv për dobinë dhe lehtësinë e sistemit të mësimit online gjatë pandemisë Covid-19. Megjithatë, më shumë se gjysma e mësuesve nuk ishin dakord për efektivitetin e kësaj forme mësimi. Edhe pse mësuesit përballen me shumë probleme të procesit të mësimdhënies online, ato shfaqin qëndrimin e duhur ndaj përdorimit të teknologjisë për organizimin e mësimit përmes internetit (Wirza, 2020).

***Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie***
Hulumtimi Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie është një domosdoshmëri, sepse një ndër prioritetet kryesore të MASHT-it për TIK, të paraqitur në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, është edhe integrimi i teknologjisë mësimore në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Ky hulumtim fokus kryesor ka studimin e gjendjes në disa shkolla të mesme të ulëta, për mënyrën e integrimit të teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Përdorimi i TIK–ut në të gjitha proceset jetësore është kthyer në një domosdoshmëri jetike në mbarë botën. Edhe në arsim, si në çdo fushë të jetës, TIK-u ka sjellë një kthesë rrënjësore në zhvillimin e kulturës së të nxënit, duke i bërë njohuritë më të qasshme për të gjithë nxënësit. Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të tyre gjatë orës së mësimit duke lehtësuar të nxënit. TIK-u sjell dinamizëm në mësimdhënie/nxënie dhe i vendos nxënësit në kontroll për të nxënit e tyre, duke lejuar progres zhvillimi të pavarur (Mexhuani, 2014).

***Sfidat e mësimit online në botë.***
***Amerikë***: Mësimi online përballet me shumë sfida duke filluar nga çështjet e nxënësve, çështjet e edukatorëve dhe çështjet e përmbajtjes mësimore. Është sfidë për institucionet që të angazhojnë studentët dhe t'i bëjnë ata të marrin pjesë në procesin e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Është një sfidë për mësuesit që të kalojnë nga modaliteti offline

në atë online, duke ndryshuar metodologjitë e tyre të mësimdhënies dhe duke menaxhuar kohën e tyre. Është sfiduese të zhvillohet një përmbajtje që jo vetëm mbulon kurrikulën, por gjithashtu angazhon studentët (Kebritchi, 2017).

***Romani***: Cilësia e programeve të e-learning është një sfidë e vërtetë. Nuk ka asnjë përcaktim të qartë nga qeveria në politikat e tyre arsimore për programet e e-learning. Ka mungesë të standardeve për cilësinë, kontrollin e cilësisë, zhvillimin e burimeve elektronike dhe shpërndarjen e përmbajtjes elektronike. Ky problem duhet të trajtohet menjëherë në mënyrë që të gjithë të mund të gëzojnë përfitimet e arsimit cilësor nëpërmjet mësimit elektronik (Cojocariu, 2014).

***Palestinë***: Nuk duhet të përqendroheni thjesht në avantazhet që lidhen me adoptimin e të mësuarit në internet gjatë krizave botërore, por duhet gjithashtu të merret parasysh zhvillimi dhe rritja e cilësisë së kurseve virtuale të ofruara në raste të tilla urgjente (Affouneh, 2020) . Shumë kohë dhe kosto përfshihet në mësimin elektronik. Nuk është aq e lehtë sa duket, nevojitet një investim i konsiderueshëm për marrjen e pajisjeve dhe, mirëmbajtjen e tyre, trajnimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e përmbajtjes në internet. Prandaj, duhet të zhvillohet një sistem arsimor efektiv dhe efikas për të dhënë arsimin nëpërmjet internetit.

## Medotologjia e hulumtimit

Në këtë pjesë të punimit përshkruhen në mënyrë të detajuar hapat e ndërmarrura për mundësimin e mbeldhjes së të dhënave duke filluar me dizajnin e hulumtimit, popullatën e hulumtimit, përshkrimin e instrumenteve, rezultatet e pritura dhe analizimi i të dhënave.

### 3.1 Metoda e hulumtimit

Për të realizuar hulumtimin në lidhje me sfidat e mësimit online gjatë pandemisë në Kosovë dhe Ballkan si edhe për gjetjen e përgjigjes së pyetjes së hulumtimit është përdorur metoda sasiore.

### 3.2 Instrumenti i hulumtimit

Instrumenti i përdorur për realizimin e këtij hulumtimi është pyetësori i mbyllur I realizuar përmes Google Docs. Ky pyetësor është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e pare të pyetësorit përfshihen 3 pyetje në lidhje me të dhënat personale të respodentit që janë të nevojshme për tu kualifikuar si pjesëmarrës. Pjesa e dytë e pyetësorit përfshinë 7 pyetje që i takojnë fushës së studimit në lidhje me sfidat e mësimit online me të cilat janë përballur nxënësit, mësimdhënësit por edhe prindërit.

#### 3.2.1 Pyetësori

Pyetësori përbëhet prej gjithsejt 13 pyetjeve dhe 2 sektorëve. Sektori fillestar përbëhet nga 3 pyetje rreth të dhënave personale të pjesëmarrësit, kurse sektori i dytë përmban 10 pyetje rreth mësimit online për të cilat mundësohen 5 alternativa sipas shkallës së Likertit: pajtohem plotësisht, pajtohem, neutral, nuk pajtohem, aspak nuk pajtohem. 3 pyetjet e para përfaqësojnë grupmoshën, gjininë dhe nivelin akademik.

Pyetjet e pyetësorit janë këto:

Table 1 - Pyetjet e pyetësorit

| | |
|---|---|
| 1 | Organizimi i mësimit online ka qenë në nivelin e duhur edukativo-arsimor. |
| 2 | Ndryshe nga mësimi online, gjatë mësimit në klasë kam qenë me i/e vëmendëshme. |
| 3 | Mësimi online ka qenë i rregullt dhe shumë efektiv. |
| 4 | Mësimi online në Kosovë është penguar nga mungesa e pajisjeve teknologjike apo rrjetit të mirë të internetit nga ana e nxënësëve. |
| 5 | Përfshirja dhe aktiviteti nga ana studentore, ka qenë më e lehtë dhe e favorshme në mësimin online. |
| 6 | Interesimi i nxënësëve për të ndjekur orët mësimore ka qenë në të njëjtin nivel apo më i lartë në krahasim me mësimin fizik. |

| | |
|---|---|
| 7 | Qasja në orën mësimore përmes internetit ka përparësi në raport me distancën dhe kohën e nevojitur për të udhëtuar në ambientet shkollore. |
| 8 | Të gjithë nxënësit/nxënëset kanë qenë të përfshirë dhe të angazhuar në procesin mësimor gjatë mësimit online. |
| 9 | Mënyra e vlerësimit gjatë mësimit online ka qenë e njëjtë me mësimin e zakonshëm në klasë. |
| 10 | Gjatë mësimit online, kam patur mundësi të jem aktiv duke bërë pyetje ose duke u përgjigjur pyetjeve të mësimdhënësve. |

**Pytjet kërkimore**

Për përllogaritjen e anketimit në bazë të përgjigjeve, synohet përgjigja e disa pyetjeve kërkimore në bazë të pyetjeve të pyetësorit. Pyetjet kërkimore janë këto:

**PK1. Cila ishte mbarëvajtja e procesit të mësimit online në aspektin e nivelit akademik të orës mësimore të mirëfilltë?**

Për të ditur nivelin e mbarëvajtjes së procesit të orës mësimore online, duhet ditur si qëndron krahasimi me proceset mësimore të zhvilluara në shtetet e tjera në botë, a është ora mësimore në Kosovë e zhvilluar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe a kanë ekzistuar parametra efikase në trajtë të disiplinës dhe normave edukative gjatë zhvillimit të orës mësimore.

**PK2. Si ishte menaxhimi i mësmidhënësëve në përshtatjen e platformës online me atë fizike?**

Për të ditur nivelin menaxherial për mënyrën se si e kanë udhëhequr mësimin profesorët dhe mësuesit në krahasim me mbarëvajtjen e mësimit në ambientet shkollore, duhet ditur përmasa e angazhimit të studentëve nga ana e profesorit, përshtatja e zhvillimit të provimeve dhe rezultatet e tyre në krahasim me mësimin e zakonshëm.

**PK3. Cili ishte ndryshimi i mësimit online nga ai i zakonshëm për mësimnxënien?**

Për të ditur sfidat dhe avantazhet e studentëve në këtë platformë të të mësuarit, duhet ditur masa e vështirësisë së të përgjigjurit përmes një pajisjeje elektronike, mungesa apo pengesat e mundshme të lidhjes në mënyrë teknologjike me orën mësimore, vullneti i tyre për të ndjekur mësimin online në raport me atë fizik dhe koha me lehtësinë e qasjes në mësim në krahasim me atë të mëparshëm.

**PK4. A mund ta zëvendësojë mësimi online, mësimin e zakonshëm në përsosmëri?**

Një pyetje e tillë vlen të përgjigjet nga të gjitha anët e protagonistëve në këtë platformë të të mësuarit, për qëndrimin e tyre në vlerësimin e zhvillimit të procesit të kësaj platforme.

Table 2 - Pyetjet e pyetësorit që i përgjigjen pyetjeve kërkimore

| Pyetjet kërkimore | PK1 | PK2 | PK3 |
|---|---|---|---|
| Pyetjet në pyetësor | P1-P6 | P7-P10 | P11-P13 |

## Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve

Në pyetësor, pjesëmarrja përbëhet nga 100 persona prej të cilëve 53 (53.0%) janë studentë, 13 (13.0%) janë nxënës të arsimit parauniversitar, 9 (9.0%) janë mësues të arsimit parauniversitar, 8 (8.0%) janë profesor të arsimit universitar dhe prej asnjërës nga këto fusha janë 17 (17.0%) persona.

Gjinia e pjesëmarrësëve përbëhet nga 48 (48.0%) femra dhe 52 (52.0%) meshkuj. Mosha e pjesëmarrësëve ju takon 4 grupmoshave: 12-18 (12.0%), 19-25 (57.0%), 26-39 (18.0%) dhe 40-65 (13.3%).




Figure 1 - Grafiku i gjinisë pjesëmarrëse në pyetësorë në raport me moshën




Figure 2 - Grafiku i gjinisë së pjesëmarrësëve në raport me nivelin akademik

**PK1. Cila ishte mbarëvajtja e procesit të mësimit online në aspektin e nivelit akademik të orës mësimore të mirëfilltë?**

Për këtë pyetje kërkimore, pëgjigjet janë kërkuar në pyetjet 1, 3 dhe 5 të pyetësorit të cilat i referohen kësaj pikëpamjeje.

***P1* - Organizimi i mësimit online ka qenë në nivelin e duhur edukativo-arsimor.**
***P3* - Mësimi online ka qenë i rregullt dhe shumë efektiv.**
***P5* - Mënyra e vlerësimit gjatë mësimit online ka qenë e njejtë me mësimin e zakonshëm në klasë.**




Figure 3 - Grafiku i qëndrimit të pjesëmarrësëve për 3 pyetjet që i përgjigjen pyetjes kërkimore 1, të shprehura në përqindje

Nga grafiku vërejmë se për pyetjen 5, një shumicë prej 39% nuk ishin te pajtimit me mënyren e vlersimit. Një gjë e tillë e tregon më së miri se pjesëmarrësit në pyetësor, nuk janë të informuar sa duhet për të ditur nëse shteti i Kosovës, e ka realizuar këtë platformë në mënyrën më të mirë të mundshme kurse për pjesën që mbajtën një qëndrim, 21% pajtohen, 2% pajtohen plotësisht, 24% neutral dhe 14% nuk pajtohen aspak. Nga pjesëmarrësit të cilët mbajtën një qëndrim duke neglizhuar ata që u shprehehn jo te pajtimit, vërejmë një dallim prej 18% që i avantazhon ata që u pajtuan se Kosova e ka menaxhuar këtë platformë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për pyetjen 1 dhe 3, përqindja e qëndrimeve neutrale është e barabartë me vlerën prej 22%, kurse sasia e përqindjes së mos pajtimit me këtë deklaratë është dominante për të dyja pyetjet; për pyetjen 3, 25% nuk pajtohen dhe 11% nuk pajtohen aspak, kurse për pyetjen 1, 19% nuk pajtohen dhe 9% nuk pajtohen aspak. Kjo lë të kuptohet se niveli disiplinor dhe edukativ i orës mësimore të zhvilluar online, sipas pjesëmarrësëve, nuk ka qenë i kënaqshëm dhe niveli i zhvillimit të kësaj platforme në Kosovë, nuk ka qenë në nivelin e shteteve të zhvilluara.

Përgjigja e kësaj pyetjeje kërkimore paraqet se sipas pjesëmarrësëve në studim, niveli i mbajtjes së mësimit online në Kosovë nuk ka qenë i kënaqshëm por poashtu sipas pjesëmarrësëve, nuk është besuar se mund të arrihet një nivel më të lartë i kësaj platforme. Një konkludim i tillë nga ana e pjesëmarrësëve, shpreh një mosbesim ndaj kapacitetit të arritshmërisë së vendit të tyre në raport me barazimin akademik të nivele botërore.

**PK2. Si ishte menaxhimi i mësmidhënësëve në përshtatjen e platformës online me atë fizike?**

Për këtë pyetje kërkimore, pëgjigjet janë kërkuar në pyetjet 2, 8 dhe 9 të pyetësorit të cilat i referohen kësaj pikëpamjeje.

***P2* - Mësimi online ka qenë i rregullt dhe shumë efektiv.**
***P8* - Të gjithë nxënësit/nxënëset kanë qenë të përfshirë dhe të angazhuar në procesin mësimor gjatë mësimit online.**
***P9* - Mënyra e vlerësimit gjatë mësimit online ka qenë e njëjtë me mësimin e zakonshëm në klasë.**




Figure 4 - Grafiku i qëndrimit të pjesëmarrësëve për 3 pyetjet që i përgjigjen pyetjes kërkimore 2, të shprehura në përqindje

Nga grafiku vërejmë se, vlerësimi në mbarëvajtjen dhe elementet e procesit të mësimit online, gjë të cilën e paraqesin të tre pyetjet, nuk ka qenë në nivel të kënaqshëm për shumicën e pjesëmarrësëve. Pyetja e tetë e cila i referohet nxënësit, nëse është angazhuar në procesin mësimor dhe ka qenë gjithëpërfshirës në temat e diskutimit, 20% kanë mbajtur qëndrim neutral, kurse me një avantazh të dukshëm është zgjedhur alternativa ”nuk pajtohem” me 35% dhe ”aspak nuk pajtohem” me 7%. Duke qenë që dihet se 53% e pjesëmarrësëve ishin studentë, kjo përfaqëson pakënaqjen e mësimnxënies në raport me platformën e mësimit online. Diçka e tillë sigurisht që pasqyrohet edhe në rënien e suksesit të përgjithsëm të studentëve të cilët nuk kanë arritur të nxjerrin arsimimin e nevojshëm për të përformuar mirë në rezultate.

Pyetja e dytë dhe e nëntë, në të cilat vendoset në provë efektiviteti i orës mësimore dhe efektiviteti i provimeve si dhe procesit të zhvillimit të tyre, shumica dërrmuese kanë qenë të mos pajtuar me pohimet e bëra ku për pyetjen e dytë 25% kanë zgjedhur alternativën ”nuk pajtohem” kurse 11% kanë zgjedhur ”aspak nuk pajtohem”. Për pyetjen e nëntë, 39% kanë zgjedhur ”nuk pajtohem” kurse 14% kanë zgjedhur ”aspak nuk pajtohem”. Veçanërisht në pyetjen kushtuar procesit të zhvillimit të provimeve, vërehet pakënaqje edhe nga ana e profesorit, edhe nga ana e studentëve. Kjo tregon pa aftësinë e platformës së mësimit online, për të zëvendësuar mësimin e zakonshëm në ambientet shkollore bashkë me të gjithë proceset e veta.

**PK3. Cili ishte ndryshimi i mësimit online nga ai i zakonshëm për mësimnxënien?**

Për këtë pyetje kërkimore, pëgjigjet janë kërkuar në pyetjet 4, 5, 7 dhe 10 të pyetësorit të cilat i referohen kësaj pikëpamjeje.

***P4* - Mësimi online në Kosovë është penguar nga mungesa e pajisjeve teknologjike apo rrjetit të mirë të internetit nga ana e nxënësëve.**

***P5* - Përfshirja dhe aktiviteti nga ana studentore, ka qenë më e lehtë dhe e favorshme në mësimin online.**

***P7 - Qasja në orën mësimore përmes internetit ka përparësi në raport me distancën dhe kohën e nevojitur për të udhëtuar në ambientet shkollore.***

***P10* - Gjatë mësimit online, kam patur mundësi të jem aktiv duke bërë pyetje ose duke u përgjigjur pyetjeve të mësimdhënësve.**




Figure 5 - Grafiku i qëndrimit të pjesëmarrësëve për 4 pyetjet që i përgjigjen pyetjes kërkimore 3, të shprehura në përqindje

Nga grafiku vërejmë se për avantazhet e njohura që ofron shërbimi virtual në krahasim me sfidat e udhëtimit dhe proceseve fizike që ndërmerren në mësimin fizik, përgjigjet anojnë në pajtueshmërinë e pjesëmarrësëve me pohimet se platforma online ka shumë përparësi. Pyetjet që lidhen me peripecitë më të mëdha të studentëve për tu përgjigjur gjatë platformës online dhe lehtësisësë qasjes në orën mësimore përmes kësaj platforme, një shumicë dërrmuese janë pajtuar me këtë pikëpamje. Nga ana tjetër, një shumicë poashtu është pajtuar me qëndrimin se mësimi online në Kosovë, është penguar nga mos posedimi i pajisjeve teknologjike apo rrjetit të mirë të internetit nga ana e nxënësëve duke bërë të ditur se, Kosova si shtet nuk mund të arrijë nivelet e shteteve të tjera në këtë drejtim, sepse pengesat kryesore lidhen me teknologjinë dhe posedimin e këtyre pajisjeve qasëse.
Sa i përket pyetjes nëse vullneti i studentëve ka qenë i barabartë me atë të mësimit të zakonshëm, mbizotërojnë përgjigjet mohuese duke u ndarë në 17% me ”nuk pajtohem” dhe 13% me ”aspak nuk pajtohem”. Çuditërisht, studentët nuk e kanë parë elementin e lehtësisë në qasje dhe avantazhet e tjera të platformës online si një shtysë për vullnetin e tyre në ndjekje të lëndëve.

**PK4. A mund ta zëvendësojë mësimi online, mësimin e zakonshëm në përsosmëri?**
Për këtë pyetje kërkimore, pëgjigjet janë kërkuar në pyetjen 6 të pyetësorit e cila i referohet kësaj pikëpamjeje.
***P6* - Interesimi i nxënësëve për të ndjekur orët mësimore ka qenë në të njëjtin nivel apo më i lartë në krahasim me mësimin fizik.**




Figure 6 - Grafiku i qëndrimit të pjesëmarrësëve për pyetjen që i përgjigjet pyetjes kërkimore 4, e shprehur në përqindje

Grafiku për këtë pyetje të drejtëpërdrejtë, interpreton qëndrimin e pjesëmarrësëve në pyetësor si të pakënaqur me këtë pohim. 13% duke mos u pajtuar aspak dhe 47% duke mos u pajtuar, përbëjnë shumicën dërrmuese të pjesëmarrësëve duke qenë se 25% kanë mbajtur qëndrim neutral. Por kontradikta ndodh në rastin e pyetjes së parë kërkimore, në të cilën është rezultuar se pjesëmarrësit nuk kanë menduar se Kosova mund të realizojë një platformë të tillë më mirë nga se e ka menaxhuar.

## KONKLUZIONET

Nga përfundimet e gërshetuara si rezultat i pyetjeve kërkimore të këtij punimi, konkludohet se:

Mësimi online në Kosovë, nuk është realizuar në nivelin e shteteve më të zhvilluara.

Ora mësimore dhe provimet, nuk kanë qenë efiçente me rezultate të kënaqshme.

Lehtësia në qasje, përdorim dhe kursimi i kohës përmes përdorimit të kësaj platforme, nuk ka ndonjë impakt në vullnetin e studentëve për të ndjekur mësimin.

Mësimi online mbetet një platformë premtuese dhe e nënvlerësuar, por jo në shtetin e Kosovës sipas pjesëmarrësëve në pyetësor dhe sipas disa analizimeve të tjera.

Këto konkluda dhe përfundime, mbështeten në analizat e realizuara nga publikimet mbi shtetet e zhvilluara të botës si Gjermania, Britania e Madhe dhe ShBA, si dhe në përformancën e përgjigjeve të pyetësorit të realizuar mbi 150 persona në Kosovë. Sipas studimeve të këtyre shteteve rreth përformancës së kësaj platforme, sfidat kanë qenë të pranishme në aspektin e efektivitetit të orëve mësimore si dhe rezultatet poashtu kanë qenë të disavantazhuara në krahasim me ata të zhvillimit të mësimit të zakonshëm.

Një qëndrim i njejtë mbahet edhe nga pjesëmarrësit në pyetësor të cilët e kanë vlerësuar në të njejtën pikëpamje platformën e mësimit online përgjatë pandemisë. Pika më interesante është paraqitur në mos besimin e pjesëmarrësëve të pyetësorit, se shteti i Kosovës ka mundur të menaxhojë këtë platformë më mirë. Pas pohimit që platforma sigurisht

ka mundur të menaxhohet edhe më mirë, qytetarët e shtetit të Kosovës, nuk besuan se sistemi i edukimit përmes internetit, mund të arrinte nivelin e shteteve të jashtme.

Përfundimisht, platforma online ishte alternativa më e mirë në periudhën e karantinimit si pasojë e pandemisë, por kurrsesi nuk e arrin efikasitetin e mësimit të zakonshëm dhe nuk e zëvendëson mësimin e zakonshëm në përsosmëri.

Bibliography


Affouneh, S. S. (2020). Designing quality e-learning environments for emergency remote teaching in coronavirus crisis. *Interdisciplinary Journal of Virtual Learning in Medical Sciences*, 1-3.

Allen, I. &. (2008). Staying the course: Online education in the United States. . *Web site: http://www.sloan-c.org/publications/survey/pdf/staying_the_course.pdf*.

Asghar, R. M. (2020). Online Teaching. . *Journal of Rawalpindi Medical College.* , https://doi.org/DOI: 10.37939/jrmc.v24i1.1531.

Awal Bahasoan, W. A. (2020). Effectiveness of Online Learning In Pandemic Covid-19. *International Journal Of Science, Technology & Management*.

Cojocariu, V.-M. L. (2014). SWOT analysis of e-learning educational services from the perspective of their beneficiaries. . *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 1999–2003.

Commons, S. C. (2010). *Glossary of Online Terms.* Retrieved from Retrieved from http://commons.sloanconsortium.org/document/glossary-alphabetic-listing-definitions-about- online-learning-jaln

Council, I. T. (2010). Tracking the impact of e-learning atcommunity colleges. *Tracking the impact of e-learning atcommunity colleges*, (p. Retrieved from http://www.itcnetwork.org/images/stories/ITCAnnualSurveyMarch2010Final.pdf). Washington, D.C.

COVID-19., M. H. (2020). *Centers for Disease Control and Prevention.* . Centers for Disease Control and Prevention.

Herbert, M. (2006). Staying the course: A study in online student satisfaction and retention. *Online Journal of Distance Learning Administration, 9(4).*, 4-9.

Kebritchi, M. L. (2017). Issues and challenges for teaching successful online courses in higher education. *Journal of Educational Technology Systems*, 4-29.

Mexhuani, A. (2014). *Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie.* . Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Ministria e arsimit, s. d. (2018). *Statistikat e arsimit në Kosovë.* Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë.

Nishikant, S. (2009). The paradigm shift for adult education: from educational slavery to learning freedom of human brain with synaptic learning. *In T. Kidd (Ed.), Online education and adult learning: New frontiers for teaching practices. Hershey, PA: IGI Global.*

Sammons, R. &. (2007). The Invisible Professor and the Future of Virtual Faculty. . *International Journal for Instructional Technology and Distance Learning.* , 3-17.

Sugiyono. (2017). Quantitative Research Methods, Qualitative and R & D Bandung. *Alfabeta*.

Tello, S. F. (2007). An analysis of student persistence in online education. *International Journal of Information and Communication Technology Education, 3(3)*, 47-62.

UNESCO. (2020). COVID-19 education webinar #2. . *COVID-19 Webinar: A new world for teachers, education's frontline workers* , https://en.unesco.org/news/covid-19-webinar-new-world-teachers-educations-frontline-workers-covid-19-education-webinar-2. .

Wirza, R. P. (2020). Teachers' Perception of Online Learning during Pandemic Covid-19. *Universitas Pendidikan Indonesia, Bandung, Jawa Barat, Indonesia*, 392 - 406.

# Educational measures for juveniles and their implementation

**Prof. Dr. Jetmire Zeqiri**
University of Tetovo, Tetovo, Republic of North Macedonia jetmire.zeqiri@unite.edu.mk

**Abstract:** In the Criminal Code, apart from the criminal penalties, there are also prescribed educational measures, which have a somewhat complex nature, since although they are distinct from the penal punishment, they remain state coercive measures. This paper will address some key issues regarding educational measures as their main characteristics, persons to whom they can apply, their types accompanied by a comparative look, issues related to the implementation of the educational measure against minors, these also in the framework of international legal instruments that define basic criminal justice standards for juveniles, as well as illustrated on a case by case basis. Through the analysis of the aforementioned issues, it is not only the highlighting of the special nature of the educational measures under the criminal law and the importance of their effective implementation, but also the issuance of some conclusions and recommendations from the legislative and institutional point of view regarding these measures punishable penalties that may be rendered by Albanian courts against children or juveniles who commit criminal offenses.
**Key words:** Children, minors, child's highest interests, institutional education measures, special protective measures, the principle of proportionality, criminal offenses.

## 1. Hyrje

Në legjislacionin trajtimit të fëmijëve në konflikt me ligjin i janë kushtuar disa dispozita ligjore, të cilat synojnë përmbushjen e detyrimit kushtetues të mbrojtjes së veçantë të fëmijëve nga shteti. Megjithatë, karakteristikë e legjislacionit penal shqiptar lidhur me fëmijët është se dispozitat ligjore janë të shpërndara në kode e ligje të ndryshme dhe nuk ekziston një ligj i plotë i veçantë, i cili të përfshijë të gjitha çështjet e drejtësisë penale për fëmijët.[43] Po kështu, edhe dispozitat e Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal (KP) mbi fëmijët që kanë kryer një veprër penale gjenden të shpërndara në krerë të ndryshëm të saj. Ndërkohë, masat edukuese janë parashikuar në kreun e pestë, i cili i është kushtuar dënimeve penale.

## 2. Karakteristikat kryesore të masave edukuese

E vetmja ngjashmëri midis masave edukuese dhe dënimeve penale konsiston në faktin se edhe këto sikurse dënimet janë masa shtrënguese shtetërore, pasi ndër të tjera kanë edhe këto karakteristika:

- mund të jepen vetëm nga gjykata ndaj personave që kanë kryer një vepër penale dhe pa pëlqimin ose vullnetin e të interesuarve;[44]
- zbatohen me detyrim nga Policia e Shtetit, nëse nuk ekzekutohen vullnetarisht;

si dhe

- kufizojnë disa të drejta dhe liri të fëmijës që vendoset në mënyrë të detyruar në një institucion edukimi, i cili imponon një regjim të veçantë jetese dhe marrëdhënie të kontrolluara me familjen.[45]

Megjithatë, masat edukuese kanë edhe disa karakteristika të tjera, të cilat i dallojnë nga dënimet penale, dhe konkretisht në interpretim të nenit 46 të KP ato paraqiten si më poshtë vijon:

1) masat edukuese mund të jepen nga gjykata ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale;

2) kanë karakter fakultativ për gjykatën, pasi në bazë të nenit 46 KP gjykata mund të japë masa të tilla, por nuk është e detyruar të bëjë një gjë të tillë për çdo të mitur që përjashtohet nga përgjegjësia penale për shkak të moshës

---

[43] V. Kambovski "E drejta penale për të mitur"- Shkup fq.98

[44] N.Peza, I.Elezi, G.Gjika, D.Dumi, A.Çela," E drejta penale e Republikës së Shqipërisë (Pjesa e Përgjithshme), Shtëpia botuese "8 Nëntori", 1982, f. 289.

[45] I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Ribotim, West Print, Tiranë, 2009, f.230;

apo që përjashtohet nga dënimi;
3) kanë për qëllim edukimin e të miturit dhe si pasojë edhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale prej tij apo saj në të ardhmen;
4) nuk kanë afat të përcaktuar në ligj, pra jepen pa afat nga gjykata;
5) i nënshtrohen rregullisht rishqyrtimit nga gjykata, pasi në çdo rast kjo e fundit, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj për masën edukuese[46];
6) vendimi gjyqësor për masën edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë. Revokimi mund të bëhet kryesisht nga gjykata gjatë rishqyrtimit të detyruar të vendimit të saj pas një viti nga dhënia e tij ose para këtij afati me kërkesën e të interesuarit ose të institucionit të edukimit;
7) *nuk kanë pasoja të tjera juridike në statusin* e të miturit ndaj të cilit janë dhënë, pra nuk regjistrohen në regjistrin gjyqësor;
8) në KP parashikohet vetëm një lloj mase edukuese, e cila konsiston në vendosjen e të miturit në një institucion edukimi.

**3. Personat ndaj të cilëve mund të zbatohen masat edukuese**

Në bazë të nenit 46 të KP masat edukuese mund të zbatohen ndaj të miturve, të cilët:
a) përjashtohen nga dënimi; ose
b) për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Sipas KP të mëparshëm masat edukuese mund të zbatoheshin edhe ndaj *madhorëve* kur gjykata çmonte se dënimet nuk ishin të përshtatshme,[47] për shkak se kishin kryer vepra penale me rrezikshmëri të pakët shoqërore dhe se më parë kishin shfaqur sjellje të mirë. Në funksion të zbatimit të masave edukuese edhe ndaj kësaj kategorie personash në vitin 1988 në KP u shtuan edhe disa lloje të reja masash edukuese.

Sikurse vihet re nga përmbajtja e nenit 46 të KP për të dy kategoritë kryesore të personave ndaj të cilëve mund të zbatohet masa edukuese e parashikuar në të është përdorur i njëjti term, "i mitur". Kuptimi i këtij termi, i cili është përdorur edhe në dispozita të tjera të KP, shpesh duke përfshirë edhe fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale nuk është përcaktuar në këtë Kod. Megjithatë, në disa dispozita të tjera vihet re se pas ndryshimeve të vitit 2001 është përdorur edhe termi "fëmijë të mitur". Ndërkohë, sipas teorisë së të drejtës penale në të drejtën penale shqiptare "i mitur" konsiderohet çdo person i grup-moshës 14-18 vjeç[48].

Në përgjithësi në legjislacionet e posaçme për të miturit në shtete të tjera personat në ose mbi moshën minimale për përgjegjësi penale deri në 18 vjeç konsiderohen të mitur (juvenile), ndërsa personat nën moshën minimale për përgjegjësi penale konsiderohen fëmijë (children). Sipas Konventës për të drejtat e fëmijës (1989), me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç[49]. Në lidhje me përkufizimin e fëmijës në Shqipëri Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, pas marrjes në shqyrtim të Raportit fillestar të Shqipërisë, në vëzhgimet përfundimtare të sesionit të 38-të ka theksuar mungesën e qartësisë lidhur me statusin e fëmijëve ndërmjet moshës 14-18 vjeç ndër të tjera edhe në fushën e drejtësisë për të rinjtë dhe në këtë kontekst i ka rekomanduar Shqipërisë që të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përkufizuar se kush konsiderohet fëmijë në Shqipëri dhe që legjislacioni ekzistues të rishikohet për të siguruar që të gjithë fëmijët nën moshën 18-vjeçare të marrin mbrojtjen për të cilën ata kanë nevojë

---

[46] Sh.Muçi, E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme, Botimet Dudaj, Tiranë, 2007, fq.261-320

[47] Në bazë të nenit 28, paragrafi i parë të KP masat edukuese jepeshin nga gjykata, kur çmonte se dënimet nuk ishin të përshtatshme ose kundër personave, që për shkak të moshës nuk kishin përgjegjësi penale.

[48] I. Elezi, S Kaçupi, M Haxhia, "Komentari i Kodit penal", 2009 fq.100.

[49] Sipas nenit 1 të Konventës për të drejtat e fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 : "...me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet."

dhe që u takon në bazë të Konventës.
Në këtë kontekst, duke iu referuar kuptimit të termit “fëmijë” sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe kuptimit të termit “i mitur” në të drejtën penale shqiptare personat ndaj të cilëve mund të zbatohet masa edukuese e parashikuar në KP mund të grupohen si më poshtë vijon:
a . të mitur që përjashtohen nga dënimi;
b. *f* fëmijë që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.
Ndërkohë në bazë të KP, për masat edukuese, të cilat mund të zbatohen edhe ndaj fëmijëve nën moshën minimale për përgjegjësi penale (MMPP), nuk është përcaktuar kufiri më i ulët i moshës nën të cilin masa edukuese nuk mund të zbatohet, ndërsa kufiri më i lartë është i përcaktuar në mënyrë indirekte me mbarimin e miturisë, pra në moshën 18 vjeç. Në shumë shtete të tjera në rajonin e Ballkanit, si p.sh. në Slloveni, Kosovë, Mal i Zi, dhe Kroaci vihet re se legjislacioni përkatës penal parashikon se masat edukuese ose korrektuese mund të zbatohen edhe për kategorinë e personave në moshën 18-21 vjeç (madhorë të rinj), ndonëse sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligj.
Në lidhje me këtë kategori edhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës në Rekomandimin mbi mënyrat e reja të trajtimit të kriminalitetit tek të miturit dhe rolin e drejtësisë për të miturit, iu ka rekomanduar Shteteve Anëtare që ndër format e reja të reagimit të përfshijnë mundësinë që edhe *të rriturit e rinj nën moshën 21 vjeç* t'i nënshtrohen një trajtimi *të krahasueshëm* me atë të *të miturve* dhe zbatimit të ndërhyrjeve *të njëjta* me ato që zbatohen ndaj të miturve, *nëse* gjykata çmon se ata nuk janë aq të pjekur dhe përgjegjës për veprimet e tyre sa të rriturit e tjerë. Edhe në bazë të Kushtetutës shqiptare të rinjtë, ashtu sikurse fëmijët, kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. Ndërkohë, me ndryshimet më të fundit në KP vihet re se janë hedhur hapa pozitivë drejt njohjes së kësaj kategorie në KP, si p.sh. me rastin e shtimit të qëndrimit në shtëpi si një alternativë e re e dënimit me burgim, e cila mund të zbatohet edhe “për të rinj, nën moshën 21 vjeç”.

### 3.1 Zbatimi i masave edukuese ndaj të miturve që janë përjashtuar nga dënimi

Përsa i përket grupit të parë të personave ndaj të cilëve mund të jepen masa edukuese, vihet re se kjo masë mund të jepet ndaj të miturve autorë të veprave penale vetëm nëse ata janë përjashtuar nga dënimi. Në bazë të nenit 52 të KP gjykata mund ta përjashtojë të miturin nga dënimi nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, si dhe sjellja e mëparshme e të miturit. Si rrjedhim, për të miturit 14-18 vjeç masa edukuese është “sekondare”[50] ndaj dënimit penal, i cili mbetet parësor për këtë grup-moshë. Për këta fëmijë rregulli është caktimi i dënimit penal, ndërsa vetëm si përjashtim dhe në varësi të rrethanave të përmendura në nenin 52 të KP ndaj tyre mund të caktohet masa edukuese e vendosjes në institucion e dukimi.
Në legjislacionet e disa shteteve të tjera vihet re se për këtë grup-moshë njihen diferencime të mëtejshme si ndarja në të mitur të rinj dhe të mitur të rritur dhe parashikohet shprehimisht se për të miturit e rinj që zakonisht përfshijnë moshën 14-16 vjeç, në shtete në të cilat mosha minimale për përgjegjësi penale është 14 vjeç, mund të jepen vetëm masa edukuese, ndersa denimet penale mund te jepen vetem duke filluar nga grup-mosha e te miturve te rritur ndonse edhe ne kete rast vetem per disa vepra penale te renda, sin je perjashtim nga rregulli i ybatimit te masave edukuese.

### 3.2 Zbatimi i masave edukuese ndaj fëmijëve që nuk kanë arritur moshën për përgjegjësi penale

Një veçori tjetër e masës edukuese të parashikuar në KP shqiptar është se ajo mund të zbatohet edhe ndaj fëmijëve që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale dhe pa asnjë kufi minimal moshe të përcaktuar për dhënien e saj. Në KP shqiptar nuk parashikohet shprehimisht një kufizim i tillë i moshës për zbatimin e masës edukuese ndaj fëmijëve nën MMPP. Në bazë të nenit 12 të KP mosha minimale për përgjegjësi penale (MMPP), e cila ndryshon në varësi të llojit të veprës penale është 14 vjeç për çdo lloj krimi dhe 16 vjeç për kundërvajtjet penale. Nën këto kufij minimal të moshës asnjë individ nuk mund të merret në përgjegjësi penale. Në bazë të Nenit 40/3/a të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, i cili iu kërkon shteteve Palë që të caktojnë një MMPP, fëmijët nën MMPP “*prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal*”. Si rrjedhim, ndonëse edhe këta fëmijë mund të jenë të aftë për të shkelur ligjin

[50] V.Kambovski, E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup 2007, f. 602.

penal, nëse ata kryejnë një vepër penale kur janë nën MMPP, atëherë sipas *prezumimit të pakundërshtueshëm* ata nuk mund të akuzohen dhe të mbajnë përgjegjësi sipas një procedure penale. Sipas Defence for Children International, MMPP është një indikator i rëndësishëm i gjendjes në të cilën ndodhet sistemi i drejtësisë për të miturit në një shtet të caktuar. Aktualisht MMPP varion ne vende të ndryshme të botës, duke filluar nga mosha shumë të vogla si 7 vjeç e deri në moshëm 18 vjeç.

Vetë Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës nuk e ka përcaktuar MMPP në nenin 40 të saj, por sipas Komitetit për të Drejtat e Fëmijës një MMPP nën moshën 12 vjeç do të konsiderohet se nuk është ndërkombëtarisht e pranueshme dhe në këtë kontekst Shteteve Palë iu rekomandohet që të rrisin kufirin e ulët të MMPP deri në 12 vjeç, si mosha minimale absolute, si dhe të vazhdojnë me një rritje të mëtejshme të tij në nivele edhe më të larta, mundësisht 14 ose 16 vjeç. Në Shqipëri ka patur diskutime në lidhje me ndryshimin e MMPP-së, kryesisht për unifikimin e dy kufijve minimalë duke rekomanduar moshën 16 vjeç si MMPP për çdo lloj vepre penale. Këto diskutime janë zhvilluar edhe në KRL gjatë punës për paketën ligjore për drejtësinë për të miturit duke arritur në konkluzionin se mënyra se si kjo moshë është përcaktuar aktualisht në KP konsiderohet se është në koherencë si me gjendjen aktuale të kriminalitetit të fëmijëve ashtu edhe me faktorë të tjerë që ndikojnë në përcaktimin e MMPP-së[51]. Në bazë të KP shqiptar kufijtë minimalë të moshës për përgjegjësi penale shërbejnë edhe si një bazë për të dalluar "statusin e ndryshueshëm penalo-juridik"[52] të fëmijëve autorë të veprave penale nën MMPP dhe në MMPP (të miturit), trajtimin e mundshëm të tyre me masa edukuese, përkatësisht *sipas rastit* me masa edukuese për fëmijët *nën MMPP* apo me dënime penale dhe vetëm *përjashtimisht e sipas rastit* me masa edukuese për *të miturit që përjashtohen nga dënimi*. Në bazë të KP shtytja ose tërheqja e të miturve nën MMPP për të kryer një *krim* përbën një figurë të veçantë krimi. Ndërkohë, në bazë të Kodit të Familjes nëse bashkëpunëtorë në veprën penale të kryer nga fëmija kanë qenë vetë prindërit e tij, atëherë këta të fundit nëpërmjet vendimit penal të dënimit humbasin edhe përgjegjësinë prindërore dhe fëmija i tyre rrezikon në këtë mënyrë të kalojë në kujdestari[53].

**4. Llojet e masave edukuese**

Në KP aktual parashikohet vetëm një lloj mase edukuese dhe konkretisht "vendosja e të miturit në një institucion edukimi". Kjo masë me karakter institucional, e cila është e vetmja masë edukuese që mund të zbatohet qoftë ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi, qoftë ndaj fëmijëve nën MMPP, konsiston në mbylljen e detyrueshme të fëmijës në një institucion të posaçëm edukimi. Fëmijës që vendoset në mënyrë të detyruar në një institucion edukimi i kufizohen disa të drejta dhe liri, pasi ky institucion i posaçëm imponon një regjim të veçantë jetese dhe marrëdhënie të kontrolluara me familjen.[54] Në KP të mëparshëm parashikoheshin dy lloje të masave edukuese, të cilave me ndryshimet e vitit 1988 iu shtuan edhe pesë lloje të tjera që mund të zbatoheshin kryesisht ndaj madhorëve. Mbyllja në një institucion edukimi parashikohej edhe në KP të vitit 1928, por në dispozitat përkatëse sqaroheshin edhe disa detaje të nevojshme në lidhje me këtë masë, si p.sh. përcaktime në lidhje me llojet e veprave penale për të cilat mund të jepej kjo masë, rregulla për revokimin, zbatimin e saj etj. Kështu, vlen të theksohet se për fajtorët e vegjël, të cilët në kohën e kryerjes së fajit (veprës penale) nuk kishin mbushur moshën 10 vjeç (ndaj të cilëve për shkak të moshës nuk lejohej ndjekja penale) gjykata, me kërkesën e prokurorit, mund të urdhëronte mbylljen në një institut edukimi dhe përmirësimi, kur ekzistonin të tilla, vetëm nëse fëmija kishte kryer një faj të ndëshkueshëm "me vdekje, me burgim të përjetshëm me burgim të randë ose me burgim jo ma pak se një vit". Mbyllja në këtë institute edukimi dhe përmirsimi vazhdon deri sa fajtori të mbushte moshën 20 vjeçe, porn ë çdo kohë gjykata kishte të drjtë të revokonte vendimin e mbylljes në këtë institute ose të urdhëronte që fëmija ti diryohej prindërve ose atij që ligji i ngarkonte kujdesin e edukimit të tij. Në lidhje me rastin e dytë, kur urdhërohej dorëzimi i fëmijës prindërve ose kujdestarit të tij, parashikohej se gjykata i jepte atyre *porosi* që "të kujdesen për ruejtjen dhe edukimin dhe të

---

[51] Po aty.

[52] V.Kambovski, E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup 2007, f.605.

[53] Po aty fq.31

[54] I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, 2009, f.230; Sh.Muçi,E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme, 2007, f. 261, 320.

vërejnë sjelljet e tija, se, në rast që këta nuk e vrejnë dhe kështu i vogëli ban ndonjë delikt të çdo lloji, kanë me pague një gjobë të lehtë nga një qint deri në pesqint fr.ari të cilën e cakton n'at vendim." Pra, prindërit ose kujdestari paralajmëroheshin mbi pagesën e një *gjobe* të lehtë, të përcaktuar në vendim, në rast se fëmija kryente një *delikt* të çdo lloji ndërkohë që ata nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre në "*vërejtjen e sjelljeve të tija'*[55]. Rregullat e parashikuara për fëmijët e moshës nën 10 vjeç, mbi mbylljen në institut edukimi dhe përmirësimi, lirimin në moshën 20 vjeç ose revokimin e vendimit apo dorëzimin prindërve apo kujdestarit në çdo kohë me vendim të gjykatës, zbatoheshin edhe për fëmijët e moshës 10-15 vjeç nëse provohej se nuk kishin patur një *"fuqi mëndore çmuëse (discernement)*" dhe nëse kishin kryer të njëjtat vepra penale të rënda të përcaktuara për fëmijët nën moshën 10 vjeç. Ndërkohë, për fëmijët 10-15 vjeç me fuqi mendore çmuese në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe për fëmijët e moshës 15-18 vjeç përcaktoheshin rregulla të posaçme për zbritjen e ndëshkimit. Për fëmijët e moshës 15-18 vjeç, të cilët *në kohën e dënimit* nuk kishin mbushur moshën 18 vjeç, parashikohej edhe mundësia që, me urdhër të gjykatës, dënimin kundër lirisë personale ta vuanin në një *institut përmirësimi.*

**Përfundimi**

Masat edukative të parashikuara nga Kodi Penal mund t'u shqiptohen të miturve (të miturve) vetëm kur ato përjashtohen nga dënimi penal për veprën penale të kryer dhe gjithashtu për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale në kohën e kryerjes së veprës penale. Sipas nenit 46 të këtij Kodi, gjykata mund të vendosë vetëm një masë edukative që është masë institucionale e përbërë nga vendosja e fëmijës ose të miturve në një institucion të veçantë arsimor.

Ky punim analizon karakteristikat e masës edukative të parashikuar nga Kodi Penal në kontekstin historik, në krahasim me legjislacionin penal të vendeve të tjera evropiane dhe rajonale dhe duke iu referuar instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, duke marrë në konsideratë edhe çështjet kryesore në lidhje me zbatimin e masës edukative. Ai përfundon me rekomandime për disa përmirësime të rëndësishme të nevojshme, siç është përcaktimi i masave edukative në të paktën një kapitull të veçantë në Pjesën e Përgjithshme të Kodit Penal Shqiptar që do të përqendrohej tek kryesit e mitur dhe ndër të tjera çështje që lidhen me të miturit do të specifikonin karakteristikat dhe rregullat e imponimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit për masat edukative. Në dispozita të tilla, masa institucionale e parashikuar aktualisht në këtë Kod do të bëhej një përjashtim dhe një masë e mjetit të fundit midis një sërë masash edukative të zbatueshme për të miturit dhe kjo shumëllojshmëri do të siguronte zbatueshmërinë e parimit të proporcionalitetit në procesin e zgjedhjes së mënyrës më të përshtatshme dhe masa efektive. Çështje të tjera relevante përfshijnë sigurimin e kritereve kryesore që gjykatat vendase shqiptare duhet të marrin parasysh kur vendosin një masë edukative, ku interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore; ndryshimi i rolit të masave edukative për të miturit në lidhje me ndëshkimin penal nga sekondaria, siç parashikohet tani, në rolin parësor (duke i dhënë përparësi masave edukative); duke marrë në konsideratë, në përputhje me rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, mundësinë e zgjerimit të zbatueshmërisë së dispozitave të veçanta për të miturit, kur është e përshtatshme, për të rinjtë kryesorë të moshës nën 21 vjeç; për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale, është e nevojshme të merret parasysh rekomandimi i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës se për këta fëmijë mund të merren masa të veçanta mbrojtëse nëse është e nevojshme në interesin e tyre më të mirë.

**Bibliografia**


Elezi I., Kaçupi S., Haxhia M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Ribotim, West Print, Tiranë, 2009.

Elez, Hysi, V. Politika kriminale, PEGI, 2006. Hysi, V. "Penologjia", PEGI, Tiranë, 2006.

Kambovski, V. , *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Botimi i dytë, Furkan ISM, Shkup 2007.

Muçi, Sh., *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2007.

Peza, N., Elezi, I., Gjika, G., Dumi, D., Çela, A., *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Pjesa e Përgjithshme),* Shtëpia botuese "8 Nëntori", 1982.

Committee of Ministers of the Council of Europe, *Recommendation Rec(2003)20 of the Committee of*


[55] Po aty.

*Ministers to member states concerning new ways of dealing with juvenile delinquency and the role of juvenile justice* (Adopted on 24 September 2003) Committee on the Rights of the Child, *General Comment No.10 "Children's rights in juvenile justice"* (CRC/C/GC/10), 2007.

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara me mbështetjen e Save the Children in Albania, *Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës- Studim Krahasues*, 2007.

Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri- Analizë e shkaqeve dhe faktorëve te kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri*, ViSi Design, Tiranë, Qershor 2007.

Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA), *Drejtësia për të mitur në Shqipëri- Një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri*, ViSi Design, Tiranë, 2007.

UNICEF, Regional Office for CEE/CIS, *Evaluation of UNICEF's contribution to Juvenile Justice System Reform*, Final Evaluation Report, March 2007.

# Uticaj ambijenta i poslovnog okruženja na svjetske turističke tokove

**Prof. Dr. Husnija Bibuljica**
Univerzitet "Haxhi Zeka",Fakultet Biznisa,Peć

**ABSTRAKT**

Ovaj rad sadrži neke od smjernica održivog razvoju budućeg svjetskog turizma. Imajući u vidu nestabilno svjetsko tržište koje je rezultat uticaja u prvom redu Covida-19, kao i trenutne politike vodećih zemalja u svijetu sa koncentracijom moći u desetak najrazvijenijih zemalja i antagonostičkim previranjima u nerazvijenim zemljama s druge strane, kao i upadom zemalja u tranziciji u nove svjetske tržišne procese, turizam se posmatra kao dio moguće prilagodljive varijante.
Svjetski turizam treba da doprinese ujednačavu procesa globalizacije,međunarodne saradnje, regionalizacije i održivog razvoja sa ciljem prelaska od starih istrošenih masovno zadovoljavajućih potreba ka novim individualnim zahtjevima visokog nivoa i u prvom redu odraziti na standard i kvalitet pružanja usluga samim tim i na standard života. Na taj način doći će do promjena kako socijalno-ekonomskih tako i tehničko-tehnoloških pozicija najrazvijenijih zemalja svijeta.

**Ključne riječi**: svjetski turizam,covid-19, nove tendencije,tranzicija, razvoj, promjene.

**ABSTRACT**
This paper contains some of the guidelines for the sustainable development of future world tourism. Given the volatile global market resulting primarily from the influence of Covida-19, as well as the current policies of the world's leading countries with a concentration of power in the top ten developed countries and antagonistic turmoil in underdeveloped countries on the other hand, global market processes, tourism is seen as part of a possible adaptive variant.
World tourism should contribute to the unification of the process of globalization, international cooperation, regionalization and sustainable development in order to move from old spent massively satisfying needs to new individual high-level requirements and primarily reflect the standard and quality of service and thus the standard of living. In this way, there will be changes in both the socio-economic and technical-technological positions of the most developed countries in the world.

**Keywords:** world tourism, covid-19, new tendencies, transition, development, changes.

**Uvod**

Prema predviđanjima Svjetske turističke organizacije (WTO) turistički promet iza 2000.godine povećavaće se godišnje po stopi od 3,4% do 4% što znači da će 2015.godine obuhvatiti milijardu i više putnika.Međutim, privreni rast neće biti ujednačen između inostranog i domaćeg turističkog prometa. Domaći turizam imaće tendenciju laganog pada u onim regionima svijeta koji su dostigli visok turistički razvoj i onim koji imaju ubrzanu stopu rasta i razvoja turizma. Tako će Evropa i Severna Amerika i dalje privlačiti inostrane turiste a u tom trendu konkurisaće im regioni Dalekog Istoka, Sjeverne Afrike, Kariba i Centralne Amerike. Razlika je u tome što će stopa rasta inostranih turista u Evropi i Sjevernoj Americi biti u stagnaciji, a u ostalim posmatranim regionima imaće oblik ubrzanog rasta.Naravno ovdje treba imati u vidu da u vrijeme Covida -19 kako domaći tako i inostrani turizam

doživljava borbu za opstanak i sada u ovo vrijeme javlja se tendencija rasta i razvoja u svim turističkim sredinama.

Domaći turizam dobiće značajnu poziciju u srednje razvijenim i zemljama u razvoju na bazi novihih kapaciteta, novih sadržaja i novih turistički nevalorizovanih prostora. To znači da tražnja uslovljava brzi razvoj turističke infra i supra strukture, a ponuda iznalaženje novih oblika ublažavanja pada ekomomske moći, viška slobodnog vremena i različitih prirodnih promjena (bioklimatologije, klimatomedicine, psihičkog stanja i dr.).

Treba imati u vidu da u sistemu globalizacije i regionalizacije svjetske privrede turizam mora tačno da definiše skup svih relevantnih promjena, nosioce tih promjena i organizacione oblike njihovog rješavanja.

Zato upravljanje turističkim razvojem podrazumijeva integraciju dvije grupe tih odnosa i to:
1. Skup onih promjena koje su izvan stalne kontrole turističke aktivnosti, ali prema "teoriji haosa" one mogu u svakom trenutku da utiču na njen razvoj. To su tzv. egzogene varijable, tj. one koje dolaze iz svjetskog društveno-ekonomskog sistema; i
2. Skup onih promjena koje su rezultat dejstva samog turizma, odnosno, proističu iz njegove dinamičko heterogene strukture i označavaju se kao endogene ili promjene unutar turističkih relacija.

Unarednom periodu budući turistički razvoj mora da uspostavi balans između brzog mijenjanja socijalnih, ekonomskih, ekoloških, političkih i drugih parametara koji direktno ili indirektno utiču na njegovu strukturu i promjena u dostignuću tehničko-tehnoloških poboljšanja ponude, tj. nove turističke destinacije i ukupnog turističkog proizvoda.

Novi korisnici turističkih usluga su putem savremenih medija dobro obavješteni što povećava njihovu produktivnost, radoznalost i dinamiku. To uslovljava da se mijenja oblik tražnje po različitim starosnim grupama, a samim tim ujednačava se sezonski karakter turizma. Zato će budući turizam imati dva različita tempa razvoja:

Prvo:Formiranje tražnje i ponude za pasivni dio turističke populacije koji teži ka stacionarnom turizmu sa pretežno ekološki vrednim parametrima bez većih troškova transporta i koga obuhvata najveći deo domaćeg turističkog prometa; i

Drugo: Trend modernog turizma edukativno radoznalnog karaktera sa visokim nivoom kvaliteta turističkog proizvoda, višestrukom ponudom koja podleže brzim promjenama turističkim zahtjevima. Takav turizam uključuje sve segmente ponude od gradova, planinskih centara, turizma na vodi do onog specifičnog (klubova, ulaženje u grotlo vulkana, vožnja gradskim kanalizacijama, putjevi Marka Pola, doživljaji Džejmsa Kuka i sl.).

Treba istaći prilagodljivost industrije turizma svjetskim tržišnim promjenama, razvoj informacionih sistema i stvaranjem marketing baze podataka uslovljavaju brzi prelazak iz masovne ujednačenosti turističkog prometa ka strogo definisanim individualnim zahtjevima oblikovanja turističke ponude.

Nove promjene na političkim i ekonomskim kartama u svijetu zahtjevaju od turizma brzo reagovanje u:
1.Smislu prihvatanja novog privrednog okruženja;
2.Uključivanju novih destinacija u turističku ponudu;
3.Cjelovitom obuhvatanju prostora i lokalnog stanovništva u cilju zadovoljavanja turističkih potreba;
4.Aktiviranju do sada nedovoljno traženih i neafirmisanih turističkih regija;
5.Uspostavljanju informacionih sistema nad cijelim turističkim prostorom; i
6.Brzom razvoju stručnih kadrova za realizaciju stalno promjenljivih turističkih zahtjeva.

Težeći ka što bezbolnijim promjenama svjetski turizam u novim uslovima privređivanja mora da pođe od sljedećih

varijabli:

Prvo, treba utvrditi demografske osobine kako na strani tražnje tako i na strani ponude. Najizrazitije promjene su kod starosne i ekonomske strukture na strani tražnje i kod polne i ekonomske strukture na strani ponude. Starosne grupe iznad 45 godina starosti teže da zadrže stari oblik turističke aktivnosti stacionarnog i zdravstveno-rekreativnog tipa, a mlađe segmentne grupe traže nov razvoj turističke ponude u obliku poslovnog, edukativnog, radoznalog i atraktivnog turizma. S' druge strane, razvoj alternativnih oblika turizma i valorizacija novih prostora zahtjeva sve veće aktiviranje ženske radne snage u dopunskim turističkim poslovima. U isto vrijeme, ekonomska struktura u obliku visine ostvarenog dohotka za putovanja i dužine neiskorišćenog slobodnog vremena omogućava biranje novih i skupljih oblika tutizma kako na strani ponude tako i na strani tražnje;

Drugo, političke promjene u svjetskim okvirima dovele su i do razvoja koncepcije turizma različitih tržišta. Naročit uticaj imaju države u tranziciji koje teže da u okviru svojih regiona postave novu turističku koncepciju. Ta koncepcija je na tržišnim osnovama, što im omogućava prilagođavanje svjetskom turističkom tržištu. Kako je u njima bio razvijen kulturni turizam, to su i mogućnosti bržeg prilagođavanja veće. Naročito su u tome uspjele Mađarska, Češka i Poljska, koje imaju turistički dobro razvijenu prirodno-antropološku bazu. Na području Južne Afrike kao i zapadnog dijela tog kontinenta, razvija se tzv. turističko-demografski povraćaj, tj. bivši stanovnici tih zemalja i njihovi potomci demografski se vraćaju u te zemlje razvijajući ponudu sopstvenim kapitalom, a u isti vreme postaju i korisnici turističkih usluga (Nigerija, Obala Slonovače i sl.).

Takođe i Svjetske političke i privredne integracije kao što su Evropska unija, Sjeverno-američki sporazum o trgovini i druge, koncentracijom ekonomske moći stvaraju potencijalne turiste sa višim zahtjevima i za kvalitetnim uslugama, što mnogim nerazvijenim regionima svijeta donosi veliki dohodak i brži razvoj (Kini, Tajlandu, Nepalu, Argentini, Brazilu, Meksiku, itd.).
Na kraju, sama globalizacija i regionalizacija kao svjetski političko-ekonomski problem u svakom pogledu ne odgovara malim i nerazvijenim zemljama, zato što dohodak koji se prelije iz razvijenihh zemalja u njihovu turističku kasu je u većini slučajeva stvoren u njihovim zemljama raznim eksploatacijama svjetskih moćnika;

Treće, kao osnovni indikator masovnih turističkih putovanja razvoj transporta će i u buduće biti jedna od četiri integralne cjeline turističkog progresa. Moderni turizam zahtijeva tehničko-tehnološko poboljšanje saobraćajnih sredstava u vidu bezbjednosti, kvaliteta usluga, smanjenja buke, nižih cijena i stvaranja tzv. ekoloških sredstava prevoza. Mijenjaće se i odnos broja putnika i tražnje za pojedinim vrstama saobraćaja, tako da će prednost biti na strani suvozemnih i vodenih prevoznika sa tendencijom smanjenja za vazdušnim saobraćajem.
U pozicijama globalizacije i regionalizacije svjetskog ekonomskog sistema, stvaranje integralnih cjelina tj. udruženja, asocijacija, saveza i federacija svjetskih prevoznika, omogućiće brži razvoj tehničko-tehnoloških sistema saobraćaja, protok informacija i razmjenu kadrova. To će stvoriti svjetski strategijski sistem upravljanja transportom, brzu realizaciju tražnje različitih turističkih grupa i efikasnu kontrolu izvršenih usluga. Uz poštovanje tačno preciziranih normativa kvaliteta, garantovanih cijena i jedinstvenog sistema funkcionisanja saobraćaja u zemljama turističke tražnje i ponude i utvrđenih koridora između njih, ostvariće se relativno praćenje dinamike turističkih potreba i dinamike razvoja saobraćaja za zadovoljenje tih potreba;

Četvrto, značaj dostignuća tehničkog progresa utiče na povećanje konkurentske sposobnosti pojedinih turističkih regiona koji podstiču preduzetništvo u cilju smanjenja operacionalnih troškova poslovanja i maksimiranje profita.
U tom smislu treba evidentirati:
1.Efikasnost i produktivnost turističke aktivnosti koje smanjuju troškove poslovanja na bazi tehničko-tehnoloških prednosti regiona; i
2.Kvalitetne razlike i učvršćivanje pozicije na turističkom tržištu koje donose izvedene prednosti.
Tehnički progres u turizmu implicira bržu razmjenu informacija između ponuđača i potrošača, omogućava

smanjenje troškova po jedinici proizvoda u hotelijerstvu, učešće potencijalnih turista u kreiranju turističke ponude, stvaranje pojedinačne baze podataka u okviru kompleksne marketing baze, približavanje turista i lokalnog stanovništva, kao i njihovo zajedničko približavanje organizatorima i izvršiocima turističkih usluga, i brže i kvalitetnije povezivanje svih kreatora sekundarnog turističkog proizvoda (saobraćaj, građevinarstvo, poljoprivreda, trgovina, itd.) i stvaralaca primarnog turističkog proizvoda (ugostiteljstvo i turizam).

Potreba za efikasnošću na tržištu međunarodnog turizma je ubrzala hitnost multinacionalnih korporacija koje obezbjeđuju usluge turizmu u raznim zemljama. Globalizacija je jedan od vodećih trendova u industriji međunarodnog turizma. Bazirana je na konvergenciji u svjetskim ukusima i preferencija proizvoda, koja rezultira u globalno standardizovanim proizvodima i koja je olakšana tehnološkim inovacijama sistema, kao što je GDS.

Međutim, globalizacija ide paralelno sa povećanom koncentracijom u industriji turizma, tako što vodeće kompanije dobijaju dio tržišta i uticaj istog. U isto vrijeme, vidimo da je koncentracija kapitala u rukama nekoliko vodećih igrača u sektoru turizma, trend koji takođe vodi turizam ka pokazateljima performansi i praktičnim poslovima tražen je od strane finansijske industrije.

Za turizam preduzeća postoji mnogo prednosti koje povećavaju širinu u multinacionalnom tržištu, i to:
1. ekonomija rasta i razvoja;
2. sposobnost da izvor visokog profita promoviše kompaniju;
3. beneficirano zaštitno ime kroz standardizaciju i kontrolu kvaliteta;
4. sposobnost da pokrije rizik među raznim tržištima;
5. implementacija prednosti tehnika marketinga na institucionalnim osnovama svjetskogturističkog sistema;
6. upotrebe tehnologije;
7. optimizacije kapaciteta;
8. prihvatanje međunarodnog tržišta radne snage;
9. prednosti preko drugih članova distribucionih kanala;
10. dokazan politički uticaj;
11. menadžeri koji imaju više vremena da rukuju; i
12. tržišno isticanje i jačanje pozicija preduzeća.

Treba istaži da najveći broj velikih korporacija nema programe sa specifičnim destinacijama, dok u isto vrijeme turistička preduzeća male i srednje veličine i lokalne destinacije strahuju od neokolonijalnog odnosa koji može da se pojavi u slučaju poređenja sa velikim kompanijama, jer njihove komparativne prednosti uključuju:
1.različitost proizvoda koja ne utiče na cijenu;
2.visok nivo ličnih usluga;
3.visok nivo znanja proizvoda;
4.kvalitet; i
5.oslobađanje novih prostora za formiranje specifičnih oblika turističkoh tržišta.

Iz svega navedenog slijedi da razvoj novih tehničko-tehnoloških dostignuća na prvo mjesto stavlja značaj turističke organizacije i njenu inkorporaciju u globalni svjetski turistički sistem;

Peto, dejstvo promjena prirodnih faktora određivače kreaciju budućeg turizma u zavisnosti od efekta staklene bašte,globalnog zagrijevanja i pojave različitih bolesti koje iz njih proističu (očne bolesti, rak kože i sl.). To će uticati na novu ponudu kupališnog i planinskog turizma.
U isto vrijeme obrazovanje ljudi i brz prijem informacija o svjetskim destinacijama usloviće ubrzano prelaženje iz

ustaljenih oblika odmora (porodični turizam) na nove oblike putovanja, odmora i razonode. S toga svjetski turizam mora stalno da prati faktor iznenađenja kako u promjenama prirodnog okruženja, tako i u svim drugim socio-ekonomskim varijablama; i

Šesto, saturacija turističkih prostora u razvijenim zemljama inicirala je potrebu za turističkom valorizacijom novih prostora naročito u nerazvijenim zemljama. Kako ne bi došlo do stihijskog prodora turizma u te prostore i uništavanja životne sredine ostvarivanjem profita na kratak rok, pojavio se i koncept održivog turizma. Još 1961.godine na Svjetskoj konferenciji u Nju Delhiju, kada je prvi put definisan nacionalni park kao zaokružena ekonomsko-ekološka sredina, pa do svjetskog ekološkog samita u Rio de Žaneiru 1982.godine odnosi razmjene turizma i prirodnog okruženja se postavljaju na nivo uzročno-posljedičnih veza. Budući turizam mora da ujednači bilans samoobnavljanja prirodne sredine i turističkih potreba. Na taj način granično ekonomsko-ekološki prostori postaju prilagodljivi najezdi turističke industrije, s tim što dobijaju višu društvenu vrijednost i ekonomsku cijenu. Zato održivi turizam mora da prilagodi ekonomiju resursa stalnom rastu i razvoju turizma uz oplemenjivanje i kvalitativno ocjenjivanje životne sredine,a ne njeno stihijsko iscrpljivanje. U tom pogledu dinamički rast turističke industrije će uvek imati veću vrijednost u budućnosti, a lokalne zajednice biće zadovoljnije.

Osnovne pretpostavke budućih trendova razvoja svjetskog turizma zato treba tražiti u:
1.difuziji sistema novih informacionih tehnologija u industriji turizma;
2.deregulaciji turističke industrije i finansijskih usluga;
3.negativnom uticaju masovnog turizma na domaće zemlje;
4.kretanju unazad od žudnje za suncem do sunce-plus turizam;
5.pritiscima okruženja;
6.tehnologiji;
7.konkurenciji; i
8.promjenama ukusa potrošača.
Drugim riječima,budućnost turizma će biti jedan od fleksibilnih, segmentiranih, običajnih i dijagonalno suprotno spojenog turizma radije nego masovnog, ukočenog, standardizovanog i “upakovanog” turizma ranijeg perioda.

**Zaključak**

Sklop savremenih promjena svjetskog društveno ekonomskog sistema sa tendencijama globalizacije, regionalizacije i ubrzane tranzicije obuhvata i novu fizionomiju budućeg razvoja turizma. Ta fizionomija zasniva se na brzim reakcijama i odgovorima na novo nastale odnose. Zato svjetski turizam u budućem periodu mora da izvrši prečišćavanje starog načina funkcionisanja i uključivanje u nove oblike razvoja samo onih stabilnih dijelova bez kojih i budući turizam ne može. To znači usavršavanje transportnih usluga, uvođenje u ponudu novih nekorišćenih prostora, oplemenjivanje starih destinacija, rekonstrukcija i zaštita svih antropoloških vrijednosti i dopunjavanje turističko-ugostiteljske infra i supra strukture novim izazovima.

Budući turizam postaje zavistan od tehničko-tehnoloških dostignuća, naročito u informacionim tehnologijama, što omogućava približavanje tražnje ponudi i učešće svih relevantnih parametara u kreiranju turističkog proizvoda. On mora da koristi svjetsku turističku marketing bazu podataka uz poštovanje tzv. principa poštenog marketinga gdje je čovjek, tj. turista, osnovni nosilac ukupnog izgleda turističke industrije.

Integrisanjem u globalni svjetski turistički sistem tržište će da ima osnovnu ulogu u preraspodjeli turističke aktivnosti u informacionom, prirodno - antropološkom, demo-grafskom i ekološkom pogledu sa osnovnim ciljem stvaranja profita.
Na kraju buduće tendencije svjetskog turizma imaju oblik pomirenja starog i novog koncepta, uz tendencije trenutnog reagovanja na izmjenu motiva turističkih putovanja.

**Literatura**


1. Berc Radišić, B., Marketing turističkog proizvoda destinacije, Sveučilište u Rijeci, Fakultet za menadžment u turizmu i ugostiteljstvu u Opatiji, Opatija
2. Christie Robert Mill (1990): Tourism The International Business, New Jersey.
3. Cooper (2000): Tourism Principles and Practice, Longman, Singapore (COS).
4. Čavlek, N. (2018). Tourism Distribution and Intermediaries, u The SAGE Handbook of Tourism Management, C. Cooper, S. Volo, W.C. Gartner & N. Scott (eds.), SAGE Publications Ltd: London
5. Memedović, O. & Iapadre, L. (2010). Structural Change in the World Economy: Main Features and Trends. Vienna.
6. Milenković, S. (1999): Turistička aktivnost u tržišnoj privredi, Vuk Karadžić, Paraćin.
7. Vodeb, K. (2014). Turistična destinacija: sodobna obravnava koncepta, Univerza na Primorskem, Fakulteta za turistične študije – Turistica, Portorož.

# Menaxhim Risku

**Gazmore Rexhepi, PHD CAND**
Akademia Tempulli – Prishtine
rexhepigazmore@gmail.com

APSTRAKT

Egzsitojnë shumë definicione te riskut , risku me shumë definohet si pasiguri ose shansë që diqka të ndodhë nga e cila do të ketë ndikim në objektivat e kompanisë.
Jemi dëshmitarë të asaj se risku ndikon në renje dhe ne ngritje si dhe në identifikimin e mundesive për të eliminiar humbjet .
Një vemendje të veqant kërkojnë komponentët kryesor të riskut si dhe menaxhimi I mirë I tyre si psh volalititeti ose paqëndryeshmëria ,pasiguria ose paqartësia si dhe ngjarjet ekstreme të cilat kërkojnë një përkushim të veqant.
Me e rëndesishmja është të dimë të identifikomë reziqet kryesore te pastra që lidhen ngushtë më pasigurinë financiare, të jënë idetë e qarta ne lidhje me rrezikut dhe barra e tij për shoqerin në përgjithësi , si dhe teknikat kryesorë për menaxhimin e rrezikut.
Një sigurues munde te marre një varg te masave per te zvogëluar riskun e biznesit te tij. Kjo përfshinë blerjen e risigurimit, blerjen e letrave me vlere per një pjese te portofolios se aseteve apo te detyrimeve, vetëmbrojtjen e garancioneve financiare duke shfrytëzuar instrumentet derivateve, shfrytëzimin e dizajnit te produkteve per ta bartur riskun te policmbajtesit, sikurse edhe menaxhimin efektiv te riskut. Ne masën aq sa këto veprime ne mënyre efektive e zvogëlojnë riskun e kompanisë, nevojitet qe ne mënyre te duhur te pranohen ne kalkulimin e kërkesave per kapital te kompanisë. Veshtërsit qëndrojnë ne vlerësimin adekuat te shkalles se riskut te cilin duhet transferuar nga kompania e sigurimit ne arrangjimet e këtilla.

Fjalët kyqe : risk, menaxhment, sigurim, humbje.

**ABSTRACT**

There are many definitions of risk, more risk is defined as uncertainty or the chance that something will happen that will have an impact on the company's objectives.
We are witnessing that risk affects the decline and increase as well as the identification of opportunities to eliminate losses.
Special attention is required to the main components of risk as well as their good management such as volatility or instability, uncertainty or uncertainty as well as extreme events which require special attention.
The most important thing is to know how to identify the main clean risks that are closely related to financial uncertainty, to have clear ideas about the risk and its burden on society in general, as well as key risk management techniques.
An insurer can take a number of measures to reduce the risk of its business. This includes the purchase of reinsurance, the purchase of securities for a portion of the asset or liability portfolio, the self-protection of financial guarantees using derivatives instruments, the use of product design to bear the risk of policyholders, as well as effective risk management. To the extent that these actions effectively reduce the company's risk, they need to be properly accepted in the calculation of the company's capital requirements. The difficulty lies in the adequate assessment of the degree of risk to be transferred from the insurance company to such arrangements.

Keywords: risk, management, insurance, loss.

# HYRJE

INSTITUCIONET E KURSIMIT TË KONTRAKTUAR INDUSTRIA E SIGURIMEVE NË KOSOVË

Disa ndodhi kërkojnë mjete të mëdha financiare kur të paraqiten, siç është, bie fjala, emergjenca mjekësore apo aksidenti i trafikut, ose vdekja e anëtarit të familjes. Për t'i evituar këto rreziqe, rol të rëndësishëm luajnë **institucionet e kursimit të kontraktuar,** të cilat u mundësojnë individëve që:
të paguajnë para për ta transferuar rrezikun e shpenzimeve të mëdha financiare te dikush tjetër, apo
2. të paguajnë në mënyrë të disiplinuar për pensionim[56].

**Kompanitë e sigurimeve**

Janë ndërmjetësuese financiare të specializuara për nënshkrimin e kontratave për mbrojtjen e poseduesve të policave nga rreziku i humbjes financiare që mund të paraqitet në raste të veçanta. [57]Sigururesit grumbullojnë fonde, duke lëshuar premtime për të paguar në kushte të caktuara dhe pastaj duke u huazuar paratë huamarrësve. Mundësia e mbulimit të shpenzimeve të mëdha financiare i shtyn shumë njerëz që t'u paguajnë kompanive të sigurimit provizionet që quhen *prime,* në mënyrë që kompania e sigurimit të bartë rrezikun. Të marrim një shembull: Një individ mund të paguajë primin prej 1000 € për sigurimin e jetës, të cilën kompania e sigurimit do t'ia huazojë një hoteli.

Industria e sigurimeve ka dy segmente.

*Kompanitë e sigurimit të jetës i* shesin policat për t'i mbrojtur familjet nga humbja e fitimeve për shkak të paaftësisë, pensionimit dhe vdekjes së personit të siguruar.
*Kompanitë e pasurisë dhe dëmeve* i shesin policat, për të mbrojtur familjet dhe firmat nga rreziqet e sëmundjeve, vjedhjeve, zjarrit, aksidenteve dhe katastrofave natyrore. Profitabiliteti i kompanive të sigurimit varet në masë të madhe nga aftësia e tyre për t'i reduktuar shpenzimet e informimit të zgjedhjes adversive dhe hazardit moral.

**Parimet e menaxhimit të sigurimeve**

Kompanitë e sigurimeve realizojnë fitime nga teprica e primeve përmbi pagimin e kërkesave dhe nga investimet në biznese.[58] Këto institucione një kohë të gjatë kanë qenë pjesëmarrës të rëndësishëm në sistemin financiar, duke i investuar primet e pronarëve të policave në tregjet e kapitalit, rëndom në aksione, obligacione, hipoteka dhe kredi direkte për firma.

Parashikimi i rrezikut

Kompanitë e sigurimeve mund të parashikojnë lehtë, kur dhe sa kompenzim do të kërkojnë kursimtarët, duke shfrytëzuar përparësitë e *ligjit të numrave të mëdhënj.* Ky koncept statistikor thotë që, edhe pse rreziqet nga vdekja, sëmundja apo lëndimi për individin nuk mund të parashihen, paraqitja mesatare e një ndodhie të tillë, për një numër të madh njerëzish, mund të parashihet. Prandaj, duke lëshuar një numër të mjaftueshëm të policave, kompanitë e sigurimeve e shfrytëzojnë përparësinë e përmbledhjes (pooling) dhe diversifikimit të rrezikut për të vlerësuar madhësinë e rezervave të nevojshme për kërkesat potenciale. Statisticienët, të njohur si aktuarë, përpilojnë tabelat e probabilitetit për të ndihmuar parashikimin e paraqitjes së rrezikut në popullsi.

---

[57] Prof. dr. Gazmend Luboteni " Financat e Korporatave" Prishtinë- fq: 15
[58] Prof. dr. Gazmend Luboteni " Financat e Korporatave" Prishtinë- fq:19

## RISKU I SIGURUESVE

Bazat e riskut

Menaxhimi i riskut ne sigurime përfshinë:
- Dizajnimin, formimin e çmimeve, marketingun dhe marrjen ne sigurim;
- Përzgjedhjen e aseteve te cilat mbështesin policat e sigurimit;
- Vlerësimin e numrit dhe volatilitetit te detyrimeve bashkangjitur policave te tyre;
- Përcaktimin e nevojave për kapital te siguruesit;[59]
- Menaxhimin e dëmeve;
- Freskimin e vazhdueshëm te te gjithë elementeve, ashtu qe te dhënat dhe informatat e reja te jene te mundshme, sepse risku i caktuar munde te ndryshoi;
- Një proces adekuat, i sigurt i komunikimit me te gjithë aktoret kyçe (p.sh menaxhmenti, mbikëqyrësi, aksionaret dhe investitorët);
- Analizat e kushteve financiare ne te ardhshmen, te cilat ofrojnë një perspektive dhe pasqyre multi-scenario te kompanisë ne përgjithësi.[60]

Hapat e menaxhimit te përgjithshëm te siguruesi ilustrohen ne diagramin e mëposhtëm. Diagrami ilustron se operacionet e siguruesit ndikohen nga ambienti i biznesit ne te cilin operon (p.sh nga ai ligjore, social, konkurrenca, ekonomik, qeverisës, tatimeve et.).




[59] Pasiguria dhe Sigurimet" Koçi,Bundo,Shalari faq .91
[60] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition faq:6

Ne figurën e mësipërme shohim se risku është i pandare ne secilin hap te diagramit. Vlerësimi i këtyre risqeve është element kyçe ne operacionet e një siguruesi. Meqenëse aktuaret janë persona te specializuar për vlerësimin e risqeve financiare dhe menaxhimin e riskut te ngjarjet e rastit, është e natyrshme qe aktuaret te ndihmojnë ne vlerësimin e riskut, ne shume pika te "te ciklit te kontrollit aktuarial".[61]

Është me rëndësi te potencohet roli qendrore qe ka kapitali ne diagramin e mësipërm. Kapitali paraqet një amortizatorë kryesor i cili na siguron se obligimet ndaj policembajtesve do te përmbushen. Operacionet e një siguruesi, pas efektit neto ndaj te gjitha risqeve, duhet te sigurojnë një fitim te arsyeshëm për investitorët e kapitalit te tyre.

## Definicioni i riskut

Ekzistojnë shume definicione te riskut. Me i shpeshtë është definicioni se:
***Risku – është shanse qe diçka te ndodhe e e cila do te ketë ndikim ne objektivat e kompanisë***. Risku matet ne termat e konsekuencës dhe te gjasave.
Ky definicion nënkupton se risku munde te ketë ndikim rënës dhe ngritës. Kështu qe:
***"Menaxhimi i riskut ka te beje me shume me identifikimin e mendësive për te eliminuar humbjet".***

## Llojet e risqeve te siguruesit

Risqet e siguruesit munde te kategorizohen ne katër lloje kryesore:
- **Risku i marrjes ne sigurim**
- **Risku kreditor**
- **Risku i tregut**
- **Risku operacional**

Secili lloj i riskut përmban ne vete me shume risqe specifike.

## Komponentët kryesore te riskut

Ne modelimin e risqeve, aktuaret i kushtojnë vëmendje te rëndësishme këtyre komponentëve kryesore te riskut:

**<u>Volatilitetit (paqendrueshmerise)</u>**

Volatiliteti është risku i fluktuimit te rastësishëm ne cilëndo frekuence apo ashpërsi te një rast i mundshëm.[62] P.sh vdekshmëria, gjithnjë është e mundur qe jetëgjatësia e personit te ketë lëkundje nga ajo e pritura (nga jetëgjatësia mesatare). Ky lloj risku është i "deversifikueshem" qe nënkupton se volatiliteti i shumes se demit mesatar zvogëlohet

---

[61] Pasiguria dhe Sigurimet" Koçi,Bundo,Shalari faq .92
[62] Pasiguria dhe Sigurimet" Koçi,Bundo,Shalari faq .93

ne bllok si rezultat i rritjes se riskut te pavarur te siguruar.
Ne ekonomit efektive te tregut, volatiliteti nuk do te vlerësohet ne kalkulimin fere te vlerës se aseteve sa i përket projektimit te rrjedhës se parës ne te ardhmen. Sepse kapitali do te shfrytëzohet për te absorbuar fluktuimet qe rrjedhin nga risku i volatilitetit.[63] Kjo teori e formimit te çmimeve ne tregun efektiv mbështetet ne kendeveshtrimin e investitorëve, përderisa risku ne portofolin e tyre munde te diversifikohet. Sidoqoftë, për shkake te tregut relativisht jo efektiv për te vlerësuar riskun sigurues, komponenti e volatilitetit te riskut nuk munde te injorohet, përderisa policmbajtesit zakonisht nuk munde ta diversifikojne riskun metutje. Një sigurues munde te bankrotoi për shkak te mos diversifikimit te riskut, ashtu qe policmbajtesit duhen te mbrohen nga ai risk.

**b) <u>Pasiguria (paqartësia)</u>**

Pasiguria është risku se modelet e shfrytëzuara për te vlerësuar demet apo proceset tjera relevante janë te specifikuara keq, apo qe parametrat brenda modelit janë te keqe vlerësuara. Risku i pasigurisë është i padiversifikueshem, sepse nuk munde te zvogëlohet (relativizohet) përmes rritjes se madhësisë se portofolios.
Duke shfrytëzuar shembullin e vdekshmërisë, ne raste se vdekshmëria aktualisht ka dy 5- she ne te dhe jo 6- she (apo numra te ndryshëm anash), atëherë vlerësimi me 3,5 duke u bazuar ne vdekshmërinë (normale) paraqet keqe specifikim nga vlerat e pritura. Përderisa kompanitë e sigurimeve shpeshherë kane standarde unike te marrjes ne sigurim dhe shprehi te tregut, ato duhet te pritet qe te kenë edhe parametrat e tyre unike. Eksperiencat aktuale te vështruara për një grup, ndoshta nuk do te jene relevante për eksperiencën e ardhshme për grupin tjetër, ashtu sikurse qe eksperienca e tere populacionit ndoshta nuk do te jete adekuate për një kompani individuale.

Tre elemente kyçe përfshihen te pasiguria:

- **Modeli vetvetiu munde te jete jo korrekt** (p.sh nuk ekzistojnë parametra te caktuar, te cilat e bëjnë modelin jo adekuat për ta përshkruar realitetin). Kjo zakonisht i referohet riskut te “gabimeve ne model”. Kjo munde te ndodh atëherë kur distribuimi vetvetiu keqkuptohet (ne rastet kur proceset aktuale munde te jene ne aspektin afatgjate normale dhe dikush e vlerëson si distribuim normal), apo kur forcat kryesore shtytëse te marrëdhënieve +janë te gabueshme.[64]

- Madje edhe nëse modeli i kesh floëit (rrjedhës se parasë) munde te jete korrekt, dhe nëse modeli themelor është adekuat, **parametrat duhet te ri vlerësohen**. ***Risku i parametrit është gabimi ne vlerësim***, i cili ekziston sepse:
- Numri i vrojtimeve mbi te cilët bazohen vlerësimet me te mira i kane limitet e tyre, sepse periudha e vrojtimit munde te jete shume e shkurtër;
-Volatiliteti i vrojtimit e bene vlerësimin me pake te sigurt;
-Periudha gjate se cilës është bere vrojtimi ndoshta nuk ka përfshirë disa ngjarje katastrofike te cilat, ne fakt, duhet te reflektohen ne parametrat e distribucionit;
-Vrojtimi përfshinë te dhëna kontaminuese (te ndyra).

- **Struktura e riskut (p.sh parametrat) munde te ndryshoje gjate kohës apo te behet e pasigurt për shkaqe te ndryshme.** Kjo duhet te merret parasysh ne modelimin e risqeve. Ndonjëherë te ashtuquajturit risqe strukturore ndryshojnë, për shembull, vendimet e reja gjyqësore munde te ndryshojnë interpretimin dhe gjuhen e politikave, zbulimet e reja te mëdha ne medicine (ilaçet për kancer), apo sëmundjet e reja (AIDS). Ky risk ndonjëherë inkorporohet ne kuadër te modelit përmes distribuimit “struktural” te parametrave.

---
[63] Pasiguria dhe Sigurimet” Koçi,Bundo,Shalari faq .94
[64] Pasiguria dhe Sigurimet” Koçi,Bundo,Shalari faq .98

c) **<u>Ngjarjet extreme</u>**

Ngjarjet extreme përshkruhen me impakte te larta, por si ngjarje janë me frekuence te ulet për biznesin e përgjithshëm te kompanisë. Për cilin do risk, një apo me shume ngjarje extreme munde te shkaktojnë qe fluktuimi te jete shume me i larte se sa ai i prituri nga fluktuimi normal (modeluar). Ato janë goditje apo tronditje te menjëhershme për nga ekstremi, rrjedhe e pafavorshme e distribucionit te probabilitetit i cili nuk është prezantuar ne mënyre adekuate përmes ekstrapolimit nga me shume ngjarje te përbashkëta dhe për te cilat është zakonisht vështirë te specifikohet vlera e humbjeve. [65]Për shembull, një sëmundje ngjitëse munde te afektoi shume persona ne mënyrë simultane, kështu qe një fenomen i tille shfuqizon vlerësimin e zakonshëm për pavarësinë ndërmjet personave; apo, thashethenat apo deklaratat dramatike publike munde te ndikojnë ne rrënimin e likuiditetit ne një kompani sigurimi. Mundësi tjetër është se munde te ndodhe një ngjarje e cila munde te ketë probabilitet eksremisht te ulet te ndodhjes. Risku i ngjarjes ekstreme, përveç volatilitetit normal te cash floës, ka nevoje për përkushtim te veçante përderisa fluktuimet rezultateve munde te jene aq ekstreme sa qe kërkojnë një strategji te pavarur te menaxhmentit.

**Llojet e risqeve**

Risku i marrjes ne sigurim

Kompanitë e sigurimit e pranojnë riskun përmes lidhjes se kontratave se sigurimit te cilat ato i shesin.[66] Risqet ne kuadër te kategorisë se riskut te marrjes ne sigurim janë te bashkangjitura përmes rrezikut te mbuluar për linjat specifike te sigurimit (zjarri, vdekja, incidentet motorike, tufani, tërmeti etj.), si dhe përmes proceseve specifike qe ndërlidhen me ushtrimin e biznesit te sigurimit. Ne nuk do ti listojmë te gjitha hazardet specifike, por me shume do te fokusohemi ne risqet me gjenerike te cilat kane te bëjnë me te gjitha linjat e biznesit te sigurimeve:

- ***Procesi i riskut te marrjes ne sigurim*** - risku nga ekspozimi i humbjeve financiare te cilat kane te bëjnë me aprovimin e riskut për ta siguruar;
- ***Risku i çmimit –*** risku qe çmimi i përcaktuar nga kompania për kontratën e sigurimit te jete jo adekuate për te mbuluar obligimet e ardhshme te cilat dalin nga ajo kontrate;
- ***Risku i dizajnit te produktit*** – risku qe kompania te ballafaqohet me ekspozimin e riskut ne kuadër te kontratës se saj te sigurimit e cila është anticipuar ne dizajn dhe çmimin e kontratës se sigurimit;
- ***Risku i dëmeve*** – risku qe te ndodhin me shume dëme se sa ato te pritura apo disa dëme te cilat ndodhin te jene shume me te mëdha se sa ato te pritura, e te cilat rezultojnë ne humbje te papritura. Kjo përfshinë se bashku si riskun se demi munde te ndodhe, ashtu edhe riskun qe demi munde te zhvillohet ne mënyre te pafavorshme pasi qe te ndodhe;
- ***Risku i ambientit ekonomik*** – risku qe kushtet sociale te ndryshojnë ne atë mënyrë qe te kenë efekt prapavajtës ne kompani;
- ***Risku neto i mbajtur*** – risku qe vete mbajtja e larte e dëmeve te sigurimit te rezultoi ne humbje nga shkaqet katastrofike apo te një eksperience te dëmeve te koncentruar;

---

[65] Pasiguria dhe Sigurimet” Koçi,Bundo,Shalari faq .100
[66] Leksioni “Risku dhe Sigurimet” Gentiana Sharku faq.103

• *Risku i sjelljes se policmbajtesve* – risku se policmbajtesit e kompanisë se sigurimit te veprojnë ne mënyrën qe nuk është pritur dhe te kenë një efekt te dëmshëm prapavajtës ne kompani;
• *Risku i rezervimeve* – risku qe provizionet e mbajtura ne pasqyrat financiare te kompanisë se sigurimit për te mbuluar detyrimet ndaj policmbajtesve te tyre ( "detyrimet ndaj dëmeve", "provizionet teknike") te jene jo adekuate.

Risku kreditor

Risku kreditor është risku i dështimit apo ndryshimit ne kualitetin e letrave me vlere te siguruesit (ne portfolion e investimeve te kompanisë se sigurimit) kundrejt-palës (p.sh kontrata e risigurimit, kontratat e derivativeve apo te depozitave te investuara) dhe te ndërmjetësuesve, te te cilat kompania ka një ekspozim. Brenda kësaj kategorie bëjnë pjese:
• *Risku i drejtpërdrejte i mospagimit* – risku se firma nuk do te pranoi cash floës apo asetetet ndaj te cilave është titullarë, sepse pala me te cilën firma ka kontrate bilaterale ka dështuar ne përmbushjen e një apo me shume detyrimeve;[67]
• *Risku i degradimit apo migrimit* – risku se ndryshimet ne mundësit e dështimit te pagesës ne te ardhmen nga një obligator do te afektoi vlerën e tanishme te kontratës ne ditën e obligimit;
• *Risku indirekt risku i shtrirjes* – risku për shkak te perceptimit te tregut ndaj riskut ne rritje (p.sh për shkak te ciklit biznesor apo te kredisë se pranuar ne raport me pjesëmarrësit e tjerë te tregut);
• *Risku i rregullimit* – risku i ekspozimit ndaj humbjeve për shkak te renjes se vlerës te aseteve te jashtme apo rritjes se vlerës se obligimeve te denominuara ne mjete te huaja monetare;
• *Risku i koncentrimit* – risku i rritjes se ekspozimit ndaj humbjeve për shkak te koncentrimit te investimeve ne një regjion gjeografik apo ne një sektori ekonomik;
• *Risku i kunderpales* – risku i ndryshimit te vlerës se risigurimit, te aseteve te rastit dhe detyrimeve (p.sh si janë marrëveshjet sëaps te cilat nuk janë reflektuar ne bilancin e gjendjes).

Risku i tregut

Risku i tregut vjen nga niveli i volatilitetit te çmimeve te tregut dhe te aseteve. Risku i tregut involvon ekspozimin e lëvizjes se variablave financiare si janë çmimi i aksioneve, te normave te interesit, këmbimit valutore apo te çmimeve te mallrave. Gjithashtu përfshinë ekspozimet e lëvizjes se opsioneve ne çmimet e aseteve te caktuara.[68]

Ne këtë kategori te riskut përfshihen:

***Risku i normës se interesit*** – risku i ekspozimit te humbjes te cilat rezultojnë nga fluktuimi ne normat e interesit;
***Risku i ekuitetit dhe i pronës*** – ekspozimi i riskut te humbjes e cila rezulton nga fluktuimi i vlerës se tregut te ekuiteteve si dhe te aseteve te tjera;
***Risku i monedhës*** – risku qe ndryshimi relativ ne vlerën e monedhës te zvogëloj apo te rrite vlerën e detyrimeve te përcaktuara ne monedhën e jashtme;
***Risku bazik*** – risku qe te ardhurat nga investimet nga krediti me kualitet te ndryshueshëm, ashtu qe likuiditeti dhe maturiteti (afati) i tyre te mos lëvizin ne te njëjtin drejtim (njëkohësisht), e cila e ekspozon kompaninë kah vlera e luhatshme e tregut e cila lëviz ne mënyre te pa varur nga vlera e detyrimeve;
***Risku i riinvestimit*** – risku i rritjes se ekspozimit për humbje për shkak te koncentrimit te investimeve ne një rajon gjeografik apo te një sektori ekonomik;
***Risku i mos përputhjes se aseteve me detyrimet*** – risku qe shuma e rrjedhës se parës kesh nga asetet te cilat duhet te mbështesin detyrimet si dhe vete detyrimet te jene te ndryshme, e cila munde ta sjellin siguruesin qe te vjen ne pozite

---

[67] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition faq.112
[68] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition faq:113

te mospërputhjes se aseteve me detyrimet;
***Risku i pozicioneve jashtë billancore*** – risku i ndryshimit te vlerës te aseteve dhe te detyrimeve te rastit (kontingjente) si janë shkëmbimet (sëaps) te cilat përndryshe nuk reflektohen ne bilancin e gjendjes.
Risku operacional

Koncepti i riskut operacional fillimisht ka rrjedhe nga industria bankare, dhe ne fillim është definuar ne terma plotësuese, kryesisht duke përfshire te gjitha risqet përveç riskut kreditor. Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare ka propozuar kërkesat për kapital plotësues për riskun operacional për institucionet bankare. Me qellim te evaluimit te kërkesave për kapital risku specifik duhet te identifikohet dhe te matet dhe kjo ka quar deri te adoptimi i definicionit i cili fillimisht qe zhvilluar nga Asociacioni Britanik Bankar. Risku operacional, me pikësynim kapitali, është definuar si "si risk për humbje nga proceset e brendshme jo adekuate apo procese te dështuara duke përfshirë njerëzit, sistemet apo nga ngjarjet e jashtme"[69]

Definicioni i me sipërm mendohet te përfshijë riskun legal por përjashton riskun strategjik, te reputacioni dhe atë te riskut sistemik.

Ne industrinë bankare çdo dite procedohen me mijëra transaksione. Prandaj, shuma e shënimeve (te dhënave) te cilat i referohen humbjeve nga dështimet është me i madhe. Kjo shpeshherë ne mënyrë natyrore kërkon qe te zhvillohen modele te rrepta për te vlerësuar distribuimin e humbjeve te përgjithshme dhe te përkujdeset për kërkesat shtese te kapitalit.
Ne sektorin bankar besohet se nga 60% e riskut te përgjithshëm te kredive, risku operacional merre pjese me 30%, risku i tregut me 5%, ndërsa risqet tjera marrin pjese me 5%.
Risku operacional është gjithashtu një risk i rendesishem për siguruesit ashtu sikurse edhe për bankat, dhe dallon nga bankat për aq sa dallon natyra e vete biznesit te sigurimeve, ashtu qe kompanitë e sigurimeve duhet te dëshmojnë një menaxhim te kujdesshëm te riskut operacional.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është i pandashëm ne industrinë e shërbimeve financiare. Ne kontekstin e sigurimeve, risku i likuiditetit është ekspozimi për humbje ne rastet e pamjaftueshmërisë se aseteve likuide për te përmbushur detyrimet ndaj policmbajtesve. Ne kuptim me te gjere, risku i likuiditetit te kompanitë e sigurimeve quhet edhe risku i financimit te likuiditetit. [70]Një sigurues duhet te jetë i kujdesshëm ndaj riskut potencial te likuiditetit bashkangjitur se bashku me mbarimin e hershem te kontratës se sigurimit. Humbjet për shkak te riskut te likuiditetit munde te ndodhin atëherë kur kompania duhet te marri hua ne mënyrë te papritur apo duhet te shes asetet për një çmime shume te ulet. Profili i likuiditetit te një kompani është funksion si i aseteve ashtu edhe i detyrimeve.

Siguruesit e jetës shpeshherë iu ofrojnë policmbajtesve opsionet e zbukuruara (p.sh opsionet me marrëveshje) te cilat kane potencial qe te shkaktojnë probleme te likuiditetit. Siguruesit e përgjithshëm nganjëherë duhet te paguajnë dëme me herët se sa qe kane pritur, kështu qe detyrohen te likuidojnë asetet e investuara para afatit dhe atë me kushte te pafavorshme.

Ekzistojnë nivele te ndryshme te menaxhimit te likuiditetit:
***Menaxhimi ditor i keshit***, i cili është zakonisht funksion i trezorit apo arkës brenda kompanisë;
***Menaxhimi i rrjedhës se keshit***, i cili zakonisht monitoron nevojat për kesh për gjashte deri njëzet e katër muajt e ardhshëm;
***Stres-testi i riskut te likuiditetit***, i cili fokusohet ne riskun katastrofik.
**Burimet e mundshme te riskut te likuiditetit**
Kërkesat e papritura për likuiditet munde te jene rezultat i:
***Nevojat për kesh për shkak ngjarjes me dëme te madhe***;

[69] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition faq:14
[70] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition faq: 17

***Zbritjes se rejtingt kreditor,***
***Publicitetit negativ***, pa marre parasysh se a është i justifikuar ajo;
***Përkeqësimit te ekonomisë***;
***Raportimit te problemeve te kompanitë tjera ne linjën e njëjte te biznesit***;
***Shkalles se larte te financimit dhe qasjes/likuiditetit te tregut te kapitalit*** (p.sh te fleteobligacioneve për katastrofa)
***Fluktuimet tjera te rastit ne kërkesë për likuiditete*** si dhe disa karakteristika specifike te disa kompanive munde te rrisë riskun e likuiditetit. Sidoqoftë, këto karakteristika munden apo nuk munden te shkaktojnë dështime te likuiditetit. Menaxhimi i mire i likuiditetit mundet ne mënyre sinjifikante te reduktoi këtë risk. Shembull i karakteristikave specifike te kompanisë qe munde te kontribuojnë ne ekspozimin e riskut te likuiditetit përfshinë:
një zotërues i vetëm i kontratës apo disa zotërues te kontratave te cilët kontrollojnë një shume te madhe te parave (policave apo te kontratave). Produktet e llojit-institucional janë riske i madhe ne këtë kuptim, zakonisht ne linjat e shitjes me pakice, një numër i vogël agjentesh apo brokerash munde te kontrollojnë blloqe te mëdha te biznesit, dhe ata munde te sjellin risqe te ngjashme.[71]
Madhësia e kompanisë munde ta limitoi qasjen ne tregun e kapitalit. Nëse kompania është shume e vogël, munde te mos ketë zgjedhje te financimit e te cilat i kane kompanitë e mëdha. Ne anën tjetër, nëse kompania e madhe është e detyruar te likuidoi miliona euro menjëherë, tregu ndoshta nuk ka mundësi te absorboi këtë sasi me vlere fere.
Kërkesa e menjëhershme për pagesa ne kesh munde te jete risk nëse oferta e keshit është e mangët. Një kërkesë e menjëhershme për kesh është risk i larte. Nëse marrëveshja e financimit e ka opsionin e pagesës për 7 dite, siguruesi ka ne dispozicion vetëm një jave për te grumbulluar keshin e nevojshëm për te përmbushur detyrimet e tij. Një kompani e menaxhuar mire do ti strukturoi asetet e saj ne atë mënyrë qe te ketë kesh te mjaftueshëm për te mbuluar detyrimet e njohura te saj.
Mungesa e diversitetit te cilit do detyrim apo te portofolios se aseteve kur analizohen sipas produktit, regjionit, industrisë, kreditoreve etj. munde te krijoi një mbi koncentrim te aseteve jolikuide, si janë patundshmëritë apo te letrave me vlere te trajtuara dobët, e te cilat munde ta rrisin riskun e likuiditetit.
Se fundi risku i likuiditetit munde te arrije gjate krizave ne tregun e kapitalit. Atëherë kur lëvizjet e çmimeve ne treg bëhen ekstreme, dhe volatiliteti e tyre rritet ne mënyrë dramatike, relacionet normale dështojnë. Atëherë kur investitorët fillojnë te sillen ne mënyrë te njëjte, asetet munde te bëhen te pa tregtueshme apo te bëhen jo likuide.

**Matja e riskut**

Modelet e brendshme për matjen e riskut prodhojnë probabilitetin për te gjitha rezultatet e mundshme për secilën komponentë te riskut te kompanisë se sigurimit qe janë te përfshira ne model. Shuma e rezultateve për te gjitha risqet e kombinuara si rezultat i “agreguar”, zakonisht vlerësohet si humbje. [72]Humbja e agreguar përshkruhet përmes probabilitetit te distribuimit, i cili mate gjasat për rezultatet e mundshme. Matja e riskut është funksion i probabilitetit te distribuimit te humbjeve. Shfrytëzohet për te përcaktuar edhe kërkesat për kapital (duke u bazuar ne distribuimin e agreguar te humbjeve) apo te sugjeroi kërkesat për kapital PR secilën komponentë te riskut (duke u bazuar ne distribuimin e humbjeve te riskut te njësisë se vetme).
Ne mënyre specifike definicionet e këtyre masave te riskut janë:
- Vlera ne risk (VR) është sasiori i distribuimit. Per shembull, 95 perqind e distribuimit është vlera per te cilën ka probabilitet te tejkalimit per 5%.
- Devijimi Standard i distribuimit është masa e nivelit te pasigurisë.
- Gersheret e Vlerës ne Risk (GVR) është VR e matshme plus mesatarja e tejkalimit nëse ai tejkalim ndodhe. Per shembull, 95% GVR është mesatare aritmetike e te gjitha VR nga 95 perqind e mbi.

---

[71] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition faq: 20
[72] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition fq: 25

**Menaxhimi i riskut, lehtësimi dhe transferi**

Një sigurues munde te marre një varg te masave per te zvogëluar riskun e biznesit te tij. Kjo përfshinë blerjen e risigurimit, blerjen e letrave me vlere per një pjese te portofolios se aseteve apo te detyrimeve, vetëmbrojtjen e garancioneve financiare duke shfrytëzuar instrumentet derivateve, shfrytëzimin e dizajnit te produkteve per ta bartur riskun te policmbajtesit, sikurse edhe menaxhimin efektiv te riskut. [73]Ne masën aq sa këto veprime ne mënyre efektive e zvogëlojnë riskun e kompanisë, nevojitet qe ne mënyre te duhur te pranohen ne kalkulimin e kërkesave per kapital te kompanisë. Veshtërsit qëndrojnë ne vlerësimin adekuat te shkalles se riskut te cilin duhet transferuar nga kompania e sigurimit ne arrangjimet e këtilla.

**Risigurimi**

Risigurimi paraqet rruge te zakonshme per siguruesit per ta menaxhuar riskun e tyre. Te rasti i risigurimit ne kursin normal te biznesit, apo risigurimi i zhdëmtimit, siguruesi mbanë riskun te pandare (inherent) ne policen origjinale te shitur, ndërsa risiguruesi dhe siguruesi veçmas pajtohen te shkëmbejnë disa pagesa te caktuara. [74]Kjo ka per efekt transferimin e një pjese te riskut te siguruesit per ato polica te risiguruesi. Risigurimi i zhdëmtimit munde te strukturohet ashtu qe ti lejoje policmbajtesit qe te mbaje nivel te ndryshueshëm te riskut (p.sh përmes zbritjeve, bashkesigurimit, risigurimit kaptiv (vetanak), aranzhimeve retrospektive te primeve etj.). Ekzistimi i kontratës se risigurimit e ekspozon siguruesin ndaj riskut te dështimit te kundër-palës.[75]

Risigurimi munde te shfrytëzohet per zvogëlimin e volitalitetit, te pasigurisë, dhe te riskut te ngjarjes ekstreme. Per shembull, disa lloje te sigurimit munde te strukturohen per sigurimin e drejtpërdrejte ndaj ngjarjeve katastrofike si janë tërmetet apo uraganet. Ato kane sukses përmes limitimit apo “shtrirjes” se riskut per një rast te caktuar përmes shfrytëzimit te risigurimit per ta limituar ekspozimin e tyre.

Kontrata e risigurimit munde te përmbaje shumëllojshmëri te marrëveshjeve financiare te cilat specifikojnë se cila pale mbanë rezervat aktuarale per biznesin i cili është risiguruar. Është me rendësi qe te pranohet se kur detyrimet mbahen ndoshta nuk do te tregoi plotësisht se cila pale e ka riskun. Gjithashtu është me rendësi te pranohet se disa lloje te risigurimeve, përgjithësisht quhen si financiare apo risigurime te përcaktuara, janë te strukturuara per te ofruar financim nga risiguruesi te marrësi i drejtpërdrejte ne sigurim përmes transferit minimal te riskut real.

**Hedgingu**

Transaksionet e hedgingut rezultojnë ne reduktimin neto te riskut per aq sa siguruesi pretendon një kompensim te riskut ndaj atij qe aktualisht e mbanë. Siguruesi edhe metej do mbanë riskun origjinal por kompensimi

[73] George Rejda, Principles of Risk management and Insurance, Eigth Edition faq: 115
[74] Prof. dr. Gazmend Luboteni “ Financat e Korporatave” Prishtinë- fq: 20
[75] Prof. dr. Gazmend Luboteni “ Financat e Korporatave” Prishtinë- fq:25

i transaksionit te hedgingut rezulton ne reduktimin neto te riskut per siguruesin. Është me rendësi te theksohet se siguruesi marre riskun shtese per dështimin e kundër-palës si rezultat i transaksionit te hedgingut per derisa hedgingu është hedging “natyral”. Hedgingu natyral ndodh atëherë kur kompania mund te kompensoi riskun ne linjat e ndryshme te biznesit. Per shembull, marrja ne sigurim te jetës dhe te anuiteteve te mundshme te jetës per grupet e njëjta te policmbajtesve munde te ndihmon qe te ofrohet hedgingu përkundër ndikimit te rritjes se mortalitetit.

Pranimi i hedgingut natyral paraqitet kur një sigurues shkruan linja ndihmese te biznesit, munde te paraqitet ne nivelin e gjere atëherë kur komponentët e ndryshme te kapitalit per riskun individual munde te kalkulohen.[76]

Hedgingu financiar i cili involvon derivativet financiare shfrytëzohet nga disa kompani te sigurimit per te kompensuar garancionet e caktuara financiare te cilët ata iu ofrojnë policmbajtesve te tyre. Para se te lejohet kredia per hedging financiar brenda kërkesave per kapital, mbikëqyrësi duhet te jete i qete se programi i hedgingut i kompanisë është formuluar mire, është konsistent me teorinë ekonomike financiare dhe ofron ne mënyre efektive hedgingun e dëshiruar. Hedgingu financiar zakonisht shfrytëzohet vetëm nga kompanitë me te fuqishme.

## LITERATURA


1 .Principles of Risk Management and Insurance | 12th Edition – Authors:George E Rejda,Michael McNamara.

2. Principles of Risk Management and Insurance | 13th Edition – Authors:George E Rejda,Michael McNamara.

2. . Prof. dr. Gazmend Luboteni “ Financat e Korporatave” Prishtinë

2. Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA”

3. http://ëëë.rims.org/Pages/Default.aspx

4. http:/ëëë.fgi.org/reinsurance.htm

5. https://ëëë.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-biznesit/departamenti-i-fincance-kontabilitet/industria-e-sigurimeve-dhe-drejtimi-i-rrezikut/

6. https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/161-manaxhim-risku/962-msc-ne-menaxhim-risku

7. Greene, Jmes S. Trieschmann, Risc and Insurance

8. Pasiguria dhe Sigurimet” Koçi,Bundo,Shalari


[76] Greene, Jmes S. Trieschmann, Risc and Insurance faq.45

# Faktorët përcaktues të cilësisë së Kontabilitetit në Bankat në Kosovë

**Fitim Raci**
University of Prishtina "Hasan Prishtina", Prishtina, Kosova
fitim-raci@hotmail.com

**ABSTRACT**
The aim of this research is to identify the impact of accounting quality factors by analyzing the factors of competence, objectivity and performance on the quality of accounting in banks in Kosovo. This research provides evidence on whether competency, objectivity and performance factors affect the quality of accounting. The research methodology is based on a structured questionnaire completed by the staff of the Accounting and Finance Department of all Banks in Kosovo. Multifactorial regression was used in this research. The results of the questionnaire show that accountants in banks in Kosovo consider competence, objectivity and performance as important factors in the quality of accounting. Impact factors competence, objectivity and performance have been empirically examined which have a positive relationship with quality and we find that they have an impact on the quality of accounting. This study will contribute in the future the connection with research cases respectively in the quality of accounting.

**Key words**
Accounting, Quality, Competence, Objectivity, Banks.

**ABSTRAKT**
Qëllimi i këtij hulumtimi është të identifikojë ndikimin e faktorëve të cilësisë së kontabilitetit duke analizuar faktorët e kompetencës, objektivitetit dhe performancës në cilësinë e kontabilitetit në bankat në Kosovë. Ky hulumtim ofron dëshmi nëse faktorët kompetenca, objektiviteti dhe performanca ndikojnë në cilësinë e kontabilitetit. Metodologjia e hulumtimit bazohet në pyetësor të strukturuar të plotësuar nga personeli i Departamentit të Kontabilitetit dhe Financave të të gjitha Bankave në Kosovë. Në këtë hulumtim është përdorur regresioni shumfaktorial. Rezultatet e pyetësorit tregojnë se kontabilistët në bankat në Kosovë i konsiderojnë kompetencën, objektivitetin dhe performancën si faktorë të rëndësishëm në cilësinë e kontabilitetit. Ndikimi faktorëve kompetenca, objektiviteti dhe performanca janë ekzaminuar në mënyrë empirike të cilat kanë një lidhje pozitive me cilësinë dhe konstatojmë se kanë ndikim në cilësinë e kontabilitetit. Ky studim do të kontribuojë në të ardhmen ndërlidhjen me rastet hulumtuese respektivisht në cillësinë e kontabilitetit.

**Fjalët kyçe**
Kontabiliteti, Cilësia, Kompetenca, Objektiviteti, Bankat.

## Hyrje

Cilësia e raportimit financiar në kuadër të kontabilitetit si faktorë përcaktues, veçanërisht gjatë dekadës së fundit, ka qenë shqetësim i konsiderueshëm për studiuesit e kontabilitetit; megjithatë, një nga problemet kryesore është se si të matim të ashtuquajturin cilesia e raportimit financiar (Scaltrito, 2015). Cilësia e informacionit, sidoqoftë, nuk është gjithmonë e kuptuar thjeshtë dhe menjëherë: metodat e ndryshme janë aplikuar në studimet e mëparshme për matjen e tij (Lang dhe Lundholm, 2000). Teoria e kontabilitetit argumenton se raportimi financiar zvogëlon asimetrinë e informacionit duke zbuluar informacione të rëndësishme dhe në kohë (p.sh. Frankel dhe Li, 2004). Për shkak se ka ndryshime të konsiderueshme në cilësinë e kontabilitetit dhe efikasitetin ekonomik në të gjithë vendet, sistemet ndërkombëtare të kontabilitetit ofrojnë një mjedis interesant për të ekzaminuar pasojat ekonomike të raportimit financiar. Cilësia e kontabilitetit është shkalla në të cilën informacioni i kontabilitetit pasqyron me saktësi performancën aktuale të kompanisë, është i dobishëm në parashikimin e performancës së ardhshme, dhe ndihmon në vlerësimin e vlerës së firmës (Deschow & Schrand, 2004 siç citohet në Hribar, Kravet& Wilson, 2011). Studimi

empirik i kryer në këtë punim shqyrton përcaktuesit e cilësisë së kontabilitetit në Sektorin e Bankave Kosovare. Qëllimi kryesor është të studiojmë nga afër karakteristikat e caktuara të kontabilitetit në banka të tilla si performanca, objektiviteti dhe kompetenca. Këto karakteristika shpesh janë përcaktues të praktikave të zbulimit të cilësisë së kontabilitetit. Cilësia e pasqyrave financiare nuk është një tregues që mund të kuantifikohet lehtë, pasi nuk mund të identifikohet drejtpërdrejt, duke u bazuar në perceptimin e përdoruesve të informacionit financiar. Çdo kategori e përdoruesve ka pritjet dhe perceptimet e veta se cili informacion është i dobishm edhe me cilësi të mirë (Achim& Chis, 2014). Në fushën e ekonomisë dhe kontabilitetit, studimet e fundit po analizojnë gjithnjë e më shumë termin e cilësisë së kontabilitetit. Një nga objektivat kryesore të numrit të madh të studimeve mbi këtë temë është gjetja e një mase të përshtatshme për të. Kjo është arsyeja pse, është e rëndësishme të kuptohet se çfarë përfaqëson cilësia e kontabilitetit dhe si mund të shpjegohet dhe kuantifikohet. Qëllimi kryesor i raportimit financiar është të sigurojë raportim financiar të cilësisë që është i dobishëm në marrjen e vendimeve në lidhje me sigurimin e burimeve për njësinë ekonomike dhe në vlerësimin nëse menaxhimi i njësisë ekonomike ka bërë përdorim efikas dhe efektiv të burimeve të siguruara (IASB, 2010). Cilësia e raportimit financiar ka marrë vëmendjemë të madhe, veçanërisht pas skandaleve të fundit të kontabilitetit. Ky studim ka tendencë të zbulojë nëse bankat kosovare i përmbahen cilësisë së raportimit të kontabilitetit duke përdorur objektivitetin, përfomancën dhe kompetencën si ndryshore kryesore. Studimi i mëparshëm ka treguar që përfitimi mund të ndikojë në cilësinë e shpalosjes së një pasqyre financiare. Një firmë do të jetë e interesuar të zbulojë lajme të mira në treg në mënyrë që të shmangë nënvlerësimin e aksioneve të tyre dhe të zvogëlojë kostot e kapitalit (Trueman, 1986). Meqenëse firmat ekzistojnë për të maksimizuar pasurinë e aksionarëve, kështu që është e nevojshme të sigurohet raportim cilësor i kontabilitetit.
Prandaj, ky studim synon të hetojë përcaktuesit kryesorë të mundshëm që mund të ndikojnë në cilësinë e kontabilitetit në Bankat e Kosovës. Këta përcaktorë saktësisht i përkasin karakteristikave specifike të bankës dhe variablave të qeverisjes korporative.

## Rishikimi i literatures

Hulumtimet e mëparshme tregojnë se ekzistojnë disa përcaktues që lidhen me raportimin financiar (Takhtaei et al., 2014; Soheilyfar et al., 2014; Monday dhe Nancy, 2016). Këta përcaktorë kryesisht janë ekzaminuar në vendet e zhvilluara (Pivac et al., 2017). Sidoqoftë, këto rezultate shumë nuk janë të përshtatshme në vendet në zhvillim pasi këto vende, kanë shoqëri, kultura, ekonomi dhe politikë divergjente. Për më tepër, këto hulumtime të mëparshme janë përqendruar në përcaktuesit që kanë një ndikim në nivelin e informacionit financiar të shpalosur, ndërsa studime të pakta kanë ekzaminuar përcaktorët e cilësisë së informacionit financiar të shpalosur. Literatura e kontabilitetit ndërkombëtar siguron prova që cilësia e kontabilitetit ka pasoja ekonomike, siç janë kostot e kapitalit (Leuz dhe Verrecchia, 2000), efikasiteti i alokimit të kapitalit (Bushman et al., 2006; Sun, 2006) dhe lëvizshmëria e kapitalit ndërkombëtar (Young and Guenther, etj. 2002). Më 19 korrik 2002, Parlamenti i Bashkimit Evropian (BE) miratoi një rregullore që kërkon që të gjitha kompanitë e listuara në BE të miratojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për vitet fiskale duke filluar pas 1 Janarit 2005. Miratimi i përhapur i SNRF-ve do të rezultojë në një ndryshim thelbësor në mjedisin e biznesit, që përpara vitit 2005, kompanitë ndoqën një larmi parimesh të kontabilitetit të pranuara në përgjithësi specifike për një vend (GAAP). Në një përpjekje për të dhënë pasqyrë mbi efektet e ndryshimit, ky punim shqyrton literaturën mbi faktorët përcaktues të cilësisë së kontabilitetit të cilët ndikojnë në procesin e kontabilitetit dhe efektivitetin në raportimin sipas Standardeve.
Shumë skandale kontabël dhe kriza financiare kanë ndodhur kohët e fundit në shumë firma të njohura të cilat kanë zvogëluar besimin e investitorëve në lidhje me raportet financiare dhe kanë prezantuar disa kritika për cilësinë e raportimit financiar (CRF) (Akeju dhe Babatunde, 2017). Zakonisht është pranuar që zhgënjimi kryesor çon në këto kriza financiare të lindura menjëherë nga mungesa e shpalosjes së cilësisë financiare dhe praktikave të pamjaftueshme të qeverisjes (Fung, 2014).
Kështu, dështimi i gjerë në zbulimin financiar ka krijuar kërkesën e investitorëve, rregullatorëve dhe palëve të tjera të interesit për të përmirësuar cilësinë e informacionit financiar dhe për të forcuar kontrollin e menaxherëve duke vendosur struktura të përshtatshme qeverisjeje (Klai dhe Omri, 2011). Kjo do të lejojë që bordet e drejtorëve të

vlerësojnë efektivitetin e menaxhimit dhe të ndërmarrin veprime korrektuese në kohë, kur është thelbësore, për të adresuar dështimin në gjendjen financiare të firmave (Fung, 2014).
Prandaj, firmat duhet të përgatisin informacion financiar me cilësi më të lartë (Asegdew, 2016). Kjo do të thotë, informacioni i shpalosur duhet të jetë i besueshëm dhe i rëndësishëm për të ndihmuar përdoruesit e raporteve financiare në vendimmarrje (Fathi, 2013). Ky nivel i lartë i cilësisë së zbulimit është i vlefshëm për firmën pasi ka perspektivën për të zvogëluar shpenzimet e borxhit dhe për të rritur çmimin e aksioneve (Soheilyfar et al., 2014; Savina, 2016).
Prandaj, është e rëndësishme që të gjitha firmat publike të paraqesin një përshkrim të kuptueshëm, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm të performancës së tyre financiare (Schnackenberg, 2009). Kjo veçanërisht, që raportimi i korporatave kohët e fundit nuk është më i kufizuar në pasqyrat financiare, por përfshin një gamë të gjerë përmbajtjesh shtesë që gjithashtu duhet të shpalosen për t'i dhënë investitorëve informacionin jetësor që ata kërkojnë për të vlerësuar investimet e tyre (Liapis et al., 2013; Allegret et al., 2016).

## Metodologjia

Ky hulumtim shkencor është realizuar sipas regresionit linear shumfaktorial, dhe për të aritur objektivat e saj hulumtimi do të përfshijë të dhëna primare. Të dhënat primare janë mbledhur dhe analizuar nga pyetësori i përgatitur posaçërisht për këtë hulumtim me fokus në Faktorët Përcaktues të Cilësisë së Kontabilitetit në bankat në Kosovë. Ndërsa të dhënat dytësore do të shfrytëzohen nga punimet e ngjashme shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare, publikime nga institucione kredibile dhe literaturë relevante të kësaj fushe. Për arritjen e qëllimeve të këtij hulumtimi shkencor ne kemi aplikuar teknikën e statisikës deskriptive dhe analizën e përmbajtjes.
Hipotezat të cilat do t’i testojmë nga ky hulumtim janë:
H01: Ekziston një marrëdhënie positive ndërmjet kompetencës së kontabilistëve dhe cilësisë së kontabilitetit.
H02: Ekziston një marrëdhënie positive ndërmjet objektivitetit të kontabilistëve dhe cilësisë së kontabilitetit.
H03: Ekziston një marrëdhënie positive ndërmjet performancës së kontabilistëve dhe cilësisë së kontabilitetit.
Popullacioni i këtij punimi shkencor përfshinë të gjitha bankat në Kosovë të përfaqësuar nga kontabilistët e bankave. Pyetësori është dërguar në mënyrë elektronike dhe nga totali i popullatës prej ~44 staf, numri i pyetësorëve të vlefshëm për analizë është 32, prandaj përqindja e mostrës në këtë punim është 72% e cila është e mjaftueshme për të nxjerrë përfundime për të gjithë popullatën.
Modeli i cili do të përdoret për këtë hulumtim është: Modeli i Regresionit të Shumëfishtë
CK = B0 + B1KO + B2OB + B3PE + e
Bi = Koeficienti i Regresionit, i=0,1,2,3; KO = Kompetenca; OB = Objektiviteti; PE = Performanca; E= Koeficienti i Gabimit; CK = Cilësia e Kontabilitetit

## Rezultatet

Rezultatet e testimit të hipotezave në këtë hulumtim shkencor janë interpretuar duke përdorur analizën e regresionit të shumëfishtë. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që në mënyrë empirike të testojmë dhe analizojmë nëse ekziston ndonjë marrëdhënie ndërmjet kompetencës, objektivitetit, performances dhe cilësisë së kontabilitetit në bankat në Kosovë.

Tabela 1. Përmbledhje e statistikës Deskriptive

| | Mean | Std. Deviation |
|---|---|---|
| Cilësia e Kontabilitetit | 4.4625 | .33864 |
| Kompetenca | 4.4250 | .36544 |
| Objektiviteti | 4.3563 | .39262 |
| Performanca | 4.3750 | .44504 |

Burimi: Autorët

Në tablën 1 është paraqitur një përmbledhje e statistikës deskriptive të gjeneruara nga programi statistikor SPSS v. 25.

Tabela 2. Përmbledhja e Modelit

| **Model Summary**[b] | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Change Statistics | | | | | |
| Model | R | R Square | Adjusted R Square | Std. Error of the Estimate | R Square Change | F Change | df1 | df2 | Sig. F Change | Durbin-Watson |
| 1 | .552[a] | .405 | .230 | .29715 | .405 | 4.087 | 3 | 28 | .016 | 1.695 |
| a. Predictors: (Constant), Performanca, Kompetenca, Objektiviteti | | | | | | | | | | |
| b. Dependent Variable: Cilësia e Kontabilitetit | | | | | | | | | | |

Burimi: Autori

Rezultatet e përmbledhjes së modelit ekonometrik sipas tabelës 2 tregojnë që koeficienti i determinacionit është 40.5%, pra një shkallë mjaftueshme qe tregon se variablat e pavarura të vendosura në model janë të arsyeshme dhe e shpejgojnë mjaftë mirë variablën e varur.

Koeficienti Durbin Watson, që bënë matjen e prezencës së korrelacionit serial tregonë që nuk kemi të bëjmë me korrelacion serial në modelin ekonometrik të përdorur, pra vlera 1.695 tregon qëndrueshmërinë e modelit ekonometrik të përdorur në punim.

Tabela 3. ANOVA

| **ANOVA** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Model | | Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
| 1 | Regression | 1.083 | 3 | .361 | 4.087 | .016b |
| | Residual | 2.472 | 28 | .088 | | |
| | Total | 3.555 | 31 | | | |
| a. Dependent Variable: Cilësia e Kontabilitetit | | | | | | |
| b. Predictors: (Constant), Performanca, Kompetenca, Objektiviteti | | | | | | |

Burimi: Autori

F-testi është i barabartë me .000 tregon se të gjitha koeficientet së bashku janë statistikisht signifikat dhe të ndryshëm prej zeros.

Tabela 4. Koeficientët e Regresionit

| **Coefficients**[a] | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Unstandardized Coefficients | | Standardized Coefficients | | |
| Model | B | Std. Error | Beta | T | Sig. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | (Constant) | 2.172 | .749 | | 2.900 | .007 |
| | Kompetenca | .207 | .173 | .223 | 2.196 | .042 |
| | Objektiviteti | .040 | .175 | .046 | 2.227 | .022 |
| | Performanca | .354 | .139 | .465 | 2.553 | .016 |
| a. Dependent Variable: Cilësia e Kontabilitetit | | | | | | |

Burimi: Autori

Bazuar në rezultatet në tabelën 4 sa i përket variablës së parë të pavarur “Kompetenca” vlera e përllogaritur “B” është 0.207 në nivelin e signifikancës prej 0.042 që nënkupton pranueshmërinë e modelit. Bazuar në rezultatet në tabelën 4 sa i përket variablës së parë të pavarur “Objektiviteti” vlera e përllogaritur “B” është 0.40 në nivelin e signifikancës prej 0.022 që nënkupton pranueshmërinë e modelit. Poashtu për variablen e pavarur “Performanca” vlera e përllogaritur “B” është 0.354 në nivelin e signifikancës prej 0.16 që nënkupton pranueshmërinë e modelit.

Figura 1. P-Plot e Regresionit




Në figurën 1 është paraqitur P-plot i regresionit në vijën lineare si dhe observimet të cilat janë kalkuluar. Siç shihet observimet janë shumë afër vijës lineare të regresionit që nënkupton se ka një lidhje të ngushtë në mes të observimeve. Vlenë të theksohet se në këtë figure nuk janë paraqitur observimet ekstreme të cilat do të ishin large vijës lineare të regresionit.

Interpretimi i Testimit të Hipotezave: Në bazë të nivelit të signifikancës sig. =0.042 apo 4.2 % shkalla e gabimit dhe vlerës testuese t=2.196, pra aprovohet hipoteza bazë (HO1a) dhe refuzohet hipoteza alternative (HO1b). Në bazë të nivelit të signifikancës sig. =0.022 apo 2.2 % shkalla e gabimit dhe vlerë testuese t=2.227, pra aprovohet hipoteza bazë (HO2a) dhe refuzohet hipoteza alternative (HO2b). Në bazë të nivelit të signifikancës sig. =0.016 apo 1.6 % shkalla e gabimit dhe vlerë testuese t=-2.553, pra aprovohet hipoteza bazë (HO3a) dhe refuzohet hipoteza alternative (HO3b).

Konkudime

Nga ky hulumtim konkludojmë se kompetenca, objektiviteti dhe performanca ndikojnë në cilësinë e kontabilitetit në bankat në Kosovë. Është konfirmuar se variabla e pavarur e performancës në bazë të nivelit të signifikancës sig.=0.016 apo 1.6 % ka shkallën më të ulët të gabimit, pasuar me variablën e pavarur objektiviteti në nivel të signifikancës sig.=0.022 apo 2.2 % dhe variabla e pavarur kompetenca me nivel të signifikancës sig.=0.042 apo 4.2%.

Vlera e koeficientit standard të regresionit është 0.223, që tregon se ndryshimi prej një shkallësh i vlerës së variablës së pavarur "Kompetenca", rezulton në ndryshimin e variablës së varur (cilësia e kontabilitetit) në vlerën prej 0.223, ndërsa vlera e koeficientit standard të regresionit është 0.046, që tregon se ndryshimi prej një shkallësh i vlerës së variablës së pavarur "Objektiviteti", rezulton në ndryshimin e variablës së varur (cilësia e kontabilitetit) në vlerën prej 0.046, pasuar me vlerën e koeficientit standard të regresionit i cili është 0.465, që tregon se ndryshimi prej një shkallësh i vlerës së variablës së pavarur "Performanca", rezulton në ndryshimin e variablës së varur (cilësia e kontabilitetit) në vlerën prej 0.465.

Në bazë të hulumtimit ne i rekomandojmë stafit të bankave që fokusi më i madh të jetë në ngritjen e kompetencës dhe edukimit të vazhdueshëm profesional meqenëse niveli i signifikancës ka rezultura më i larti nga objektiviteti dhe performanca dhe konsiderohet si faktor kyç në ngritjen e cilësisë së kontabilitetit. Sa i përket performancës rekomandojmë që kontabilistët të kenë përkrahjen e nevojshme të menaxhmentit.

## Referencat


Akeju, J.B. and Babatunde, A.A. 2017. Corporate Governance and Financial ReportingQuality in Nigeria. *International Journal of Information Research and Review*, 4(2), 3749-3753.

Leuz, C. and Verrecchia, R. (2000) The economic consequences of increased disclosure. *Journal of Accounting Research*, 38(Suppl.), pp. 91–124.

Bushman, R., Piotroski, J. and Smith, A. (2006) Capital allocation and timely accounting recognitionof economic losses, Working Paper, *University of North Carolina and University of Chicago.*

Sun, K. (2006) Financial reporting quality, capital allocation efficiency, and financing structure: aninternational study, Working Paper, University of Hawaii at Manoa.

Young, D. and Guenther, D. (2002) Financial reporting environments and international capitalmobility. *Journal of Accounting Research*, 41(3), pp. 553–579.

Frankel, R. and Li, X. (2004) Characteristics of a firm's information environment and the informationasymmetry between insiders and outsiders. *Journal of Accounting and Economics*, 37(2), pp. 229 –259.

Hribar, P., Kraret, T., & Wilson, R. (2011). A new measure of accounting quality.

Achim, A. M. & Chis, A. O. (2014). Financial accounting quality and its defining characteristics. *SEAPractical Application of Science*. 2(3(5)).

Trueman, B. (1986). Why do managers voluntarily release earnings forecast? *Journal of Accounting andEconomics*, 8, 53-71.

Fung, B. 2014. The Demand and Need for Transparency and Disclosure in Corporate Governance. *Universal Journal of Management*, 2(2), 72-80.

Klai, N. and Omri, A. 2011.Corporate Governance and Financial Reporting Quality: TheCase of Tunisian Firms. *International Business Research*, 4(1), 158-166.

Asegdew, K. 2016. Determinants of Financial Reporting Quality: Evidence from LargeManufacturing Share Companies of Addis Ababa.Master Thesis, Department ofAccounting and Finance, College of Business and Economics, Addis AbabaUniversity- Addis Ababa, Ethiopia.

Fathi, J. 2013. The Determinants of the Quality of Financial Information Disclosed byFrench Listed Companies. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 4(2), 319-336.

Soheilyfar, F., Tamimi, M., Ahmadi, M.R. and Takhtaei, N. 2014. Disclosure Quality andCorporate Governance: Evidence from Iran. *Asian Journal and Finance and Accounting*, 6(2), 75-86.

Savina, N.T. 2016. The Institutionalization of the Concept of Corporate SocialResponsibility: Opportunities and Prospects. European Research Studies Journal,19(3) Part B, 56-76.

Schnackenberg, A. 2009. Measuring Transparency: Towards a Greater Understanding ofSystemic Transparency and Accountability. Working Paper, Department ofOrganizational Behavior-Weatherhead School of Management-Case WesternReserve University, 1-55.

Liapis, K., Thalassinos, I.E. 2013. A Comparative Analysis for the Accounting Reporting of “Employee Benefits” between IFRS and other Accounting Standards: A Case Studyfor the Biggest Listed Entities in Greece. *International Journal of Economics andBusiness Administration*, 1(1), 91-116.

Allegret, J.P., Raymond, H. and Rharrabti, H. 2016. The Impact of the Eurozone Crisis onEuropean Banks Stocks, Contagion or Interdependence. European Research StudiesJournal, 19(1), 129-147.

Scaltrito, D. 2015. Assessing Disclosure Quality: A Methodological Issue. *Journal of Modern Accounting and Auditing*, 11(9), 466-475.

Lang, M.H. and Lundholm, R.J 2000.Voluntary Disclosure and Equity Offerings: ReducingInformation Asymmetry or Hyping the Stock. *Contemporary Accounting Research*,17(4), 623-662.

Takhtaei, N. and Mousavi, Z. 2012. Disclosure Quality and Firm's Characteristics: Evidencefrom Iran. *Asian Journal of Finance and Accounting*, 4(2), 290-300.

Monday, I.I. and Nancy, A. 2016. Determinants of Voluntary Disclosure Quality inEmerging Economies: Evidence from Firms Listed in Nigeria Stock Exchange.*International Journal of Research in Engineering and Technology*, 4(6), 37-50.

Pivac, S., Vuko, T. and Cular, M. 2017. Analysis of Annual Report Disclosure Quality forListed Companies in Transition Countries. *Economic Research Ekonomska Istraživanja*, 30(1), 721-731.

# Trafficking in human beings: Case study Kosovo

**MSc. Fife Kovaci - Uruci**
Hasan Prishtina University, Pristine
kovacifife@gmail.com

**ABSTRACT**
Trafficking in human beings has become one of the biggest issues worldwide which is also present in Kosovo. The purpose of this paper is to show the current situation of trafficking in human beings in Kosovo and to elaborate on what measures have been taken so far. This phenomenon has started to spread in our society since the last war in Kosovo in '99, where the most affected victims are children and women. Trafficking in human beings is a very sensitive topic. Moreover, the violation of human rights comes as a result of the poverty as a part of the society which has no financial support and falls prey to organized crime. Victims of trafficking are exploited in a variety of ways including prostitution, the recording of pornographic videos by criminal groups regardless of in what form it has been used through fraud or violence. Children are mostly forced to work by sending them to bars to perform massage services or to beg on the streets which are controlled by the organized group. Almost all of the states are developing program awareness to prevent their citizens from this phenomenon but is impossible to eliminate.
**Key words:**
Kosovo; Trafficking; Women; Children

**ABSTRAKT**
Trafikimi i qenieve njerëzore është bërë një nga çështjet më të mëdha në mbarë botën e cila është e pranishme edhe në Kosovë. Qëllimi i këtij punimi është të tregojë gjendjen aktuale të trafikimit me qenieve njerëzore në Kosovë dhe të elaborojë se çfarë masash janë marrë deri më tani. Kjo dukuri ka filluar të përhapët në shoqërinë tonë që nga lufta e fundit në Kosovë në vitin '99, ku viktimat më të prekura janë fëmijët dhe gjinia femërore. Trafikimi i qenieve njerëzore është një temë mjaft e ndjeshme. Për më shumë shkelja e të drejtave të njeriut vije si pasojë e varfërisë së një pjese të shoqërisë e cila nuk ka asnjë mbështetje financiare dhe bie pre e krimit të organizuar. Viktimat e trafikimit shfrytëzohen në mënyra të ndryshme duke përfshirë prostitucionin, regjistrimin e videove pornografike nga grupet kriminale pavarësisht se në çfarë forme është përdorur me anë të mashtrimit apo dhunës. Fëmijët kryesisht detyrohen të punojnë duke i dërguar në lokale për të kryer shërbime të masazheve apo për të kërkuar lëmoshë në rrugë të cilët kontrollohen nga grupi i organizuar. Pavarësisht se shumica apo thuajse të gjitha shtetet zhvillojnë programe vedijesimi për të parandaluar këtë dukuri është e pamundur që të eliminohet.
**Fjalët kyçe:**
Kosova; Trafikimi; Femrat; Fëmijët

## Hyrje

Trafikimi i qenieve njerëzore është i njohur edhe si trafikimi i njerëzve apo si një skllavëri moderne që shfrytëzohet nga një grup i organizuar njerëzish për përfitime financiare. Trafikimi është krim që përfshin detyrimin e një individi për të ofruar punë apo shërbime nga të cilat vije tek përfshirja në akte seksuale tregtare. Për më shumë detyrimi mund të jetë fizik ose psikologjik. Femrat dhe të miturit janë grupi më i prekur në këtë qeshtje. Mund të themi se shfrytëzimi i një të mituri për të kryer marrëdhënie seksuale komerciale është trafikim njerëzor. Për sa i përket grupimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore mund të jetë kushdo—pavarësisht racës, origjinës kombëtare, ngjyrës, fesë, aftësisë së kufizuar të individëve, moshës, orientimit seksual, gjinisë, statusit, identitetit gjinor, shtetësisë apo nivelit të arsimimit. Sipas Rrahim Ternavës, i cili koordinon sekretariatin kundër trafikimit të MPB-së në Kosovë, "Trafikimi me qenie njerëzore është praktikë e njerëzve të mashtruar, të joshur, të detyruar ose të larguar nga shtëpia apo vendi i tyre, dhe më pas të detyruar të punojnë të lirë ose me nivele të ulëta paga. Konsiderohet si tregti praktike ose tregti me njerëz, e cila ka shumë karakteristika të skllavërisë dhe është ilegalisht në shumicën e vendeve". Ky

përkufizim përdoret edhe në Kodin Penal të Kosovës. Siç është përcaktuar në nenin 171 të Kodit Penal, elementet e trafikimit me njerëz përbëhen nga: 1.1. rekrutimi, 1.2. transportimi, 1.3. transferimi, 1.4. strehimi apo pranimi i personave, me anë të kanosjes dhe përdorimit të forcës apo formave tjera të shtrëngimit, 1.5. rrëmbimit, 1.6. mashtrimit, 1.7. lajthimit, 1.8. keqpërdorimit të pushtetit apo keqpërdorimit të pozitës së ndjeshme dhe 1.9. dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, për qëllim të shfrytëzimit.[77] Çdo ditë e më shumë njerëz po informohen, si për punë të rreme të premtuara, dhe po rrëmbehen me qëllim të fitimeve personale të trafikantëve. Ky punim prezanton shumë çështje të trafikimit të qenieve njerëzore dhe gjithmonë duke pasur parasysh se trafikimi nuk përdoret vetëm për shfrytëzim seksual, ai përdoret edhe për aspekte të tjera të paligjshme si puna e detyruar, shitja e organeve njerëzore etj. Në SHBA, trafikimi i fëmijëve në punë ndodh në industritë siç janë restorantet, bare, hotelet, dhe punë bujqësore. Trafikimi i fëmijëve në shfrytëzim për marrëdhënie intime ndodh në shtëpitë publike dhe klube striptizi, nëpërmjet shërbimit e shoqërimit dhe masazheve, gjithashtu nëpërmjet prostitucionit të kontrolluar nga tutorët në rrugë. Gjithnjë e më shumë iu lehtësohet puna përmes internetit. Përafërsisht 244,000 deri në 326,000 fëmijë amerikanë janë në rrezik për shfrytëzim seksual komercial secilin vit. Shumë prej tyre janë të arratisur, të pastrehë ose të rinj të pambrojtur.[78] Ekzistojnë institucione dhe organizata të ndryshme në Shtetet e Bashkuara që punojnë në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore siç janë UNICEF, UNHCR, IOM, ILO etj., të gjitha këto institucione punojnë duke ngritur zërin në fushata ndërgjegjësimi që përshkruajnë metodat e trafikantëve ose grupeve kriminale dhe sesi njerëzit duhet të jenë të zgjuar për të mbrojtur veten e tyre nëse mund të përballen me këto situata.

**Shqyrtimi i literaturës**

Aktualisht, Kosova nuk është vetëm vend transiti apo destinacioni, por është edhe vend ku trafikimi i brendshëm për shfrytëzim seksual është në rritje. Megjithëse trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual mbetet dominues, ekzistojnë të dhëna edhe për forma të tjera të shfrytëzimit. Sidoqoftë, rastet e identifikuara të fëmijëve të trafikuar për kërkim lëmoshe, të cilëve iu është dhënë ndihmë, janë të pakta. (masht.rks-gov, 2001). Ende nuk ka ndonjë definicion të caktuar të trafikimit pasi që kjo dukuri përfshinë një sëre aktivitetesh kriminale të cilat dënohen me ligj dhe klasifikohen si vepra penale. Numri i të trafikuarve kryesisht është më i lart tek gjinia femërore dhe tek fëmijët e gjinisë mashkullore. Më 2014-të janë trafikuar 86 fëmijë/meshkuj, përderisa ka pasur rritje enorme të kësaj dukurie më 2015-të pasi numri është rritur në 134 raste.Kurse,90 fëmijë të gjinisë femërore janë trafikuar më 2014-të kurse më 2015-të është rritur numri në 116 raste. Sa i përket nacionalitetit, është e kuptueshme se më së shumti janë trafikuar fëmijët shqiptarë të Kosovës ku më 2014-të janë shënuar 144 raste, kurse një vit më janë shënuar 183 raste. (Hashani,2017). Siç është raportuar gjatë pesë viteve të fundit, trafikantët e qenieve njerëzore shfrytëzojnë viktima vendase dhe të huaja në Kosovë, dhe trafikantët shfrytëzojnë viktimat nga Kosova jashtë vendit. Rrjetet kriminale shfrytëzonin viktimat në trafikun seksual brenda vendit. Shumë viktima të trafikimit seksual në Kosovë janë vajza, megjithëse trafikantët detyrojnë gjithashtu gra nga Shqipëria, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe vende të tjera evropiane në trafikim seksual.[79]

**Trafikimi i grave dhe fëmijëve**

Rastet më të shpeshta të trafikimit të qenieve njerëzore janë gratë dhe fëmijët. Për shembull: gratë mund t'iu shiten bandave që i detyrojnë të punojnë si prostituta në vende të ndryshme të huaja. Ka edhe disa raste kur meshkujt i detyrojnë partneret e tyre të punojnë për ta. Rastet kur gruaja detyrohet të kryejë marrëdhënie intime me burra të ndryshëm si prostitutë dhe ka frikë të raportojë këtë çështje, sepse jeta e saj do të jetë në rrezik. Viktimat e trafikimit që konsiderohen si fëmijë janë ata/ato nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ata/ato viktima përdorën për seks komercial si: prostitucion, pornografi dhe turizëm seksual. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë për qëllime dhe situata

[77] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Kosovës. 2013, NR. 04/L-218 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT.

[78] UNICEF, Trafikimi i fëmijëve, U.S.,York, 2016 (vizituar së fundi në Prill, 2022), https://www.unicefusa.org/sites/default/files/9-12_Child_Trafficking_HS_2016.pdf

[79] Raporti i vitit 2020 mbi trafikimin e personave. Prishtinë. 2020. https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/kosovo/. (vizituar së fundi në Prill,2020).

të ndryshme si p.sh. duke e përfshirë kështu prostitucionin, fuqinë punëtore (përfshirë punën e lidhur ose skllavërinë e borxhit) dhe forma të tjera të robërisë së pavullnetshme. Shitja e foshnjave dhe fëmijëve që kërkojnë lëmoshe në rrugë apo qëllime të tjera konsiderohen gjithashtu si trafikim i këtyre fëmijëve. Raportimi Kombëtar i Krimit Uniform (UCR) për sa i përket trafikimit të njerëzve në vitin 2019 , është raporti i shtatë për sa i përket mbledhjes së të dhënave të Programit për Trafikimin e Njerëzve. Dyzet e tetë (48) shtete dhe ku mori pjesë edhe territori amerikan i Puertos Rico. Raporti i këtij viti tregon se gjithsejtë janë 1,883 incidente të trafikimit të qenieve njerëzore, ku të raportuara ishin 1607 në kategorinë e akteve seksuale komerciale dhe 274 ishin raste të pavullnetshme. (Puerto Rico i paraqiti dy incidente dhe nuk specifikoi nëse ato incidente ishin nën kategorinë e akteve seksuale tregtare apo të servitutit të pavullnetshëm.) Nga raportimi i shkelësve në korrelacion me këto incidente u arrestuan 708 persona. Prej tyre, 684 ishin të rritur dhe 24 ishin të mitur.[80] Aktorët e trafikimit përdorin mjete të ndryshme për të mashtruar njerëzit dhe për të dërguar individë në vende të ndryshme në mënyrë që të marrin përfitime financiare prej tyre. Përkundër faktit se shumica e grave përdoren për prostitucion, fëmijët përdoren për seks komercial, i cili përfshin prostitucionin, pornografinë dhe turizmin seksual. Trafikantët i detyrojnë fëmijët të punojnë në vende të ndryshme si në ferma, restorante, lypsa të rrugëve etj. Rastet kryesore të viktimave në Kosovë janë individë nga mosha 15 deri në 25 vjeç dhe vijnë nga qytete të ndryshme të Kosovës, kryesisht nga Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjakova dhe Ferizaji. Trafikimi për shfrytëzim seksual duket se ka rënë prej vitit 2002. Në vitin 2017, në Kosovë nga policia janë regjistruar 18 raste të trafikimit, prej të cilave të gjitha ishin gra, në mesin e tyre 10 vajza. Po këtë vit, nga 38 të arrestuar, 34 ishin burra ndërsa katër ishin gra.[81] Përveç shtetasve kosovar, ka shumë raste që vijnë nga Shqipëria ku në vitin 2017 janë ndaluar dhjetëra shtetas shqiptar. Sipas një raportimi policia e Kosovës ka ndaluar 42 shtetas nga Shqipëria të cilët lypnin në rrugët e Prishtinës. Mes tyre janë 18 fëmijë dhe 23 persona në moshë të rritur. Mësohet sa ata kanë hyrë ilegalisht në Kosovë.[82]

**Traumat dhe simptomat**

Viktimat e trafikimit përballen me sëmundje të ndryshme fizike dhe mendore si: HIV/AIDS, trauma rektale, frikë, depresion etj. Traumat dhe depresioni janë çështje me të cilat përballen shumica e viktimave. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore meritojnë vëmendje të veçantë, shumica e tyre duhet të vizitojnë psikologët. Për më tepër, viktimat pasi trafikohen qajnë vazhdimisht, e kanë problem të harrojnë momentin e tyre tragjik në të cilin kalojnë etj. Sipas neuropsikologut Jeton Rafuna, "Simptomat e viktimave të traumatizuar të trafikimit janë të shumta. Për shembull: ata vuajnë nga humbja e kujtesës pothuajse çdo ditë, viktimat kanë probleme gjuhësore, ata harrojnë se cilat janë fjalët përkatëse që duhet të përdoren kur flasin fjalë të përziera, në shumicën e rasteve janë konfuz, kanë probleme në kujtimin e gjërave ose informacioneve të reja, aftësi të dobëta në të shkruar dhe vështirësi në lexim." Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore duhet të vizitohen nga psikologët ose ekspertët neuropsikologë, të cilët mund t'i ndihmojnë ata në forme emocionale dhe psikike për të tejkaluar traumat e tyre. Disa nga viktimat nuk i kujtojnë momentet që kanë kaluar gjatë torturave të tyre. Madje, ka prej tyre që kujtojnë momente se si dhe nga kush janë torturuar mirëpo kanë frikë të flasin sepse trauma qëndron tek ata për një periudhë të gjatë kohore. Kuptohet se kjo ndodh pasi që janë të tmerruar nga trafikantët dhe mendimet e tyre janë të tilla sa që mendojnë ende se nëse flasin duke dhënë informacione tek personat kompetent për sa i përket trafikantëve do të torturohen përsëri. Përveç situatës psikologjike që kanë, ka raste të viktimave të cilët nuk posedojnë kujtesë të mirë dhe mos të dijë as vendet se ku kanë qëndruar apo sa kohë kanë qëndruar gjate procesit të trafikimit të tyre. Kur është fjala për dëshmimin e tyre është gjithmonë një çështje mjaftë delikate se nëse këto viktima do të jenë dëshmitarë të besueshëm për të dëshmuar kundër trafikantëve apo jo.

**Shkaqet dhe efektet**

---

[80] Crime in the United States, U.S. department of justice, 2019 http.s://ucr.fbi.gov/crime-in-the-u.s/2019/crime-in-the-u.s.-2019/additional-data-collections/human-trafficking/human-trafficking.pdf. (vizituar së fundi në Mars, 2022)

[81] Strategjia e RrGK, Rrjeti i Grave të Kosovës, Prishtinë, 2019-2022. https://womensnetwork.org/ëp-content/uploads/2019/05/Strategjia-e-RrGK-2019-2022_FINAL_2019-05-22-1.pdf. (vizituar së fundi në Mars, 2022)

[82] Lapsi.al, Ndalohen në Kosovë 41 lypsa nga Shqipëria, 2017. https://lapsi.al/2017/10/13/ndalohen-ne-kosove-41-lypsa-nga-shqiperia/. (vizituar së fundi në Mars, 2022)

Shkaqet e kësaj veprimtarie vijnë nga rrethanat e ndryshme siç janë varfëria, lufta, diskriminimi gjinor, problemet familjare etj. Njëri ndër faktorët më të shpeshta është gjendja ekonomike e cila i shtyn gratë dhe fëmijët të bëhen viktima të trafikimit; për arsye të situatës së tyre prej një varfërie të skajshme ata pranojnë të punojnë çfarë do pune që iu ofrohet edhe jashtë vendit të tyre. Derisa gjendja ekonomike në Kosovë po përkeqësohet dhe shkalla e papunësisë po rritet, numri i viktimave po rritet në çdo qytet. Sipas anketës se fuqisë punëtore (AFP) shkalla e papunësisë arrin në një numër jo të mirë për sa i përket numrit të banorëve ku kryesisht gjinia femërore është më e prekura. Në tremujorin e parë të vitit 2021, të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeçare dhe në fuqinë punëtore, 48.6 % ishin të papunë. Papunësia është më e lartë te femrat e reja (53.5 %) se te të rinjtë meshkuj (46.1%). Papunësia më e theksuar është te femrat me 29.7 për qind krahasuar me meshkujt me 24.2 për qind. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grup moshat 15-24 vjeçare me 48.6 për qind.[83] Raportimi i nxjerr nga Agjencia e Statistikave të Kosovës duket qarte se fuqia punëtore të cilët janë të aftë për punë është më e lart tek gjinia femërore.

| Kosovë | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| **PUNËSIMI (NË MIJËRA)** | | | |
| 15-24 | 27.547 | 12.343 | 39.889 |
| 25-34 | 66.596 | 27.488 | 94.085 |
| 35-44 | 63.485 | 23.550 | 87.036 |
| 45-54 | 62.544 | 21.823 | 84.367 |
| 55-64 | 40.926 | 12.864 | 53.790 |
| **15-64** | **261.098** | **98.069** | **359.167** |
| **Raporti punësim ndaj popullsisë (%)** | | | |
| 15-24 | 16.1 | 7.7 | 12.0 |
| 25-34 | 48.9 | 22.3 | 36.2 |
| 35-44 | 60.4 | 20.9 | 39.9 |
| 45-54 | 56.2 | 18.0 | 36.3 |
| 55-64 | 47.5 | 13.1 | 29.2 |
| **15-64** | **42.8** | **15.9** | **29.3** |

Tab 1. Të punësuar dhe raporti punësim ndaj popullsisë - shkalla e punësimit, sipas gjinisë dhe grup moshës

Me një nivel të lartë papunësie dhe gjendje jo stabile ekonomike njerëzit përballen me varfërinë dhe kjo i shtyn ata të bëjnë zgjedhje të vështira sidomos moshat e reja ku disa prej tyre kthehen në prostitucion ose duke u bërë pronë e trafikantëve. Grupet kriminale i detyrojnë i mashtrojnë femrat dhe fëmijët duke ju premtuar punë jashtë vendit duke e bërë si lokacion më të shpeshtë vendet rajonale dhe Evropën. Trafikantët i nënshtrojnë qytetarët e Kosovës në trafikim për seks dhe punë të detyruar në mbarë Evropën. Komunitetet e margjinalizuara të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve janë të cenueshme ndaj lypjes së detyruar dhe trafikimit për seks. Korrupsioni qeveritar krijon një mjedis që mundëson disa krime trafikimi.[84] Nisur nga ky fakt, numri i viktimave është në rritje. Në Kosovë edhe fëmijët detyrohen të lypin në rrugë.

**Mbrojtja**

Masat mbrojtëse për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore ekzistojnë në shumë vende të botës po ashtu edhe Kosova posedon qendrën për mbrojtje të viktimave dhe rehabilitimin e tyre. Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT bënë ofrimin e shërbimeve mjekësore, psikologjike, psikiatrike, sociale, mbështetje ligjore, avokim, hulumtim dhe monitorim sistematik të vendeve të paraburgimit dhe objekteve të shëndetit

---

[83] Agjensia e statistikave të Kosovës ASK. Statisitkat Sociale. Anketa e fuqisë punëtore. Prishtinë. Tetor, 2021.

[84] Raporti i vitit 2020 mbi trafikimin e personave. Prishtinë. 2020. https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/kosovo/. (vizituar së fundi në Prill,2020).

mendor në Kosovë.[85] Përveç qendrës ekzistojnë edhe strehimore të cilat i marrin nën mbikëqyrje personat e traumatizuar dhe i sistemojnë duke i mbështetur me të gjitha nevojat personale individualisht secilin person i/e cila ka kaluar në këto situata. Vendet e Bashkimit Evropian kanë masa mbrojtëse shumë të mira për shtetasit e tyre. Qeveria ndau 172,960 € (194,340 dollarë) për mbrojtjen e viktimave, krahasuar me 150,680 € (169,300 dollarë) në 2018. Megjithatë, qeveria vazhdoi të ulë në mënyrë progresive fondet për strehimoret e drejtuara nga OJQ-të, të cilat morën 67,000 € (75,280 dollarë), krahasuar me 79,420 dollarë) në 2018, 72,870 € (81,880 dollarë) në 2017, 91,010 € (102,260 dollarë) në 2016 dhe 101,930 € (114,530 dollarë) në 2015. ISF mori 80 € (80,9,0 dollarë). 5,160 € (5,800 dollarë) për shërbimet shëndetësore dhe qeveritë komunale dhanë 7,100 € (7,980 dollarë) për një strehë të drejtuar nga OJQ.[86] Ligjet që e bëjnë të detyrueshme për shtetet anëtare përmbushjen e një standardi të kërkuar të masave mbrojtëse për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë linjat telefonike pa pagesë që funksionojnë 24 orë në 7 ditë të javës, duke marrë raporte për aktivitete të dyshimta në lidhje me punën e detyruar, të cilat sigurojnë anonimitetin e lajmëtarëve të mundshëm dhe lajmëruesit do të kenë shpërblime modeste në disa prej vendeve. Në Suedi ku prostitucioni është i ligjshëm, qeveria ka vendosur që nga fillimi i viteve 1990 një program rehabilitimi për të gjitha prostitutat duke u dhënë atyre rreth 3000 euro në muaj si një program ndihmës/mbrojtjeje nga qeveria, me kusht që të ndërpresin tregtinë e tyre dhe të përpiqen të rehabilitohen me shoqërinë duke gjetur alternativa më të mira punësimi ndaj prostitucionit. Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishmja, çdo iniciativë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë duhet të shihet brenda një konteksti më të gjerë të gadishullit ballkanik ku Kosova është vetëm një bazë tjetër e trafikantëve të qenieve njerëzore dhe rrjeteve të krimit të organizuar që janë të përhapura në të gjitha vendet fqinje për rreth ( Serbia, Maqedonia, Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Turqia, Mali i Zi, Rumania, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Sllovenia dhe Hungaria). Kuadri ligjor ndërkombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore përfshin edhe traktate të specializuara të cilat janë realizuar midis grupimeve rajonale të shteteve. Një shembull shumë i rëndësishëm është Konventa e vitit 2005 e Këshillit të Evropës "Për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore" (Konventa Evropiane kundër Trafikimit), e cila hyri në fuqi në muajin shkurt 2008. Kjo konventë ka potencialin për të lidhur më se dyzet vende të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore me një nivel shumë më të lartë detyrimi, sidomos sa i takon mbrojtjes së viktimave, në krahasim me detyrimin e kërkuar nga Protokolli i OKB-së për Trafikimin. Të gjitha vendet pjesëmarrëse e kanë zbatuar këtë Konventë (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia dhe Mali i Zi në vitin 2008, dhe Serbia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në vitin 2009).[87]

**Parandalimi**

Ka disa grupe antitrafik që hetojnë për të gjetur raste të viktimave të trafikimit dhe për të dërguar trafikantët fajtorë para drejtësisë për t'u përballur me gjykatat, por jo gjithmonë ata dënohen për krimet e tyre dhe rrallëherë lirohen me dënime të lehta që varionjë nga 1 vjet deri në 3 vjet burgim, ndërkaq personat e krimit të organizuar rrallëherë sillen para drejtësisë. Për të parandaluar këtë fenomen Qeveria e Kosovës benë fushata vetëdijesimi për të rinjtë dhe të rejat, studentet dhe për publikun e përgjithshëm që të kenë kujdes të shtuar dhe mos të bijën pre e krimit të organizuar. Linja e drejtpërdrejtë telefonike për viktima të dhunës në familje dhe të krimeve të tjera, e drejtuar nga qeveria, pranoi 831 thirrje (929 në vitin 2018), përfshirë nëntë raste të trafikimit të mundshëm (tetë në vitin 2018). Qeveria zhvilloi fushata vetëdijesimi për ta ulur kërkesën për akte të seksit komercial.[88]Kuptohet se për tu reduktuar kjo dukuri, Qeveria e Kosovës duhet të marrë urgjentisht në konsideratë eliminimin apo uljen e numrit të individëve të cilët ndikohen të marrin vendime duke u mashtruar nga grupet e krimit të organizuar. Qeveria organizojnë seminare vetëdijesimi të cilat i ofrojnë shoqërisë më të re informacion të mjaftueshëm mbrojtjen e vetës së tyre nga ndonjë mashtrim i mundshëm që mund të vije deri tek trafikimi. Një çështje që është shumë e rëndësishme është se qeveria duhet të sigurojë kufirin e Kosovës qoftë atë tokësor dhe at ajror. Duhet të shtohen forcat e policisë në mënyrë që identifikimi

[85] Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT. Prishtinë, 2022.
[86] Raporti i vitit 2020 mbi trafikimin e personave. Prishtinë. 2020. https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/kosovo/. (vizituar së fundi në Prill,2020).
[87] Zyrave e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin - UNODC. (2010). TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE & KALIMI KONTRABANDË I MIGRUESVE. [Broshur]

[88] Zeqiri. KOSOVË: Raporti i vitit 2020 mbi trafikimin e personave. Prishtinë.2020.

i trafikimeve të jetë më i lehtë, të cilët me anë të kontrolleve të tyre mund të përpiqen sado pak të parandalojnë lëvizjet e paligjshme klandestine ndërkufitare të "skllevërve të bardhë" dhe atyre të drogës. Për më tepër, duke ndërmarrë disa nga hapat e lartpërmendur kjo çështje mund të reduktohet dhe kur ka më shumë siguri në zonat kufitare do të thotë edhe ekziston mundësia e personelit më të pa-korruptuar si njerëz më të sigurt.

**Metoda**

Për studimin e këtij hulumtimi janë përdorur disa metoda. Të dhënat e grumbulluara për realizimin e këtij punimi janë metodat primare duke intervistuar neuropsikologun z. Jeton Rafuna dhe zyrtarin e lartë të sekretariatit kundër trafikimit të qenieve njerëzore z. Rrahim Ternava. Po ashtu për gjatë hulumtimit është përfshirë metoda historike - webografike ku janë nxjerre të dhënat e gjetura me herët nga analizat dhe anketat e përdoruara përmes raportit të statistikave me ç ‘rast këtu hynë edhe metoda sasiore përmes të cilës kemi nxjerr një përfundim të një numri të caktuar të personave që kanë qenë pjesë e trafikimit të qenieve njerëzore.

**Metodologjia**

Metodologjia e përdorur në këtë punim është e veçantë pasi qe studion një sferë mjaft specifike e cila ka të bëjë me një temë të ndjeshme. Studimi i ligjeve kundrejt këtij fenomeni e pasuron punimin me të dhëna statistikore. Të dhënat e grumbulluara nga metoda historike na japin mundësi që të kuptojmë se si ishte situata e viteve të kaluara në krahasim me kohën e tanishme duke e ditur se ky fenomen ka filluar të rritet në Kosovë që nga pas lufta e vitit ’99. Përveç të tjerash në këtë punim është përdorur edhe metoda dogmatike-juridike nga e cila është studiuar kuptimi i krimit të organizuar nga mashtrimet e trafikantëve.

**Përfundimi**

Tani është koha që Kosova të marrë më shumë përgjegjësi në sigurimin e një mjedisi të sigurt jetësor për qytetarët e saj. Kosova nuk duhet të mbështetet vetëm në mbështetjen financiare dhe teknike ndërkombëtare. Një mënyrë për të përmirësuar pozitën e Kosovës në parandalimin e fenomenit është krijimi i më shumë mundësive të punësimit për një popullatë që në 20 vitet e fundit ka pasur një nga normat më të larta të papunësisë në rajon lidhur me situatën e paqëndrueshme politike si pasojë e kolapsit të Komunizmi dhe ish-Jugosllavia. Ndryshime të tilla pa dyshim do të ndihmonin të rinjtë. Ata do të kishin të ardhurat e tyre legjitime dhe stimujt për të jetuar një jetë më të mirë brenda kuadrit ligjor të ligjit. Pra, duke investuar në ekonominë dhe infrastrukturën e Kosovës, do të krijoheshin kushte më të mira jetese ku mendimi për të zgjedhur aktivitetet ilegale nuk do të ishte opsion për të zgjedhur si burim të jetesës. Trafikimi me qenie njerëzore është fenomen global dhe Kosova duhet ta luftojë këtë çështje me masa më të ashpra. Të ndëshkohen kriminelët që punojnë me rrjetet e trafikimit me qenie njerëzore. Trafikimi me qenie njerëzore në Kosovë si shtet i ri është një problem i tmerrshëm që cenon ligjin dhe funksionimin e duhur të vetë shtetit. Së fundi, mendoj se prostitucioni është një nga pikat kryesore të trafikimit; prandaj, prostitucioni duhet të hiqet nga çdo vend ku është i legalizuar (duke përfshirë disa shtete anëtare të BE-së).

**Kufizimet dhe studimet e ardhshme**

Duke e ditur që trafikimi i qenieve është një dukuri mjaft e kufizuar për sa i përket grumbullimit të numrit të sakte të viktimave pasi që sigurisht se ka raste në Kosovë të pa-deklaruara në organet kompetente. Kjo ndodh nga frika e tyre për të dëshmuar por edhe nga mos qasja e mundësie që të shprehën pasi që iu cenohet e drejta e lirisë nga trafikantët të cilët i mbajnë të mbyllur në shtëpi publike apo banesa private të tyre dhe të cilët i mbajnë nën kontroll të shtuar.

**Mirënjohje**

Shpreh mirënjohje të pamasë për kohën e ndarë gjatë intervistës direkte me zyrtarin e lartë të sekretariatit të Ministrisë së punëve të brendshme për ndalimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë Z. Rrahim Ternava, i cili me profesionalizmin e tij më informoj me të dhënat e sakta lidhur me gjendjen momentale në Kosovë.
ndihmoi dhe përkrahu gjatë punimit të kësaj teme, me qëllimin e mirë për ta finalizuar në mënyrë sa më të denjë. Gjithashtu e falënderoj neuropsikologun z. Jeton Rafuna i cili po ashtu gjeti kohë të i përgjigjet pyetjeve të mia lidhur me pasojat e të trafikuarve dhe stabilitetin e viktimave për sa i përket jetës së tyre.

**Referencat**

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2021). Statistikat sociale: https://ask.rks-gov.net/media/6354/afp-tm1-2021.pdf.

(vizituar së fundi në Prill, 2022)
Intervista me neuropsikologun  Z. Jeton Rafuna
Intervistë me zyrtarin e lartë të sekretariatit Z. Rrahim Ternava
Kadriu, L., Gashi, S., Demiri, N., & Shanaj, H. (2017). Të parandalojmë trafikimin e qenieve njerëzore . Manual për mësues, 100-109.
Kodi penal i Kosovës, 2013.
Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2013). LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT. Prishtinë: Republika e Kosovës. https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8875. (vizituar së fundi në Mars, 2022)
Lapsi.al. (2017, Tetor). https://lapsi.al/2017/10/13/ndalohen-ne-kosove-41-lypsa-nga-shqiperia/. (vizituar së fundi në Prill, 2022).
Organizata Botërore e Shëndetësisë "Parandalimi i Dhunës dhe Dëmtimit, Dhuna ndaj Grave: Çështjet prioritare të shëndetësisë". Infomacion i OBSH-së përdhunën dhe shëndetin.
Raporti i vitit 2020 mbi trafikimin e personave (2020). *U.S. Department of State.*, https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/kosovo/. (vizituar së fundi Prill, 2022).
Rrjeti i grave të Kosovës. (2018). Strategjia e RrGK 2019-2022. Prishtinë, Kosovë: RrGK.
Uajt, E. (2021). Mediat dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Këshilli i Evropës , f. 30-36.
Zeqiri, P. (2020). KOSOVË: Raporti i vitit 2020 mbi trafikimin e personave. Hungari: childhub.
Zyrave e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin - UNODC. (2010). TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE & KALIMI KONTRABANDË I MIGRUESVE [Broshur]

# Efektet e Trajnimeve  në Menaxhimin e përformancës së Korporatës- Korporata KEK Rast studimor

**Bekim Syla PhD Cand.**
Universiteti “Kirilj Metodij” Shkup
**Prof. Asoc. Naim Baftiu**
Universiteti “ Ukshin Hoti” Prizren
**Sabri Tërnava PhD Cand.**
Drejtor Teknik Korporata KEK
Email: bekimsylaj@hotmail.com; sabri.r.ternava@kek-energy.com; naim.baftiu@uni-prizren.com

**Abstrakt**

Trajnimi i të punësuarve në korporata është elementi kyç i përformancës efektive të korporatës e cila mundëson komunikimin dhe realizimin e detyrave ditore në mes të menaxhmentit dhe të punësuarve në korporatë, në këtë sens edhe Korporata Elektroenergjetike e Kosovës- KEK përdor strategjinë  e trajnimit të punëmarrësve me fokus të veçant me gjendje ekonomiko – sociale të rënduar si dhe mbajtjen nën kontrollë të  situatave kritike që shfaqen nga gjendja e tillë e të punësuarve në departamente të ndryshme punuese.

Ky punim elaboron efektet e trajnimit tek punëmarrësit në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës -KEK, që të identifikoj ambientin punues dhe komunikimin menaxherial me të punësuarit sepse keq-menaxhimi me punëmarrësit në korporatë, shkakton probleme shëndetësore, sociale dhe humbje vetëbesimi tek të punësuarit dhe familjet e sidomos zvogëlim të përformances dhe humbje financiare në  Korporatë.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është bazuar kryesisht nga burime primare të marra në mbledhjet e të dhënave duke përdor metodën Deskriptive të shtrirjes së efekteve të trajnimit dhe humbjet ( Dëmtimet) e shëndetit të punëmarrësve përgjatë viteve 2007-2020, të raportuara në menaxhmentin e lartë,  si dhe në burime sekondare të marra nga raportet e publikimeve shkencore të efekteve të trajnimeve në performancën e korporatave.

Përmes këtij punimi ne do mundohemi të vejmë në pah rendësin e Menaxhimit Strategjik të  trajnimeve dhe rëndësisë së saj që ka në efeqiencën e përfomancës së Korporatës KEK dhe krijimit të ambientit më të sigurt punues në implementimin e objektivave ditore të punëmarrësve në korporatë.

*Fjalët Kyqe: Trajnimi, korporata,  efektet ekonomike financiare, Menaxhimi i Performancës, efektet sociale.*

## Hyrje

Korporata Energjetike e Kosovës KEK është e njohur si një vend i mrekullueshëm për të punuar dhe kjo i mundëson punëmarrësit të jetë i përkushtuar dhe i motivuar për tu ngritur vazhdimisht në aspektin profesional. Kjo fillon duke komunikuar me punonjësit për vështirësitë në kryerjen e  punëve ditore dhe brengat familjare me të cilat ata vijnë në punë.  Me një kulturë të dyerve të hapura, komunikim të shkëlqyer nga  Menaxhimenti i Lartë dhe një fuqi punëtore bashkëpunuese, në KEK është  e ndërtuar një kulturë ku punonjësit inkurajohen dhe ndjehen rehat duke folur.

Nëpërmjet anketave të angazhimit të punonjësve dhe fokus grupeve të punonjësve pas anketës, KEK bashkëpunon me punonjësit të tregojnë se çfarë duan për KEK dhe të  ndihmojnë të gjejnë mënyra për ta bërë atë një vend edhe më të mirë punues.  Më e rëndësishmja, KEK drejton përpjekjet të vazhdueshme për ta bërë KEK një vend edhe më të mirë për të punuar drejt tyre per fushat  që punonjësit e thonë se kanë më shumë rëndësi për ta.

Sot, është e rrallë të gjesh artikuj në publikime të burimeve njerëzore ose menaxheriale dhe  të mos  përmendet strategjia e angazhimit (trajnimit) të punonjësve dhe si ta mundësojnë atë. Megjithatë, deri më sot nuk ka asnjë përkufizim të qartë dhe i dakorduar i angazhimit të punonjësve dhe shumë studiues dhe praktikues përshkruajnë termin në mënyra shumë të ndryshme. (Soldati, 2007). Megjithatë, ekziston një ndërgjegjësim në rritje se angazhimi i punonjësve është thelbësor edhe për performancën e suksesshme Financiare  të biznesit, aty ku angazhohen, punonjësit janë “*shtylla kurrizore e ambientit të mirë të punës ku ndodhen njerëzit punëtor, etik dhe të përgjegjshëm*” (Cleland A, 2008) (Levinson, 2007)

Trajnimi dhe zhvillimi është fusha që ka të bëjë me aktivitetin organizativ që synon përmirësimin e performancës së individëve dhe grupeve në mjediset organizative. Ka qenë i njohur me disa emra, duke përfshirë zhvillimin e

punonjësve, zhvillimin e burimeve njerëzore, dhe të mësuarit dhe zhvillimit.
Për-deri-sa, një organizatë që aspiron të rritet duhet të jetë në harmoni me nevojat në ndryshim të punonjësve. Trajnimi bëhet i rëndësishëm në kontekst pasi që vetëm nëpërmjet trajnimit hendeku midis performancës së organizatës dhe nevojës së ngritjes profesionale të të punësuarve mund të jetë neutralizuar. Trajnimi zvogëlon hendekun duke rritur njohuritë, aftësitë, qasjen dhe aftësitë e punonjësve të bëhen të qëndrueshme- konsistente . Punonjësit janë të motivuar të ndjekin programet e trajnimit nga menaxhmenti për vetë-zhvillim si dhe zhvillimin e organizatës punonjësit e kuptojnë rëndësinë dhe nevojat e trajnimit për të arritur qëllimet organizative (Sundarajan S, 2007).
Ndërsa, vlerësimi i efektivitetit të trajnimit është një fazë e rëndësishme në procesin e trajnimit për personelin (Alvarez, K., Salas, E., & Garofano, C.M, 2004). Qëllimi i tij është të përcaktojë se si organizata përfiton nga trajnimi i punonjësve, ose të zbulojë nëse një formë e trajnimit është më efektive se një tjetër (King, S.B., King M., & Rothwell, W.J, 2001). Pasi të jenë shpenzuar para për trajnim (Mani, 2010), atëherë duhet të dini saktësisht se çfarë do të jetë në gjendje të marrë organizata në këmbim.
Në mënyrë ideale, vlerësimi i efektivitetit të trajnimit duhet të kryhet vazhdimisht, në një formë cilësore ose sasiore (Pfau, B., & Kay, I., 2002), duke vlerësuar ndikimin e trajnimit në tregues të tillë të performancës së organizatës si shitjet, cilësia e produkteve dhe shërbimeve, produktiviteti i punës (Thang, N., Quang, T., & Buyens, D. (, 2010), qëndrimet e punëtorëve, (Werner, J.M., & DeSimone, R.L., 2006) etj.
Sipas Gallup International të paraqitur në editorialin e tyre mbi Menaxhimin dhe angazhimin e fuqisë punëtore, ajo gjen tre grupe të konsiderueshme punonjësish si në vijim: Fig: 1
Fig. 1 Tre Tipet e Angazhimit të të punësuarve




**Burimi:** (Gallup, 2006)**, Fotot nga vend punishtet KEK**
Siç shihet nga fig. 1, po ashtu dhe në Korporatën KEK gjejmë tre grupe punonjësish të cilët sa i përket angazhimit dhe qasjes në trajnime grupohen në ata Aktiv- siq e përshkruan (Bates, 2004), të cilët merren me ngritjen e tyre profesionale sepse mendojnë se ngritja e tyre dhe trajnimi është në të mirë të perfomancës personale dhe përballjes me rrezikun në punë, në kontekstin e tillë KEK i stimulon gjenerimin e ideve të reja dhe fuqizimin e menaxhimit drejt inovacionit dhe motivimeve për ndryshim të gjallërojnë fuqizim vendimmarrës në Korporatë.
Në grupin e dytë kemi punonjësit që kryejnë vetëm detyrat e dhëna dhe nuk ndërmarrin ndonjë aktivitet për tu zhvilluar të cilët sipas (Robinson D, 2007), janë kryesisht punëtoret të shtyrë në moshë dhe para pensionimit të cilët duke u nisur nga shprehja se "*u bërën shumë vite që jam në punën e njëjtë, i di të gjitha*" hezitojnë të marrin pjesë në trajnime dhe trajnimi për ta është përsëritje e rutinës ditore që ata e bëjnë qdo ditë. Këta punonjës janë të vështirë për tu

menaxhuar dhe kryesisht janë të prekur nga situata e tyre financiare dhe socio-ekonomike e familjeve të tyre, të cilët vëmendjen e kanë tek brengat familjare dhe jo tek puna që e kryejnë.
Dhe në fund, grupi i punonjësve që Refuzojnë të trajnohen apo angazhohen në trajnime të tilla, e cila vjen si pasojë e ndjenjës së nënvlerësimit të personit me punën dhe aftësive profesionale të tyre, dhe trajnimet u duken humbje kohe dhe shpërblimin që e marrin nga trajnimet nuk përmbush pritshmërit e tyre. Me këtë llojë të punonjësve sipas (Langelaan S, Bakker AB, van Doornen LJP, Schaufeli WB, 2006), të cilët e mendojnë vetën më të përgatitur se pozitat e tyre është vështirë të gjendën lloje të trajnimeve që i motivojnë dhe kryesisht për temperamentin personal të punonjësve të tillë bien ndesh me mënyrën organizative të menaxhimit të korporatës.
Shumë autor që vlerësuan se ndryshimet në biznes nuk ndodhin pa pasur ndikimin në resurset njerëzore u nisën nga pikëpamjet teknike të atyre ndryshimeve e që më-pastaj edhe analizuan ndërveprimet e bazuara në delegimin e shtuar të autoritetit si dhe praktikave moderne të menaxhimit të resurseve njerëzore me këto ndryshime. Sipas (Laursen, K. Foss, N., 2003) të cilët ofrojnë argumente teorike nga të cilat lidhet ndërveprimi në mes të menaxhimit të resurseve humane dhe ndryshimeve në biznes, duke përmendur se me delegimin shtesë dhe ndryshimeve vie edhe nevoja e motivimit dhe shpërblimit shtesë për motivim, që këtë autoritet ta përdorin në përpikëri me politikat e zhvillimit të organizatës që i takojnë. Rast i tillë është edhe trajnimi në IT për Resurset humane dhe shpërblimi shtesë në pagesa për avancimin e tyre në Korporatë. Përderisa stafi më i prirur për të ndërvepruar me ndryshime është shfaqur ai i cili ka një stabilitet në kohëzgjatjen si punëtorë i asaj Korporate përkundër asaj që në shumë raste Korporatat Kosovare kanë tentuar që ndryshimet në bizneset e tyre ti bëjnë përmes stafit të angazhuar me raste si ato sezonale, të përkohshme apo ekip të projektit, duke ditur që projekti ka një kohë përmbarimi. (Syla, B. and Lecaj, V., 2016)
Fig. 2 Ndërveprimi në mes menaxhimit të resurseve Humane dhe trajnimeve




Burimi: autorët
Sikurse shihet nga fig.2, gjeneratori i ndryshimit në resurse humane ka të bëjë ekskluzivisht me involvimin dhe faktorizimin e resurseve humane në trajnim dhe përgjegjësi të cilat kanë një lidhje të drejtë për drejtë me Modernizimin që dërgojnë në performancë në kushtet e inovacionit që kushtimisht ndërlidhë performancën ekonomike, që do të thotë produktivitet. Elementet shtesë në praktikat e resurseve humane sipas fig.2 kanë një ndërveprim të drejtë për drejtë në raport me inovacionin dhe raport të zhdrejtë me produktivitetin, e cila shprehet në praktik të gjenerimit të profitabilitetit ekonomik të ndërmarrjes e cila praktikon këto ndryshime në resurse humane të saj. Kjo na ofron argumente të mjaftueshme se ndryshimi në delegimin e përgjegjësive si element i praktikës shtesë të ndryshimit, implementon politikat inovative të menaxhmentit dhe në koordinim me politikat relevante inovative ecën edhe resurset humane e cila në raste ku nuk ekzistojnë marrëveshje të fshehta për marrjen e kontrollit ndikojnë pozitivisht në profitabilitet që njëherit është edhe synim i qdo korporate për ta realizuar si qëllim.

**Qendra e trajnimeve KEK.**

Në një Korporatë si KeK, ku natyra nuk fal dhe burimet janë të pakta, nevoja për një sistem të fuqishëm gatishmërie te fuqisë punëtore profesionale nuk mund të respondoj mjaftueshëm. ( World Health Organization Regional Office for Europe, 2013)

Humbje të konsiderueshme njerëzore dhe ekonomike do të vazhdojnë të ndodhin nëse Korporata nuk ndermerr hapa që kapaciteti aktual i kufizuar njerëzor midis niveleve të ndryshme të profesionistëve të përfshirë në departamente të caktuar nuk vihet në përdorim të gjerë të fuqisë punëtore (United Nations Development Programme Disaster Risk Management Programme and Swiss Agency for Development & Cooperation, 2006). Qendra e trajnimeve është hapi i parë në një rrugë të gjatë për të transformuar, rimodeluar dhe zhvilluar përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e emergjencave, strukturave dhe funksioneve.

Andaj, Krijimi i departamentit apo sektorit te trajnimit Brenda kompanisë ishte nevojë imediate dhe emergjente, sikurse kompletimi i kabineteve me pajisje për trajnimin e stafit të ri është themeli drejt formësimit, ngritjes së resurseve dhe përfitimeve me qëndrueshmëri afatgjate.

*“ Si ditë zyrtare e fillimit të punës së Qendrës së Trajnimit merret data 23 maj 2005. Ndërtimi i Qendrës së Trajnimit e po ashtu pajisja e zyrave, laboratorëve dhe punëtorive është financuar nga burimet vetanake të KEK-ut dhe Agjencioni Evropian për Rindërtim. Themelimi i Qendrës së Trajnimit ka lindur si nevojë për aftësimin e punëtorëve të KEK-ut për një kualifikim plotësues nga pikëpamja praktike orientuese dhe inovative me qëllim që të kontribuojë në kualifikimin e personelit të kompanisë”* (kek-energy.com, 2005)

Qendra e Trajnimit e KEK e themeluar në vitin 2005 ka të organizuar trajnimin nëpër programe të trajnimit dhe atë bazuar në nevojat e trajnimeve është e ndarë në:[89]

Programi për Mekanikë.
Programi për Elektrikë.
Programi për Saldim
Programi për Teknologji Informative
Programi për sigurin në punë, dhe
Programi për Administrim dhe Menaxhim.

Ndarja e tillë është bërë në bazë të kërkesave nga njësit gjeneruese të departamenteve dhe organizimi i tyre bëhet në menyre periodike dhe ad-hoc sipas nevojave, në mënyrë që stafi menaxhues të bëj planifikimin e dergimit të stafit të tyre sipas nevojave dhe në anën tjetër mos të ketë mungesë në implementimin e kërkesave ditore të punës.

Kjo qendër trajnuese aktivitetet e saj i menaxhon me SMC (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë), sipas standardeve të përcaktuara të dokumentimit ISO 9001:2015, të hierarkisë së dokumentimit sipas standardit për Menaxhimin e Cilësisë -MC 4220 të Manualit të cilësisë.[90]

**Efektet e trajnimeve në performancën e Korporatës KEK**

Studimet e përfitimeve të zhvillimit të fuqisë punëtore për organizatat kanë supozuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis strategjisë së trajnimit dhe rezultateve të performancës: të mësuarit, ndryshimi i sjelljes dhe përmirësimi i performancës (Santos, A. and Stuart, M, 2003). Ndikimi i praktikave në vendin e punës dhe përvojat e punonjësve për efektivitetin e trajnimit kanë marrë jo pak vëmendje (Deloitte Haskins and Sells, 1989).

Ky punim analizon strategjitë e manxhimit të cilësisë për të nxjerrë konkluzione se sa efektiv është trajnimi dhe eksploron ndikimin e trajnimeve në performancën e Korporatës. Përfitimet që një punonjës merr nga trajnimi dhe zhvillimi përfshijnë “përdorimin efikas të aftësive dhe aftësive për kryerjen e detyrave të lidhura me punën” (Chiaburu, D. S., & Tekleab, A. G, 2005), ndërsa përfitimi për punëdhënësin dhe/ose organizatën varion nga “rritja e mbajtja, reduktimi i aksidenteve në punë, rritja e fleksibilitetit të punës dhe qëndrimet e ndryshuara drejt organizatës” (Al-Emadi, M. A. S., & Marquardt, M. J., 2007)

Korporata KEK përballet çdo ditë me ndikimin në uljen e performancës së kompanisë si rezultat i mos menaxhimit të situatave me risk. Faktorët më të rrezikshëm në kompani që shkaktojnë humbje dhe de-stabilizim në prodhim janë faktorët e pa zbuluar – të paidentifikuar. Gjendjet shpërthyese në kompani lindin si pasojë e mos menaxhimit të riskut dhe faktorëve të pa zbuluar që ndihmojnë që risku të ngritet në nivel të pa menaxhueshëm. Faktorët e pa zbuluar në kompani përveç që shkaktojnë humbje, ata janë edhe barrierë për mbikëqyrje dhe kontrollë financiare në kompani.

Andaj, Për te ofruar një pasqyrë se si ndikon aftësimi profesional i kuadrove në zvogëlimin e lëndimeve në punë,

---

[89] http://kek-energy.com/kek/qendra-e-trajnimit/menaxhimi-i-cilesise-ne-qendren-e-trajnimit/ , shikuar më 05.12.2021

[90] ibidem

kemi të dhënat bazë nga një studim në Divizionin e prodhimit të qymyrit në KEK.

| Raporti i lëndimeve në DPQ[91]-në për vitet: | | | | | | | | 2007-2020 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Vit/Muaj | Jan | Shk. | Mar. | Pr. | Maj. | Qer. | Korr. | Gush | Sht. | Tet. | Nën. | Dhje. | Total |
| 2007 | 26 | 26 | 30 | 20 | 25 | 30 | 27 | 20 | 30 | 18 | 17 | 20 | 289 |
| 2008 | 20 | 28 | 24 | 17 | 17 | 17 | 14 | 14 | 4 | 10 | 15 | 17 | 197 |
| 2009 | 16 | 21 | 10 | 12 | 20 | 11 | 14 | 18 | 11 | 14 | 9 | 9 | 165 |
| 2010 | 14 | 6 | 10 | 10 | 11 | 6 | 7 | 11 | 7 | 8 | 5 | 7 | 102 |
| 2011 | 8 | 4 | 8 | 12 | 6 | 12 | 11 | 7 | 6 | 9 | 8 | 6 | 97 |
| 2012 | 8 | 6 | 13 | 6 | 6 | 10 | 8 | 9 | 9 | 8 | 10 | 7 | 100 |
| 2013 | 10 | 14 | 6 | 7 | 9 | 9 | 7 | 10 | 12 | 3 | 13 | 4 | 104 |
| 2014 | 12 | 5 | 4 | 5 | 5 | 1 | 1 | 4 | 8 | 8 | 4 | 7 | 64 |
| 2015 | 4 | 7 | 7 | 2 | 2 | 2 | 2 | 3 | 9 | 2 | 1 | 1 | 42 |
| 2016 | 2 | 5 | 2 | 3 | 4 | 3 | 3 | 2 | 2 | 6 | 6 | 6 | 44 |
| 2017 | 3 | 0 | 1 | 4 | 1 | 2 | 0 | 3 | 1 | 2 | 0 | 1 | 18 |
| 2018 | 2 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 3 | 3 | 2 | 3 | 2 | 18 |
| 2019 | 2 | 1 | 2 | 0 | 1 | 0 | 4 | 3 | 0 | 1 | 1 | 2 | 17 |
| 2020 | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 |
| *TOTAL* | 129 | 123 | 119 | 99 | 107 | 104 | 99 | 109 | 102 | 91 | 92 | 89 | 1263 |

Burimi: Mbledhja e të dhënave nga Autorët
Fig. 3 Grafikoni i lëndimeve në DPQ 2007-2020.

[91] DPQ- Divizioni i Prodhimit të Qymyrit, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës-KEK, i cili mesatarisht përbëhet nga 2400-2500 punonjës të ndarë në departamente. Qymyri është lënda kryesore djegëse për gjenerimin e energjisë elektrike në Termo-elektranat e KEK.




Siç mund të vërejmë nga të dhënat e grumbulluar ndër vite shihet qartë se ndikimi i trajnimeve në korporatën e KEK ka ndikuar që lëndimet në vendin e punës të ulen nga 289 punonjës ne vitin 2007 në vetëm 6 punonjës në vitin 2020, kjo situatë e vendos korporatën në nivelin e menaxhueshëm të performancës dhe humbjet financiare zvogëlohen, sepse korporata e ka obligim të kujdeset për punëtoret e vet dhe familjet e tyre në rast se familjari i tyre lëndohet në vendin e punës.

Kjo situatë është marr shumë seriozisht nga menaxhmenti dhe veprimet ditore të ndikimit të trajnimeve vërehen edhe përgjatë komunikimit të detyrave dhe përgjegjësive që i kemi qdo ditë me punëtorët tanë, e në anën tjetër performanca e korporatës varet kryesisht në implementimin e detyrave ditore të punonjësve dhe shëndetit të ambientit në punë, kur dihet se divizioni i prodhimit të qymyrit është një vend pune me rrezikshmëri të lartë për shkak të shembjeve të vazhdueshme të qymyrit nga nivelet më të larta në paisje dhe operator. Mu për këtë KEK ka krijuar standarde operative dhe rregullatore të operimit duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar ose zvogëluar në minimum rreziqet për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve sipas standardeve dhe rregulloreve në puneë.

Koprorata, ka detyrimin të krijoj kushte, ambient të sigurt, të kujdeset që i punësuari të mos rrezikohet nga devijimi i standardeve për përfitime materiale personale. Të punësuarve duhet të ju ofrohen shërbime, kushte higjienike, hapësirat punuese të mirëmbahen në mënyrë të tillë që punonjësit të mund të kryejnë detyrat e caktuara pa rrezik për sigurinë dhe shëndetin e tyre ose të personave të tjerë si dhe te mjeteve që operojnë (punojnë).

Në vijim ju sjellim disa nga dëmet që i shkaktohen si pasoj e vjetërsimit të paisjeve dhe përdorimit jo adekuat sipas standardeve të operimit.





**Fig 11.** Dëme të mëdha materiale nga devijimi i standardeve dhe mos respektim i rregulloreve. **Burimi:** Foto në Korporatën KEK 2017-2020

Shih për këtë korporata KEK ka të standardizuar rregulloren e kontraktimit të ndërsjellë në:

Detyrimet që ka kompania ndaj punëmarrëseve.

Detyrimet që ka i punesuari ndaj kompanisë.

Detyrimi kryesor i kompanisë mbetet respektimi i përpiktë i masave të sigurimit teknik dhe higjeno-sanitar, me qëllim që të mbrohet jeta dhe shëndeti i te punësuarve si dhe sigurimi i pagave sipas vijueshmërisë dhe angazhimit. Punëdhënësi duhet t'u shpjegojë punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve, domosdoshmërinë e zbatimit të masave të sigurimit teknik dhe higjienës. Të investoj në sigurimin e pajisjeve mbrojtëse për punëmarrësit dhe pajisjet në punë ti bëj të afta me qëllim të mos jen burim i rreziqeve dhe fatkeqësive. Për shkeljen e legjislacionit të punës, të rregullave të sigurimit teknik dhe higjieno-sanitar, subjekti mund të ngarkohet edhe me përgjegjësi penale. Mos zbatueshmëria e standardeve të cekura reflektojnë në ulje të performancës së kompanisë.

Të punësuarit i është besuar një pasuri apo pajisje për të manipuluar në mënyrë të drejt nga ana e kompanisë pajisje ato që i punësuari përmes tyre përfiton të mira materiale për familje dhe standard jetësorë. Shumë ndërmarrje dhe kompani falimentojnë si rezultat i mos manipulimit si duhet me pajisjet në punë dhe mos respektimit të standardeve dhe rregulloreve që kompania i bën obligative për të punësuarit e saj.

Punëtoret të cilet në punë apo lidhur me punën me qëllim apo nga pakujdesia i kanë shkaktuar dëm ndërmarrjes, institucionit apo punëdhënësit, ata janë të obliguar që të raportojnë për dëmet e shkaktuara. Nëse dëmet e shkaktuara nga të punësuarit janë me kosto më të lartë se përfitimet e kompanisë, atëherë kompania rrugëton drejt falimentimit.

Rastet e punëtorëve problematik në kompani duhet të izolohen dhe të trajtohen sipas rregullave në fuqi. Veprimet dhe devijimet e punëtorëve nga standardet dhe rregullat e caktuara nga punëdhënësi, duhet të sanksionohen dhe parandalohen pasi kompanisë i shkaktohen humbje nga veprimet e tilla.

Në fund duke analizuar ndërlidhjen e efekteve të trajnimit dhe prformancës së korporatës mund të themi se ka një ndikim te drejtëpërdrejtë sepse menaxhimi efikas i fuqisë punëtore lidhet drejtpërdrejtë me fuqinë prodhuese të korporatës e që njëherit dhe fuqisë gjeneruese financiare të saj.

**Konkluzione**

Trajnimet në korporata përdorën për të përmirësuar performancën dhe për të rritur efikasitetin në punë, përderisa KEK me departamentin e trajnimit siç e elaboruam në këtë punim e përdorë për të ulur rrezikun në punë dhe për të rritur shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese të qymyrit, dhe energjisë elektrike.

Inkorporimi i punonjëseve siç u pa është duke ndodhur edhe pse ka disa pika të cilat duhet përmirësuar, por duke analizuar moshën, aftësitë në përdorimin e teknologjive prodhuese dhe informative të punonjësve dhe situatën socio-ekonomike të tyre shpesh-here KEK adapton nivelet e trajnimeve me synim të rris pjesëmarrjen, mos të rrezikoj prodhimin dhe njëkohësisht të minimizoj punonjësit refuzues të cilët për arsye të ndryshme nuk marrin pjesë në trajnime.

Menaxhimi me resurse njerëzore në KEK u pa se është jo i lehtë dhe strukturimi në nivel të menaxhimit të ekipeve i'u mundëson atyre të shpërndajnë njohurit e marra nga trajnimet dhe vendosja në punë e këtyre aftësive për ekipin që ata

përfaqësojnë, ku rol te madh në përpilimin, aplikimin dhe implementimin e tyre luan aftësia e buxhetimit të trajnimeve që kalojnë kapacitetet e brendshme të korporatës dhe angazhimin e trajnimeve nga ekspertë të jashtëm të fushës së interesit.

Departamenti i trajnimit në KEK, edhe pse ka kapacitete trajnuese në ambientet e saj, për shkak të buxhetit shpesh-herë nuk arrin të simuloj trajnime të duhura për nivele të caktuara operatoresh dhe qasja në trajnime në bazë të nevojës shpesh-herë nuk i paraprinë nevojës së preventives në punë të caktuara por reagimit në rastin e shfaqjes së saj.

Humbjet që i shkaktohen KEK-u për shkak te paaftësisë së punonjësve për të operuar me kapacitete prodhuese dhe teknologjinë në operim, ndodhin për arsye të shumta por që nuk po mund të dokumentohen nga departamenti i trajnimeve që të përdorin si argument për të absorbuar më shumë fonde në aplikim të trajnimeve në fusha të caktuara, por që fokusi i tyre është aktivizimi i marrjes së përgjegjësive për rastet e caktuara që ndodhin nga rreziku në punë, e që me ketë rast ky rol nuk i atribuohet departamentit të trajnimeve por ai shpërndahet në departamentet e kontrollës dhe shfrytëzimit të kapaciteteve tekniko-teknologjike të korporatës.

U vërejtë se Korporata KEK përballet çdo ditë me ndikimin në uljen e performancës së kompanisë si rezultat i mos menaxhimit të situatave me risk. Andaj, identifikimi i faktorëve të rrezikshëm në kompani që shkaktojnë humbje dhe de-stabilizim në prodhim janë faktorët e pa zbuluar – të paidentifikuar.

Nga punimi gjithashtu u vërejt se gjendjet shpërthyese në kompani lindin si pasojë e mos menaxhimit të riskut dhe faktorëve të pa zbuluar që ndihmojnë që risku të ngritët në nivel të pa menaxhueshëm. Andaj, siç u identifikua përgjatë punimit se faktorët e pa zbuluar në kompani përveç që shkaktojnë humbje, ata janë edhe barrierë për mbikëqyrje dhe kontrollë financiare në kompani.

Në fund, punimi ka arritur te analizoj ndërlidhjen e efekteve të trajnimit dhe performancës së korporatës nga e cila mund të themi se trajnimi ndikon drejtpërdrejtë sepse siç u pa menaxhimi efikas i fuqisë punëtore lidhet drejtpërdrejtë me fuqinë prodhuese të korporatës e që njeherit edhe me fuqinë gjeneruese financiare të saj.

**Rekomandime**

Për te përmirësuar ambientin e punës dhe rritur performancën e korporatës ne rekomandojmë që:

Të shfrytëzohen kapacitetet trajnuese të Korporatës për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin organizativ.

Të organizohen trajnime në cilësi dhe rritja e punës ekipore ndër funksionale dhe shtrirjes.

Orientimi dhe fokusi i departamentit të trajnimit të jetë në fokus të drejtimit drejt rezultateve të korporatës që ndihmojnë në përmbushjen ose tejkalimin e objektivave te performancës së korporatës.

Të ushtrohet funksioni i departamentit të trajnimeve në Përmirësimin e probabilitetit drejt realizimit të projekteve sipas buxhetit, sipas planit dhe brenda fushëveprimit

Të arrihet qëllimi që të Zvogëlohet rreziku dhe kapërcimi i pengesave për projektet më të rëndësishme

Tërhiqni dhe ruani talentet me cilësi të lartë duke ofruar mundësi zhvillimi profesional.

Departamenti i trajnimit duhet te ketë qasje dhe feedback në matjen e rezultateve të trajnimeve që ndërlidhen me ekipet menaxhuese në korporatë.

Duhet të formohet në kuadër të departamentit të trajnimeve seksioni për Inovacion i cili hulumton dhe përpilon praktikat më të mira në korporatë që të synoj rritjen e performancës.

Manualet trajnuese të jenë te qas’shme nga punonjësit në kohe reale dhe të jenë sa me afër ambientit punues.

**Bibliografia**

World Health Organization Regional Office for Europe. (2013, September). Assessment of health-system crisis preparedness – Kosovo. *WHO Regional Office for Europe.*

Al-Emadi, M. A. S., & Marquardt, M. J. (2007). Relationship between employees‟ beliefs regarding training benefits and employees‟ organizational commitment in a petroleum company in the State of Qatar. *International Journal of Training and Development, 11 (1),* 49-70.

Alvarez, K., Salas, E., & Garofano, C.M. (2004). An integrated model of training evaluation and effectiveness. *Human Resource Development Review 3*.

Bates, S. (2004). Getting Engaged. *HR Magazine*, pp. 44-51.

Chiaburu, D. S., & Tekleab, A. G. (2005). Individual and contextual influences on multiple dimensions of training effectiveness. *Journal of European Industrial Training, 29(8)*, 604-626.

Cleland A, M. W. (2008). *Engagement, Assertiveness and Business Performance – A New Perspective.* Ixia

Consultancy Ltd.
Deloitte Haskins and Sells. (1989). *Training in Britain: A study of Funding, Activity and Attitudes ± Employer's Activities.* London: HMSO.
Gallup. (2006). Engaged employees inspire company innovation: national survey finds that passionate workers are most likely to drive organisations forward. *The Gallup Management Journal*, 27-65.
kek-energy.com. (2005). *http://kek-energy.com/kek/qendra-e-trajnimit/*. Retrieved from www.kek-energy.com.
King, S.B., King M., & Rothwell, W.J. (2001). The complete guide to training delivery: a competency based approach. *American Management Association.* New York.
Langelaan S, Bakker AB, van Doornen LJP, Schaufeli WB. (2006). Burnout and work engagement: Do individual differences make a difference? *Personality and Individual Differences 40*, 521-532. Retrieved from wwww.sciencedirect.com:
https://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.599.6547&rep=rep1&type=pdf
Laursen, K. Foss, N. (2003). New human resource management practices and the impact on Innovation Performance. *Cambridge Journal of Economics*, 243-261.
Levinson, E. (2007, 05). *Developing High Employee Engagement Makes Good Business Sense.* Retrieved from www.interactionassociates.com.
Mani, V. (2010). Evaluating effectiveness of executive training. *International Bulletin of Business Administration 9.*, 201-909.
Pfau, B., & Kay, I. (2002). HR playing the training game and losing. *HR Magazine, 47(8)*, 49-54.
Robinson D, H. H. (2007). Engagement: The Continuing Story. Institute for Employment Studies.
Santos, A. and Stuart, M. (2003). Employee perceptions and their influence on training effectiveness. *Human Resource Management Journal, Vol 13 No 1*, 27-45.
Soldati, P. (2007, 08 03). *www.managementissues.com/2007/3/8/opinion/employee-engagement-what-exactly-is-it.asp*. Retrieved from www.managementissues.com.
Sundarajan S. (2007). PERCEIVED EFFECTIVENESS OF TRAINING AND DEVELOPMENT IN STC. *Indian Journal of Training and Development xxxvii No.3*, 64-71.
Syla, B. and Lecaj, V. (2016). nderveprimi ne mes menaxhimit te resurseve Humane dhe ndryshimeve ne Biznes . Rep. of Kosova: umyos.org.
Thang, N., Quang, T., & Buyens, D. (. (2010). The relationship between training and firm performance: A literature review. *Research and Practice in HRM*, 18-27.
United Nations Development Programme Disaster Risk Management Programme and Swiss Agency for Development & Cooperation. (2006, May). Mission Disaster Response Preparedness in Kosovo.
Werner, J.M., & DeSimone, R.L. (2006). Human Resource Development. *Human Resource Development (4th ed.).*, 121-245.

# Strategjia e Marketingut në Ndërmarrjen " Sharrcem" Hani i Elezit

**Prof. Asst. Dr. Fari Bushi**
Universiteti i Shkencave të Aplikuara –Ferizaj

**Abstrakt**
Duke e ditur se marketingu është orientim afarist që identifikon nevojat, dëshirat e kërkesat e konsumatorëve, përkëtësisht proces i interesimit të njerëzve për produktin ose shërbimin e ndërmarrjes, atëherë qëllimi i ndërmarrjes është të përshtatë këtë afarizëm në plotësimin e këtyre nevojave. Në këtë kontekst marketingu bën hulumtimin kërkimin dhe studimin e tregut dhe është bashkëpjesëmarrës në marrjen e vendimeve për krijimin e produkteve dhe shërbimeve që janë të pranueshme për treg. Nëpërmjet ketij punimi kemi vënë në zbatim njohuritë teorike dhe zhvillimin e procesit të marketingut të produktit të çimentos nëpër sfidat e zhvillimit të këtij produkti si proces përgjegjës për identifikimin, parashikimin dhe plotësimin e kërkesave dhe nevojave të konsumatoreve.

Fjalë kyqe: *marketing, konsumator, produkt, sukses, treg, ndërmarrje*

**Hyrje**
Në Kosovë është vetëm një prodhues vendor për prodhimin e çimentos. Ajo është një ndërmarrje me traditë në prodhimtarinë e prodhimeve të çimentos me reputacion dhe performancë të lartë falë një plani të qartë dhe marketingut që i sjellë kompanisë përfitime të prekshme financiare duke pasur identitet të qartë në treg, klient të përhershëm dhe biznes të vazhdueshëm**.** Marketingu si proces ekonomik është ndërmjetesues që lidh prodhimin dhe konsumin duke mundësuar që produktet dhe shërbimet t'u destinohen konsumatorëve, ndërsa informacionet rreth nevojave dhe kërkesave t'u shkojnë prodhuesve. Ndërmarrja nëpërmjet marketingut e bën identifikimin e nevojave dhe të kërkesave, i analizon dhe i ndjekë ato deri në përmbushjen e tyre. Marketingu ka ndikimin e vet jo vetem në sferën e përmbushjes së kërkesave të konsumatorëve, por gjithsesi edhe në realizimin e objektivave të ndërmarrjes. Po kështu edhe ndërmarrjes që iu kemi qasur në këtë punim për prodhimin e çimentos ka bërë të mundur rritjen e produkteve duke u shoqëruar me praktikat e marketingut që ka quar në suksese të mëtutjeshme përmes performancës së produkteve e shërbimeve për të përfituar tregun, kënaqësinë e konsumatorit dhe ruatjen e konsumatorëve. Ndaj duke e kuptuar tregun si një matës të suksesit është e rëndësishme që për departamentin e shitjes dhe marketingut të ndërmarrjes të kuptohet pjesa më e madhe e tregut si stabilitet më i madh i markës në treg si dhe përfitueshmëri më e madhe.

**Marketingu si nocion**

Termi marketing përdoret shpesh në jetën e përditshme. Ai është kuptim më i gjerë se shitja dhe reklama, ngase i përket të gjitha aspekteve të një biznesi, përfshirë zhvillimin e produktit, metodat e shpërndarjes, shitjet dhe reklamat. Marketingu është çelësi i suksesit të çdo ndërmarrjeje. Suksesi i marketingut matet me shkallën që ky funksion i siguron ndërmarrjes mundesine që t'i njoh nevojat, dëshirat dhe kërkesën e konsumatorëve. (Rexha & Rashidi, 1998). Menaxhimi i marketingut është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për suksesin e ndëmarrjes dhe pa funksionimin e këtij sektori çdo organizatë është e determinuar të dështojë. Marketingu lidhë konsumatorin, klientin dhe publikun me tregtarin përmes informacionit. Marketingu duhet të kuptohet si aktivitet me qëllim të gjetjes së tregut të konsumatorëve për të përgatitur produkte dhe shërbime me çmime të volitshme, shpërndarje të përshtatshme dhe komunikim të vazhdushëm me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve. Mund të bëjmë dallimin midis një përkufizimi social dhe atij menaxherial për marketing. Sipas një përkufizimi social, marketingu është një proces shoqëror me të cilin individët dhe grupet marrin atë që kanë nevojë dhe duan nëpërmjet krijimit, ofrimit dhe shkëmbimit të produkteve dhe shërbimeve me vlerë lirisht me të tjerët. (Kotler, 2002).
Sipas konceptit të marketingut, në fokusin e të gjitha angazhimeve të ndërmarrjes është tregu, përkatësisht konsumatori. Ndërmarrja nuk do të jetë e suksesshme në biznesin e vet, nëse paraprakisht nuk i kryen punët hulumtuese, kërkimore-studimore për tregun dhe konsumatorin.

Aktivitetet fillestare të marketingut kanë të bëjnë me hulumtimin dhe kërkimet e tregut, identifikimin e konkurrencës dhe gjetjen e konsumatorëve. Pra koncepti i marketingut është orientim i tillë afarist i cili niset nga parimi se detyra kryesore e ndërmarrjes është identifikimi i nevojave, i dëshirave dhe i kërkesave të konsumatorëve dhe ndërmarrja ia përshtat afarizmin mënyrës me efikase të kënaqjes së nevojave te konsumatorëve.

### Historiku i Ndërmarrjes Sharrcem

Para disa decenieve pikërisht me 1936 e ndërtuar nga një grup akcionaresh privat filloi të punojë fabrika e parë e çimentos në Kosovë me lokacion në Han të Elezit. Ajo ishte uzina e tretë e Çimentos në ish –Jugosllavi dhe njëherit uzina e parë që është ngritur nga kapitali i vendit pas luftës së parë botërore. Kjo ndërmarrje ishte e karakterit akcionar. Në përcaktimin e lokacionit të objekteve ekonomike atë kohë, ka vendosur faktori ushtarako-strategjik. Ndërtimi i kësaj uzine filloi qysh me 1934, kurse prodhimit ia filloi në vitin 1936. Realizimi i investimeve është bërë nga kapitali i vendit.[92]

Si fabrikë e vetme me emrin Lepenci ajo ka luajtur rol të rëndësishëm në ndërtimin jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Çimentorja "Lepenci" në Han të Elezit është radhitur një ndër ndërmarrjet më të rëndësishme në vend. Ajo gëzonte një formë të lartë në lëmin e industrisë. Ndërmarrja në fjalë në vitin 1936 punësonte gjithsej 5 punëtorë profesional me kualifikim të lartë dhe rreth 150 punëtorë të pakualifikuar sezonal. Duke u nisur nga arsyeshmëria dhe interesi ekonomik, gjatë periudhës 1968-1972 bëhet zgjerimi i kapacitetit prodhues, ndërtohet fabrika e re për prodhimin e Çimentos Pc-35 prej 450 ton klinker në ditë. Ndërtimi i objektit të ri për prodhimin e çimentos 1500 ton klinker në ditë filloi ne vitin 1975, kurse u inaugurua në vitin 1980 kapaciteti i të cilit ishte 525,000 tonelata çimento në vit. Kjo Organizatë u bë Organizatë e Punës së Bashkuar me emrin" Çimentorja" në kuadër të Organizatës Punuese "Sharr".

Fabrika e Çimentos " Sharr" me emër të ri "Sharrcem" në Han të Elezit është bërë anëtare e Holder Bankës sipas Marrëveshjes për komercializim( me qira) nga data 15.06.2000, pra hyri në familjen e madhe të Holcimit e cila përmbante me shumë se 114 fabrika ne botë.

Në shkurt 2010 Sharrcem është privatizuar dhe operon nga TITAN Group. TITAN Group është një prodhues i pavaraur multi rajonal i Çimentos dhe materialeve tjera të lidhura me ndërtimin me seli në Greqi me një histori të rritjes së vazhdueshme, duke e zgjeruar prodhimin dhe operacionet e shpërndarjes në 12 vende të botës, me të punësuar 5900 njerëz. TITAN Group merr Sharrcemin dhe lanson një program ambicioz modernizimi për plotësimin e standardeve ndërkombëtare ne cilësi, teknologji dhe mbrojtje mjedisi[93].

### Investimet e Përgjithshme

Në Kosovë është vetëm një prodhues vendor i Çimentos i cili trashëgoi një gjendje kaotike nga lufta, mirëpo që nga viti 2000 e deri më sot, arriti të investojë më shumë se 30 milion Euro në paisje të reja per shtimin e kapaciteteve prodhuese, të cilat janë evidente në mënyrë që t'i plotësojë diku rreth 60% të nevojave të tregut kosovar.

### Kapacitet e mundshme

Sharrcemi me kapacitetet prodhuese prej 600,000 ton në vit është kompani e vetme për prodhimin e çimentos në Kosovë e cila bën përpjekje të vazhdueshme për të ngritur informimin për llojet e produkteve dhe shërbimeve të saj. Sharrcemi është në proces të fokusimit në blerës dhe në aksion të vazhdueshëm në segmentimin e blerësve për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave dhe dëshirave të tyre. Për shkak të kapacitetit të mundshëm të prodhimit e kërkesës së madhe të tregut të brendshëm, Sharrcem nuk bën përpjekje të mëdha për tregjet e rajonit.

### Konkurenca

Siç e kemi shprehur në Kosovë ekziston vetëm një prodhues i çimetos "Sharrcem". Sharcemi prodhimete veta i shet kryesisht në mënyrë direkte dhe nëpërmjet shitësve me shumicë dhe zë vendin e parë nga 50,55 % me sasi prej

---

[92] Monografia me rastin e pesëdhjetvjetorit të themelimit të fabrikës së Çimentos ne Han të Elezit ; Vecer Maribor 1986, faqe 9.

[93] Përgjegjësia Shoqërore e Korporatës ( CSR) dhe Qëndrueshmëria; Raport 2012, faqe 6.

600,000 ton në vit në tregun kosovar, për arsye të performancës së lartë në treg, besnikëria e markave të produkteve dhe furnizimi stabil i blerësve me të gjitha llojet e produkteve te veta. Blerësit që kanë kontratë iu lejohet forma kredituese prej përqindjes së sasisë, pranohet çdo reklamacion eventual, afërsia që luan një rol shumë domethënës në treg etj.

Sipas indexit Sharrcemi radhitet si kompani e parë prej ndërmarrjeve tjera që konkurojnë në treg.

**Produktet e konkurentëve**

Produktet e çimentos që janë prezente në tregun e Kosovës:

**Usje nga Maqedonia -** vazhdimisht bën përpjekje të mëdha për t'u futur edhe më tepër në treg nëpërmjet agjentëve të vet dhe me çmim më të ulët.

**Popovc -** Çimetorja nga Popovci është e kufizuar për shkak të largësisë dhe konkurencës së çmimit.

**Kosjeriq** - nuk ka vlerë të lartë sa i përket kualitetit, prandaj është fare pak në treg.

**Fushë Krujë-nga Shqipëria** - me hapjen e autostradës ka filluar të jetë dukshëm në tregun tonë falë çmimit të ulët konkurues dhe zë vendin e dytë.

**Cola cem nga Italia -** me hapjen e autostradës nga Italia importohet çimetorja 42,5 rinfuz nëpërmjet trajekteve e cila deponohet në Shqipëri dhe ka filluar të jetë dukshëm edhe në tregun ton falë çmimit shumë të ulët konkurues.

**Objektivat e Marketingut**

Për të diferencuar veten nga konkurentët e tjerë Sharrcemi paraqet propozimet e saja unike të shitjes së produkteve në të gjitha zonat dhe më gjerë ku përfshihet shitja, marketingu, prodhimi.

Sharrcem do të fokusohet në shitjen më të madhe të prodhimeve të veta, rritjen e pjesës së tregut, numrin e klientëve të rinjë të shtuar dhe ngritjen sipas ndikimit në treg.

**Objektivat e shitjes dhe marketingut**

Sharrcemi produktet e veta i ka përcaktuar në ofrues të zgjidhjeve, që ka për qëllim të aplikojë strategji që të mundësoj vlerën e bazuar në çmim.

**Objektivat e tregut**

Sharrcem është i fokusuar mjaft mirë në tregun vendor të Kosovës, njëherit ka arritë të gjej plasman edhe për eksport në pjesën Jugore të Malit të Zi dhe në Shqipëri.

**Prioritetet e Marketingut**

Implementimi i performancave të shitjes në të gjitha segmentet e biznesit dhe ndryshimet e çmimeve nga kostoja në bazën e arritjes së vlerësuar është prioritet i marketingut në Sharrcem. Ndërtimi i reputacionit të ofruesit të zgjidhjeve në fushën e produkteve speciale nëse kërkohet në treg, pastaj konsumatorëve t'u ndihmohet për të bërë zgjidhjen e drejtë me rastin e blerejs së prodhimeve të Sharrcem me qëllim të shfrytëzimit optimal të veçorive të produkteve të çimentos.

**Kënaqësia e konsumatorit**

Sharrcem ka bërë të mundur rritjen e produkteve duke e shoqëruar me praktikat e marketingut që kanë quar në sukseset e mëtutjeshme përmes performancës së produkteve, shërbimeve, duke përfituar pjesën e tregut, kënaqesinë e konsumatorit dhe ruajtjen e konsumatorëve. Një produkt që është i lansuar apo është i pranishëm me mbi 50% siç është Çimentoja e Sharrcemit është një forcë që duhet të merret parasysh te çmimet konkuruese, promocionet, besnikëria ndaj markave të produkteve që janë të njohura për cilësi në tërë rajonin e Kosovës, por edhe jashtë.

Kënaqësia e konsumatorit si përfshirje e tërësishme është e vështirë për të kuptuar, pasi këto janë gjëra që s'mund të kontrollohen dhe as të preken, por Sharrcem i kushton vëmendje të rëndësishme kësaj pjese duke kujtuar se suksesi vjen pikërisht nga arritja e këtij treguesi, pasi kënaqësia e konsumatorit shfaqet dhe vlerësohet nga ndjenjat që kanë konsumatorët për markën e produkteve, se ata janë të kënaqur me çmimet, me cilësinë e produktit, shërbimet e mira dhe besnikërinë e ndërsjellë ne mes vete.

**Fokusimi tek konsumatoret**

Marka paraqet një premtim sepse, ajo ka vlerë të mirë, por gjithnjë duke pyetur konsumatorët se sa janë të kënaqur

me produktet e Sharrcemit dhe me këtë arrijnë konkluzion se blerësit njohin mirë produktet e Sharrcemit, por gjithnjë duke iu përmbajtur kritereve të dozimit sipas standardeve të parapara siç janë: çimentoja, uji, rëra, si dhe masat tjera në përputhshmëri me rregullat teknike, për çdo klasë të betonit gjatë aplikimit. Shitja dhe marketingu në realizimin e kërkesave të blerësve, duke iu afruar cilësi dhe shërbime të mira në treg, blerësit këtë e tregojnë më së miri në intervistat mujore që bëjnë nëpërmjet buletinit të Sharrcemit, vizitat e përditshme, takimet e rregullta me blerësit, si me prodhuesit e betonit, poashtu edhe me pronarët e depove të materialit ndërtimor që furnizohen me çimento në thasë, gjë që ata vlerësojnë lart bashkëpunimin e ndërsjellë si në furnizim, poashtu edhe në shërbimet e ofruara sic janë: kualiteti i mirë i prodhimeve, siguria në furnizime, sasitë në rritje, produkte të reja, ngarkimi i shpejtë, çmimi i garantuar, konkurentët në treg, aplikimi i rabatit dhe diskonti, shërbime të mira gjatë hyrje-daljes, informacione nëpërmjet botimit të broshurave për secilin produkt, hulumtimi i tregut permanent etj. Këto dëshmojnë se slogani i Sharrcemit ”*I mbajmë premtimet*” nuk është vetëm porosi, por është vepër dhe vazhdimësi e punës së përditshme, duke bërë përpjekje maksimale në ofrimin e zgjidhjeve për kërkesat dhe nevojat që ata kanë.

**Aplikimi i marketingut mix**

Sharrcemi ka pozitë të fortë në segmentimin e të gjitha llojeve të produkteve të veta. Ai dëshiron të pozicionoj veten si ofrues i zgjidhjeve dhe të forcojë marrëdhëniet sikurse deri tani me blerës. Performanca shitëse do t'i mundësojë Sharrcemit të aplikojë çmimin bazuar në vlerë.

**Marketingu mix**

Aplikimi i marketingut mix duhet të përshtatet për të arritur objektivat e shitjes dhe marketingut. Marketingu mix shoqëron këto dimensione siç janë: produkti, çmimi, vendi, promocioni.

**Produktet**

Sipas (En 197-1, 2000). Çimentoja paraqet njërin prej materialeve më të rëndësishme dhe më së shumti të shfytëzuar në ndërtimtari. Në Sharrcem prodhohen çimentot të cilat shenohen me shenjat vijuese :

**Cement IV/ B-M 32.5 N, PRAKTIKE-** që aplikohet me rastin e ndërtimit të objekteve individuale të banimit dhe afariste me më pak hapësirë dhe kate.

**Cement II/ B-M 42.5N, UNIVERSALE** –aplikohet në rastet kur kemi të bëjmë me betonin e markave më të larta siç janë – beton rrugor të klasëve (rrugë, autostrada, punime industriale, banesore, ura ) etj.

**Cement I /52.5N, FORCA**- aplikohet për ndërtime të shpejta, epërsi me rastin e ndërtimit gjatë ditëve të ftohta në ura, vijadukte, pista të aeroporteve, ndërtime për banim, afariste etj.

**Sharrmall** - i cili përdoret për llaq për murim, llaq për suvatim të brendshëm dhe të jashtëm[94].

Sharrcemi, nuk do të ndryshoj portfolion prodhuese deri sa nuk ndryshon kërkesa e tregut, por duke i ndjekur trendet e tregut do të fokusohet në ofrimin e zgjidhjeve për blërësit .

Produkti i refuzit është duke u rritur dukshëm dita-ditës, prandaj i kushtohet rëndësi e veçantë, sepse në këtë mënyrë do të rritet shitja dhe pozicionimi më i mirë në treg në mënyrë që të zvogëlohet dukshëm konkurenca nga importi.

**Çmimi**

Sharrcemi do të dëshiroj të dallohet me çmim shpërblyes. Çmimi mesatar i produkteve të Sharrcemit është 1ton = 72.00 Euro. Sharrcem ka pasur sukses që gjithnjë të prijë me çmime duke qenë sa më afër blerësit si dhe duke zbatuar marketing aktiv përmes prezencës së përhershme në treg të ekipit të shitjes dhe marketingut, në mënyrë që të ketë njohuri të larta mbi zhvillimet në treg dhe blerësit në përgjithësi. Aplikimi i konsultantëve, përcakton përfitimet e krijuara të blerësve përmes dhënies së zgjidhjeve. Sharrcem akcent kryesor gjatë veprimtarisë së saj në kuadr të Shërbimit të shitjes dhe marketingut përveç se i kushtohet kualitetit të mirë, sigurisë në furnizim, sasisë në rritje, produkteve në rritje, poashtu një vëmendje të veçantë i kushton çmimit konkurent në treg, duke aplikuar rabat sasior

[94] Udhezues praktik Doracak “ Si te ndertoni me Sharrcem “ faqe 4.

si dhe diskonte te kohëpaskohshme.

**Vendi**

Sharrcemi koncentrohet në shitjen personale, për t'i ofruar blerësve produktet e veta në mënyrë direkte, për zgjidhje rreth aplikimit final të çimentos. Sharrcemi me kujdes të madh monitoron kompanitë e produkteve të çimentos që vijnë nga importi, në mënyrë që ta mbroj volumin.

Sharrcemi nuk ka linjë te transportit, por as te kontraktuar, shumica e blerësve kanë transport vetanak apo të kontraktuar. Sa i perket nivelit te shërbimeve ajo eshtë siguruar përmes bashkepunimit të ngushtë me partnerët afarist. Aplikimi i pyetësorit për verejtjet dhe sygjerimet gjatë ngarkimit si dhe sygjerime tjera që produkti të arrijë në vendin e duhur është berë sipas sygjerimeve, nevojave dhe kërkesave të blerësve.

**Promocioni**

Promocioni do te jetë efikas, nëse edhe aktivitetet tjera të marketingut ( produkti, çmimi, distribuimi) i kryejnë në menyrë efikase detyrat e veta. Nëse produkti me atributet e veta nuk i përgjigjet kritereve të tregut.( çmimi i larte, kanalet e distribuimit joefikas) atëherë promocioni nuk mund ta luajë rolin e vet ne afarizmin e ndermarrjes (Rexha & Rashidi, 1998).

Duke e ditur se promocioni është proces i komunikimit ndërmjet ndërmarrjes dhe blerësve, si dhe informimi dhe komunikimi jane çështje shumë të rëndësishme, Sharrcem ndërmerr të gjitha aktivitetet për të arritur cakun e duhur nëpërmjet këtij komunikimi. Të gjitha mesazhet fokusohen në drejtim të ofruesit të zgjidhjeve si:

Marrdhënia me marketing
Marketingu direkt
Fushata dhe promovime të shitjes
Publikime dhe dokumentacione të shitjes
Panaire dhe ekspozita
Marrdhëniet me publik
Sponsorimet etj.

Ky shërbim është gjithnje prezent te blerësit e vet me vizitat direkte gati të përditshme, kontaktet telefonike si dhe të gjitha format tjera të komunikimit elektronik me të gjitha strukturat e blerësve te vet si: prodhuesit e betonit, prodhuesit e elementeve të betonit, depot e materialit e kur ipet mundësia edhe deri te konsumatori i fundit të cilët i furnizon Sharrcem me të gjitha llojet e prodhimeve si: çimento refuz, çimento në thasë dhe sharrrmall.

Pjesëmarrja në panaire të ndryshme, seminare të organizuara nga institucione të ndryshme vendore e ndërkombatare, bashkëpunimi i ngushtë me Odën Ekonomike të Kosovës, Odën ekonomike amerikane, Odën Ekonomike rajonale ne Ferizaj, Asociacionet e ndrysjhme siç jane AKB ( Alenaca Kosovare e Biznesit, ), AKPB ( Asociacioni Kosovar i Prodhuesve te Betonit), takimet e rregulllta me blerës në fundvit, forume të ndryshme të shitjes e marketingut, reklamat në TV, radio, gazetat, buletini mujor informativ për rrjedhat e prodhimit, faqja e internetit etj.

## Konkluzione

Duke e bërë trajtimin e kësaj teme kemi ardhur në përfundim se aplikimi i vazhdueshëm i standardeve më të larta për përmbushjen e kënaqësive të konsumatorit nëpërmjet inovacioneve në prodhim dhe shërbime duke siguruar pozicion të fortë konkurues nëpërmjet dizajneve kreative të produkteve dhe operimeve të shkelqyeshme, janë aktivitetete, përkatësisht shërbime që lancohen në treg nga ana e Sharrcem, gjë që e bëjnë një ndërmarrje shumë të suksesshme.

Sharrcem bën përpjekje për të pozicionuar veten si ofrues i zgjidhjeve në mënyrë që të forcoj marrëdhëniet me blerësit përmes ofrimit të solucioneve. Ndërtimi i reputacionit të ofruesit të zgjidhjeve në fushën e produkteve, prezantime të rregullta dhe promovime lidhur me produktet, implementimit të çmimeve në bazë të vlerës, menaxhimi mbi kënaqjen më të mirë të blerësit, dizajnit në thas me shumë të dhanuna të markës së produkteve etj. bëhen me qëllim të shfytëzimit optimal të veçorive të çimentove në Sharrcem.

## Bibliografia

Boris, T.  (1995), *Istraživanje marketinga,* Fabulas ABC, Sarajevo: 411 str.
Havolli, Y. (2001). *Afarizmi Komercial*. Prishtinë.
Kotler, P. (2002). *Marketing Management, Millenium Edition* (10th Edition). Pearson Custom Publishing.
Livoreka, R.  (2011). *Kërkim Marketingu.* Prishtinë
Monografia me rastin e pesëdhjetëvjetorit të themeleimit të Fabrikës së Çimentos në Han të Elezit, (1986). Maribor..
Përgjegjësia Shoqërore e Korporatës ( CSR) dhe Qëndrueshmëria, (2012). Sharrcem TITAN Group Raport.
Rexha, N & Reshidi, N, (1998). *Bazat e Marketingut*. Prishtinë.
Rexha, N. (1982). *Marketingu*. Prishtinë.
Sharrcem SH.P.K. Hani i Elezit, Shërbimi i Marketingut.
Udhëzues Praktik: Si të ndërtoni me Sharrcem. Doracak, Sharrcem. TITAN Group.

# Albanian Health Care system during pandemic SARS- CoV 2.

**MD. Emirjeta Kuniqi**
**Dr. Enis Uruci**

Lector in the University "Aleksander Moisiu", Durres, Albania.
Faculty of Professional Studies, Department of Technical Medical Science.
E-mail: emirjetakuniqi@gmail.com
Email: enisuruci@gmail.com

**Aims and objectives:** With this manuscript we represent how pandemic of SARS CoV- 2 affected Albanian Health care system.

**Background:** As worldwide also Albanian Health Care system was affected by global pandemic of SARS CoV-2 COVID 19 infection.

World Health organization (WHO) announce that the transmition was spread worldwide as a pandemic infection.

During March-June period the Health care service was obtained only by specialized medical centers like QSUT,"Mother Teresa"University Hospital and Lung diseases University Hospital
"Shefqet Ndroqi".

Regional Hospital public or private service and also dental care service was suspended.

But there are patients with Nontransmisional diseases NTD that are affected and need care, avocations or treatment of these conditions.

So Cardiovascular disease has decreased the hospitalization 70 % during year 2020 compared with that period during 2019 that was 140 % hospitalized patients.

Also Oncologic diseases were decreased during pandemic period.

**Methodology:** We analyzed public data like INSTAT, MSHMS, WHO, ISHP that has publicized as orders, Strategies and guidelines of treatment and prevention of SARS CoV- 2 COVID 19 infection.

**Results:** As worldwide pandemic of SARS CoV 2 affected also Albanian Health care service.

Non-communicable diseases was undertreated and " forgotten" by global pandemic of COVID 19 infection. Hospitalization of NTD, Oncological diseases tumors, then diseases were decreased.

But the complication of these diseases are nursery, so they need more budget. We also know that was a bad management of public Health Care budget that affected more the low outcomes of our country, which will increase sudden death or complications, low quality of life patients.

**Conclusions:** SARS CoV- 2 affected also Albanian Health care service and patients lives. Changed the budget and investments in Health care system.

Worsen the NTD, oncological diseases, and complications of post Covid 19 patients.

Human resource of medical specialties also increased.

**Recommendations:** Regional Strategies of prevention, treatment and management are needed according to global pandemic.

Public budget and investments of Health care system must increase.

Human resource also must increase the number of students admitted at medical studies.

Hospital must increase the number of Hospital bed/hospitalizations.

**Key words:** pandemic, SARS CoV- 2, COVID 19, health care service, Albanian.

**Introduction;** COVID-19 pandemic caused the most serious health crisis across the world, in the last 100 years.

**Globally**, as of **5:04pm CEST, 30 March 2022**, there have been **483,556,595 confirmed cases** of COVID-19, including **6,132,461 deaths**, reported to WHO. As of **27 March 2022**, a total of **11,054,362,790 vaccine doses** have been administered.

In **Albania**, from **3 January 2020** to **5:04pm CEST, 30 March 2022**, there have been **273,529 confirmed cases** of COVID-19 with **3,492 deaths**, reported to WHO. As of **13 March 2022**, a total of **2,764,839 vaccine doses** have been

administered.

In this framework, both the size of risk for public health and the measures for disease control have been extraordinary in Albania. It should also be highlighted the importance of pandemic effects in health services. Some of the specifics of SARS-Cov-2 virus circulation in the community, as well as some of the consequences in health care systems have remained poorly described.
The pandemic severely affected or even disrupted the chain of services for non-communicable diseases such as diagnose, treatment, rehabilitation and palliative related services. The pressure on health services is also expected to increase in the long run. The main reasons will be related to:
- increase of cases that could not be diagnosed during the pandemic;
- increase of cardiovascular and respiratory complications for persons who suffered COVID-19 in long-term;
- depletion of the preventive chain of services for non-communicable diseases related to tobacco alcohol, unhealthy diet and physical inactivity, may translate into an increase in future cases.

The future will also bring other emergencies and it remains a priority for non-communicable disease services to continue functionating, despite the changing political drive of the situation.
Assessing and evaluating the health care policies offered to Albanian population in the coming years is important, especially concerning the management of the category of chronically ill in any other cases similar to the situation caused by Sars-Cov 2 virus.

The COVID- 19 pandemic we are experiencing learned us useful lessons and reflections on
issues faced during the COVID-19 pandemic;
chronically ill as a risk group;
implementing the recommendations of the Global Health Summit to promote access of the society to health, fostering accountability at the highest levels of government in achieving better preparedness, prevention, detection and response;
considering WHO appeal to be prepared for possible pandemics and epidemics that could accompany humanity in the years to come.
Non-communicable diseases or non-communicable diseases are the leading causes in the world today of deaths, ill health and disability in most countries. They kill 41 million people each year, accounting for 71% of global deaths, including 15 million people who die before time from cardiovascular disease, diabetes, cancer or chronic respiratory diseases between the ages of 30 and 69.
Over 85% of premature deaths from non-chronic diseases occur in income countries
low and medium.
EMERGENCIES
Emergencies according to the United Nations are events or incidents that require actions that are usually urgent and often not routine. Emergencies are caused by natural hazards (such such as earthquakes, cyclones, forest fires, floods, heat waves and droughts), epidemics and pandemics, diseases, transport accidents, fires, chemical, radiological leaks, etc., uncertainty food, conflicts and situations associated with mass gatherings.
**Global crisis caused by the covid-19 pandemic and situation in Albania.**
The COVID-19 pandemic during the period 2020-2021 has caused the biggest crisis world health of the last 100 years. Even in Albania, as the dimensions of health risk public, as well as disease control measures, have been extraordinary. Also to important are considered to be the effects of the pandemic on health services.
Part of the specifics of the SARS-Cov-2 virus circulation in the community, as well as part of
consequences in health care systems, have still remained well-described. In this report brings facts and experiences on the effects of emergency on related health services with non-communicable diseases and propose a plan of measures for follow-up care health in the field of non-communicable diseases in emergency conditions.

Community circulation of SARS-COV-2 virus in Albania, as in most European countries
Eastern, started relatively later than in most Western European countries. This has allowing a high effectiveness of public (non-pharmaceutical) health measures during the first wave of pandemic in the spring of 2020. It is estimated that for each day postponement of circulation community virus, about 30 deaths per 1 million inhabitants have been prevented.

The real serious consequences of the pandemic were felt in Albania in the second half of 2020,
especially in October-December, during the second wave of COVID-19. As well as in a part of
countries of Eastern Europe, even in Albania the indicators of the pandemic during this period were similar or higher than in most Western European countries. Real level I infections, measured through a seroprevalence study, is estimated to be over 10 times more high compared to diagnosed cases.

In this period the circulation of the virus has been more intense in Tirana and in some big cities in west of the country, while at the end of the first quarter of 2021 it is noticed that the report of cases new with active cases was higher in some smaller cities like Gjirokastra or Berat.

In the spring of 2021, at the end of the third wave, Albania was among the first countries in Europe with moderate or low risk. In an epidemiological analysis it is estimated that the real level of infections in April 2021 was about 2 times higher than the diagnosed case indicators.

Meanwhile, at the time of preparing this report, late summer and early fall of 2021.

The pandemic has continued in Albania with high intensity.

The consequences of the pandemic and emergency conditions have been felt in other systems as well health, including non-communicable disease control programs. Program national basic health control was discontinued for more than a year.

Also, cancer screening programs were discontinued for several months and, despite the resumption of them, reductions of 30-40% of service usage indicators have been observed.

The workload of health care services remains high with case management suspected with COVID-19 (including rapid tests) and vaccination campaign.

With the resumption of the check-up program in September, the challenges for care services have increased primary health for related reasons:

with the increase in the number of visits
with the competition of health priorities (acute and chronic pathology)
with the special needs of service organization to avoid contacts and reduce risk for nosocomial infections.

While new variants of the virus have pushed it in time and done with complex control final of the pandemic, it remains imperative to follow with intensity the campaigns of vaccination and long-term preparation of the health system for acute and chronic disease of associated with SARS-Cov-2 infection. It is also important that they are supported services in the field of non-communicable disease control to reach as soon as possible indicators of pre-pandemic use.

**Methodology;**

This report aims to assess the consequences of the emergency caused by the COVID-2019 pandemic in health services for non-communicable diseases and propose a plan with priority. This document can help to supplement an important component in started process of preparation of the new National Program of non-communicable diseases 2021-2030.

A systematic review of international assessments of the consequences of pandemic in non-communicable disease services; WHO and other organizations in the United Nations has conducted rapid assessments and operational reports in this area.Meanwhile there are several earlier publications in the literature that analyze the needs and principles of adaptation of services for non-communicable diseases in the conditions of emergencies of various natures. 8 relevant documents were used for this purpose.

Data from health information systems were analyzed. Aggregate data on hospital admissions based on annual reports of public hospitals in Albania are provided and analyzed comparatively over time, to identify changes in the year pandemic 2020 compared to a year ago. Data on non-disease outbreaks transmissible are based on the international ICD9 disease system. Are provided and also analyze the operating data of screening programs related to the volume of examinations performed during the pandemic year from other countries regarding the pandemic and disruption of

services.
**Results and recomandation;** According to a study conducted by the WHO in May 2020, prevention and treatment services non-communicable diseases have been severely affected since the onset of the pandemic, causing reduction or complete restriction of access to treatment for hypertension, myocardial infarction, stroke cerebrovascular, cancer or diabetes, for many people.
Of the 163 countries included in the study, 122 of them or 75% reported interruptions or limitations of partial of at least one of the 8 services for 8 non-communicable diseases as a consequence of measures in response to the pandemic. Rehabilitation was the most affected service.
More than half of the countries (53%) reported partial outages or restrictions services for hypertension, 49% for the treatment of diabetes or complications of diabetes, 42% for cancer treatment and 31% for the treatment of cardiovascular emergencies. Degree of limitation of utility was related to the turnover level of COVID-19.
**Opinions in focus groups from service providers.**
The number of consultations and hospitalizations dropped significantly during the pandemic. This phenomenon may bring consequences in the future, leading to delays in the diagnosis of some diseases.
Family physicians continued to establish contact with patients through the Whatsapp platform for various medical advice or consultations.
Although a good solution in pandemic conditions, this practice has a tendency to be used more than is necessary even after the end of the infesting pandemic standards of medical visit and artificially avoid visits to the center.
The level of risk of becoming infected by doctors has been high. Many of the patients who went to health centers often did not show that they had signs of Covid infection.
Underline the challenge of clinical management of chronic multipathologies combined infection by COVID-19.
Inefficient organization in schedules and distribution of visits during the day, which creates influx incertain hours in the morning increasing the risk of infecting patients who present physically. During the afternoon or evening hours the influx of patients is much lower.
Many patients to avoid the risk or queue have used in addition as well private health services system.
It has often not been possible to maintain distance in the narrow corridors of polyclinics and health centers with outdated infrastructure.

**BIBLIOGRAPHY OF REVIEWED DOCUMENTS**

1. National Program on Prevention and Control of NCDs in Albania, 2016-2020
2. National Strategy for Development and Integration 2015-2020
3. Order of Minister of Health, date 07.08.2015, No. 163, on "Setting up a national committee for the prevention and control of chronic diseases"
4. National Health Strategy 2016-2020
5. National Strategy on Sexual and Reproductive Health 2017-2021
6. Government Program 2017-2021
7. Guideline for the follow-up of cases based on findings of Basic Medical Check-Up for citizens age 35-70 years old
8. Country programme document for Albania 2017-2021, UNPFA
9. Decision of Council of Ministers on the approval of the package of health services, in primary public health care, financed by compulsory health insurance fund, 2019
10. Decision of Council of Ministers on list of reimbursable drugs, 2019
11. Decision of Council of Ministers on financing of hospital health services from the CHCIF, 2019
12. Decision of Council of Ministers on determination of categories of insured individuals excluded from direct payments of health services, 2016

13. Model set of documents for accreditation of health centers, Ministry of Health and Social Protection, HAP. 2018
14. Decision of Council of Ministers on determining the format and manner of data collection and reporting by public and private health care service providers, 2014
15. Law on Health Care, updated in 2019
16. Plan of monitoring NCDs and progress in their control in Albania (framework indicators and their metadata), 2017
17. Inventory of existing protocols on non-communicable diseases and elderly people care for family medicine in Albania, 2019
18. Annual reports of Compulsory Health Care Insurance Fund
19. Primary Health Care in Albania. Comprehensive assessment. WHO. 2018
20. National food and nutrition action plan 2013-2020
21. National health promotion action plan 2017-2021
22. Political document of the strategy for the prevention and reduction of alcohol related harms in Albania 2017-2021
23. Demographic and health challenges facing Albania in the 21st century 2020
24. Country programme document for Albania 2017-2021, UNDP
25. Programme of cooperation for sustainable development 2017-2021, Progress Report 2019
26. Clinical guidelines for prevention, diagnosis and control of several chronic diseases (for cardiovascular diseases, diabetes, hypertension, cancer, chronic pulmonary disease including asthma, mental conditions, elderly people, etc.), were updated in 2019
27. Primary Health Care Strategy 2020-2025
27. Guidance of the Minister of Health and Social Welfare no. 499 date 02/07/2019 on patronage and bonus systems; binding contracts for new specialists to work in districts outside the capital for free training
28. NCDs report, Institute of Public Health. 2018
29. 2019 NCD country capacity assessment for Albania, WHO

# Efektet e përdorimit të ditarit elektronik krahas ditarit manual në SHML

**MSc. Brikenë Elshani-Sejdiu**
brikena.elshani@gmail.com
ShFMU "Hasan Prishtina" Prishtinë, Kosovë
**MSc. Matej Bushi**
matejbushi@hotmail.com
ShML "Kadri Kusari" Gjakovë, Kosovë
**MSc. Islam Sejdiu**
islam.sejdiu11@gmail.com
ShFMU "Hasan Prishtina" Prishtinë, Kosovë
**Ma. Egzon Nezaj**
egzon-nezaj@hotmail.com
ShFMU "Ukshin Miftari" Gjakovë, Kosovë

**Abstrakti**
Studimi kishte për qëllim që të eksplorojë situatën aktuale të përdorimit të ditarit elektronik nga mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme.
Qëllimi i studimit ishte të zbulojmë se sa përdoret ditari elektronik nga mësimdhënësit dhe
nxënësit e klasave X-XII, për të lehtësuar punën e të dy palëve dhe për të arritur rezultate më të mira në të nxënit e diturive të ndryshme, cilat ishin sfidat e mësimdhënësve rreth qasjes në ditarin elektronik, vështirësitë që hasën gjatë kalimit nga ditari manual në ditarin elektronik, efektet e përdorimit të ditarit elektronik si dhe arsyjet e mësimdhënësve që ende punojnë me ditar manual.
Hulumtimi është bazuar në metoda sasiore dhe cilësore.
Hulumtimi u realizua në Komunën e Prishtinës në shkollat "7 Shtatori" dhe "Mileniumi i Tretë", si dhe në Komunën e Shtimës, në shkollat "Naim Frashëri" dhe "Shkolla e Mesme Profesionale".
Pjesëmarrës në hulumtim ishin 200 nxënës të klasave të X-XII, 20 mësimdhënës të këtyre
klasave si dhe 20 prindër të këtyre nxënësve qe iu kanë nënshtruar pyetësorit. Si instrument matës është përdorur pyetësori për nxënës dhe mësimdhënës si dhe intervista për prindër.
Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se një numër i mjaftueshëm përdorin ditar elektronik dhe janë shumë të kënaqur me përdorimin e DE. Sa i përket rezultateve nga nxënësit shihet se kanë preferuar përdorimin e ditarit elektronik dhe ka ndikuar pozitivisht pasi që rezultatet e tyre mësimore janë më të larta.
Përmes analizës korrelative kemi hulumtuar ekzistencën e lidhjes midis përdorimit të ditarit elektronik, efektet e DE dhe arritjen e rezultateve mësimore te nxënësit. Sipas rezultateve të arritura, analiza korrelative tregon për një lidhje pozitive dhe të dukshme në mes përdorimit të ditarit elektronik dhe rezultateve mësimore.
**Fjalët kyçe:** *Ditari, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, rezultatet.*

HYRJE

Përdorimi i TIK-ut ka lehtësuar jetën në ditët e sotme dhe tani zë vend të rëndësishëm në fushën e edukimit. Në bazë të hulumtimeve kam parë që disa studiues mendojnë se TIK-u po ndikon negativisht në edukimin e fëmijëve pasiqë ata po i kushtojnë më shumë rëndësi pajisjeve teknologjike sesa shkollës, por kjo nuk do të thotë që teknologjia është një armik i edukimit, përkundrazi ajo është shumë e dobishme, kuptohet nëse përdoret në masë dhe vend të duhur.
Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë ka imponuar gjithsesi nevojën për ndryshime në struktura të përshtatshme dhe organizuese të shkollës. Teknologjia është një koncept i gjerë që merret me aplikimin e njohurive për veglat dhe profesionet, në funksion të kontrollimit dhe përshtatjes së rrethanave në ambientin jetësor në përputhje me nevojat e tij. Teknologjia ka ndikuar në shoqëri në mënyra të ndryshme. Arsimi është njëra nga sferat më perspektive të jetës dhe çdo ndryshim që rritë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies pa dyshim është i mirëseardhur.
Me kalimin e kohës me avansimin e teknologjisë mësimdhënësve iu është lehtësuar puna si në pjesën e mësimdhënies

poashtu dhe në pjesën administrative, njëra ndër to është edhe krijimi i ditarit eletronik. Ditari elektronik është duke u zbatuar si një web aplikim i bazuar në infrastrukturë ekzistuese.
Ditari elektronik ka për qëllim ti ndihmoj mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit të shohin aktivitetet, mungesat, e-mësimin, rezultatet e nxënësve, komunikim mes të tri palëve dhe punët administrative të mësimdhënësve.
Duke marrë parasysh rëndësinë e ditarit elektronik në këtë hulumtim kemi trajtuar rëndësinë e përdorimit të ditarit elektronik që ju mundëson mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve të shohin aktivitetet, mungesat, e-mësimin, rezultatet e nxënësve, komunikim mes të tri palëve dhe punët administrative të mësimdhënësve në procesin edukativo-arsimor. Në bazë të këtij hulumtimi do të nxjerrim rezultatet se sa përdoret ditari elektronik në shkolla nga mësimdhënësit, prindërit, nxënësit, çfarë efekte sjellë përdorimi i ditarit elektronik, pse shumë shkolla nuk e kanë futur në përdorim ditarin elektronik, por vazhdojnë të punojnë me ditar manual.

**RISHIKIMI I LITERATURES**

Realizimi i këtij projekti ka rëndësi për ta shqyrtuar problematikën e interesimit të mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve për të përdorur ditarin elektronik.
Shqyrtimi i literaturës përqëndrohet në përdorimin e ditarit elektronik njëkohësisht dhe analizimin e përdorimit të ditarit elektronik krahas ditarit manual. Përmes kësaj analize evidentohen dhe sqarohen faktorët dhe rrethanat që ndikojnë në nivelin e aplikimit me efektivitet të ditarit elektronik krahas ditarit manual.
Vendosja e komunikimit efektiv mes mësuesve dhe prindërve është një nga gjashtë mënyrat që Epstein (2002) i rekomandon shkollave që duhet të kërkojnë për të përmirësuar përfshirjen e prindërve në shkollë e ato janë si vijon më poshtë:
Prindërimi;
Komunikimi;
Vullnetarizmi;
Mësoni në shtëpi;
Vendimmarrja; dhe
Bashkëpunimi me Komunitetin "(Epstein, 1995).
Nëse komunikimi nga shtëpia funksionon në mënyrë efektive, çon në zhvillimin e një bashkëpunimi partnerial midis prindit dhe mësuesit, i cili mund të jetë i rëndësishëm në mbështetjen e fëmijëve dhe në arritjen e rezultateve më të mira të mundshme të të nxënit (Beveridge, 2007; Ludicke & Kortman, 2012)
Komunikimi shtëpi-shkollë zhvillohet nëpërmjet një sërë metodash, duke përfshirë telefon, email, raporte dhe intervista ballë për ballë (Cameron & Lee, 1997; Kervin, 2005).
Një sistem komunikimi efektiv, komunikimi nga shtëpia mundëson që prindërit të marrin përditësime mbi përparimin e fëmijës së tyre dhe t'u ofrojë mundësi prindërve të bëhen të përfshirë në mësimin e fëmijës së tyre. Një sistem komunikimi shtëpi-shkollë që lehtëson angazhimin e prindërve në mësimin e fëmijës së tyre është i rëndësishëm, siç tregon hulumtimi angazhimi prindëror në mësimin e fëmijës ndikon pozitivisht në rezultatet e të mësuarit të fëmijës (Educational Research, 2012; Harris & Goodall, 2008; Zhang et al., 2011)
Përfshirja e prindërve është një pjesë e rëndësishme e shkollimit të një fëmije (Epstein, 1995); megjithatë, mësuesit dhe prindërit ndajnë pikëpamje të ndryshme për përfshirjen e prindërve (Todd, 2003). Përveç kësaj, shumë shkolla kanë ende për të gjetur zgjidhje të përsosur për një sistem komunikimi efektiv komunikimi mësues-prindër (Cucchiara & Horvat, 2009; Elbaum, 2014; Horvat, Curci, & Partlow, 2010).
Hulumtimet tregojnë se lidhjet e forta midis shtëpisë dhe shkollës mund të prodhojnë pozitivitet në rezultatet e fëmijëve (Beveridge, 2007; Ludicke & Kortman, 2012; Melhuish et al.2008; Ramirez, 2001); megjithatë, vendosja e komunikimit efektiv midis shtëpisë dhe shkollës vazhdon të jetë sfidë në shkolla (Cucchiara & Horvat, 2009; Elbaum, 2014; Horvat et al., 2010).
Siç është diskutuar më parë, për shkollat që përdorin ditar elektronik, ekziston mundësia që fëmija humb ose harron librin (Burrows, 2004; Cameron & Lee, 1997).
Kosaretskii dhe Chernyshova (2013) argumentojnë: "Është e njohur se metodat tradicionale të komunikimi midis prindërve, shkollave dhe personelit mësimor janë duke u bërë më pak efektive.
Hulumtimi i kryer mbi rolin e TIK-ut për të mbështetur lidhjen shtëpi-shkollë ka treguar rezultate të dobishme për

mësuesit, fëmijët dhe prindërit (Journal of Computer Assisted Learning, 2003; Grant, 2011; Kervin, 2005; Lewin & Luckin, 2010; Olmstead, 2013).

Si Lewin dhe Luckin (2010) thonë: "kur paraqitet, mbështetet dhe përdoret në mënyrë të përshtatshme, teknologjia mund të përmirësojë lidhjet mes mësimit në shtëpi dhe shkollë dhe mbyllin zbraztirat midis prindërve, mësuesve dhe nxënësve "(faqe 756). Deri në vitin 2003, studimi i kryer nga Departamenti i Arsimit të New South Wales ka gjetur më së shumti komunikime efektive shtëpi-shkollor në shkollat të cilat po përdorin TIK-un për të mbështetur këtë proces (NSW Department of Education and Training, 2003).

Formë tjetër e përdorimit të TIK për të mbështetur komunikimin në shtëpi-shkollë është edhe përdorimi i telefonave celularë, postës zanore, blogjeve, laptopëve dhe faqeve të internetit (Cameron & Lee, 1997; Grant, 2011; Lewin & Luckin, 2010).

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull përshkruhen në mënyrë të detajuar hapat e përdorur për realizimin e këtij punimi. Këtu përshkruhen: popullata e përzgjedhur, metoda e mbledhjes së të dhënave, instrumentet e përdorura, administrimin e tyre, çështjet etike të marra në konsideratë si dhe kufizimet e kërkimit.

Metodologjia e realizimit të këtij hulumtimi është bazuar në metoda sasiore dhe cilësore. Të dhënat do të mblidhen përmes pyetësorit për mësimdhënësit dhe nxënësit e klasave X-XII, kurse të dhënat për prindër do të mblidhen me anë të intervistës.

Për të kryer hulumtimin sesa mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit e përdorin ditarin elektronik për të arritur rezultate më të mira mësimore, janë përdorur këto metoda:

- Metoda e analizës teorike është përdorur për të shfletuar dhe analizuar literaturën aktuale, artikujt shkencor e profesional që në një mënyrë ose në tjetrën kanë qenë të lidhura me problemin e hulumtimit. Poashtu një rëndësi të veçantë do t'i kushtohet edhe hulumtimeve vendore që kanë të bëjnë në mënyre direkte me përdorimin e ditarit elektronik dhe ditarit manual.
- Metoda krahasuese - mundëson të bëjmë dallimet ekzistuese ndërmjet gjinisë si dhe dallimet ndërmjet vendbanimeve urbane dhe rurale.
- Metoda deskriptive mundëson të përshkruhen të dhënat e nxjerrura nga hulumtimi.
- Metoda statistikore mundëson të dhënat e grumbulluara të përpunohen, analizohen dhe interpretohen përmes programit SPSS.

### Popullacioni dhe mostra

Meqë numri i nxënësve në shkollat tona është i madh, dhe në pamundësi për t'i përfshirë të gjithë në hulumtim, u përcaktuam për një grup reprezentativ me qëllim dhe hulumtimi u realizua në komunën e Prishtinës dhe Shtimës, duke besuar se këto të dhëna nga hulumtimi do të jenë reprezentative edhe për rajonet e tjera të Kosovës. Sa i përket metodës së hulumtimit gjatë këtij studimi është përdorur metoda sasiore dhe cilësore ku të dhënat janë mbledhur me anë të pyetësorëve.

### Variablat

Si dizajn më i përshtatshëm për të shikuar ndikimin e një variabël të pavarur në variabël e varur dhe ndërveprimin e tyre.

**Variabli i pavarur** - *Në këtë rast si variabël e pavarur është përdorimi i ditarit elektronik,* **Variabli i varur** - *është rezultatet mësimore të nxënësve*.

### Instrumentet

Si instrument matës u përdor pyetësori për mësimdhënës dhe nxënës. Pyetësori për mësimdhënës përbëhet nga tri pjesë, përmbanë 16 pyetje ku pyetja e parë është pyetje demografike në të cilën kërkohet shkolla ku ligjërojnë, pjesa e dytë përfshinë 9 pyetje që kanë të bëjnë me përdorimin e ditarit elektronik, ku dhe kur e përdorin si dhe sa është lehtësues për ta, ndërsa 6 pyetjet e fundit kanë të bëjnë me motivimin e nxënësve, rezultatet mësimore, komunikimin me prindër dhe trajnimet që kanë ndjekur për përdorim të ditarit elektronik, si dhe pyetësori për nxënës i cili përmban dy pjesë. Pyetësori për nxënës përmbanë pyetjet demografike në të cilat kërkohet gjinia, shkolla qe janë, shkolla që ndjekin, ndërsa pjesa e dytë përfshinë identifikimin mbi ndikimin e përdorimit të ditarit elektronik në rezultatet mësimore të nxënësve. Pyetësori përmban 16-të pyetje ku 3 pyetje janë demografike, 11-të pyetje kanë të bëjnë me shprehin e punës mësimore, dëshirën dhe formën e punës mësimore, 2 pyetje kanë të bëjnë me përdorim të ditarit

elektronik dhe komunikim.
Karakteristikë e këtyre pyetësorëve është se pyetjet kanë qenë të qarta si dhe pyetësorët ishin anonim në mënyrë që nxënësit dhe mësimdhënësit të jenë më të lirë dhe më të sigurtë në plotësimin e tij.

**Pjesëmarrësit**

Në këtë hulumtim mostra ka qenë e qëllimshme e cila ka përfshirë 200 nxënës të klasave të X-ta-XII-ta, 60 mësimdhënës të këtyre klasave. Të dhënat parësore janë grumbulluar me anën e pyetësorëve të përpiluar për nxënësit dhe mësimdhënësit.

**Detyrat e hulumtimit janë:**

- Konstatimi i nivelit të përdorimit të ditarit elektronik krahas ditarit manual nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit;
- Njohja më e detajishme e zbatimit praktik të ditarit elektronik nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit;
- Dhënia e rekomandimeve për zbatim sa më të madhë të ditarit elektronik nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit;

**Pyetjet dhe hipoteza e hulumtimit**

Nga formulimi i mësipërm i qëllimit të hulumtimit rrjedhin pyetjet të cilat kanë ndihmuar në realizimin e hulumtimit dhe poashtu kam nxjerrë hipotezën nga e cila jemi nisur.

**Pyetjet e hulumtimit**

1. Në çfarë niveli zbatohet ditari elektronik nga ana e mësimdhënësve në SHML të Prishtinës dhe Shtimës?
2. Cilat janë efektet pozitive të përdorimit të ditarit elektronik krahas ditarit manual?
3. Cilat janë vështirësitë e mësimdhënësve në zbatueshmërinë e komunikimit në mes subjekteve të cilët e shfrytëzojnë ditarin elektronik?

**Hipoteza e hulumtimit është:**

*Përdorimi i ditarit elektronik lehtëson dhe avanson punën me nxënës, prindër dhe mësimdhënës.*

**Hipoteza me rezultat negativ**:

*Përdorimi i ditarit elektronik nuk lehtëson dhe nuk avanson punën me nxënës, prindër dhe mësimdhënës.*

**Procedura**

- Në fazën e parë të zbatimit të hulumtimit bisedova me drejtorët e shkollave të përzgjedhura dhe mora miratimin për të filluar aplikimin e hulumtimit me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të hulumtimit për mbledhjen e të dhënave.
- Në fazën e dytë shpërndava pyetësorët në klasat e X-XII, ku përmes pyetësorëve janë marrë të dhënat nga nxënësit për përdorimin e ditarit elektronik si dhe kur e përdorin, për çka e përdorin dhe rezultatet e tyre mësimore. Pyetësorët ishin të njëjtë për të gjithë nxënësit e katër shkollave të përzgjedhura.
- Në fazën e tretë të këtij hulumtimi analizova të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorëve dhe sistemimin e përgjigjeve në programin SPSS (Statistical Package for the Social Sciences), pastaj rezultatet e fituara i prezantova në mënyrë tabelare dhe grafike.

## ANALIZA E REZULTATEVE

Në vazhdim janë paraqitur përgjigjet e pjesëmarrësve në formë grafike dhe tabelare.
Pyetja demografike e pyetësorit për mësimdhënës.
Në tabelë është paraqitur numri i mësimdhënësve dhe shkollat në të cilat ligjërojnë. Nga shkolla e mesme “Naim Frashëri” në Shtime kemi 15 mësimdhënës, nga “Shkolla e mesme profesionale” në Shtime kemi 15 mësimdhënës, nga shkolla e mesme private “Mileniumi i tretë” në Prishtinë kemi 15 mësimdhënës, si dhe nga shkolla e mesme “7 Shtatori” poashtu kemi 15 mësimdhënës.

**Analizat përshkruese**

Grafikoni 1. Përqindja e mësimdhënësve se a e përdorin ditarin elektronik apo ditarin manual.




Grafikoni 2. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: A e përdorni ditarin elektronik gjatë orëve mësimore?




Grafikoni 3. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Pasi që ju e preferoni ditarin elektronik për ta përdorur për çfarë arsyje e përdorni më shumë?




Grafikoni 4. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Pasi qe ditari elektronik ka shume mundesi perdorimi, a e perdorni ditarin elektronik per te krijuar ndonje kuiz?




Grafikoni 5. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Bazuar në përvojën tuaj a duhet që të gjithë mësimdhënësit të përdorin ditarin elektronik në vend te ditarit manual?




Grafikoni 6. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Bazuar në përvojën tuaj të përdorimit të ditarit elektronik a është i sigurt përdorimi i ditarit elektronik?




Grafikoni 7. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: A ndikon përdorimi i ditarit elektronik në rezultatet e nxënësve?




Grafikoni 8. Përqindja e mësimdhënësve e përgjigjes në pyetjen: Me përdorimin e ditarit elektronik a është bërë më i lehtë komunikimi me prindër?




Grafikoni 9. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Sa e përdorin mësimdhënësit ditarin elektronik gjatë orëve

mësimore?




Grafikoni 10. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Sa e përdorni ditarin elektronik gjatë orës mësimore për të mësuar?




Grafikoni 11. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: A ju kanë mësuar mësimdhënësit tuaj se si ti shihni të dhënat tuaja mësimore në ditar elektronik?




Grafikoni 12. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen Çka ju lejohet të shikoni në ditar elektronik?




Grafikoni 13. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: : A keni mundësi që materialet mësimore ti shkarkoni dhe ti merrni për të mësuar?




Grafikoni 14. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Për çfarë arsyje e përdorni ditarin elektronik?




Grafikoni 15. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Përmes kujt kyqeni në ditar elektronik?




Grafikoni 16. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Si mendoni për qasjen e prindërve në ditar elektronik?




Grafikoni 17. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen Si mendoni a ndikon përdorimi i ditarit elektronik tek suksesi juaj?




Grafikoni 18. Paraqitja grafike e përgjigjes në pyetjen: Me përdorimin e ditarit elektronik a është bërë më i lehtë komunikimi me mësimdhënësit?




**DISKUTIMI**

Ky hulumtim u realizua për të elaboruar përdorimin e ditarit elektronik dhe ndikimin e tij, përkatësisht në suksesin e rezultateve mësimore.

Duke iu referuar pyetjeve hulumtuese, rezultatet e dala nga ky hulumtim tregojnë për rëndësinë dhe efektet e përdorimit të ditarit elektronik në procesin mësimor, po ashtu në ngritjen e cilësisë në të nxënit e nxënësve.

Pra, rezultatet e fituara nga ky hulumtim i përgjigjen të tri pyetjeve me përgjigje pozitive që tregojnë zbatimin e ditarit eletronik nga ana e mësimdhënësve dhe nxënësve, përdorimi i ditarit elektronik ka treguar sukses të mirë në rezultatet e të nxënit si dhe komunikimi në mes të subjekteve të cilët e shfrytëzojnë DE.

Dhe si rezultat i fituar nga klasat e përzgjedhura të cilat kanë shënuar ngritje në rezultatet e të nxënit si i tillë ka ardhur nga ndikimi i përdorimit të ditarit elektronik gjegjësisht pyetësorëve të plotësuar nga ana e nxënësve dhe mësimdhënësve.

Po ashtu ditari elektronik ka motivuar nxënësit që të mësojnë më shumë, rezultatet e fituara e dëshmojnë një gjë të tillë.

Hipoteza e këtij hulumtimi ishte:

**Përdorimi i ditarit elektronik lehtëson dhe avanson punën me nxënës, prindër dhe mësimdhënës.**

Nëse i referohemi hipotezës së këtij studimi, sipas kornizës teorike që është paraqitur më lartë, dhe sipas hulumtimeve të elaboruara në shqyrtimin e literaturës dhe rezultateve të këtij hulumtimi është pohuar se përdorimi i ditarit elektronik mund të ndikoj në rritjen e rezultateve të nxënësve dhe suksesit mësimor

Për të kuptuar rëndësinë e DITARIT ELEKTRONIK si dhe për të vërtetuar hipotezën e këtij hulumtimi ne kemi formuluar dy pyetësor me anë të të cilëve kemi vlerësuar efektet e përdorimit të DE në mësimdhënie dhe nxënie. Përveq se kemi fituar një rezultat të lartë nga përgjigjet e dhëna, ne kemi parë edhe një motivim më të mirë nga nxënësit në procesin mësimor. Poashtu interesimi për të përdorur DE është vërejtur edhe gjatë vëzhgimit të nxënësve në klasë të cilët kanë shprehur një interesim më të mire për të përdorur DE gjatë orës mësimore.

Duke i’u referuar rezultateve të fituara nga ky hulumtim dhe poashtu shqyrtimit të literaturës së ndryshme rreth problemit të ngritur në këtë temë, atëherë mund të themi se ditari elektronik lehtëson dhe avanson punën me nxënës, mësimdhënës, prindër si dhe rritë cilësinë në të nxënit e nxënësve.

Për dallim nga klasat që e përdorin ditarin elektronik, klasat ku e përdorin ditarin manual (fizik) na kanë sjellë një rezultat më të ulët në aspektet mësimore. Në klasat ku përdoret mënyra tradicionale dhe jo shfrytëzimi i teknologjisë informative kryesisht përdorimi i DE ka bërë që në këto klasë të kemi një rezultat më ulët në motivimin e nxënësve për të nxënë.

**KUFIZIME**

Realizimi i këtij studimi përmbanë disa kufizime që jemi në dijeni nga ana jonë të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë interpretimit të rezultateve. Popullata e targetuar është në dy shkolla të mesme të ulëta të Komunës së Shtimës dhe dy shkolla të mesme të ulëta të Prishtinës , duke lënë anash nxënësit e të njëjtës grupmoshë nga shkollat tjera të këtyre komunave dhe qyteteve tjera. Një tjetër kufizim i supozuar ka të bëjë me saktësinë e përgjigjeve të plotësuara

nga nxënësitë dhe mësimdhënësit. I bëmë të gjitha përpjekjet për të inkurajuar përgjigjet e ndershme nëpërmjet ruajtjes së privatësisë, por fakti që pyetësorët e nxënësve u kryen në klasë mund të ketë ndikuar në përgjigjet e tyre ose në dhënien e përgjigjeve "të dëshirueshme". Një kufizim tjetër lidhet me faktin e mungesës së studimeve të kësaj natyre në vendin tonë, e cila sjell pamundësinë e krahasimit të gjetjeve.

**REKOMANDIMET**

Ky hulumtim ka përfshirë një mostër relativisht të vogël, si i tillë nuk mund të gjeneralizoj rezultatet për një popullatë më të gjerë andaj hulumtimet tjera që do të mund të realizoheshin, do të mund të përfshinin numër më të madhë të pjesëmarrësve nga më shumë shkolla të mesme të ulëta/larta publike dhe private e poashtu në më shumë qytete të Kosovës. Megjithatë nga ky hulumtim kemi fituar një rezultat pozitiv mbi përdorimin e ditarit elektronik, me këtë rezultat të fituar rekomandoj që të gjitha shkollat, të gjithë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit të përdorin ditarin elektronik që t' lehtësohet puna dhe të arrihen rezultate sa më të larta në mësimnxënie.

**REFRENCAT BIBLIOGRAFIKE**


Anderson, T.(2008). The Theory and Practice of Online Learning, Second Edition. Canada.

Caka, N. (2006). *Metodologjite e mesimit elektronik.* Tirane.

Cardon, T. A. (2012). Teaching caregivers to implement video modeling imitation training via iPad for their children with autism. Research in Autism Spectrum Disorders,

Epstein, J.L. (1995). School/family/community partnerships: Caring for the children we share. Phi Delta Kappan, 76(9), 701-7012.

Grant, L. (2011). 'I'm a completely different person at home': Using digital technologies to connect learning between home and school. Journal of Computer Assisted Learning

Kosaretskii, S. G., & Chernyshova, D. V. (2013). Electronic communication between the school and the home. Russian Education and Society

Mexhuani, A. (2014). *Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie.* Prishtinë: IPK.

Mossley, D. D. (2013). *Open Educational Resources and Open.* Burrows, L. (2004). Compassionate communication with parents of children and young people with learning disabilities. Australian Journal of Learning Disabilities,

Musai, B. (2012). *Metodologjia e mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.

NSW Department of Education and Training. (2003). Time to teach: Time to learn. Retrieved from

OECD, O. F.-O. (2007). Giving Knowledge for Free - THE EMERGENCE OF OPEN EDUCATIONAL RESOURCES.

Woolfolk, A. (2011). Psikologji Edukimi. Tiranë: CDE.

Zhang, D., Hsu, H. Y., Kwok, O. M., Benz, M., & Bowman-Perrott, L. (2011). The impact of basic-level parent engagements on student achievement: Patterns associated with race/ethnicity and socioeconomic status (SES). Journal of Disability Policy Studies

# Përdorimi i teknologjisë digjitale në Shqipëri në proceset gjyqësore civile. Parashikimet, risitë dhe problematikat e evidentuara gjatë pandemisë Covid-19

**Dr. Idlir Duhanxhi**
*University of Shkodër "Luigj Gurakuqi", Albania, email:* duhanxhii@hotmail.com
**MSc. Mariglen Tanushi**
*"Studio Legale Çerekja", Tiranë, Albania, e-mail:* tanushimario@gmail.com

***Abstrakt***

Zhvillimi i teknologjisë kompjuterike, sidomos përhapja që pati pas viteve '90, është shoqëruar me aplikim në pjesën më të madhe të aktivitetit të shoqërisë, kjo për shkak të lehtësirave që mundëson kjo teknollogji. Një proces i tillë zhvillimor është shoqëruar me kërkesën për një rregullim normativ me një projeksion afat gjatë. Nga ky zhvillim i teknologjisë, për shkak dhe të lehtësirave që krijon, nuk "shpëtoi" as sistemi gjyqësor Shqiptar, i cili filloi të aplikonte pavarësisht një ritmi më të ngadaltë të zbatueshmërisë, shoqëruar kjo me ndryshime të rëndësishme në legjislacionin procedural *(penale, civile dhe administrative)*. Kështu, regjistrimi audio i seancave gjyqësore me mjete digjitale, komunikimi elektronik me palët ndërgjyqëse apo përfaqësuesit e tyre, marrja e dëshmisë me anë të video-konferencës *(gjykimet e padive me vlerë të vogël)* shihet si një mënyrë shumë më e shpejtë dhe e lehtë komunikimit në kuadër të proceseve gjyqësore dhe një lehtësim i punës të organeve gjyqësore por dhe një ndihmë e madhe në një vendimmarrje brenda afateve të arsyeshme. Ndryshimet në legjislacionin procedural, në aplikimin e teknologjisë digjitale në proceset gjyqësore, evidentohen aktualisht si instrument i qenësishëm i proceseve gjyqësore në tërësi dhe atyre civile në veçanti. Këtë do e ilustrojmë me dy momente të rëndësishme: ai i procesit të vetingut dhe periudha pandemike e Covid-19 që vijon akoma të kërcënoj shoqërinë në tërësi. *Së pari*, procesi i vetingut solli një mungesë të numrit të gjyqtarëve, sidomos në nivel të Gjykatave të Apelit, që po vihet re dhe në nivel të Gjykatave të Shkallës së Parë *(nuk duhet harruar as rasti i bllokimit të Gjykatës së Lartë)*. Kjo me pasojë, vonesa në gjykimin e çështjeve, dhe një ngarkesë të madhe të çështjeve që presin për gjykim. Një rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe përshpejtimin e gjykimeve në këtë rast, marrin mënyrat apo rrugët e komunikimit elektronik. *Së dyti*, periudha e pandemisë ishte një situatë e paparashikuar, me pasoja të bllokimit të aktivitetit, përfshirë dhe pezullimin e punës të gjykatave. Komunikimi elektronik mori një rëndësi të veçantë dhe solli një zgjidhje të pranueshme në disa vende të botës, sidomos në vendet me zhvillim të lartë të saj dhe me aksesueshmëri të kënaqshme në nivel popullate. Prandaj, aplikimi i këtij komunikimi hapi një mundësi të re për të ardhmen duke zënë një rol kyç dhe shumë të rëndësishëm në zhvillimin e gjykimeve në përgjithësi dhe civile në veçanti.

Të tilla eksperienca, kanë evidentuar jo vetëm kërkesën për rritjen e nivelit të aplikueshmërisë së teknologjisë digjitale në shumë sektorë, duke përfshirë dhe atë të drejtësisë, por dhe kërkesën për një zhvillim të mëtejshëm të infrastrukturës që e mundëson një gjë të tillë, për të minimizuar ato problematika që u vunë re. Pikërisht ky do jetë dhe fokusi dhe linjat e këtij punimi.

***Fjalë kyçe: Adresë elektronike, komunikim elektronik, sistem gjyqësor, shpallje në ueb, zhvillim teknologjik.***

### *NË VEND TË HYRJES!*

Që në kohët e hershme, mjetet dhe mënyrat e komunikimit kanë qenë baza e zhvillimit të një shoqërie. Mjetet e komunikimit ishin baza e kalimit të dijes nga njëri brez tek tjetri, mënyrë e cila në vazhdimësi ka pësuar ndryshime dhe përmirësim të vazhdueshëm. Njëkohësisht kalimi i informacionit nga shoqëria e një vendi në një shoqëri të një

vendi tjetër, ka qenë një prej mënyrave të zhvillimit shoqëror të tërësi. Që me shpikje si telefoni apo telegrafi u panë mundësi të reja komunikimi mes zonave apo individëve, në distanca të largëta gjeografike. Kjo tërhoqi interesin e shpikësve por dhe shumë investitorëve, të cilët panë një mundësi të re që lehtësonte komunikimin, duke sjellë zhvillim të mëtejshme të kësaj teknologjie. Kjo pasqyrohet më së miri në zhvillimin e dekadave të fundit në fushën e teknologjisë së komunikimit elektronik. Ky zhvillim erdhi si rezultat i zhvillimit paralel të një sërë sektorësh dhe nevojës së vazhdueshme të shoqërisë për të pasur kontakte dhe komunikim në kohë sa më të shpejtë të mundshme apo domosdoshmërinë e përcjelljes së informacionit në kohë reale. Duke filluar në vitet'90, bërja pjesë e jetës së përditshme e kompjuterit dhe personalizimi i tij *(siç njihet ndryshe kompjuteri personal),* ku çdo individ kishte mundësi të kishte një të tillë, u shoqëruar me nevojën për lidhjen mes tyre. Kjo lidhje ndërmjet tyre u realizua nëpërmjet rrjetit të internetit, që hapi shumë mundësi të reja në mundësimin e komunikimit të shpejtë ndërmjet individëve apo subjekteve të ndryshme tregtare të cilët arrinin të komunikonin shpejtë në kuadër të aktivitetit apo transaksioneve që ata kryenin me njëri-tjetrin. Kjo mënyrë komunikimi u shoqëruar nga një proces përmirësimi të vazhdueshëm dhe njëkohësisht zgjerimi të tij, duke evidentuar avantazhet e shumta që ajo sillte në jetën e përditshme. Zgjerimi i masës së përdoruesve të internetit, që aksesonin me pajisje që evoluonin dhe përmirësoheshin në mënyrë shumë të shpejtë, u shoqërua edhe me aplikimin e kësaj metode komunikimi në shumë sektorë. Lehtësirat që krijonte sistemi kompjuterik, duke marrë në konsideratë dhe zgjerimin e tij dhe format e ndryshme të komunikimeve elektronike që ofroheshin, u pa si një mundësi e mirë përdorimi nga subjektet kryesisht tregtare të cilat po hynin në erën digjitale të komunikimit. Nga shumë studiues kjo u pa si një mënyrë shumë e mirë komunikimi me shumë lehtësira edhe për sistemin e qeverisjes në tërësi dhe atë gjyqësor në veçanti. Kuptohet që, kjo qasje e re, kërkonte hapa jo të paktë në drejtim të ndërtimit të një infrastrukture të re mbështetëse, por dhe në drejtim të miratimit të një kuadri ligjor që e parashikon dhe përcakton mënyra të qarta të aplikimit të komunikimit elektronik. Edhe Shqipëria nuk pati *"mundësi zgjedhje"* veç përfshirjes dhe implementimit të komunikimeve elektronike. Kjo u pa në një sërë sektorësh publik, siç ishte prokurimi elektronik, duke e kaluar në një stad tjetër këtë mënyrë të prokuruarit të të mirave dhe shërbimeve, aplikimet për dokumente me funksione të ndryshme, gjithmonë në shërbim të publikut të gjerë, duke lehtësuar shumë kohën që investohej në pajisjen me të tillë dokumente. Këtu mund të përmendim, platformën e-albania e cila ofron një gamë jo të paktë të shërbimeve që deri dje ofroheshin pranë sporteleve të administratës dhe ku duhet të paraqiteshe fizikisht.

## 1. MBI IMPLEMENTIMIN E DERI TANISHËM TË TEKNOLOGJISË ELEKTRONIKE NË LEGJISLACIONIN PROCEDURAL.

Zgjerimi i shpejtë i teknologjisë elektronike të komunikimit (internetit), u pa si një mundësi e mirë zhvillimi edhe për sistemin gjyqësor. Kjo erdhi si produkt i një procesi disa vjeçar që kishte edhe kundërshtitë e veta. Por, lehtësirat që ai ofronte në aplikimin e tij në lehtësimin e gjykimeve në drejtim të kohës dhe mënyrës transparente të gjykimit. Në shumë procese gjyqësore, një nga problemet kryesore është komunikimi ndërmjet palëve të përfshira në gjykim, si dhe i vetë gjykatës si subjekt gjykues i mosmarrëveshjes. Komunikimi ndërmjet palëve shihet si domosdoshmëri për avancimin dhe arritjen e një vendimmarrje që zgjidh mosmarrëveshjen.[95]
Sa më sipër u përmend, aplikimi i teknologjisë elektronike kryesisht gjeti hapësirë në sektorin privat në mënyrë shumë

---

[95] Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 42 parashikon se:*"... Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë,..., ka të drejtën e një gjykimi... nga një gjykatë..."* por kjo duhet të realizohet edhe në respektim të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces. Pra, është një mënyrë të vepruari duke ngritur një pretendim për cënim të së drejtës, por që ky veprim dhe mënyra se si mund dhe duhet të sillet kjo palë, pala kundërshtare apo edhe vetë gjykata, aktet që duhet të nxirren në kuadër të këtij gjykimi, afatet kohore etj., parashikohen në normat procedurale civile, të *"renditura"* dhe të strukturuara në Kodin e Procedurës Civile. Prandaj, në një kuptim: *"...kodi i procedurës civile është ajo bashkësi normash në të cilat është përshkruar dhe disiplinuar i ashtuquajturi aktivitet "i procedimit" – apo procesi civil...ndërsa e drejta procedurale civile është ajo degë e shkencës të së drejtës që studion disiplinën në procesin civil, në përmbajtje të kësaj bashkësie normash juridike."*

të shpejtë. Nga ky proces nuk shpëtoi sektori publik, ku një prej këtyre sektorëve është dhe drejtësia, më konkretisht procedurat e ndjekura në gjykimin e çështjeve pranë gjykatave me theks në çështjet me karakter civil. Duke qenë një proces evolutiv, procesi i gjykimit të këtyre çështjeve, që zhvillohet kryesisht nëpërmjet komunikimeve, ku këto të fundit bëhen ndërmjet palëve të përfshira në proces, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Civile, kryesisht dhe në ligje të tjera të veçanta, ngrihen një sërë çështjesh të mundësisë së aplikimit të komunikimit elektronik. Respektimi i normave procedurale civile gjatë shqyrtimit gjyqësor, shihet gjithmonë i domosdoshëm për të siguruar atë që synohet: mbrojtjen e të drejtave subjektive të palëve nëpërmjet gjykimit në përputhje me përcaktimet normative të së drejtës procedurale civile, pa cënuar të drejtat themelore të individëve. Prandaj, zbatimi i asaj që parashikon e drejta objektive *(njohjen, mbrojtjen e të drejtave të subjekteve nga cenimet që mund tu bëhen nga të tjerë subjekte)* të mos mbetet thjesht një fiksion ligjor apo i pakuptimtë, duhet *"ndihma"* e mjeteve apo instrumentave ligjore procedurale, që kjo të bëhet e mundur, pra që palëve t'u mundësohet rivendosja e të drejtave apo interesave të cenuara. Pra, ligji procedural përfaqëson atë që mund të quhet ligji i mjeteve juridike *( Emery S. J., Edëards L. L., Edëards J. S., 2000)*
Pikërisht në këtë prizëm aplikimi i teknologjisë, pavarësisht lehtësirave që ofron, duhet të shihet me kujdes, pasi lidhet me procesin e vendimmarrjes së gjykatës që përcakton fatin e të drejtave të palëve në proces. Prandaj, kjo vendimmarrje duhet të jetë produkt i respektimit maksimal të të drejtave procedurale që u njihen me ligj palëve, kjo vlen edhe në rastin e aplikimit të teknologjisë elektronike.

## 1.1 Juridiksioni virtual si perspektivë e së ardhmes.

Juridiksioni është sferë brenda së cilës ushtrohet një e drejtë a një veprimtari, vendi a rrethi brenda të cilit një organ vepron dhe ka të drejta të plota të ushtrojë detyrën e tij. [96] E drejta e organeve shtetërore për të zgjidhur çështje që përfshihen në funksionin e tyre, duke zbatuar në çdo rast ligjin quhet juridiksion *(jus dicere - me thënë ligjin d.m.th të zbatosh ligjin).( Lamani A. 1962)* Juridiksioni, kryesisht ndahet në Juridiksion Gjyqësor dhe Administrativ, i pari ndahet në juridiksionin civil, penal dhe administrative. Mendime të autorëve të ndryshëm e konsiderojnë dhe juridiksionin kushtetues si juridiksion të veçantë. Kjo sidomos me ndryshimet kushtetuese të 2016 *(Anastasi A., 2017)* që i dhanë një përqasje të ndryshme dispozitave që bëjnë fjalë për mundësinë dhe rrethin e subjekteve që mund ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese (nenit 131/f dhe 134 të Kushtetutës së RSH-së).
Pjesa më e madhe e ligjit që kufizon juridiksionin territorial, në nivel ndërkombëtar, u formua rreth konsideratave të qasjes fizike në gjykatë.*(Kengyel M, Nemessányi Z., 2012)* Kjo është e kuptueshme, pasi zhvillimi i teknologjisë elektronike, siç edhe përmendëm më sipër, mori zhvillim në dekadat e fundit dhe kryesisht pas viteve '90. Një zhvillim i tillë, referuar lehtësive që sillte, u shoqërua me ndryshime të shpejta në legjislacionin procedural, duke bërë pjesë të procesve gjyqësore dhe këtë mënyrë komunikimi apo zhvillimi të tyre. Duke referuar zhvillimeve teknologjike të kohëve të fundit, koncepti i gjykatës virtuale shihet e ardhmja dhe që është njësoj e arritshme kudo nga ndërgjyqësit, kështu, doktrina e *forum non conveiens* bëhet *"e vjetëruar"*. Palët, avokatët dhe dëshmitarët do të ishin në gjendje të merrnin pjesë në proces gjyqësor duke qenë në territore të ndryshme, ku distanca mundësisht nuk do ishte një problem, pjesëmarrja në seancë gjyqësore duke zhvilluar një juridiksion të ri atë të quajturin juridiksion virtual.*(Kengyel M., Nemessányi Z., 2012)* Por, ndërtimi i këtij juridiksioni, do të jetë shumë i afërt drejt një gjykate që shtrin hapësirën e saj në të gjithë planetin.*(Kengyel M., Nemessányi Z., 2012)* Por edhe faktet të tjera do të duhet të rregullohej me një normë ndërkombëtare, konventë apo marrëveshje ndërkombëtare për shtrirjen e këtij juridiksioni. Në studimet e ndryshme, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilët po e aplikojnë këtë lloj juridiksioni, "*një paditës që zgjedh një gjykim virtual në një juridiksioni të ndryshëm nga ai që ligji i të cilit rregullon çështjet në mosmarrëveshje*". Gjykatat duhet të kenë juridiksion që të zbatojnë ligjet e tyre, në këtë dilemë ata duhet të marrin nga juridiksioni i ligjeve të një sovrani *(Omari L. 2007)* të huaj (*shteti tjetër*). Konventa e Brukselit, e datës 27 shtator 1968, "*Për juridiksionin dhe ekzekutimin e vendimeve të çështjeve civile dhe tregtare*" ka pasur ndikim shumë të madh mbi këtë çështje. Konventa e konsideron *"vendbanimin"* si kriter të përgjithshëm për përcaktimin e juridiksionit. Kështu një individ mund të padisë në gjykatat vendase, nëse ai ajo ka banimin (apo selinë në rastin e personave

[96] https://fjale.al/juridiksion "E drejtë e një organi për të bërë një gjyq, për të zgjidhur një çështje, për të ushtruar një veprimtari të caktuar etj. në përputhje me ligjin. *Juridiksion ndërkombëtar. Juridiksion gjyqësor (administrativ, ushtarak, civil). Ushtron (shtrin) juridiksionin.*

juridikë) në këtë vend. Megjithatë, është e drejta kombëtare e çdo shteti palë të përcaktojë nëse një individ do ta ketë ose jo vendbanimin brenda territorit të tij *(Simoni A., Sadushi S. & Çomo S.,2006).* Përveç rregullit të përgjithshëm të sipërpërmendur, konventa e Brukselit vendos vetëm një sërë rregullash të tjera të veçanta *(Simoni A., Sadushi S. & Çomo S.,2006).* Nëse në gjykimin virtual nëpërmjet teknologjisë, do të bëhej i vështirë fakti i mosushtrimit të ligjit të vendit ku ndodhe paditësi apo i padituri palë në proces, që nuk do ti realizonte të drejtat e tij. Me fjalë të tjera, zgjedhja ligjore do të bëhej çështje e juridiksionit gjyqësor dhe konflikti për juridiksionin do të ishte një problem i vazhduar. Problemet me juridiksionin virtual do kishte në fushën e zbatueshmërisë së normës, shtrirja e palëve në vende të ndryshme do të konsistonte dhe në faktin se cila normë do të zbatohej dhe cila do të kishte fuqi. Përfundimi i kësaj forme gjykimi, që edhe pse është në fazat e para por që shihet si e ardhme e afërt e gjykimit, do të duhet të zbatojmë me përpikmëri rregulla të detajuara dhe duhet të kemi një mekanizëm kontrolli të gjyqtareve që do marrin pjesë në këtë lloj gjykimi. Pyetja që është shtruar për diskutim; *A është një metodë e suksesshme juridiksioni virtual?* Arsyet e shumta, që shtete të ndryshme nuk e ushtrojnë këtë llojë juridiksioni, janë pamundësitë teknologjike për të përmbushur kushtet e nevojshme për të realizuar këtë lloj gjykimi. Por kjo nuk do të thotë se do jetë e pamundur në një të ardhme jo të largët. Profilimzimi i gjyqtareve është një faktorë i rëndësishëm për teknologjinë dhe gjyqtarët që do të gjykojnë çështjet. Një përpjekje nga ana e ligjbërësit tonë, në kuadër të zhvillimeve të mjeteve të komunikimit elektronik, në analizën e kodit të procedurës civile të Republikës së Shqipërisë, shihet në paditë me shuma të vogla. Në diskrecionin e gjykatave parashikohet mundësia që nëpërmjet video-konferencave të realizojnë seanca gjyqësore në distancë. Fakti i zhvillimit të teknologjisë duhet të jetë i shoqëruara dhe me sigurinë kibernetike të platformave të aplikuara të komunikimit, ku kjo lloj teknologjie lë hapësirë *"ndërhyrje"* duke cënuar një realizim normal të një procesi të tillë. Problemi i shtrirjes territoriale, është një faktor që duhet të nënkuptohet nëse ka juridiksion gjykata në shtrirje territoriale të një vendi tjetër ku është personi që është paditur apo paditësi, si në marrjen në pyetje pa letër-thirrje të dëshmitarëve në deklarimet e detyrimeve (kontratat e huas) etj. Provueshmëria në seancë gjyqësore mundet të bëhet edhe me dëshmitarë dhe ky fakt mundet të realizohet nëpërmjet video-konferencave[97].

## 2. MJETET E KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK TË PARASHIKUARA NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË. NDIKIMI I TYRE.

Duhet mbajtur në konsideratë se procesi i gjykimeve civile përfaqësohet nga një sërë veprimesh juridike që realizohen në etapa të ndryshme të zhvillimit të këtij procesi. Konkretisht, do ta ndanim në katër faza kryesore procesin e gjykimit, *Faza e parë që përfshinë paraqitjen e padisë (neni 154/a i K.Pr.Civile) dhe provave ku mbështetet pretendimi i kërkuesit/paditësit (neni 156 i K.Pr.Civile) dhe realizimi i veprimeve paraprake që kanë të bëjnë me vlerësimin e plotshmërisë së padisë (padia nuk ka të meta) (neni 154/a/3 i K.Pr.Civile);*

*Veprimet paraprake të gjyqtarit të vetëm pasi vlerëson padinë pa të meta në realizimin e komunikimit të kësaj padie dhe provave ku pala e paditur bayon pretendimet e saj apo kryen proces vendimmarrës në veprime paraprake të tij. (nenet 158, 158/a të K.Pr.Civile)*

*Faza e dytë është seanca përgatitore, ku gjykata komunikon me palët duke përgatitur çështjen në drejtim të provave që do i nënshtrohet debatit gjyqësor apo dhe pretendimeve të tjera të palëve ndërgjyqëse apo personave të tretë që marrin pjesë në proces.*

*Faza e tretë është seanca gjyqësore, ku zhvillohet debati gjyqësor mbi provueshmërinë e fakteve ku mbështeten pretendimet e palëve dhe provave që shkojnë në themel të këtyre fakteve.*

*Faza e katërt është vendimmarrja e gjykatës dhe komunikimi i vendimit përfundimtar, paraqitja e ankimeve etj.*

Këto faza mund të identifikohen në gjykimin në shkallë të parë, pasi gjykimi në apel, përfshinë kryesisht seancës gjyqësore dhe vendimmarrjen e gjykatës shoqëruar me komunikimet përkatëse të këtij vendimi, ku në...*shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë...*[98]

---

[97] Neni 236/a - Rregullat për pyetjen e dëshmitarëve për paditë me shuma të vogla i ligjit Nr. 8116, datë 29.3.1996 "KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" i ndryshuar.

[98] Neni 465 pika 2 i ligjit Nr. 8116, datë 29.3.1996 "KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" i ndryshuar.

Ashtu siç përcaktohet në Kodin e Procedurës Civile, palëve duhet tu njoftohen aktet e gjykatës. Kjo realizohet nëpërmjet njoftimeve që përfshinë një sërë mënyrash apo mjetesh të komunikimit.

Kodi ynë i Procedurës Civile njeh mënyrat e komunikimit të gjykatës nëpërmjet sekretarisë gjyqësore, me anë të letër-thirrjes (neni 129/1 i K.Pr.Civile) apo dëftesa komunikimit, si dhe me mjete elektronike (neni 129/2 i K.Pr.Civile), ku kjo e fundit është mënyrë e cila mund të aplikohet vetëm në rast se: *"...pala ose personi i tretë ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, sipas rregullave të përcaktuara..."*. Pra, paraprakisht duhet një pëlqim paraprak i palës për tu njoftuar në mënyrë elektronike. Pra, gjykata mundësinë e përdorimit të kësaj mënyre komunikimi e ka të kushtëzuar me miratimin apo dhënien e pëlqimit paraprak të palëve të përfshira në proces. Njëkohësisht, gjykata aplikon edhe njoftimin me shpallje publike parashikuar në nenin 133/a dhe 133/b.[99] Këtu përfshihet edhe detyrimi i gjykatës, që përveç afishimit të shpalljes së njoftimit në ambientet e gjykatës dhe…në vendin ku personi të cilit i drejtohet njoftimi ka vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin ose vendqëndrimin...(neni 133/b/1 i K.Pr.Civile) por dhe...*në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim.*(neni 133/b/3 i K.Pr.Civile të RSH-së).

Duke referuar në këto parashikime dhe të tjera që bëhen në Kodin e Procedurës Civile, evidentohet pozita që gradualisht po zë komunikimi nëpërmjet teknologjisë elektronike. Kjo për vetë faktin dhe të mundësisë që jep për një komunikim sa më të shpejtë dhe në kohë sa më reale, sidomos për situata ku individët të cilëve u drejtohen këto komunikime janë në distanca të largëta. Duhet marrë në konsideratë fakti që jemi para një mundësi mobiliteti të popullatës, kjo e bën edhe më të vështirë respektimin e duhur të parashikimeve procedurale në raport me komunikimet dhe mundësinë e prezencës së subjekteve që u drejtohet në gjykatën ku zhvillohet procesi gjyqësor, për shkak pikërisht të distancave dhe pamundësisë të të qenurit prezent në sallë. Prandaj shihet e qartë se mjetet e komunikimit elektronike kanë lehtësuar në mënyrë të qenësishme çështjen e kohës që duhet në realizimin e këtyre komunikimeve, që pasqyrohet shumatore e kohës të procesit të të gjykuarit që duhet për një çështje të caktuar. Kjo mënyrë komunikimi, po shihet si një instrument zëvendësues i komunikimeve tradicionale në të ardhmen, referuar zhvillimit të shpejtë dhe përhapjes së gjerë të teknologjisë elektronike dhe komunikimit elektronik.

## 2.1 Ndikimi teknologjik në procesin civil për njoftimet e palëve.

Njoftimet janë një element i rëndësishëm i procesit gjyqësor civil, ftuesit gjyqësor duhet të kryejnë detyrën e tyre në përputhje me rregullat procedurale. Thirrja apo njoftim-marrjet të parashikuara në kodin e procedurës civile janë dispozita ligjore që për arsyet e zhvillimeve teknologjike kanë bërë të mundur të pësojnë ndryshime të domosdoshme. Thirrja e ndërgjyqësve dhe e personave të tretë përpara gjykatës bëhet me dërgimin e shkresave të posaçme që quhen letër-thirrje *(Lamani A. 1962)*. Këto shkruhen në dy kopje për cilindo ndërgjyqës ose person të tretë dhe vulosen me vulën e gjykatës. Komunikimet bëhen me anën e një personi të posaçëm të quajtur ftues ose me anë të postës. Risitë teknologjike kanë përparuar në gjykimiet civile ku e-mail është bërë një mjetë i domosdoshëm për palët pjesë një procesin gjyqësorë. Ndërgjyqësit duhet të paraqesin në kërkesëpadi apo deklaratat e mbrojtjes adresën e e-mailit apo kontakte telefonike, këto janë së pari risi e ligjit 49/2012 për gjykatat administrative, dhe këto parashikime po transferohen edhe në gjykimin civil, në mënyrë të herëpashershme. Ligji procedural civil dhe ligji i gjykimit administrativ parashikojnë se në gjykimin në gjykatën e apelit dhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë palët njoftohen me shpallje për datën ,ditën dhe orën e gjykimit. Shpallja në gjykimin në gjykatën e apelit, qoftë civil dhe administrativ, bëhet duke afishuar një fletë formati A4 në një nga stendat e shpalljeve publike në gjykatën e apelit dhe në gjykatën e shkallës së parë të paktën 10 ditë para datës së gjykimit *(Kalaja F. 2021)*. Thënë ndryshe, ligji ka parashikuar se individi, për të marrë pjesë në gjykim, duhet të kontrollojë sa herë bëhen shpalljen, në gjykatat e apeleve apo në Gjykatën e Lartë, nëse ka dalë gjyqi ku ai është palë apo jo. Ky detyrim vlen njëlloj si për palën që është fqinj me gjykatën e apelit apo Gjykatën e Lartë dhe për palën që është me qindra kilometra larg. Ligjvënësi kështu ka vlerësuar se kjo zgjidhje është më e mirë se sa detyrimi i gjykatës për të njoftuar palët *(Kalaja F. 2021)*. Ndryshimet

[99] Shtuar me ligjin 38/2017, datë 30.03.2017.

në nenin 460[100] të Kodit të Procedurës Civile të RSH-së, vlerësojmë se duhet të mbajnë parasysh se shpallja si mënyrë njoftimi është një masë procedurale *ultima ratio*, që do të thotë se, vetëm kur gjykata nuk arrin të njoftojë palët sipas mënyrave të zakonshme të njoftimit dhe pasi i ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme të njoftimit, vetëm atëherë mundet të procedojë me njoftimin me shpallje *(Kalaja F., 2021)*. Këtë jurisprudencë ka mbajtur GJEDNJ në çështjen "*Gakharia vs. Georgia*"[101] mbi pajtueshmërinë me nenin 6 të KEDNJ të mënyrës së njoftimit me shpallje *(Kalaja F., 2021)*. Njoftimet e cila sipas nenit 460 pika 5 i K. Pr. Civile janë shoqëruar me një sërë problematikash në stokun e gjykimeve për shkak të reformës në drejtësi që shoqëruan shkarkimin e një numri të madh të gjyqtarëve. Kjo bëri që të kemi një numër të madh të stokut të çështjeve në GJA dhe në GJL. Gjykata e Lartë mbeti pezull për një kohë të gjatë duke mosfunksionuar për një kohë relativshtë të gjatë. Kështu në informacione të mara nga ana jonë në GJA dhe GJL po gjykojnë akoma vitin 2016-2017, pra janë afërsisht 5 vite larg në kohë me realitetin e gjykimit. Konkretisht ndryshimet e nenit 460 janë të fundit të vitit 2021 por që e ka bërë gjykatën të gjykojnë në bazë dokumentash duke i njoftuar palët vetëm me e-mail ose me shpallje. Njoftimi me e-mail është risi teknologjike dhe fakti që shumë çështje janë të pagjykuara përpara ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile ata nuk kanë pasur detyrimin që të paraqesin në kërkesëpadi email apo forma elektronike njoftimi. *Neni 129 në paragrafin e dytë parashikon se kur pala apo personi i tretë ka dhënë pëlqimin paraprak, atëherë gjykata urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet me mjetet e komunikimit elektronik.* Kjo do të thotë se nuk mjafton që të dhënat elektronike të komunikimit të jenë dhënë nga pala, personi i tretë apo përfaqësuesi i tyre në gjykimin në shkallë të parë në mënyrë që Gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë të procedojë me njoftimin individual në këto adresa *(Kalaja F., 2021)*. Përkundrazi, do të duhet që pala, personi i tretë apo përfaqësuesi i tyre të ketë dhënë pëlqimin e shprehur, që jo vetëm në gjykimin në shkallë të parë, por edhe në gjykimin në apel apo edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Gjykatat janë të autorizuara të përdorin të dhënat elektronike në mënyrë formale të komunikimit të akteve procedurale. Pikërisht kjo është pjesa që duhet të kuptohet nga praktikantët e së drejtës se mungon nje element i rëndësishëm tek këto dy dispozita dhe se zbatimi i tyre pa këtë pjesë të munguar do të shkaktonte gjykim në mungesë në kundërshtim me nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ *(Kalaja F., 2021)*. Në qëndrimin që gjykata duhet të ketë parasysh për njoftimin në rrugë elektronike, ai kryhet në rastin kur palët ndërgjyqëse kanë lënë një adresë e-mali për njoftim. Një shembull i jashtëzakonshëm i inovacionit teknik të kohëve të fundit dhe epokës në elektronike ishte *sistemi e-mail*. E-mail-i ka bërë përparim befasues në dy dekadat e fundit dhe tani është befasuese si në aspektin e cilësisë së tij, ashtu edhe në aspektin e të qenit të pajisur mirë në respekt të kapacitetit të tij për të shkëmbyer informacion. Meqenëse është në dispozicion një pajisje kompakte e cilësisë së lartë, dhe me disponueshmërinë e arsyeshme të kompjuterëve, emali mund të përdoret gjerësisht në mesin e njerëzve. Kjo mënyrë e njoftimit përdoret në ditët e sotme në jetën tonë të përditshme për shkëmbim dhe komunikimin e ndërsjellë dhe dërgimi i dokumenteve të detajuara zyrtarisht dhe privatisht me shpejtësi në të gjithë botën. Përveç avantazheve teknike, për shkak të performancës së arsyeshme të kostos, tani është e përhapur në jetën përditshmen të njerëzve në pjesën më të madhe të botës. E-mail-i duhet të jetë fokusi kryesor për të zhvilluar në procedurën civile moderne. Vende të ndryshme kanë aplikuar sistemin e *faksimileve*[102] i cili u zhvillua si një pajisje kompakte për shkëmbimin e kopjeve të dokumenteve para përdorimit të gjerë të sistemeve të postës elektronike në botë. Ky sistem bëri të mundur shkëmbimin e kopjes së dokumenteve *origjinale* me linjë telefonike, pa i transformuar ato me teknologji elektronike të pajisur posaçërisht kanë një avantazh të qartë për shkëmbimin e dokumenteve të shkruara nga kompleksiteti, si dhe metoda gjuhësore të përbëra nga lloje të panumërta të karaktereve *(Kengyel M.,*

---

[100] *Neni 460 pika 5 ..."Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen bëhet nga gjykata e apelit me shpallje në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të gjykatës së apelit, si dhe, nëse ka, edhe në faqen e internetit të gjykatës përkatëse të shkallës së parë, dhe, me njoftim individual në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit. Shpallja ose njoftimi bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimit. Në rast se përbërja e trupit gjykues nuk është njoftuar sipas rregullave të përcaktuara në këtë pikë, palët mund të kërkojnë shtyrjen e gjykimit, përveç rasteve kur marrin pjesë në gjykim dhe nuk kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve."....*

[101] https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=003-5599389-7074064&filename=Judgments%20of%2017.01.17.pdf aksesuar më datë 10.09.2021.

[102] Metodë komunikimi të trasferimit të dokumentave në një kohë reale dhe tepër të shpejtë dhe shumë efikase.

*Nemessányi Z., 2012).*

**2.2 Video-Konferencat risi në Kodin e Procedurës Civile dhe problematikat në komunikimin elektronik.**

Në vitet e fundit, referuar ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Civile, video-konferencat janë një mënyrë komunikimi gjithnjë e më shumë në zgjerim, për kategorinë e padive me shuma të vogla. Ky zhvillim filloi në Australi dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, metoda të tilla ofrojnë përparësi veçanërisht në rastet kur dëshmitari dhe gjykata ndahen në distanca të mëdha. Sidoqoftë, ky nuk është aspak rasti i vetëm kur dikush mund të të përdorë video-konferencat. Raste të tjera mund të përfshijnë dëshmitarë të cilët nuk janë në gjendje të udhëtojnë ose që janë në kushte të pafavorshme. Sipas Rregullave Federale të Procedurës Civile në SHBA "*...gjykata mundet, për një arsye të mirë treguar në rrethana bindëse dhe nën garancitë e duhura, të marrë leje për paraqitjen e dëshmisë në seancën gjyqësore me transmetim të njëkohshëm nga vendndodhje të ndryshme...*"[103] Ndërkohë, edhe disa sisteme ligjore evropiane[104]apo Rregulloren Europiane të Marrjes së Provave[105] parashikohet shprehimisht marrja e provave me anë të video-konferencave. Në bazë të nenit 10 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 1206/2001, gjykata kërkuese mund t'i kërkojë gjykatës së cilës i drejtohet kërkesa, të përdorë komunikimet teknologjike në marrjen e provave, veçanërisht duke përdorur video-konferencën dhe telekonferencën. Teknologjitë moderne të komunikimeve dhe marrjes së informacionit, p.sh. në marrjen e dëshmive, ofron një hap të madh në komunikimet në kohë reale, përtej procedurave tradicionale të asistencës gjyqësore ku gjykata kërkuese merr vetëm një transkript të komunikimit. Marrja në pyetje e dëshmitarëve, me anë të video-konferencës në kohë reale, është vetëm një hap i vogël drejt një lidhjen me video-konference me avokatët, palët dhe gjyqtarët pra zhvillimin e një proces gjyqësor virtual  pa "prezencë fizike". Kjo metodë përdoret në Shtetet e Bashkuara për disa vite,[106] ku si shembuj të aplikimit përfshijnë kryesisht rastet e mosmarrëveshjes së qirasë, seancat e gjykimit të shkurtuar dhe seancat e apelit *(Lederer F.I., 1998)*. Në disa gjykata krijohen disa salla të posaçme, duke siguruar pajisje të posaçme teknologjike *(Lederer F.I., 1998)*. Jo vetëm avokatët mund të paraqiten me anë të video-konferencës, por edhe gjyqtarët mund të marrin pjesë në seancë në këtë mënyrë *(Lederer F.I., 1998)*.[107] Nga një pikëpamje teknike është e rëndësishme që të gjithë pjesëmarrësit të kenë një shans për të perceptuar gjithashtu reagime jo verbale të pjesëmarrësve të tjerë, veçanërisht të gjyqtarëve. Kështu, një sistem i aktivizuar me zë nuk është i mjaftueshëm. Një alternativë më ekonomike për video-konferencën është përdorimi i bisedave në dhoma, të cilat natyrisht lejojnë vetëm transmetimin e tekstit. Kjo metodë tashmë është përdorur në Shtetet e Bashkuara për konferenca paraprake. Po në këtë frymë ka vijuar edhe Kodi ynë i Procedurës Civile, i cili ka parashikuar se pyetja e dëshmitarëve mundet të realizohet nëpërmjet video-konferencave me anë të deklarimeve dhe dëshmive të personave që kërkohen nga palët për të dëshmuar. Në ditët e sotme aplikueshmëria nga ana e gjyqtarëve të video-konferencave është i limituar. Në fakt përdorimi i kësaj mënyrë komunikimi, do ishte i rëndësishëm në çështjet familjare, me objekt zgjidhje martese *(palët janë në shtete të ndryshme dhe padia është paraqitur në Shqipëri me dëshirën e dy palëve për të zgjidhur martesën)*. Gjykata e Shkallës Parë Tiranë-Dhoma Civile apo dhe në ndonjë gjykatë tjetër si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në çështje të tilla, ka pranuar si mundësi të ndërgjyqësve që janë jashtë territorit të Shqipërisë të bëjnë deklarimet e tyre nëpërmjet video-konferencave. Këtë kontekst e ka realizuar nëpërmjet aplikacioneve online si platforma Zoom, Teams etj. Kjo është një mënyrë shumë e mirë komunikimi duke shmangur shtyrjet pa fund dhe njëkohësisht pamundësinë e lëvizjes të palëve të përfshira, sidomos në rastin e periudhës së pandemisë Covid-19.

---

[103] Neni 43/a - Rregullat Federale të Procedurës Civile - THE COMMITTEE ON THE JUDICIARY HOUSE OF REPRESENTATIVES, U.S. Governement Publishing Office, Ëashington 2021, P. 60:

[104] Shih Nenin 128/a Kodi Gjerman i Procedurës Civile.

[105] Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1206/2001 e datës 28 maj 2001 Mbi bashkëpunimin midis gjykatave të Shtetet Anëtare në marrjen e provave në çështjet civile ose tregtare, OJ L 174, 27.6.2001, faqe 1–24.

[106] " http://lawtechnews.com/december00/litigation_support_p133.html aksesuar me datë 09.092021

[107] Në 1996 në *Shtetet e Bashkuara kundër Salazar*, dy nga pesë gjyqtarët u ulën në shtete të ndryshme dhe morën pjesë në dëgjimin me anë të videokonferencës. Përveç kësaj, një *amicus curiae* e plotësoi përmbledhjen e tij me parashtresat elektronike.

Po çfarë janë video-konferencat a mundet të shtrijmë juridiksionin jashtë territorit të RSH-së? Përgjigjet e kësaj i janë dhënë në juridiksionin virtual i sqaruar më sipër. Po kështu neni 287/a "*1. Në lidhje me paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata vendos që palët të sjellin shpjegimet me shkrim ose nëpërmjet video-konferencës. 2. Me kërkesë të arsyetuar të palëve, si dhe kur gjykata e çmon të arsyeshme, ato mund të pyeten nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit në distancë. 3. Aspektet vizuale dhe zanore të seancës të video-konferencës transmetohen në kohë reale të vendndodhjes me sallën ku zhvillohet procesi gjyqësor. 4. Aspektet vizuale dhe zanore të transmetuara nuk regjistrohen. Vendimet e mësipërme janë të paankimueshme."* Tek paditë me vlera të vogla ju bë një përshtatje për efekt të ligjit 49/2012 dhe si rrjedhojë u konstatua në ndryshimet e 2021 ku u vendos të rritej pragu i vlerës së padisë nga 150.000 mijë lekë në shumën 20-fishit të pagës minimale në shkallë vendi. Gjykata mundet të marrë shpjegime nëpërmjet video-konferencave duke i pyetur për paqartësi apo për të gërmuar në thelbin çështjes apo për të parë pohimet dhe krijimin e bindjes së brendshme të gjykatës. Por ky nen ka shtrirë hapësirën e përdorimit duke mos pasur vetëm një platformë të caktuar për realizimin e qëllimit të teknologjisë në seancë gjyqësore. Mjetet e tjera të komunikimit të përdorura nga ligjbërësi kanë një kuptim i gjerë, ku përfshin platformave të aplikacioneve të telefonave inteligjentë si dhe thirrjeve telefonike apo dhe fax apo zhvillimeve të tjera të së ardhmes. Po kështu, KLGJ-ja, në strategjinë e saj për shtrirjen teknologjike nëpër gjykata (*sistemet audio, video-konferencat, ueb etj*.) e ka prioritet kryesor, kjo parë në këndvështrimin e uljes së numrit të gjyqtarëve konsiston në faktin që të mundësohet efekti kohë i gjykimit të përshpejtuar dhe konkretisht me bazë dokumentash.[108] Pikërisht këtu lind e domosdoshme identifikimi i aplikimit të sistemeve apo platformave të gjykatave në komunikimet elektronike *(video-konferenca)*, për të pasur të qartë dhe të unifikuar platformat që do aplikohen në këto lloj komunikimesh. Kjo mënyrë e të shkruajturit të ligjit i ka bërë që të ketë një qëndrueshmëri në kohë të mosndryshimit të dispozitës ligjore në fjalë. Ajo që mund të konsiderohte një e metë, në opinionin tonë, është mosregjistrimi i aspekteve zanore dhe vizuale që lë hapësirë që prova të manipulohet dhe mos të ngelin gjurmë mbi metodën e marrjes në pyetje apo shpjegimeve të palëve. Këto vendime janë të paankimueshme duke i dhënë ekskluzivitetin gjyqtarit të vendosë mbi faktin dhe situatat konkrete. Mendojmë se parashikimi për mosregjistrimin e aspekteve vizuale dhe zanore të video-konferencës nuk duhet kuptuar se një përmbledhje e tyre që nuk duhet të pasqyrohet në procesverbalin e seancës gjyqësore.[109] Rregjistrimi i tyre duhet të jetë i detyrueshëm dhe njëkohësisht të ruhet në paisje të posaçme duke i bërë pjesë të fashikullit gjyqësor, duke lejuar kontrollin apo rikontrollin e tyre. Përdorimi i teknologjisë lehtëson marrjen e informacionit dhe aksesin në drejtësi, ul shpenzimet për palët dhe rrit shpejtësinë e gjykimit, ndaj gjykojmë se një parashikim i tillë është pozitiv. Paqartësia ka nëse vendimi i ndërmjetëm duhet të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar duke i dhënë palëve të drejtën e ankimit pa pasur regjistrimet e video-konferencave, të cilat janë pjesë në dosjen gjyqësore, pra duke mos i dhënë mundësi të vërtetimit të deklarimeve apo thënieve në proces. Vlerësimi i pohimeve gjyqësore të palëve nëpërmjet video-konferencave do të ishte i pamundur për të vërtetuar faktin pasi ato nuk ekzistojnë të regjistruar. Pohimi gjyqësor apo jashtëgjyqësor, tej vlerës procedurale, përbën një disponim mbi të drejtën materiale të palës që e bën pohimin, kjo në optikën e parashikimeve në nenin 214 të K.Pr.Civile. Vlerësojmë se neni 214 i K.Pr. Civile duhet të ndryshohet. E nëse ndryshimi nuk vjen me ligj, atëherë gjykatat duhet të bëjnë të mundur që neni 214 i K. Pr. Civile nga gjykatat, për llogari të zgjidhjes së çështjeve gjyqësore, të interpretohet në mënyrë pajtuese me parimet e përgjithshme të procesit gjyqësor civil. Nga analiza e të dhënave të mbledhura pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi zbatimin e këtyre dispozitave rezultoi se gjatë vitit 2018 janë regjistruar dhe ka përfunduar gjykimi i 377 padive me vlerë të vogël.[110] Vetëm në një përqindje të vogël të këtyre rasteve (2.65%) rezultoi se, megjithëse padia objekt gjykimi ka qenë padi me vlerë të vogël, gjykata nuk ka zbatuar dispozitat e reja të K.Pr.Civile mbi gjykimin e padive me vlerë të vogël, duke mos bërë asnjë referim në to. Megjithatë, numri i çështjeve të regjistruara dhe gjykuara brenda vitit kalendarik 2018 krahasuar me atë të 2016 nuk tregon nivelin e aplikimit të

---

[108] Këshilli i Lartë Gjyqësor strategjia e miratuar ë vitin 2020 http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/12/PLANI-STRATEGJIK-I-KOMUNIKIMIT-P%C3%8BR-SISTEMIN-GJYQ%C3%8BSOR.pdf aksesuar më datë 09.09.2021.
[109] Monitorimi i reformes në drejtësi aksesuar në: https://www.osfa.al/sites/default/files/monitorimi-i-zbatimit-te-reformes-ne-drejtesi-4.pdf faqe.11 aksesuar më datë 09.09.2021.
[110] Monitorimi i reformes në drejtësi aksesuar në: https://www.osfa.al/sites/default/files/monitorimi-i-zbatimit-te-reformes-ne-drejtesi-4.pdf faqe.11 aksesuar më datë 09.09.2021

dispozitave të reja të K.Pr.Civile mbi gjykimin e padive me vlerë të vogël.[111] Mjeti thelbësor shihet të jetë video-konferenca, e cila shmang udhëtimet të subjekteve për në gjykatë. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, " *edhe pse pjesëmarrja e/i padituri në procedurat me video-konferencë nuk është si i tillë i kundër, sipas Konventës, i takon Gjykatës të sigurojë që përdorimi i kësaj mase në çdo rasti specifik ka një qëllim legjitim"* (*Marcello Viola kundër Italisë*, 5 tetor 2006).[112] Sipas qëndrimit të GJEDNJ-së rezultati është një ftesë për gjykatat që përdorin video-konferencëat për të vazhduar përmirësojnë cilësinë e video-konferencës dhe aplikojnë kriptimin e sinjalit video për të shmangur përgjimin. Sipas vendimit të Dhomës së Madhe në çështjen Sakhnovskiy[113], *përdorimi i videokonferencave nuk përbën problem, por as avantazh sipas nenit 6 të KEDNj-së*. Videokonferencat janë thjesht një teknologji që mund të përdoret në procedimet e gjykatës. Përdorimi i teknologjive të tilla nuk i çliron autoritetet kombëtare nga detyrimet e tyre sipas nenit 6 të KEDNj-së. Qëllimi kryesor i nenit 6 është të garantojë drejtësinë e përgjithshme të procedimeve, të cilat vlerësohen duke pasur parasysh rrethanat e posaçme të secilës çështje. Përdorimi i videokonferencave dhe aspekteve praktike që lidhen me to përcaktohet nga gjyqtari. Është gjyqtari ai që është në gjendje të sigurojë një proces të drejtë dhe të marrë parasysh të gjitha implikimet e mundshme që mund të rrjedhin nga përdorimi i zgjidhjeve teknologjike në çështjen në fjalë. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar mirë dhe të garantojë një ekuilibër të drejtë mes të drejtave të palëve të përfshira në procedim.[114]

## 3. QASJA E GABUAR NË MOSPËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË NË PROCESET GJYQËSORE, GJATË PANDEMISË COVID-19 NË SHQIPËRI. NEVOJA PËR PËRMIRËSIME TË MUNDSHME.

Situata e pazakonshme që shkaktoi pandemia Covid-19, e cituar si fatkeqësia natyrore që zuri globin, bëri që si në shumë vende të tjera edhe në RSH-në të vendoseshin kufizime në aktivitetin e përgjithshëm. Këto kufizime prekën edhe aktivitetin e gjykatave, duke sjellë pezullimin e gjykimit të çështjeve *(perveçse disa çështjeve të natyrës së ngutshme)* me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 127, datë 10.03.2020 "Për Pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësor në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë". Kjo solli jo vetëm pezullimin e gjykimeve nga ana e KLGJ-së, por shumica e vendimeve te pushtetit ekzekutiv krijuan pasoja duke sjellë pamundësi ankimimi në gjykata. Ky qëndrim i KLGJ-së mundet të kishte një impakt negativ më të vogël, nëse niveli i aplikueshmërisë së teknologjisë elektronike, të ishte në një nivel më të lartë të ngjashëm me vendet e tjera, kryesisht ato BE-së apo SHBA-së. Për më tepër, situata e jashtëzakonshme Covid-19 detyroi Këshillin e Lartë Gjyqësor të kufizonte veprimtarinë e gjykatave.[115] Por, ishte e nevojshme që Gjykata Administrative të linte një dritare për të siguruar kontrollin gjyqësor të akteve normative të Qeverisë gjatë periudhës së masave të jashtëzakonshme Covid-19.[116] Në qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe qëllimit të shëndetit publik miratoi një Akt Normativ Nr. 9, datë 25.03.2020 "*Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktua nga Covid-19*".[117,118]

Praktikat e vendeve të huaja janë të qartë që pati një ndikim, por duke mos i kufizuar gjykatat në gjykimet e tyre. Përgjigja nga gjykatat e Anglisë dhe Uellsit ishte interesante, 19 mars 2020, tre ditë para miratimit të masave të

---

[111] Po aty.
[112] Shih GJEDNJ, *Marcello Viola kundër. Itali* , 5 tetor 2006, aplikimi nr. 45106/04, §67.
[113] Sakhnovskiy v. Russia [GC], kërkesa 21273/03 datë 02 Nëntor 2010.

[114] https://rm.coe.int/regional-online-round-table-report-f-albanian/16809f2393 aksesuar më 21.09.2021.
[115] Po aty.
[116] Po aty.
[117] https://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2020/05/27/21/145c45bc-5293-482d-9c74-4cdaac3b9cb5 aksesuar më datë 10.09.2021.
[118] Shih. Akti Normativ Nr.21, datë 27.5.2020 "*Për disa ndryshime në aktin normativ NR.9, DATË 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave*, "*Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19*", Miratuar me ligjin nr. 30/2020. Aksesuar në www.qbz.gov.al më datë 10.09.2021.

përgjithshme bllokuese, Kryetar i Gjykatës së Anglisë dhe Uellsit dhanë udhëzime për trajtimin e të gjitha seancave, me një ose më shumë pjesëmarrës, në distancë. Sipas Lordit Burnett të Maldonit, një punë e madhe është bërë për ta mirëmbajtur sistemin e drejtësisë në funksionimin dhe teknologjia është përdorur gjatë masave të Covid-19 si metodë e suksesshme. Sidoqoftë, meqenëse jo gjithçka mund të bëhej në distancë, gjykatat pezulluan gjykimet për disa çështje që ishte e domosdoshme prania e palëve në proces *(Douglas-Henry J.P. & Sanderson B.,2020)*. Shërbimi i *Gjykatave dhe Tribunaleve të HM* ka zhvilluar një *Udhërrëfyes në dëgjimet telefonike dhe video gjatë shpërthimit të koronavirusit*, të azhornuara periodikisht, i cili trajton një sërë çështjesh, përfshirë mënyrën e përdorimit të seancave në telefon dhe video, përdorimi i teknologjisë, për të siguruar *Drejtësinë e Hapur*,*(Mensi M.*, *2020)* qasjen e mediave në procese, *(Mensi M.*, *2020)* modalitetet e pjesëmarrjes në një dëgjim audio ose video, si dhe betimet ose deklaratat që duhen bërë *(Mensi M.*, *2020)*. Teknologjia në dispozicionin tonë vjen në shumë forma dhe të tjera do të jenë padyshim së shpejti në dispozicion. Zoom duket se është platforma e preferuar në nivel ndërkombëtar, edhe pse shqetësimet e sigurisë kanë nxitur disa gjykata të kufizojnë ose në disa raste të ndalojnë përdorimin e tyre. Përveç Skype, mungon adekuati në funksionalitetin, BlueJeans dhe Ekipet e Microsoft (*kjo zgjedhje e fundit nga Ministria e drejtësia në Itali*) ishin mjetet të përdorura më së shumti. Sidoqoftë, në disa juridiksione nuk është e mundur të zhvillohen seanca virtuale duke përdorur sisteme të caktuara teknologjike. Në veçanti, shumë platforma të video thirrjeve janë të bllokuara në Lindjen e Mesme dhe në Kinë, atëherë është e nevojshme, në varësi të vendit, të merrni parasysh aspektet që lidhen me licencat e përdorimit dhe specifikimin dhe rregullimin aktual *(Mensi M.*, *2020)*.
Po ku gaboi Shqipëria? Cila do ishte zgjidhja e nevojshme për të pasur një gjykatë funksionale gjatë Covid-19? Në përgjigje të pyetjes së parë shtrohet në prizmin e kontekstit fjalës gabim në mos funksionimin e gjykatave nëpërmjet teknologjisë dhe platformave vizuale. Gjykata fatmirësisht me ndryshimet e vitit 2017 kishte dispozita të cilat do të interpretoheshin me analogji dhe do të zbatoheshin për disa lloj kategorish të objekteve të padive. Por në të njëjtën frymë është edhe zbatimi i gjykimeve virtuale që do të mundësonte, siç është cituar më sipër në punim, ajo u bë e mundur në disa vende dhe pati një qasje të hapur. Gjykimi i hapur beri që të miratoheshin akte për ne Angli apo vende te tjera si Holanda që kishin efikasitet jo siç është në realitet, por të paktën kishte mundësinë e një gjykimi dhe një besim të publikut për një kontroll të vendimeve apo natyrës së çështjeve gjyqësore. Përdorimi i platformave Zoom, Teams u përdorën në gjykimet Italiane, pse jo të mos ishin përdorur në Shqipëri, si një hapësirë e zhvillimit teknologjik, dhe përqasjes së ligjeve me shtetin Italian janë në përputhje me qëllimin e interesit publik.

**Në përfundim, teknologjia si një proces global do të prekë edhe territorin e RSH-së duke u mundësuar një kohë të arsyeshme dhe një ndikim në të drejtën procedurale civile. Jo vetëm fakti i teknologjisë por edhe lehtësimi i gjyqësorit në marrjen e mendimeve, pohimeve dhe provave do të ishte me i lehte në qasje me kohën. Parimi i ekonomisë gjyqësore është një parim në thelb ka ekonominë, kursimin e palëve apo gjykatës që të kryej shpenzime gjyqësore. Shpenzimet e palëve do të ishin relativisht të ulëta në rastin e përdorimit të teknologjisë, ku në kohë reale dhe në distancë mundëson që të kryhen me pak shpenzime dhe shumë shpejt në kohë. Këtë risi po sjell përdorimi i sistemeve digjitale në vendin tonë ku kjo është parë e domosdoshme sidomos me gjykimin e çështjeve me gjykim të shkurtuar. Gjykimi jo vetëm do të ishte me efektiv por do të kryhej brenda një afati të arsyeshëm brenda një kohe të cilët palëve do t'u jepej mundësia të gëzonin atë të drejtë të fituar nëpërmjet sistemit gjyqësor. Shqipëria ka përparuar në seancat gjyqësore duke përdorur teknologjinë si një kusht të rëndësishëm në këtë fakt në ndryshimet procedurale të vitit 2017 (me fjalë: dy mijë e shtatëmbëdhjetë) dhe ndryshimet e vitit 2021 (me fjalë: dy mijë e njëzet e një). Platformat e përdorura nga shtet e zhvilluar jo vetëm shërbejnë si burim reference për të përdorur në çdo kohë teknologjinë por edhe në eliminimin e disa barrierave që kanë për qëllim që të shkaktohet vonesa të gjykimeve. Fakti tjetër që kundërshton teknologjinë në pjesëmarrjen e gjykimeve civile është mundësia e palëve që të realizojnë një prizëm të ri të teknologjisë do të ishte e manipulueshme dhe do të sillte dhe pasoja të mëdha për sistemin gjyqësor. Gjykimi Civil do të kthehej në një gjykim me bazë dokumentash duke mos pasur kontradiktorialitetin në seancën gjyqësore por vetëm nga sistemi onlin. Jo pak herë ka pasur prishje të vendimeve të gjykatave më të ulta nga Gjykata e Lartë e cila ka vendosur të analizojë me kujdes duke e shprehur rëndësinë e procesit kontradiktor. Një fakt tjetër i rëndësishëm është mundësia e palëve që të merren në pyetje nëpërmjet video-konferencave, sipas parashikimit të kodit të procedurës civile mosregjistrimin e deklarimeve nëpërmjet video konferencave. Jemi të mendimit**

**që kjo sjell pasoja të rënda për sistemin e drejtësisë si në pikëpamjen e pohimeve, si prova në procesin civil edhe në provueshmërinë e faktit nga gjykata më të larta. Mendimet janë të ndryshme ka autorë që mendojnë se ky fakt duhet të regjistrohet në një procesverbal të seancës gjyqësore por nuk kemi një mënyrë të shprehur në kod nëse bëhet diçka e tillë nga gjykata. Njoftimet janë elementet të rëndësishme për palët në procesin gjyqësor civil ku jo pak herë janë shkaktuar problematika të njoftimeve dhe me ndryshimet e fundit janë parashikuar si mënyrë e njoftimit nga ana e Gjykatës së Apelit ajo me e-mail po ashtu edhe nga Gjykata e Lartë. Në fakt për çështjet e nisura para ndryshimeve gjykatat nuk i shikojnë dispozitat përfundimtar e cila shprehet se përpara vazhdimit të çështje gjyqësore nga afati 2017 (dy mijë e shtatëmbëdhjetë) do të reflektohen dispozitat e kodit të vjetër. Përcaktimi i gjykatave është shumë i rëndësishëm ku fjala në gjykatat e mëparshme nënkupton gjykatën e shkallës parë, por nëse nuk ka paraqitur e-mail në shkallë të parë, dhe gjykimi paraqitet ankimi pas ndryshimeve cila do të jetë mundësia e njoftimit? Fakti i mosnjoftimit do të sjellë edhe gjykimin në mungesë. Teknologjia është e nevojshme dhe si e tillë duhet të jetë më e parashikuar në K. Pr. Civile. Juridiksioni virtual do të parashikohet në të ardhmen të globalizimin të së drejtës në zgjidhjen e çështjeve nëpërmjet teknologjisë.**

BIBLIOGRAFIA DHE MATERIALE TË KONSULTUARA

Emery J. S., Edwards L. L. & Edwards J. S., "*Civil Procedure and Litigation*", The West Legal Studies, Thomson Learning, USA, N.Y. 2000.

Lamani A., "Procedura civile e Reublikës Popullore të Shqipërisë", Tiranë, 1962.

Anastasi A., "E drejta Kushtetuese" Botimi Dajti 200, Tiranë 2017.

Kengyel M. & Nemessányi Z.,"*Electronic Technology and Civil Procedure*", 2012.

Omari L. "Parimet dhe insitucione të së drejtës publike" Botimi I tretë shtepia botuese E&G, Tiranë 2007.

Simoni A., Sadushi S. & Çomo S., "*Vështrime krahasuese mbi procedurën civile*" Botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë 2006.

Mandrioli C., "Corso di diritto processuale civile I (Nozioni Introduttive e Disposizioni Generali)", G.Giappichelli Editore, Torino 1997.

Kalaja F., "*Dilema Kushtetuese mbi njoftimin me shpallje publike në gjykimin rishikues*" – Revista Avokatia Nr. 38, 2021.

Carnevali D. & Di Coço M. C., "*An Innovation Process Embedded in a Strict Institutional Setting*: ICT in the Italian Judicial System," in *Justice and Technology in Europe*, ed. M. Fabri and F. Contini (2001).

Lederer F. I., "The Courtroom as a Stop on the Information Superhighëay," in *Australian J.L. Reform*, 1998.

Lederer F. I., *An Introduction to Technologically Augmented Litigation*, published online 10 May 2010.

Mensi M. *"Caratteristiche e criticità della comunicazione da remoto vin tema di giustizia",* 23 settembre 2020.

Douglas-Henry J.-P. & Sanderson B., *Virtual Hearings* , DLA Piper, 2020.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Rregullorja Bruksel I.

Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1206/2001.

Kodi i Procedurës Civile Republikës së Shqipërisë.

Kodi Gjerman i Procedurës Civile

Akti Normativ Nr.21, datë 27.5.2020 "*Për disa ndryshime në aktin normativ NR.9, DATË 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave*, "*Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19*", Miratuar me ligjin nr. 30/2020.

**Web site të konsultuara**

https://www.osfa.al/sites/default/files/monitorimi-i-zbatimit-te-reformes-ne-drejtesi-4.pdf aksesuar më datë 09.09.2021

http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/12/PLANI-STRATEGJIK-I-KOMUNIKIMIT-P%C3%8BR-SISTEMIN-GJYQ%C3%8BSOR.pdf. faqe 19. Aksesuar më datë 09.09.2021.

https://www.osfa.al/sites/default/files/monitorimi-i-zbatimit-te-reformes-ne-drejtesi-4.pdf aksesuar më datë 09.09.2021 Faqe 37
http://www.apbonline.com/cjsystem/justi-ceneës/2000/06/02/dëgjimi0602_01.html/ aksesuar më 21.09.2021
http://lawtechneës.com/december00/litigation_support_p133.html 09,09, aksesuar me datë 09.092021
https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=003-5599389-7074064&filename=Judgments%20of%2017.01.17.pdf aksesuar më datë 10.09.2021
https://rm.coe.int/regional-online-round-table-report-f-albanian/16809f2393 aksesuar më 21.09.2021
www.qbz.gov.al më datë 10.09.2021

# Përdorimi i E-banking Para dhe Gjatë Pandemisë Covid 19 në Sektorin Bankar të Kosovës

**Bujar Statovci PhD c.**
[1]Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik

**ABSTRACT**
The purpose of this research is to analyze the usage of e-banking before and during the pandemic-Covid 19 in the banking sector of Kosovo. The methodology used in this research is the paried samples test and paired samples correlation model. To measure the usage of e-banking, two variables were used where one variable was used in relation to the usage of e-banking before the pandemic-Covid 19 and the other variable for the usage of e-banking after the pandemic. The research is based on the banking sector of Kosovo and was conducted using secondary data from the Central Bank of Kosovo for the period May 2018 to February 2020 for the first variable and March 2020 to December 2021 for the second variable with monthly frequency. The results of the research based on the paired sample test model with significance 0.0% approve the hypothesis that there are average differences in the usage of e-banking before and during the Covid pandemic. The research results show that the usage of e-banking after the pandemic has a significant positive impact. This study will contribute to the interconnection of new studies related to this field of research.

**Keywords: E-Banking; Covid 19; Paired Samples Test.**

**ABSTRAKTI**
Qëllimi i këtij hulutmimi është të analizoj shfrytëzimin e e-banking para dhe gjatë pandemisë Covid 19 në sektorin bankar të Kosovës. Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim është modeli paried samples test dhe paired samples correlation. Për matjen e shfrytëzueshmërisë së e-banking janë perdorur dy variabla ku njëra variabël është perdorur lidhur me shfrytëzimin e e-banking para pandemisë Covid 19 dhe variabla tjetër për shfrytëzimin e e-banking gjatë pandemisë. Hulumtimi është bazuar në sektorin bankar të Kosovës dhe është realizuar duke shfrytëzuar të dhëna sekondare nga Banka Qëndrore e Kosovës për periudhën Maj 2018 deri më Shkurt 2020 për variablën e parë dhe Mars 2020 deri më dhjetor 2021 për variablën e dyte me frekuncë mujore. Rezultatet e hulumtimit bazuar në modelin paired sample test me significance 0.0% aprovojnë hipotezën se ekzistojnë dallime mesatare në shfrytëzimin e e-banking para dhe gjatë pandemisë Covid 19. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shfrytëzimi i e-banking gjatë pandemisë ka ndikim pozitiv signifikant. Ky studim do të kontribuojë në ndërlidhjen e studimeve të reja lidhur me këtë fushë të hulumtimit.

**Fjalët kyçe: E-Banking; Covid 19; Paired Samples Test.**

Hyrje

E-banking është shërbim që ofron qasje në llogarinë bankare të klientit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. E-banking kursen kohen dhe koston për klientët të cilët zgjedhim ta shfrytëzojnë në raport me vizitën fizikisht të degës. Shfrytëzimi i shërbimit E-banking është I lehtë ku vetëm përmes qasjes në interen mundësohen kryerjet e transaksioneve të ndryshme. Përmes ketij shërbimi klientët mund të realziojnë shërbime të ndryshme, si: pagesa Brenda bankes, pagesa kombëtare dhe ndërkombëtare, pagesa të faturave, pagesa të pagave, kontrollimi I lëvizjeve në llogari dhe shumë shëribime tjera. Pandemia Covid 19 ka ndikuar që klientët të shfrytëzojnë më shumë platformën e-banking meqenëse të gjitha këto shërbime klientët mund t'i realiozjnë përmes platformës e-banking pa pasur nevojë që të vizitojnë degët fizikisht.

Sipas Yousif Alansari et.al 2020, duke aplikuar qeverisjen e teknologjisë informative, bankat dhe institucionet e tjera financiare mund të arrijnë misionin dhe objektivat e tyre në mënyrë efektive. Si të tilla, Institucionet Financiare duhet të sigurojnë që sistemet e teknologjisë informative dhe strategjitë e biznesit janë në përputhje të vazhdueshme. Tutje Yousif Alansari et.al 2000 vazhdon duke theksuar se përparimet e fundit në teknologji kanë revolucionarizuar proceset dhe metodat konvencionale bankare. Për shembull, duke qenë se shërbimet bankare janë të disponueshme 24/7, orët e punës si dhe degët fizike nuk konsiderohen më të rëndësishme. Yousif Alansari et.al (2000), ndër të tjera thekson se shërbimet që i atribuohen drejtpërdrejt përdorimit të teknologjisë informative në kontekstet bankare përfshijnë bankingun online, bankingun celular dhe bankingun në internet.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të testojmë hipotezën se a ekzisojnë dallime në shfrytëzimin e E-banking para dhe pas/gjatë [119]pandemisë Covid 19.

Rishikimi i Literaturës

Sipas Al-Sartavi, |(2020c) përdorimi i kompjuterëve në përpunimin, renditjen, klasifikimin e të dhënave përmes harduerit, softuerit, rrjeteve, internetit ose kapitalit intelektual konsiderohet si teknologji informative. Yousif Alansari et.al (2000), ndër të tjera thekson se shërbimet që i atribuohen drejtpërdrejt përdorimit të teknologjisë informative në kontekstet bankare përfshijnë bankingun online, bankingun celular dhe bankingun në internet. Përmirësimet dhe përmirësimet më të fundit të bëra në sektorin bankar i atribuohen Teknologjisë së Informacionit pasi ajo luan një rol të madh në reduktimin e kohës së nevojshme për çdo transaksion dhe rritjen e besimit në sistemet financiare, proceset, transaksionet e bankave (Al-Sartawi, 2018a).

Teknologjia e internetit ka ndryshuar procedurat e transaksioneve financiare duke i lejuar klientët të kryejnë vetë operacionet bankare, pa pasur nevojë të vizitojnë zyrën fizike të degës (Khatoon et al., 2020). Ndër të tjera Kimiagari & Baei, (2021) theksojnë se përfitimet kryesore të bankingut online janë: ruajnë dhe rrisin besnikërinë e klientëve të tyre, u ofrojnë bankave mundësinë për të rritur pjesmarrjen në treg, për të rritur kënaqësinë e klientëve, për të ulur koston operacionale dhe administrative dhe për të rritur konkurueshmërinë në treg.

Objektivi i Studimit dhe Hipotezat

Objektivi i hulumtimit është të testoj hipotezën se a ekzisojnë dallime në shfrytëzimin e E-banking para dhe pas pandemisë Covid 19 në sektorin bankar të Kosovës.

Hipoteza e cila do të testohet është:
H1: Ekzistojnë dallime mesatare në shfrytëzimin e E-banking para dhe pas pandemisë Covid 19.

[119] Pas/gjatë pandemisë Covid 19 përfshinë periudhën nga fillimi i Pandemisë Covid 19 në Kosovë, Mars 2020 deri më dhjetor 2021 (deri në periudhën kur janë analizuar të dhënat/obzervimet).

Metodologjia e Hulumtimit dhe Rezultatet

Për realizimin e këtij hulumtimi janë shfrytëzuar të dhëna sekondare nga Banka Qendrore e Kosovës për periudhën Maj 2018 deri më Shkurt 2020 për variablën e parë shfrytezimi i E-banking para Covid 19 dhe Mars 2020 deri më dhjetor 2021 për variablën e dyte shfrytëzimi i E-banking pas Covid 19 me frekuncë mujore. Testimi i hipotezës do të bëhet duke perdorur modelin Paired Samples Test dhe Paired Samples Correlations. Programi i perdorur është SPSS v.25.

Rezultatet e dy variablave në tabelën 1, "Shfrytëzimi i E-Banking para Covid 19" dhe "Shfrytëzimi i E-Banking pas Covid 19" tregojnë se mesatarja e variables së pare Shfrytëzimi i E-Banking para Covid 19 është M=836.18, ndërsa për variablën e dytë Shfrytëzimi i E-Banking pas Covid 19 mesatarja është M=1081.05, që tregon se e-banking ka pasur një shfrytëzueshmëri më të madhe pas pandemisë Covid 19.

***Tabela 1. Paired Samples Statistics***

| **Paired Samples Statistics** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Mean | N | Std. Deviation | Std. Error Mean |
| Pair 1 | Shfrytëzimi i E-banking Para Covid 19 | 836.18 | 22 | 135.314 | 28.849 |
| | Shfrytëzimi i E-banking Pas Covid 19 | 1081.05 | 22 | 267.414 | 57.013 |

*Burimi: Autori/SPSS v.25*

Korrelacioni ndërmjet variablave në tabelën 2 është C= 0.186, e cila tregon një lidhje të dobët positive në mes të variablave.

***Tabela 2. Paired Samples Correlations***

| **Paired Samples Correlations** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | N | Correlation | Sig. |
| Pair 1 | Shfrytëzimi i E-banking Para Covid 19 & Shfrytëzimi i E-banking Pas Covid 19 | 22 | .186 | .408 |

*Burimi: Autori/SPSS v.25*

Në bazë të rezultateve të Paired Sample Test, me nivel të signifikancës prej 0.000% aprovohet hipoteza bazë *ekzistojnë dallime mesatare në shfrytëzimin e E-banking para dhe pas pandemisë Covid 19.*

***Tabela 3. Paired Samples Test***

| **Paired Samples Test** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Paired Differences | | | | | | | |
| | | | | 95% Confidence Interval of the Difference | | | | |
| | Mean | Std. Deviation | Std. Error Mean | Lower | Upper | t | df | Sig. (2-tailed) |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pair 1 | Shfrytëzimi i E-banking Para Covid 19 & Shfrytëzimi i E-banking Pas Covid 19 | -244.864 | 276.393 | 58.927 | -367.409 | -122.318 | -4.155 | 21 | .000 |

*Burimi: Autori/SPSS v.25*

Konkluzionet

Pas testimit të hipotezës me nivel të signifikancës 0.000% konkludojmë se ekzistojnë dallime mesatare në shfrytëzimin e E-banking para dhe pas pandemisë Covid 19. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shfrytëzimi i e-banking pas pandemisë ka ndikim pozitiv signifikant. Sa i përket analizës së korrelacionit për ndërlidhjen e variablave konkludojmë se variablat kanë një lidhje të dobët pozitive.

Referencat


Al-Sartawi A. *Corporate Governance and Intellectual Capital: Evidence from Gulf Cooperation Council Countries.* Academy of Accounting and Financial Studies Journal. 2018c; 22(1):1-12.

Al-Sartawi A. *Ownership structure and intellectual capital: evidence from the GCC countries.* International Journal of Learning and Intellectual Capital. 2018a; 15(3):277-291.

Banka Qëndrore e Kosovës (2022). Buletini Mujor Statistikor 244

Yousif Alansaria and Abdalmuttaleb M. A. Musleh Al-Sartawi (2020). *IT governance and E-banking in GCC listed banks. Elseiver. Procedia Computer Science 183 (2021) 844–848*

Khatoon, S., Zhengliang, X., & Hussain, H. (2020). *The Mediating Effect of customer satisfaction on the relationship between Electronic banking service quality and customer Purchase intention: Evidence from the Qatar banking sector*. SAGE Open, 10(2).

Kimiagari, S., & Baei, F. (2021). *Promoting e-banking actual usage: mix of technology acceptance model and technology-organisation-environment framework*. Enterprise Information Systems, 1-57.

Qais Hammouri1, Tha'er Majali, Dmaithan Almajali, Abdalrazzaq Aloqool, Jassim Ahmad Al-Gasawneh (2021). *Explore the Relationship between Security Mechanisms and Trust in E-Banking: A Systematic Review.* Annals of R.S.C.B., ISSN:1583-6258, Vol. 25, Issue 6, 2021, Pages. 17083-17093

# Manipulimi fiskal, sjellja e bizneseve krahas kësaj dukurie

**MSc. Adela Xhaferri**
xhaferri.adela@outlook.com
*(Financë Kontabilitet, Fakulteti i Biznesit, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës)*

**ABSTRAKT**

Në ditët e sotme sistemi tatimor në Republikën e Shqipërisë ka pësuar ndryshime dhe përshtatje të mëdha. Një ndër sfidat e hasura më shpesh në tregun tonë është përballja çdo ditë me manipulimin dhe mashtrimin fiskal. Nga një kontroll i thjeshtë shumë shoqëri paraqesin parregullsi si nga ana e dokumentacionit ashtu dhe e deklarimit.

Sistemi jonë tatimor i bazuar në vetëdeklarim ka përparësitë dhe mangësitë e tij. Një nga mangësitë është mundësia që ky sistem ofron për manipulim informacionesh kontabël. Paraqitjet jo të sakta të këtyre të dhënave, japin një situatë të paqartë rreth shoqërisë dhe lexuesit e informacionit janë konfuzë.

Në këtë punim trajtohet vendi ynë në krahasim me shtetet fqinje për sa i përket masave dhe vendimeve të marra për të përmirësuar situatën. Si kanë reaguar bizneset krahas këtyre ndryshimeve dhe a janë përshtatur siç duhet dhe kanë vepruar drejt.

Përveç informacioneve zyrtare të marra nga website qeveritare dhe dokumentat e ngarkuara në to, në punim përfshihen këndvështrimi im si qytetare, taksapaguese, dhe ekonomiste e ardhshme.

Ky këndvështrim më bën ta shoh situatën në një tjetër aspekt, duke parë më me detaje ndodhitë ekonomike dhe fiskale. Gjithashtu avantazhi i të punuarit në një zyrë kontabël më bën të kem një gjykim më korrekt dhe metodologji të punimit më të saktë.

*Fjalë kyçe*: manipulimi fiskal, efiçienca, tatimpaguesit, kontrolli i bizneseve, masat

## HYRJE

Politika fiskale është një nga instrumentet kryesore të përdorura nga qeveritë për të nxitur ekonominë. Taksimi është një nga instrumentet më të rëndësishme të përdorur për të nxitur ecurinë e ekonomisë së vendit, si dhe për reduktimin e deficitit dhe borxhit të buxhetit. Efikasiteti i politikave fiskale, bazuar në tatimet dhe taksat, është i lidhur me nivelin e evazionit fiskal. Njohja e këtij niveli është një parakusht për ndërmarrjen e politikave të ndryshme fiskale dhe për administrim më të mirë të taksave në shërbim të të mirave dhe shërbimeve publike.

Për vendet në zhvillim, ku bën pjesë edhe Shqipëria, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një nga taksat kryesore që kontribuon me rreth 35 % të të ardhurave të përgjithshme tatimore në vend. Në mungesë të një analize gjithëpërfshirëse midis TVSH-së së mbledhur dhe asaj që duhej të ishte paguar, diferenca ndërmjet tyre mund të konsiderohet si evazion i TVSH-së ose i njohur si hendeku i TVSH-së. Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë ndikimin e hendekut të TVSH-së për të treguar efikasitetin e disa prej ndryshimeve kryesore në sistem.

Bizneset kanë tendencë të përdorin çdo metodë të mundshme për të maksimizuar fitimin e tyre. Shume zgjedhin manipulimin fiskal, ku duke gjetur hapsira në ligjin fiskal mundohen të fshehin detyrimin e TVSH-së dhe fitimin. Manovrime të tilla dëmtojnë shtetin dhe investitorët. Shteti e ka të pamundur të mbledhë tatimet dhe taksat që janë burimi kryesor i të ardhuarave për buxhetin, ndërsa investitorët marrin një paraqitje të gabuar të gënjeshtërt rreth performancës së bizneseve.

Prandaj është e rëndësishme që të tilla manipulime të kontrollohen dhe me anë të ndryshimeve fiskale të parandalohen në të ardhmen.

## ANALIZIMI

### KREU 1 – MASHTRIMI FISKAL

Ndërkohë që lufta kundra borxhit publik duket që tashmë është një prioritet për qeveritë, ato gjithnjë e më qartë po kuptojnë se lufta kundra mashtrimit fiskal i lejon të nxjerrin fitime që nuk mund t'i neglizhojnë. Nëpërmjet cilave kanale dhe cilët janë vëndet e origjinës (të ligjshme apo jo) të kapitaleve që ato strehojnë (parajsat e famshme fiskale)? Evazioni tatimor nuk eshte problem i ri e megjithate vitet e fundit evazioni tatimor ka terhequr vemendje te vecante, mjaft te madhe te publikut.
Mashtrimi tatimor është jashtë mase i vështirë për tu matur. Shërbimi i të hyrave të brendshme ka llogaritur se tatimpaguesit paguajnë në mënyrë vullnetare vetëm 80% të detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e tyre aktuale. Nëse ky vlerësim do të bëhej edhe më i saktë, ai sugjeron se evazioni është shumë i rëndësishëm. Njerëzit bëjnë mashtrime tatimore më lloj-lloj mënyrash:
mbajnë dy libra regjistrimi të transaksioneve të biznesit. Njëri regjistron biznesin e vërtetë dhe tjetri i paraqitet organeve tatimore. Disa evazues përdorin dy regjistra arke.
bëjnë nje punë të dytë kundrejt të ardhurave me para në dorë. Sigurisht të bësh një punë shtesë është plotësisht e ligjshme, megjithatë e ardhura e marrë nga një punë e tillë shpesh paguhet me para në dorë dhe jo me llogari bankare. Kështu që nuk ekziston asnjë regjistrim ligjor i të ardhurave, nuk u raportohen organeve tatimore.
këmbimi mall me mall: unë do të rregulloj televizorin nëse t'i do më rregullosh kompjuterin. Kur e merrni pagesën në natyrë, në vend të parave, ky është një transaksion i tatueshëm. Por këto të ardhura rrallë raportohen
veprimet me para në dorë. Duke paguar për të mirat dhe shërbimet me para në dorë është e pa raportuar, për këtë qëllim është shumë e vështirë për Shërbimin e të Hyrave të Brendshme për të rënë në gjurmë të transaksioneve.

**Arsyet që mashtrimi fiskal është kaq i përhapur**

Ka shumë arsye që shpjegojnë intensitetin e mashtrimit fiskal, i cili përfaqëson qindra-miliarda euro humbje të mirëfillta për shtetet në botë. ***E para*** dhe më e rëndësishmja, vjen nga kërkimi maksimal i rentabiltetit të ndërmarrjeve, kryesisht të shoqërive të mëdha, të cilat nga dëshira e arritjes së "optimizimit fiskal", i shmangin ligjet apo i përdorin ato në mënyrë abuzive.
***Problemi tjetër*** i përsëritur shtrohet më tepër në terma sociale se sa fiskale, është puna në të zezë, e cila lejon të ulet në mënyrë drastike kostoja e punës dhe përveç kësaj, të ofrojë një formë origjinale të fleksibilitetit të punës. Punëtori klandestin shfrytëzohet pa mëshirë, pa orare fikse, as limit kohe pune, as dhe shpërblim nëse largohet nga puna.
***Në fund***, shpjegimi kryesor buron nga kriza ekonomike e cila i shtyn shtetet në kërkim të futjes së parave në arkë dhe të rrisin taksat dhe për rrjedhojë, të zhvillojnë në mënyrë të pavullnetshme tendencat për shmangie të atyre që vlerësojnë se paguajnë shumë.
Të luftosh këtë mashtrim është efektivisht komplekse dhe punë e vështirë, sepse makinacionet nganjëherë janë inteligjente dhe të zbulueshme me vështirësi. Pastaj duhet thënë se mashtrimi fiskal është kryesisht ndërkombëtar, shumat e shmangura me shpejtësi nxirren jashtë vendit nëpërmjet shoqërive fiktive dhe llogarive të vendosura në parajsa bankare. Dhe në fund, se mjetet e përdorura për ta luftuar atë janë të pamjaftueshme, ose më mirë, të keq-shfrytëzuara.
Përpjekjet në fakt janë përqëndruar në gjuetinë e mashtrimeve të vogla të punonjësve, se sa në mashtrimet e konsiderueshme të shoqërive shumëkombëshe. Mashtrime të tilla janë në fakt më të thjeshta për t'u identifikuar dhe është në mënyrë statistike më interesante për inspektorët fiskalë, sepse numri i rregullimeve të bëra do të jetë shumë më me pasoja. Do të duhet pra që të mendojmë sërisht alokimin e mjeteve njerëzore.

**Ndër sektorët ku është më i prekshëm manipulimi fiskal**

Një nga sektorët ku është më i prekshëm moszbatimi i legjislacionit është ai i ndërtimit dhe prodhimit të materialeve të ndërtimit. Ky sektor vlerësohet si:
Një aktivitet që ushtrohet kudo pa kufizime gjeografike.
Një aktivitet fitimprurës në kushtet e sotme të ekonomisë së tregut dhe që ka premisa për evazion fiskal në lidhje me deklarime fiktive të të ardhurave për punë si dhe mos derdhjeve të kontributeve.
Një nga sektoret me rrezikshmëri më të lartë në lidhje me aksidentet në punë.
Vëmendja kryesisht është përqëndruar në :
Kontrollin e subjekteve të licensuara dhe evidentimin e aktiviteteve ilegale në ndërtim dhe prodhim të materialeve të ndërtimit.

Evidentimin e masave të marra në drejtim të zbatimit të legjislacionit të punës për mbrojtjen dhe sigurinë në punë si dhe mbrojtjen shoqërore.
Kontrollin mbi tregun e punës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore sipas rretheve dhe këtyre aktiviteteve të rëndësishme në ekonominë e vendit.
Sektori i ndërtimit dhe i prodhimit të materialeve të ndërtimit si një nga sektoret më të rëndësishëm të ekonomisë dhe të prodhimit kombëtar luan një rol të rëndësishëm në rritjen e të ardhurave për frymë të popullsisë, pasi në të është angazhuar një pjesë e rëndësishme e forcës aktive për punë dhe prandaj edhe prioriteti i punës jo vetëm gjatë vitit por edhe në aksione kombëtare ku angazhohen një numër i madh punonjësish.
Megjithëse vihet re një numër i lartë sipërmarrjesh të vogla në ndërtim, të cilat e vështirësojnë kontrollin e këtij tregu pune duke patur parasysh se organizimi sindikal në këtë sektor është relativisht në gjendje të dobët.
**Çfarë rregullore duhet të zbatojmë për të luftuar kundra mashtrimit fiskal?**

***Masa e parë*** dhe më urgjente që duhet vënë në vend, konsiston në ripërcaktimin e rregullores për çmimet e transfertave në gjirin e shoqërive të mëdha. Këto mund të përcaktojnë si çmimet e transaksioneve midis shoqërive të të njëjtit grup, dhe rezident në shtete të ndryshme.
Shkëmbimi automatik i informacioneve për qëllime fiskale midis vendeve përbën masën e ***dytë kryesore***. Ajo është duke u vënë në vend, por do të jetë efikase vetëm nëse administratat kombëtare do të luajnë lojën, me një reciprocitet total. Kjo nuk ndodh për momentin. Do të duhet krahas kësaj të parashikohen dhe sanksione kundra vendeve që refuzojnë të bashkëpunojnë. Po kaq i rëndësishëm është dhe modernizimi i sistemit të ndjekjes dhe të kontrollit të flukseve (blerje-shitje, pagat etj).
Harmonizimi fiskal në Evropë do të mund të lejojë të shpejtohet ky proces. Mashtrimi me "TVSH të rrumbullakosur" – i cili konsiston në rimbursimin pa të drejtë të TVSH në transaksionet virtuale ndërmjet vendeve – i konsideruar si mashtrimi më i rëndësishëm në Evropë do të mund të eliminohet me shpejtësi duke ndryshuar rregullat që lidhen me TVSH ndërmjet vendeve.

**KREU 2 - EKONOMIA E FSHEHUR DHE SHMANGIA E TAKSAVE NË SHQIPËRI , MAQEDONI DHE KOSOVË**

Praktikat e ekonomisë së fshehur nuk janë gjithmonë, siç sugjeron emri, aktivitete të profilit të ulët në ekonomi. Rrjedhja e të dhënave nga "Panama Papers" ka nxjerrë në pah një matricë të evazionit të taksave të nivelit të lartë, që ka fshehur një shumë të konsiderueshme të ardhurash drejt vendeve të Bashkimit Europian dhe ka privuar kryerjen e shumë shërbimeve publike, të cilat duhet t'i ofronin qeveritë. Është e qartë, që ka më shumë nevojë për një transparencë ndërkufitare dhe ndërveprim ndërkombëtar në mënyrë që të merremi me këtë problem, teksa ekonomia e fshehur dhe praktikat e evazionit fiskal janë një dukuri globale, pavarësisht se kanë karakter lokal.
Gjithsesi, duke pasur parasysh që disa shtete të BE-së (Irlanda, Luksemburgu) që njihen si parajsa fiskale, janë të orientuara nga vetë-interesi, një lëvizje e menjëhershme në sistemin e taksave të BE-së do të krijonte probleme. Sipas të dhënave të vitit 2019, të raportuara nga Reuters, Bashkimi Europian humb çdo vit rreth 1 trilion euro në të ardhura publike, për shkak të evazionit dhe mashtrimit. Duke marrë në konsideratë që Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i Bashkimit Europian ishte rreth 12.7 trilionë dollarë në 2019-n, evazioni i taksave dhe mashtrimi përfaqësonin rreth 7.9% të PBB-së vjetore. Nëse këtë përqindje e përdorim për të vlerësuar evazionin në vendet jo anëtare të BE-së, ndonëse mund të jetë e nënvlerësuar, sërish është e dobishme për shkallën dhe kontrastin që ajo jep.

**Vendet fqinje dhe Shqipëria**

Moslëshimi i kuponit tatimor dhe evazioni tatimor në Maqedoni janë dy arsyet kryesore që kanë ndikuar në gjetjen e parregullsive nga organet tatimore.
Përqindja më e lartë e shërbimeve të pataksuara është në Kosovë (74%), e dyta në Shqipëri (65%) dhe e treta në Maqedoni (54%).
Përqindja e të anketuarve që pohojnë se nuk kanë marrë një faturë/kupon tatimor pasi kanë blerë një produkt të caktuar në Kosovë është 57.1%, Shqipëri 43%, dhe më e ulëta me 11.8% të të anketuarve në Maqedoni.
Të ardhurat buxhetore në Maqedoni janë 29% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) , dhe në Shqipëri e Kosovë nga 27%. Ato janë shumë më të ulëta se mesatarja e BE-së prej 45% të PBB-së.

Mos lëshimi i kuponit tatimor për mallrat e akcizës, alkool dhe cigare pothuajse është dyfishuar në Maqedoni në 20%. Kjo përqindje është më e përkeqësuar në Shqipëri (52%) dhe është sa dyfishi i buxhetit të saj vjetor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Shqipëria humb potencialisht rreth 810 milionë euro në vit, ose 6 herë më shumë se buxheti i saj i mbrojtjes. Kosova humb më shumë se 470 milionë euro në vit, që është e barabartë me më shumë se 7 herë buxhetin vjetor të Forcave të Sigurisë së Kosovës.

Përpjekja e Qeverisë Shqiptare në krijimin dhe zbatimin e një kuadri të plotë ligjor në respekt të funksionimit të sistemeve tatimore dhe luftës kundër evazionit fiskal është një detyrë e përbashkët e të gjitha institucioneve ligjzbatuese në Republikën e Shqipëri, por jo vetëm.

Për të arritur këtë objektiv, Qeveria Shqiptare prej kohësh ka rritur bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe prej vitit 2019 u miratua marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Organizatës Për Bashkëpunim Dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), kjo për **aderimin** e Republikës së Shqipërisë në **kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit** (BEPS)".

Përmes miratimit të kësaj marrëveshjeje Qeveria Shqiptare siguroi një **instrument** për të adresuar **shmangien e taksave** dhe për të siguruar që **fitimet të tatohen** aty ku **kryhen aktivitetet ekonomike** që gjenerojnë fitimet dhe aty ku krijohet vlera.

Përpara një viti është diskutuar dhe më pas aprovuar në parlament edhe Ligjin për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, i cili e ka bërë të zbatueshëm dhe detyrues prej Janarit të këtij viti realizimin për shkëmbimin automatik të informacionit në kohë reale me disa administrata tatimore në shumë vende të botës.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e saj si politikbërëse dhe përmes institucioneve të varësisë, mbetet totalisht e angazhuar në përmirësimin tërësor të luftës kundër evazionit fiskal, por njëkohësisht të luftës kundër parandalimit dhe pastrimit të parave.

Qeveria Shqiptare zbaton aktualisht 41 Marrëveshje të ratifikuara nga Kuvendi **"Për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e Evazionit Fiskal".**

**Projektligj "Për Ratifikimin e Protokollit Ndryshues të Marrëveshjes, mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, vjen në parlament pas mbledhjes të dy qeverive, Shqipëri-Kosovë dhe ndryshimet konsistojnë:**

Në zgjidhjen e vështirësive të zbatimit në praktikë të parashikimeve të lidhura me Dividentët duke saktësuar se: të drejtën e taksimit e ka edhe vendi i burimit të të ardhurës.

Së bashku me Kosovën synohet plotësimi i standardeve minimale ndërkombëtare në kuadër dhe të projektit ndërkombëtar BEPS të sipërpërmendur.

Evazioni është një sjellje, e cila është në kontrast me rregullat e vendosura më parë nga klauzolat specifike fiskale, ku parashikohen edhe dënime administrative e penale. Ai është një shkelje e ligjit, pasi mund të përkufizohet si mos pagim i tatimeve të paracaktuara. Shmangia nuk është kundra ligjeve. Ajo konsiston në aktivitetin e një personeli, që është realizuar në rrugë legale, me synim shmangien që më parë të krijimit të bazës së tatueshme, pra uljen e detyrimit tatimor.

**KONKLUZIONE**

*Përfundime dhe Rekomandime*

Evazioni fiskal është një problem serioz, jo vetëm për vëndet me zhvillim ekonomik ende në tranzicion, por edhe në vendet që kanë një sistem fiskal të zhvilluar.

Shkaqet e evazionit fiskal janë sigurisht komplekse dhe vështirë të zbulohen. Në fakt, po të kuptoheshin totalisht shkaqet e evazionit, do të krijohej një pamje optimiste duke çuar në eliminimin apo reduktimin e tij në përmasa më pak alarmante. Prandaj që të qartësohen arsyet që të çojnë në evazion, u referohemi Administratave Financiare dhe Policisë Tatimore. Si shkaqe mund të përmendim: .

*1. Struktura organizative dhe funksionale* - është i rëndësishëm rekrutimi i personelit për inspektim dhe vlererësim tatimor. Këto aktivitete mund të përmirësohen duke u rritur sasia dhe cilësia e tyre.

*2. Sistemi legjislativ* – paqëndrueshmeria në vendosjen e ligjeve çon në një kaos të vazhdueshëm të klauzolave administrative, përveç krijimit të problemeve serioze për modernizimin profesional të operatoreve në këte fushë.

*3. Gjëndja e padive tatimore* - edhe në rastin kur të gjitha nivelet e mundshme proceduese kanë përfunduar, duhen

mesatarisht 10 vjet që të merret vendimi ligjor.
*4. Kuadri ligjor ndërkombëtar* - kuadri ligjor ndërkombëtar i tanishëm veçanërisht ai i Komunitetit Ekonomik Europian, na detyron të verifikojmë ekzistencën e diferencave të konsiderueshme në barrën tatimore.
*5. Barra tatimore* – ka opinione të ndryshme në vendin tonë në lidhje me madhësinë e barrës tatimore. Ka nga ata që mendojnë se kjo barrë nuk është në nivele të larta dhe, nga ata që mendojnë se barra tatimore është e papërballueshme, duke patur parasysh nivelin aktual të zhvillimit të Shqipërisë.

***Pasojat e evazionit tatimor***

Evazioni tatimor në çfarëdo forme qoftë, i lejueshëm apo i palejueshëm, shkakton vështirësi në financimin e të dalave të planifikuara.
Parimi kryesor i mbledhjes së tatimeve dhe taksave, të detyrimeve tatimore në përgjithësi është se ato mblidhen për interes publik. Pra një mungesë në të hyrat publike do të thotë me pak investime në infrastrukture, me pak invetime në arsim, kulture, shkence, në rend, qetësi publike etj, një pakësim të të mirave publike, në pëgjithësi në disfavor të shoqërisë.
Përsa i përket luftës së evazionit tatimor, është e rëndësishme të saktësohet se evazioni tatimor varet nga dy faktorë:




Ministria e Financave ka padyshim një detyre jo të lehtë për zbatimin e kufijve të prerë të thjeshtësimit të sistemit tatimor. Ndërkaq, kushdo që pretendon të punojë për shtetin i del detyra të paraqitet të përcaktoje strategjitë, rrugëdaljet e mundshme dhe kufijtë e dallimeve, deri ku mund të operojemë me dobi qeveria, të cilës Parlamenti i ka vënë detyrë primare të luftës ndaj evazionit fiskal.

**REFERENCA**

**1-** Jerry W. Markham (2014) Law Enforcement and the History of Financial Market Manipulation
*(Historiku dhe analiza e manipulimeve financiare)*
**2-** *George A. Akerlof and Robert J. Shiller, (2015)* Phishing for Phools: *The Economics of Manipulation and Deception*
*( Roli qe ka manipulimi financiar ne fushat e tjera )*
**3-** World Bank (2014). World Development Report 2015: Mind, Society and Behavior, Washington, D.C: World Bank.
*( Studime e artikuj lidhur me Vlerësimi i gjendjes dhe ndjeshmërive të Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në përballjen e tyre me Mashtrimin Financiar)*
**4-** INSTAT
*( Statistika lidhur me paraqitjen e bizneseve krahas parregullsive fiskale )*
**5-** Ministria e Financave dhe Ekonomisë
*(Referuar rreth masave të marra nga qeveria shqiptare lidhur me shmangien e manipulimit fiskal)*
**6-** Reuters
*( Referuar gjendjes së përgjithshme të mashtrimit fiskal )*
**7-** Albania Investment Council
*( Gjetjet kryesore të Anketës lidhur me Evazionin Fiskal )*
**8** – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
*( Referuar ligjeve tatimore dhe doganore)*

[i] https://sq.wikipedia.org/wiki/Pandemi

[ii] https://www.dw.com › obsh-e-klasifi

[iii] Qeveria e Kosovës, raport 2020

[iv] rks-gov.net

[v] https://kk.rks-gov.net/gjilan/qyteti/pozita-gjeografike

[vi] Kuvendi I Kosovës, Ligjit  për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi tjera Nr.2006/02/L-68

[vii] IKSHPK-ja, raporti 2020

[viii] IKSHPK,  Rajonale e Shëndetësisë Publike - Gjilan, raporti 2020

[ix] Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna Drenas, raporti 2020

[x] http://www.wikiwand.com/sq/Fush%C3%AB_Kosova

[xi] QKMF, Komuna e Fushe Kosovës, raporti 2020

[xii] https://sq.wikipedia.org/wiki/COVID-19